

# ENVER HOXHA

VEPRA

65




**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDEM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANE KQ TE PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**VELLIMI**

**65**

**PRILL 1978**

**SHITËPIA BOTUESE «3 NËNTORI»  
TIRANË, 1989**



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 65-TË

Vëllimi i 65-të përfshin librin «Imperializmi dhe revolucioni». Kjo vepër madhore u shkrua nga shoku Enver Hoxha në kushte të caktuara historike. Bota kapitaliste ishte mbërthyer nga një krizë e thellë dhe e gjithanshme, që kishte tronditur nga themelet të gjitha strukturat dhe superstrukturat e saj. Kontradiktat e rendit borgjez-revizionist ishin acaruar së tepërmi. Dy superfuqitë, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, po bëheshin gjithnjë e më të rrezikshëm për popujt. Në skenë kishte dalë një revizionizëm i ri — revizionizmi kinez. Çështja e revolucionit proletar dhe e çlirimit kombëtar të popujve nuk ishte vetëm një aspiratë e një perspektivë, por edhe një problem i shtruar për zgjidhje. Në rrethana të tilla, libri «Imperializmi dhe revolucioni» ishte një nevojë e kohës. Në këtë libër, duke u bazuar në mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit, udhëheqësi i dashur dhe i paharruar i Partisë e i popullit tonë trajton gjë-rësisht problemet e mëdha të epokës dhe hedh dritë të re në perspektivën e lëvizjes revolucionare botërore.

Libri «Imperializmi dhe revolucioni» zë një vend të veçantë në trashëgiminë ideoteorike të shokut Enver Hoxha. Ai përbën një kontribut të rëndësishëm

në thesarin e pashtershëm të marksizëm-leninizmit. Vlera e madhe e tij qëndron, ndër të tjera, në frymën dhe metodën dialektike krijuese me të cilën shtjellohen problemet e kohës, duke i parë ato në një plan të gjerë — me të kaluarën, të tashmen e të ardhmen e tyre. Në të u bëhet një analizë e thellë marksiste-leniniste veçorive të kapitalizmit dhe të imperializmit në kushtet e reja të gjendjes ndërkombëtare. Në faqet e tij mbrohet me vendosmëri marksizëm-leninizmi, sintetizohet përvoja historike e PPSH dhe nxirren mësimet jetike nga sukseset dhe dobësitë e lëvizjes revolucionare botërore, për të çuar gjithmonë përpara çështjen e madhe të revolucionit, të socializmit e të komunizmit.

Botimi i librit «Imperializmi dhe revolucioningjalli një jehonë të gjerë ndërkombëtare. Ai u prit me interes dhe entuziazëm në të gjitha kontinentet. Kjo vepër u bë objekt studimi, diskutimi e reflektimi nga të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë. Libri u botua në shumë vende dhe në mjaft gjuhë të botës. Për rëndësinë dhe brendinë e tij u shkrua nëpër faqet e shtypit botëror dhe u bënë vlerësime të larta nga shumë parti e grupe marksiste-leniniste, nga organizata e lëvizje revolucionare, nga personalitete politike, kulturore, diplomatë, gazetarë, publicistë e studentë të vendeve të ndryshme.

Periudha më se dhjetëvjeçare që ka kaluar qysh nga botimi i librit «Imperializmi dhe revolucion» flet për rëndësinë aktuale, teorike dhe praktike të tij. Zhvillimet dhe përvoja e këtyre viteve kanë vërtetuar plotësisht drejtësinë dhe thellësinë e analizave, të ideve

e të konkluzioneve që përmban ky libër, vlerën e pallogaritshme të tyre për fatet e revolucionit. Mësimet që rrjedhin prej tij, janë aktuale jo vetëm për sot, por edhe për të ardhmen. Ato ndriçojnë kurdoherë rrugën e fitores së proletariatit, perspektivën e revolucionit. Libri është një thirrje që u bëhet popujve për të luftuar kundër rrezikut që paraqesin imperializmi dhe reaksioni botëror, dy superfuqitë dhe revizionizmi i çdo ngjyre, një thirrje luftarake që u bëhet revolucionarëve të vërtetë, proletarëve dhe popujve, që të ngrihen në këmbë për botën e re, për botën socialiste, për të ardhmen e tyre.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



## PARATHËNIE PËR BOTIMIN E PARË TË LIBRIT «IMPERIALIZMI DHE REVOLUCIONI»

Që kur doli «Manifesti i Partisë Komuniste» i Marksit e i Engelsit më 1848 e deri më sot lufta midis marksizmit revolucionar e oportunizmit, si në fushën politike ashtu edhe në atë ideologjike, është përqendruar rreth një problemi: A është apo nuk është i nevojshëm revolucioni për transformimin e shoqërisë mbi baza socialiste, a ekzistojnë apo nuk ekzistojnë kushtet për ta kryer revolucionin, a mund të bëhet ai me rrugë paqësore apo është e domosdoshme dhuna revolucionare?

Borgjezia e oportunistët, me tërë teoritë e tyre, që numërohen me dhjetëra për të mos thënë me qindra, janë përpjekur e përpiqen të mohojnë të vërtetën e pakundërshtueshme, se kontradikta themelore e shoqërisë kapitaliste është ajo midis shfrytëzuesve e të shfrytëzuarve, të mohojnë vendin dhe rolin historik të klasës punëtore, të mohojnë edhe vetë luftën e klasave si faktori determinant i zhvillimit dhe i përparimit të shoqërisë njerëzore. Qëllimi i tyre ka qenë dhe është të çoroditin ideologjikisht proletariatin, të pengojnë revolucionin, të përjetësojnë shfrytëzimin kapitalist, të shkatërrojnë marksizëm-leninizmin, shkencën fitimtare të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit.

hodhi poshtë me vendosmëri tezat e pikëpamjet borgjezo-oportuniste mbi etapën e tanishme të procesit historik botëror, që mohojnë revolucionin e mbrojnë shfrytëzimin kapitalist, dhe theksoi me forcë se asnjë ndryshim në zhvillimin e kapitalizmit e të imperializmit nuk justifikon «shpikjet» dhe trillimet revizioniste. Kritika parimore dhe demaskimi i pandërprerë i teorie antirevolucionare e antikomuniste janë të domosdoshme për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të çuar përpara çështjen e revolucionit e të popujve, për të treguar se teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe e Stalinit qëndron kurdoherë e re, busull e sigurt drejt fitoreve të ardhshme.

Prill, 1978

## SHËNIM PËR BOTIMIN E DYTË

*Libri «Imperializmi dhe revolucioni» u botua për herë të parë në prill të vitit 1978 dhe u shpërnda në Parti.*

*Duke pasur parasysh dëshirat e komunistëve, pas njohjes me këtë libër, u dha për botim publik. Në të është përfshirë edhe ndonjë ngjarje që ka ndodhur gjatë periudhës pas botimit të parë.*

*Dhjetor, 1978.*





## **PJESA E PARË**

### **STRATEGJIA E IMPERIALIZMIT DHE E REVIZIONIZMIT MODERN**

Kongresi i 7-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke analizuar situatën e sotme ndërkombëtare dhe gjendjen në lëvizjen revolucionare botërore, vuri në dukje rreziqet që paraqesin për revolucionin dhe çlirimin e popujve imperializmi dhe revizionizmi modern, theksoi nevojën e një lufte të pamëshirshme kundër tyre dhe përkrahjen aktive që duhet t'i jepet lëvizjes marksiste-leniniste në botë.

Këto çështje kanë rëndësi të madhe për arsye se ndërtimi i socializmit, lufta për forcimin e diktaturës së proletariatit dhe për mbrojtjen e atdheut janë të pashkëputura nga gjendja ndërkombëtare dhe nga procesi i përgjithshëm i zhvillimit botëror.

Sot janë ngritur në këmbë dhe po luftojnë kundër marksizëm-leninizmit forca të mëdha përfaqësuese të errësirës, të skllavërimit, të shfrytëzimit të proletaria-  
tit dhe të popujve — imperializmi amerikan dhe agjenturat e tij, socialimperializmi sovjetik, socialimperia-

lizmi kinez, borgjezia e madhe dhe reaksioni. Kundër ideologjisë sonë revolucionare janë ngritur edhe rryma të tilla ideologjike si socialdemokracia, revizionizmi modern e shumë rryma të tjera kundërrevolucionare.

Në luftën tonë kundër gjithë këtyre armiqve ne duhet të mbështetemi fort në teorinë marksiste-leniniste dhe në proletariatin botëror. Lufta jonë në planin teorik do të realizohet me sukses kur t'u bëjmë një analizë të drejtë dialektike situatës ndërkombëtare, ngjarjeve që zhvillohen, objektivate dhe qëllimeve të të gjitha forcave shoqërore në lëvizje, që janë në kontradikta e në luftë me njëra-tjetrën. Analiza shkencore e situatës ndërkombëtare dhe qartësimi i strategjisë ndihmojnë në përcaktimin e taktikave të drejta të luftës revolucionare në rrethana të ndryshme, për të fituar beteja pas betejash. Kështu ka vepruar kurdoherë Partia jonë.

Socializmi është në luftë me kapitalizmin, proletariati botëror është në luftë të pamëshirshme dhe të vazhdueshme me borgjezinë kapitaliste, popujt e botës janë në luftë me shtypësit e tyre të jashtëm dhe të brendshëm. Proletariati botëror udhëhiqet në luftë nga ideologjia e vet marksiste-leniniste, që shpjegon domosdoshmërinë e kësaj lufte dhe mobilizon forcat në betejë. Kjo është arsyeja që kapitalizmi dhe imperiaлизmi kurdoherë kanë organizuar një luftë të ashpër kundër teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Karl Marksi ka zbuluar ligjet e zhvillimit shoqëror, të transformimeve revolucionare e të kalimit të

shoqërisë nga një rend më i ulët shoqëror në një rend më të lartë, ka analizuar mbi baza shkencore pronën private mbi mjetet e prodhimit, mënyrën e shpërndarjes kapitaliste, mbivlerën që grabit kapitalisti. Ai ka krijuar teorinë shkencore mbi klasat dhe luftën e klasave dhe ka përcaktuar rrugët e luftës së proletariatit për të përmbysur borgjezinë, për të shkatërruar sistemin kapitalist, për të vendosur diktaturën e proletaria- tit, për të ndërtuar shoqërinë socialiste.

Teoricienë të ndryshëm reaksionarë në të gjitha vendet e botës janë përpjekur me çdo mjet që ta denigrojnë teorinë e Marksit, t'i hedhin baltë, ta shtrembërojnë, ta luftojnë. Por kjo teori, që është një shkencë e vërtetë, ka mundur të zotërojë mendimin përparimtar njerëzor dhe të bëhet një armë e fuqishme e proletariatit dhe e popujve në luftë kundër armiqve të tyre.

Duke zbatuar teorinë marksiste dhe duke e zhvilluar atë më tej, Lenini u dha proletariatit dhe pararojës së tij, partisë marksiste-leniniste, një teori të pasur shkencore për kushtet e imperializmit dhe të revolucioneve proletare. Lenini e zhvilloi marksizmin jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Ai, duke zbatuar doktrinën e Karl Marksit, e udhëhoqi revolucionin bolshevik dhe e çoi atë në fitore. Veprën e Leninit e zhvilloi më tej Stalini.

Fitorja e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit u dha goditjen e parë dërrmuese imperializmit, gjithë sistemit kapitalist botëror. Ai shënoi fillimin e krizës së përgjithshme të kapitalizmit, e cila erdhi vazhdimisht duke u thelluar.

Me krijimin dhe konsolidimin e shtetit sovjetik u arrit një fitore kolosale që u tregoi proletariatit dhe popujve se armiku që kishin përpara, kapitalizmi e imperializmi, mund të mposhtej, të shkatërrohej. Prova e gjallë për këtë ishte Dashkimi Sovjetik.

Koalicioni imperialist e kapitalist botëror, i tërbuar nga humbja që i shkaktoi Revolucioni i Tetorit në Rusi, i përforcoi mjetet e luftës politike, ekonomike dhe ushtarake kundër shtetit të ri të proletarëve dhe kundër përhapjes në botë të ideologjisë marksiste-leniniste. Imperialistët, borgjezia reaksionare, socialdemokracia evropiane dhe botërore, tok me partitë e tjera të kapitalit, përgatitën luftën kundër Bashkimit Sovjetik. Ata, tok me hitlerianët, me fashistët italianë dhe japonezë, përgatitën edhe Luftën e Dytë Botërore.

Por në këtë luftë u vërtetua edhe më mirë vitaliteti i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit, që dolën ngadhënjimtarë.

Pas fitores mbi fashizmin bota pësoi ndryshime të mëdha në dobi të socializmit. Në Evropë e në Azi u ngritën shtete të reja socialiste. U krijua kampi socialist me Bashkimin Sovjetik në krye. Kjo përbënte një fitore të re të madhe të socializmit, të marksizëm-leninizmit dhe një humbje tjetër të madhe të kapitalizmit, të imperializmit.

Sistemi kapitalist doli nga Lufta e Dytë Botërore i tronditur thellë dhe me ekuilibër krejt të prishur. Gjermania, Japonia e Italia, si fuqi të mundura, dolën nga lufta me një ekonomi të shkatërruar. Ato humbën pozitë politike dhe ushtarake që zinin më parë. Shtete të tjera imperialiste, si Britania e Madhe dhe

Franca, pavarësisht se dolën fitimtare nga lufta, qenë dobësuar kaq shumë ekonomikisht dhe ushtarakisht, sa që roli i tyre, si fuqi të mëdha, kishte rënë përtokë.

Kriza e përgjithshme e kapitalizmit u thellua më tej me shembjen e sistemit kolonial. Si rezultat i kësaj shembjeje lindën një varg shtetesh të reja kombëtare, kurse në ato vende që ngelën akoma koloni ose gjysmëkoloni, u rrit lëvizja çlirimtare kundër zgjedhës imperialiste.

Këto ndryshime krijuan kushte më të përshtatshme për triumfin e socializmit në shkallë botërore. Mjaft shtete kapitaliste, për shkak të krizës së thellë ekonomike e politike dhe të rritjes së pakënaqësisë së masave, ndodheshin në prag të shpërthimeve revolucionare. Në këto situata tepër të rënda e kritike këtyre u erdhi në ndihmë imperializmi amerikan.

Ndryshe nga fuqitë e tjera imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën nga lufta më të forta. Ato jo vetëm nuk u dëmtuan, por grumbulluan pasuri kolosale dhe e rritën pa masë potencialin e vet ekonomik e ushtarak, bazën e tyre tekniko-shkencore. Ky imperializëm, i majmur nga gjaku i derdhur prej popujve, u bë lidërshipi i vetëm i gjithë botës kapitaliste.

Imperializmi amerikan mobilizoi të gjitha forcat reaksionare të botës kapitaliste, me qëllim që të shpëtonte rendin e vjetër kapitalist dhe të shtypte çdo lëvizje revolucionare e nacionalçlirimtare, që e rrezikonin atë, të shkatërronte kampin socialist dhe të rivendoste kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik e në vendet e demokracisë popullore, të vendoste hegjemoninë e tij kudo në botë.

Për të arritur objektivat e vet imperializmi amerikan me kapitalin botëror vunë në lëvizje makinën e tyre gjigante burokratiko-ushtarake shtetërore, potencialin e tyre të madh ekonomik, teknik e financiar, të gjitha forcat e tyre njerëzore. Imperializmi amerikan ndihmoi rimëkëmbjen politike, ekonomike e ushtarake të kapitalizmit evropian e japonez të dërrmuar dhe në vend të sistemit kolonial të shembur ngriti një sistem të ri shfrytëzimi e grabitjeje, neokolonializmin.

Imperializmi amerikan mobilizoi njetet e shumta të propagandës, filozofë, ekonomistë, sociologë, shkrimtarë e të tjerë, në fushatën e tërbuar që filloi kundër marksizëm-leninizmit, kundër komunizmit, kundër Bashkimit Sovjetik e kundër vendeve të tjera socialiste të Evropës e të Azisë.

Njëkohësisht imperializmi amerikan vuri në zbatim një politikë të hapët agresive. Ethet e luftës, të militarizimit dhe të antikomunizmit pushtuan të gjitha fushat e jetës, të ekonomisë, të politikës, të ideologjisë, të ushtrisë, të shkencës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për të mposhtur socializmin, për të shuar lëvizjet çlirimtare revolucionare, për të luftuar ndikimin e madh të teorisë marksiste-leniniste dhe për të vendosur hegjemoninë e vet në botë, imperializmi amerikan përdori dy rrugë.

Rruga e parë ishte ajo e agresionit dhe e ndërhyrjes së armatosur. Imperialistët amerikanë krijuan blloqe ushtarake agresive, si NATO, SEATO etj., vendosën një numër të madh forcash të armatosura në territoret e shumë vendeve të huaja, ndërtuan baza

ushtarake në të gjitha kontinentet, ngritën flota të fuqishme luftarake që i shpërndanë ndër dete e oqeanë. Për të shtypur e për të shuar revolucionin ata ndërhyjnë ushtarakisht në Greqi, në Kore, në Vietnam e gjetkë.

Rruga tjetër ishte ajo e agresionit ideologjik dhe e subversionit ndaj shteteve socialiste e partive komuniste e punëtorë, e përpjekjeve për degjencrimin borgjez të këtyre shteteve e të këtyre partive. Në këtë drejtim imperializmi amerikan dhe mbarë kapitali botëror vunë në përdorim mjete të fuqishme të propagandës e të diversionit ideologjik.

Por imperializmi amerikan me kapitalizmin botëror, që po rimëkëmbej pas luftime, kishin përballë një kundërshtar të fuqishëm, kampin socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, proletariatin botëror, popujt liridashës. Prandaj atyre u duhej t'i bënin mirë llogaritë me këtë forcë vigane, që udhëhiqej nga një politikë e drejtë dhe e qartë, nga një ideologji fitimtare që kishte pushtuar dhe po pushtonte gjithnjë e më shumë zemrat e mendjet e punëtorëve, të revolucionarëve, të elementëve përparimtarë.

Me gjithë përpjekjet që bënin imperializmi amerikan dhe reaksioni botëror për t'i shtypur e për t'i shkatërruar, lëvizja revolucionare e proletariatit dhe lufta çlirimtare e popujve rriteshin e forcoheshin. Bashkimi Sovjetik, nën udhëheqjen e Stalinit, shëroi shumë shpejt plagët e luftës dhe përparonte me ritme të larta në të gjitha fushat, në ekonomi, në shkencë, në teknikë etj. Në vendet e demokracisë popullore po konsolidoheshin pozitat e socializmit. Partitë komuniste

dhe lëvizja demokratike antiimperialiste po zgjeronin influencën e tyre në masat.

Në këto kushte imperializmi dhe kapitalizmi botëror shfrytëzuan revizionistët modernë dhe ndër të parët ata Jugosllavë në luftën kundër socializmit dhe lëvizjeve çlirimtare të popujve.

Ishte fat për kapitalizmin botëror që një vend i quajtur demokraci popullore, Jugosllavia, vinte në kundërshtim dhe hynte në konflikt të hapët ideologjik dhe politik me Bashkimin Sovjetik, sepse brenda në gjirin e kampit të socializmit një pjesëtar i tij ngrinte krye. Kësaj ngjarjeje kapitalizmi botëror i dha një bujë të madhe, që i shërbeu në luftën e tij kundër socializmit e revolucionit.

Por tradhtia titiste, megjithëse i solli shumë dëme çështjes së revolucionit e të socializmit, nuk mundi t'i përçajë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste, siç shpresuan borgjezia dhe reaksioni. Komunistët e revolucionarët në të gjithë botën e dënuan ashpër këtë tradhti dhe vunë në dukje rrezikshmërinë që paraqiste titizmi, si agjenturë e imperializmit kundër komunizmit.

Shërbimin më të madh kapitalizmit botëror në luftë kundër socializmit, revolucionit e marksizëm-leninizmit ia bënë revizionistët hrushovianë. të cilët, pas vdekjes së Stalinit, morën fuqinë në Bashkimin Sovjetik. Dalja e grupit revizionist të Hrushovit ishte fitorja më e madhe politike dhe ideologjike e strategjisë së imperializmit pas Luftës së Dytë Botërore.

Përmbysja kundërrivolucionare në Bashkimin Sovjetik i gëzoi pa masë imperialistët amerikanë dhe të gjitha fuqitë e tjera kapitaliste, sepse shteti më i fu-



qishëm socialist, mbështetja e revolucionit dhe e çlirimit të popujve, po braktiste rrugën e socializmit e të marksizëm-leninizmit dhe do të shndërrohej në një mbështetje, në teori e në praktikë, të kundërrevolucionit, të kapitalizmit.

Kthesa që ndodhi në Bashkimin Sovjetik shkaktoi përcarjen e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo ishte një nga faktorët kryesorë që ndikoi dhe krijoi kushte të favorshme për përhapjen e revizionizmit modern në shumë parti komuniste. Rryma revizioniste hrushoviane e dëmtoi rëndë çështjen e revolucionit e të socializmit në të gjithë botën.

Midis forcave të vërteta marksiste-leniniste e revolucionare, nga njëra anë, dhe revizionizmit hrushovian, nga ana tjetër, filloi një luftë e ashpër. Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu siç kishte luftuar e luftonte me vendosmëri kundër revizionizmit jugosllav, ngriti lart qysh në fillim flamurin e luftës së papajtueshme e parimore kundër revizionizmit sovjetik dhe pasuesve të tij, ajo mbrojti me guxim marksizëm-leninizmin, çështjen e socializmit dhe të çlirimit të popujve. Kundër tradhtisë hrushoviane u ngritën edhe marksistë-leninistët e revolucionarët e vërtetë në të gjithë botën. Nga gjiri i proletariatit revolucionar të vendeve të ndryshme lindën partitë e reja marksiste-leniniste, të cilat morën përsipër barrën e rëndë të udhëheqjes së luftës së klasës punëtore dhe të popujve kundër borgjezisë, imperializmit e revizionizmit modern.

Shpresat e imperializmit dhe të revizionizmit për të shkatërruar përfundimisht socializmin, për të shuar lëvizjen e vërtetë komuniste ndërkombëtare dhe për

të shtypur luftën e popujve, nuk u realizuan. Revizionistët hrushovianë e zbuluan shpejt fytyrën e tyre anti-marksiste e kundërrevolucionare. Popujt e panë se Bashkimi Sovjetik ishte shndërruar në një superfuqi imperialiste, që rivalizonte me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sundim botëror, se ai ishte bërë, krahas imperializmit amerikan, një armik tjetër i madh i revolucionit, i socializmit dhe i popujve të botës.

Nga ana tjetër, kriza e rëndë ekonomike, financiare, ideologjike e politike, që përfshiu mbarë botën kapitaliste e revizioniste, tregonte qartë jo vetëm kalbëzimin e mëtejshëm të sistemit kapitalist, natyrën e tij të pandryshueshme shtypëse e shfrytëzuese, por zbulonte edhe demagogjinë e hipokrizinë e gjithë revizionistëve modernë, të cilët zbukuronin rendin kapitalist.

Por, në kohën kur lëvizja revolucionare po rritej e konsolidohej në të gjithë botën, kur kapitalizmi po shtrëngohej gjithnjë e më shumë në darën e krizës dhe kur revizionizmi hrushovian e rrymat e tjera të revizionizmit modern po demaskoheshin në sytë e proletariatit e të popujve, në skenën botërore doli hapur revizionizmi kinez. Ai u bë aleat i ngushtë i imperializmit amerikan dhe i borgjezisë së madhe ndërkombëtare për të mbytur e për të sabotuar luftërat revolucionare të proletariatit e të popujve.

Aktualisht në botë është krijuar një situatë mjaft komplekse. Në arenën ndërkombëtare sot veprojnë forca të ndryshme imperialiste e socialimperialiste, të cilat, nga njëra anë, luftojnë së bashku kundër revolucionit e lirisë së popujve, nga ana tjetër, ndeshen e përleshën për tregje, për zona influence, për hegje-

moni. Rivalitetit sovjeto-amerikan për sundimin e botës i janë shtuar tani edhe pretendimet ekspansioniste të socialimperializmit kinez, lakmitë grabitqare të militarizmit japonez, përprojekjet për hapësira të reja të imperializmit gjermanoperëndimor, konkurrenca e egër e Tregut të Përbashkët Evropian, i cili i ka kthyer sytë nga kolonitë e vjetra.

Të gjitha këto i kanë acaruar më tej kontradiktat e shumta të botës kapitaliste dhe revizioniste. Në të njëjtën kohë, perspektiva e revolucionit dhe e çlirimit të popujve jo vetëm nuk është zhdukur si rrjedhim i tradhtisë së revizionistëve titistë, sovjetikë, kinezë etj., por, pas tërheqjes së përkohshme, revolucionit tani ndodhet përpara një hovi të ri. Ai me siguri do të çajë përpara në rrugën që i ka caktuar historia dhe do të triumfojë në shkallë botërore.

Asgjë s'mund t'i çlirojë imperializmin, kapitalizmin dhe revizionizmin nga hakmarrja e pamëshirshme e proletariatit dhe e popujve, asgjë s'mund t'i shpëtojë ata nga kontradiktat e thella antagonistike dhe nga krizat e vazhdueshme, nga revolucionet, nga vdekja e pashmangshme.

Është pikërisht kjo gjendje që e bën imperializmin të kërkojë rrugë e shtigje të reja, të ndërtojë strategji e taktika të reja për të shpëtuar nga katastrofa që e pret.

## Strategjia e imperializmit botëror

Imperializmi amerikan dhe shtetet e tjera kapitaliste kanë luftuar dhe po luftojnë për të ruajtur hegje-

moninë në botë, për të mbrojtur sistemin kapitalist dhe neokolonialist, për të dalë me sa më pak humbje nga kriza e madhe që i ka mbërthyer. Ata kanë bërë e bëjnë përpjekje për të mos i lënë popujt dhe proletariatin të realizojnë aspiratat revolucionare, çlirimtare. Rolin kryesor në luftë për të arritur këto synime e ka imperializmi amerikan, i cili dominon mbi partnerët e tij politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Armiqtë e revolucionit dhe të popujve duan të krijojnë përshtypjen se nga ndryshimet që kanë ndodhur në botë dhe nga humbjet që ka pësuar socializmi, janë krijuar rrethana krejt të ndryshme nga ato të mëparshmet. Prandaj imperializmi amerikan dhe borgjezia kapitaliste botërore, socialimperializmi sovjetik dhe socialimperializmi kinez, revizionizmi modern dhe socialdemokracia, megjithëse kanë kontradikta të ashpra me njëri-tjetrin, janë vënë në kërkim të një *modus vivendi*, të një «shoqërie të re» hibride për të mbajtur në këmbë sistemin borgjezo-kapitalist, për të mënjanuar revolucionet e për të vazhduar shtypjen dhe shfrytëzimin e popujve me forma e mënyra të reja.

Imperializmi dhe kapitalizmi arritën të kuptojnë se tani nuk mund t'i shfrytëzojnë më popujt e botës me metodat e mëparshme, prandaj, për sa kohë që nuk kërcënohet sistemi i tyre, ata duhet të lëshojnë diçka pa zarar, për t'i mbajtur nën zgjedhë masat. Këtë gjë duan ta bëjnë me investimet e kreditë që u ndajnë atyre shteteve dhe klikave ku kanë vendosur influencën e vet, ose me anën e armëve, domethënë nëpërmjet luftërave të pjesshme, qoftë duke marrë pjesë drejtpërdrejt në to, qoftë duke nxitur një shtet kundër

një tjetri. Luftërat lokale shërbejnë për t'ia nënshtruar më mirë hegjemonisë së kapitalit botëror ato vende që bien në grackën e tij.

Të gjithë «teoricienët» në shërbim të kapitalit botëror, në Perëndim e në Lindje, po përpiqen të gjejnë formulimet e kësaj «shoqërie të re». Aktualisht ata këtë formë «të re» e kanë në shoqërinë kapitalisto-revizioniste të Bashkimit Sovjetik, e cila nuk është tjetër veçse një shoqëri e degjeneruar, e kanë gjetur në sistemin kapitalist të vetadministrimit jugosllav dhe në disa regjime të ashtuquajtura të orientimit socialist të botës së tretë. Një «shoqëri të re» kapitaliste të këtij tipi po e kërkojnë ta gjejnë edhe në variantin kinez, që po kristalizohet tani.

Në deklaratat programatike që bëri presidenti Karter më 22 maj 1977, ku parashtroi vijën e një politike gjoja të re të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, del qartë se karakteristika e përgjithshme dhe themelore e kësaj «politike të re», në kushtet aktuale, është lufta e kësaj superfuqie për të përballuar revolucionin proletar dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve, që aspirojnë të çlirohen nga zgjedha e kapitalit të madh botëror, veçanërisht nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik.

Bota kapitaliste, sikurse vumë në dukje më lart, kërkon të gjejë një rrugëdalje nga humnera, qoftë edhe përkohësisht. Këtë, natyrisht, imperializmi amerikan përpiqet ta gjejë dhe ta koordinojë mundësisht tok me socialimperializmin sovjetik, me aleatët e tij të NATO-s, me Kinën, si dhe me vende të tjera kapitaliste të industrializuara. Karteri u bëri thirrje dhe u kërkoi

vendeve të Lindjes, të Perëndimit dhe vendeve të OPEK-ut që të punojnë së toku dhe «të ndihmojnë efektivisht vendet më të varfra». Këtë bashkëpunim imperializmi amerikan e quan si të vetmen alternativë dhe të vetmen rrugë për ndalimin e luftërave.

Presidenti amerikan në fjalimin e tij tha se sot «ne jemi çliruar nga ajo frikë e përhershme prej komunizmit, e cila dikur na tërhiqte të përqaфонim çdo diktator që kishte po këtë frikë».

Natyrisht, Karteri, ky përfaqësues besnik i imperializmit më gjakatar të kohës, kur flet për «çlirim nga frika e komunizmit», nuk ka parasysh komunizmin ala jugosllav, ala hrushovian, ala kinez, që vetëm maskat kanë komuniste, por borgjercia kapitaliste s'është çliruar dhe as do të çlirohet kurrë nga frika e komunizmit të vërtetë. Përkundrazi, komunizmi i vërtetë i ka tmerruar e do t'i tmerrojë akoma më tepër imperializmin e socialimperializmin. Nga frika dhe tmerrri i tij imperialistët dhe revizionistët detyrohen të puqen me njëri-tjetrin, të koordinojnë planet e të kërkojnë forma sa më të përshtatshme për t'i zgjatur jetën sundimit të tyre shtypës e shfrytëzues.

Në këto momente të një krize të thellë ekonomike, politike dhe ushtarake, fitoret e imperializmit, të arritura me tradhtinë e revizionizmit modern në Bashkimin Sovjetik, në vendet e ish-demokracisë popullore dhe në Kinë, imperialistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përpiqen t'i konsolidojnë dhe t'i shfrytëzojnë si një barrierë për të penguar revolucionin dhe luftën revolucionare çlirimtare të proletariatit dhe të popujve.

Presidenti amerikan pohon po ashtu se nga frika

e komunizmit kapitalistët dhe imperialistët kanë përqa-fuar e përkrahur në të kaluarën diktatorët fashistë, si Musolinin, Hitlerin, Hirohiton, Frankon e të tjerë. Diktaturat fashiste, në vendet përkatëse, kanë qenë arma e fundit e borgjezisë kapitaliste dhe e imperializmit botëror kundër Bashkimit Sovjetik të kohës së Lenin-Stalinit dhe kundër revolucionit proletar botëror.

Me njëfarë sigurie presidenti amerikan deklaroi se shtetet komuniste (kuptohet revizioniste) kanë ndryshuar pamjen dhe këtu ai nuk gabohet. Ai thotë se «ky sistem nuk mund të zgjaste gjithë jetën pa u ndryshuar». Natyrisht, ai konfondon tradhtinë revizioniste me sistemin e vërtetë socialist, me komunizmin. Imperializmi amerikan e konsideron sistemin sovjetik hrushovian si një fitore të kapitalizmit botëror dhe këtej del me deduksionin se kërcënimi i konfliktit me Bashkimin Sovjetik është bërë më pak intensiv, megjithëse ai nuk i mohon kontradiktat me të, nuk e mohon rivalitetin për hegjemoni.

Sipas Karterit, qeveria amerikane do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ruajtur statukuonë. Kjo, me fjalë të tjera, do të thotë se si imperializmi amerikan, ashtu edhe shtetet e tjera imperialiste, do të përpiqen t'i ruajnë dhe t'i forcojnë pozitat e tyre në botë, ndërsa mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë, dhe që në fakt ekzistojnë me vendet mike dhe me aleatët e tyre, shprejsojnë t'i zgjidhin së toku brenda kësaj statukuoje.

Si konkluzion, thotë Karteri, «politika amerikane duhet të bazohet në një mozaik të ri e më të gjerë të interesave globalë, rajonalë dhe të dyanshëm». Pasi e zbërthen këtë «mozaik» të ri dhe të gjerë të interesave

globalë, rajonalë e të dyanshëm, ai riafirmon se «të gjitha angazhimet që kanë marrë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndaj NATO-s, e cila duhet të jetë një organizatë e fortë, do t'i mbajnë, se aleanca e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me demokracitë e mëdha të industrializuara është e domosdoshme, pse ruan të njëjtat vlera, dhe për këtë ne duhet të luftojmë të gjithë për një jetë më të mirë».

Siç shihet, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkohen me përpjekjet e revizionistëve modernë sovjetikë, të atyre kinezë dhe të «demokracive të mëdha të industrializuara» për krijimin e një «realiteti të ri», të një «bote të re». Me fjalë të tjera, duke bërë demagogji, politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përpiqet t'u adaptohet situatave të krijuara. Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të ruajtur statukuonë, për t'i prerë hovin hegjemonizmit sovjetik, për ta dobësuar socialimperializmin sovjetik dhe për ta tërhequr Kinën me vete, që kjo të futet gjithnjë e më thellë në kampin imperialist, për të shuar luftërat revolucionare të proletariatit dhe të popujve, u duhet të bëjnë disa lëshime të gënjeshtërtë politike. Por ato nuk bëjnë asnjë lëshim ushtarak, asnjë lëshim në politikën e mbajtjes nën zgjedhë dhe nën kontroll të shteteve e të popujve, në politikën e shfrytëzimit të pasurive kombëtare të vendeve të tjera në dobi të tyre dhe të vendeve të industrializuara.

Kjo është «politika e re» e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për ne është e qartë se kjo nuk është aspak një politikë e re, por një politikë e vjetër imperialiste grabitqare, neokolonialiste, robëruese dhe shfry-



tëzuese deri në palcë e popujve dhe e pasurive të tyre, një politikë e shuarjes së revolucioneve dhe e luftërave nacionalçlirimtare. Kësaj politike të vjetër e të përherëshme imperializmi amerikan kërkon t'i japë tani një bojë gjoja të re, të freskët, t'u japë armë elementëve kundërrevolucionarë në pushtet ose jo në pushtet që të luftojnë komunizmin, i cili i ngre popujt dhe proletariatin në luftëra çlirimtare dhe në revolucion.

Në kundërshtim me teorinë kineze të «tri botëve», e cila është një teori e gënjeshtërt kapitaliste dhe revizioniste, imperializmi amerikan vazhdon të jetë në sulm. Ai përpiqet të ruajë aleancat e vjetra dhe të krijojë aleanca të reja, në favor të tij dhe në disfavor të socialimperializmit sovjetik ose të kujtdo që mund të kërcënojë fuqinë imperialiste amerikane. Sidomos ai përpiqet të forcojë NATO-n, e cila ka qenë dhe mbetet një organizatë politike e ushtarake agresive.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës në gjithë lojën e tyre strategjike nuk i acarojnë tej masës marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik. ato vazhdojnë tratativat SALT me të, pavarësisht se Karteri deklaroi se do t'i prodhojë bombat me neutron. Megjithatë në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik duket një tendencë për ruajtjen e statukuosë midis tyre.

Natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja përpiqen ta ruajnë këtë statukuo me Bashkimin Sovjetik, duke pasur, në të njëjtën kohë, edhe kontradikta me të, por këto kontradikta akoma nuk kanë arritur atë shkallë sa të justifikojnë predikimet kineze se lufta në Evropë është iminente.

Imperializmi amerikan, aktualisht, mbështet Kinën

që kjo të fuqizohet ushtarakisht dhe ekonomikisht. Kapitulet amerikane po vërshojnë në Kinë, ku po bëhen investime të mëdha me kredi të bankave kryesore amerikane, por dhe të shtetit amerikan.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kartën e Kinës po e luajnë fort, por me kujdes. Në të njëjtën kohë ato vazhdojnë të luajnë edhe kartën e Japonisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Japoninë kërkojnë t'i kenë ujërat të qeta, ndihma ndërmjet tyre të jetë reciproke, që Japonia, sipas amerikanëve, të forcohet dhe të bëhet një Izrael në Lindjen e L largme, në Pacifik, në Azinë Juglindore dhe, pse jo, kur ta dojë puna dhe kur të vijë koha, edhe kundër Kinës më vonë.

Në këtë situatë e nënshkroi Kina Traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Japoninë. Por ky traktat merr dhe do të marrë në të ardhmen përpjesëtime të mëdha, të shumanshme, të rrezikshme dhe të shëmtuara për fatet e botës, për arsye se në mes Japonisë dhe Kinës do të vendoset një bashkëpunim i ngushtë ekonomik-ushtarak që do të synojë krijimin e sferave të influencës, të veçanta dhe të përbashkëta, sidomos në Azi, në Australi dhe në gjithë pellgun e Pacifikut. Ky bashkëpunim, natyrisht, do të fillojë të ndërtohet nën hijen e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të propagandës së luftës kundër socialimperializmit sovjetik. Kjo aleancë kino-japoneze ka për qëllim kryesor frenimin dhe dobësimin e Bashkimit Sovjetik, largimin e tij nga Siberia, Mongolia dhe gjatë, zhdukjen e influencës së tij në të gjithë Azinë dhe në Oqeani, në të gjitha vendet e ASEAN-it.

Kjo është strategjia e imperializmit amerikan, por

njëkohësisht edhe e imperializmit kinez dhe e militarizmit japonez. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen t'i ndihmojnë Kinën dhe Japoninë dhe t'i mbajnë nën drejtimin e tyre, të forcojnë aleancën me to dhe t'i hedhin kundër Bashkimit Sovjetik. Por ekziston edhe mundësia të vijë një ditë që politika djallëzore, hipokrite, perandorake, pa parime dhe në frymën imperialisto-militariste e Kinës dhe e Japonisë, të kundërshtojë superfuqinë që i ndihmoi të mëkëmbeshin, ashtu siç bëri dikur Gjermania, e cila u bë një fuqi e tmerrshme fashiste, sulmoi aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe hyri në luftë me vetë ato në kohën e Hitlerit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që ta ruajnë balancën e fuqisë kineze dhe të asaj japoneze që po ngrihet. Por një mëngjes kjo balancë do t'u shpëtojë nga duart dhe aleanca imperialisto-militariste kino-japoneze do të bëhet njëkohësisht rrezik jo vetëm për Bashkimin Sovjetik, por edhe për vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për arsye se interesat e të dy këtyre vendeve të mëdha imperialiste aziatike, Kinës e Japonisë, puqen në synimet për dominimin në Azi e gjatë dhe për dobësimin e imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik.

Në NATO Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një pozitë dominuese dhe një influencë të madhe ushtarake, politike dhe ekonomike. Megjithatë, me gjithë unitetin e saj brendapërbrenda, organizata e NATO-s ka filluar të diferencohet nga pikëpamja e influencës së anëtarëve të ndryshëm në të, të daljes së një shteti mbi të tjerët.

Republika Federale e Gjermanisë po forcohet çdo vit e më shumë në këtë organizatë. Fuqia ekonomike e politike dhe tregtia e saj e armëve i kapërcejnë kufijtë e Tregut të Përbashkët Evropian. Mund të themi se politika e Gjermanisë Perëndimore kërkon të krijojë zonat e veta të influencës. Kjo, natyrisht, nuk u vjen për hosh as Anglisë, as Francës, dy partnerëve të tjera kryesorë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO.

Gjermania Perëndimore kërkon unifikimin e dy shteteve gjermane, që të krijojë një shtet të fuqishëm me një potencial të madh ushtarak, i cili do të jetë një kërcënim ndaj socialimperializmit sovjetik dhe në rastin e një konflagracioni të përgjithshëm, në aleancë me Japoninë e Kinën, mund të bëhet një rrezik për botën. Nga shtetet evropiane ajo zë vendin kryesor në shkëmbimet tregtare me Kinën. Gjermania Perëndimore është furnizuesja evropiane më e madhe dhe më e fuqishme e Kinës edhe në kredi, edhe në teknologji.

Anglia dhe Franca po ashtu kanë interesa të mëdhenj në Kinë, prandaj po i zhvillojnë marrëdhëniet me të. Mirëpo Kina ka interesa më të mëdhenj me Bonin. Kjo i shqetëson Anglinë dhe Francën, mbasi Republika Federale e Gjermanisë, duke u fuqizuar më tej, mund të dominojë akoma më shumë mbi partnerët e tjerë të NATO-s dhe të Tregut të Përbashkët Evropian. Prandaj konstatojmë se qoftë qeveria angleze, qoftë ajo franceze, flasin për miqësi dhe për marrëdhënie me Kinën, por nuk harrojnë të theksojnë se dëshirojnë të zhvillojnë më tej marrëdhëniet ekonomike dhe miqësore edhe me Bashkimin Sovjetik. Këtë e thotë edhe

Boni, mirëpo ky po i zhvillon me shpejtësi marrëdhëniet me Kinën, që paraqitet si armiku kryesor i Bashkimit Sovjetik. Revanshistët e vërtetë dhe të fuqishëm të Bonit, afishohen haptazi si aleatët më të afërt të Kinës. Prandaj Kina Gjermaninë Federale nuk e shikon njësoj si Francën dhe Anglinë.

## Strategjia e socialimperializmit sovjetik

Me të rrëmbyer pushtetin në Bashkimin Sovjetik, hrushovianët i vunë vetes si qëllim kryesor shkatërrimin e diktaturës së proletariatit, rivendosjen e kapitalizmit dhe transformimin e Bashkimit Sovjetik në një superfuqi imperialiste.

Në radhë të parë, Hrushovi dhe grupi i tij, mbasi konsoliduan pozitat pas vdekjes së Stalinit, ndërmorën sulmin kundër ideologjisë marksiste-leniniste dhe luftën për të shkurorëzuar leninizmin, duke atakuar Stalinin dhe duke i ngarkuar atij të gjitha ato shpifje që kishte fabrikuar prej kohësh propaganda e ndyrë e borgjezisë kapitaliste botërore. Hrushovianët u bënë kështu zëdhënësit dhe ekzekutuesit e dëshirave të kapitalit kundër ideologjisë marksiste-leniniste dhe revolucionit në Bashkimin Sovjetik. Ata në mënyrë sistematike ndërmorën likuidimin e gjithë strukturës socialiste të Bashkimit Sovjetik, luftuan për liberalizimin e sistemit sovjetik, për transformimin e shtetit të diktaturës së proletariatit në një shtet borgjez, për transformimin kapitalist të ekonomisë e të kulturës socialiste.

Bashkimi Sovjetik, që u shndërrua në një vend revizionist, në një shtet socialimperialist, ndërtoi një strategji dhe një taktikë të tij. Hrushovianët hartuan një politikë të atillë që të kishin mundësi ta maskonin gjithë veprimtarinë e tyre me frazeologji leniniste. Ata e përpunuan ideologjinë e tyre revizioniste në atë mënyrë që ta kalonin përpara proletariatit dhe popujve si një «marksizëm-leninizëm të periudhës së re», që t'u thoshin komunistëve, brenda dhe jashtë vendit, se «në Bashkimin Sovjetik po vazhdon revolucionin në kushtet e reja politike, ideologjike dhe ekonomike të zhvillimit botëror» dhe që ky revolucion jo vetëm po vazhdonte atje, por ky vend gjoja ishte duke kaluar në fazën e ndërtimit të një shoqërie komuniste pa klasa, ku partia dhe shteti po shuhen.

Partia u zhvesh nga atributet e saj si pararojë e klasës punëtore, si forcë e vetme politike drejtuese e shtetit dhe e shoqërisë dhe u shndërrua në një parti që e sundojnë aparatçikët dhe agjentët e KGB-së. Revizionistët sovjetikë e quajtën partinë e tyre «parti të të gjithë popullit» dhe e katandisën aq keq, sa ajo nuk mund të jetë më e klasës punëtore, por e borgjezisë së re sovjetike.

Nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë predikuan bashkekzistencën paqësore hrushoviane si vijë të përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe shpallën «garën paqësore me imperializmin amerikan» si rrugën për fitoren e socializmit në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera. Ata deklaruan, gjithashtu, se gjoja revolucionin proletar kishte hyrë në një fazë të re, se ai mund të triumfojë edhe në rrugë të tjera nga

ajo e marrjes së pushtetit me dhunë nga ana e proletariatit. Sipas tyre, pushteti mund të merrej me rrugë paqësore, parlamentare dhe demokratike, nëpërmjet reformave.

Duke spekuluar me emrin e Leninit dhe të partisë bolshevike, revizionistët hrushovianë bënë të gjitha përpjekjet që këtë vijë të tyre antimarksiste, këtë revizionim të teorisë marksiste-leniniste në të tëra fushat, t'ua impononin të gjitha partive komuniste në botë. Ata donin që partitë komuniste dhe punëtorë të botës të inkuadroheshin në këtë vijë revizioniste dhe të shndërroheshin në parti kundërrevolucionare, në vegla qorre të diktaturës borgjeze për t'i shërbyer kapitalizmit.

Por kjo nuk u arrit plotësisht, siç dëshironin ata, për arsye se, në radhë të parë, Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në zbatimin me konsekuencë të marksizëm-leninizmit dhe në mbrojtjen e pastërtisë së tij. Në ato momente u gjendën edhe parti të tjera që, për arsyet e tyre jo të kulluara marksiste-leniniste, u lëkundën, nuk i pranuan plotësisht orientimet hrushoviane, disa i pranuan me gjysmë goje, por më pas u nënshtruan. Në ato momente edhe Partia Komuniste e Kinës i kundërshtoi hrushovianët, por, siç e tregojnë faktet, ajo nisej nga qëllime dhe objektiva krejt të kundërt nga ata që e shtynë Partinë e Punës të Shqipërisë të hidhej në luftë kundër revizionizmit hrushovian.

Me ardhjen e tyre në pushtet, hrushovianët përgatitën edhe platformën e politikës së tyre të jashtme. Ashtu si imperializmi amerikan, edhe socialimperializ-

mi sovjetik vuri në bazë të politikës së tij të jashtme ekspansionin e hegjemonizmin, nëpërmjet garës së armatimeve, të presioneve e të shantazhit, të agresionit ushtarak, ekonomik dhe ideologjik. Synimi i kësaj politike ishte vendosja e sundimit socialimperialist në të gjithë botën.

Në vendet e KNER-it Bashkimi Sovjetik zbaton një politikë tipike neokolonialiste. Ekonomitë e këtyre vendeve janë shndërruar në shtojca të ekonomisë sovjetike. Për t'i mbajtur nën zgjedhë këto vende Bashkimit Sovjetik i shërben Traktati i Varshavës, i cili i jep mundësi të vendosë atje forca të shumta ushtarake, që s'kanë asnjë ndryshim nga ushtritë pushtuese. Traktati i Varshavës është një pakt ushtarak agresiv që u shërben politikës së presioneve, shantazheve dhe ndërhyrjeve të armatosura të socialimperializmit sovjetik. Kësaj politike neokolonialiste i shërbejnë edhe «teoritë» revizionisto-imperialiste të «bashkësisë socialiste», të «ndarjes socialiste të punës», të «sovrانيتit të kufizuar», të «integritit ekonomik socialist» etj.

Por socialimperializmi sovjetik nuk kënaqet me sundimin që ushtron mbi shtetet satelite të tij. Ashtu si dhe shtetet e tjera imperialiste, ai lufton tani për tregje të reja, për sfera influence, për investime të kapitaleve të tij në vende të ndryshme, për akaparim burimesh të lëndëve të para, për të shtrirë neokolonializmin e vet në Afrikë, në Azi, në Amerikën Latine e gjetkë.

Për të zgjeruar ekspansionin e hegjemonizmin, socialimperializmi sovjetik ka një plan të tërë strate-



gjik, që përfshin një varg veprimesh ekonomike, politike, ideologjike e ushtarake.

Në të njëjtën kohë revizionistët sovjetikë veprojnë për të minuar revolucionet e luftërat çlirimtare të popujve me po ato mjete e metoda që përdorin edhe imperialistët amerikanë. Zakonisht socialimperialistët veprojnë me anë të partive revizioniste, vegla të tyre, por, sipas rastit e rrethanave, përpiqen të korruptojnë e të blejnë edhe klika sunduese në vendet e pazhvilluara, ofrojnë «ndihma» ekonomike skllavëruce për t'u futur në këto vende, nxitin konflikte të armatosura midis klikave të ndryshme, duke marrë anën e njërës ose të tjetrës, organizojnë komplete e puçe për të sjellë në fuqi regjime prosovjetike, përdorin ndërhyrjen e drejtpërdrejtë ushtarake, siç bënë së bashku me kubanezët në Angolë, në Etiopi e gjetkë.

Ndërhyrjen dhe veprimet e tyre hegjemoniste e neokolonialiste socialimperialistët sovjetikë i bëjnë nën maskën e ndihmës dhe të përkrahjes për forcat revolucionare, për revolucionin, për ndërtimin e socializmit. Në të vërtetë ata ndihmojnë kundërrevolucionin.

Bashkimi Sovjetik përpiqet t'i hapë rrugë realizmit të planeve të tij ekspansioniste, neokolonialiste, duke e paraqitur veten si një vend që ndjek një politikë leniniste e internacionaliste, si aleat, mik dhe mbrojtës i shteteve të reja kombëtare, i vendeve të pazhvilluara etj. Revizionistët sovjetikë predikojnë se këto vende, duke u lidhur me Bashkimin Sovjetik e të ashtuquajturën bashkësi socialiste, të cilën e shpallin si «forcën kryesore lëvizëse të zhvillimit të sotëm botëror», mund të ecin me sukses në rrugën e lirisë e të pavarësisë, bile

edhe të socializmit. Për këtë kanë sajuar edhe teoritë mbi «rrugën jokapitaliste të zhvillimit», të «orientimit socialist» etj.

Strategjia e socialimperialistëve sovjetikë s'ka asgjë të përbashkët me socializmin e leninizmin, siç pretendojnë ata. Ajo është strategji e një shteti grabitqar imperialist që kërkon të shtrijë hegjemoninë e sundimin e tij në të gjitha kontinentet e në të gjitha vendet.

Kjo politikë hegjemoniste e neokolonialiste që ndjek Bashkimi Sovjetik revizionist përplasat, e s'mund të ndodhë ndryshe, me politikën që ndjekin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe që ka filluar të ndjekë edhe Kina. Kjo është një përplasje interesash të imperialistëve në luftën që zhvillojnë për rindarjen e botës. Janë pikërisht këta interesa dhe kjo luftë që i vënë superfuqitë njëri kundër tjetrës, që shtyn secilën prej tyre të përdorë të gjitha forcat e mjetet që ka në dorë për të dobësuar rivalin ose rivalet e veta, derisa përplasjet të mos kenë arritur atë shkallë acarimi që të hidhen në përleshje të armatosura.

## Strategjia e socialimperializmit kinez

Ngjarjet dhe faktet tregojnë gjithnjë e më mirë se Kina po zhytet çdo ditë e më thellë në revizionizëm, në kapitalizëm e në imperializëm. Në këtë rrugë ajo punon që të realizojë një varg detyrash strategjike, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Në shkallë kombëtare socialimperializmi kinez i ka vënë vetes detyrë të zhdukë çdo masë me karakter so-

cialist, që mund të jetë ndërmarrë pas çlirimit, dhe të ndërtojë në vend një sistem kapitalist në bazë e superstrukturë, ta bëjë Kinën deri nga fundi i këtij shekulli një fuqi kapitaliste të madhe, nëpërmjet zbatimit të të ashtuquajturave «katër modernizime», të industrisë, të bujqësisë, të ushtrisë dhe të shkencës.

Ai lufton për të krijuar brenda vendit një organizim të tillë që të sigurojë dominimin e borgjezisë së vjetër e të re kapitaliste kineze mbi popullin kinez. Këtë organizim dhe këtë dominim revizionizmi kinez përpiqet ta vendosë në rrugë fashiste, me kërbaç, me shtypje. Ai punon për të krijuar një unitet midis ushtrisë dhe prapavijave, që këto t'i shërbejnë kësaj ushtrie shtypëse.

Format dhe metodat që kanë tërhequr më shumë vëmendjen e udhëheqjes kineze, e që mund të zbatohen në Kinë, janë ato titiste, veçanërisht sistemi i vetadministrimit jugosllav. Shumë komisione e delegacione kineze nga të gjithë sektorët e profilet janë ngarkuar për të studiuar në vend këtë sistem dhe në përgjithësi përvojën e «socializmit» kapitalist jugosllav.

Ky sistem e kjo përvojë tashmë kanë filluar të vihen në jetë në Kinë. Mirëpo, nga ana tjetër, udhëheqësit revizionistë të Kinës s'mund të mos vënë re dëshimet e vetadministrimit titist, s'mund të mos marrin parasysh edhe kushtet krejt të ndryshme të vendit të tyre nga ato të Jugosllavisë. Veç kësaj, ata e quajnë të domosdoshme të huazojnë shumë edhe nga format e metodat kapitaliste, të cilat, sipas tyre, kanë treguar «efikasitet» në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në

Gjermaninë Perëndimore, në Japoni dhe në vende të tjera borgjeze. Siç duket, sistemi kapitalist që po ndërtohet e po zhvillohet në Kinë, do të jetë një sistem i kryqëzuar me forma e metoda të ndryshme revizionisto-kapitaliste e tradicionale kineze.

Për t'u bërë një fuqi e madhe kapitaliste, revizionizmit kinez i nevojitet një periudhë paqeje. Me këtë nevojë ka lidhje parulla e «rregullit të madh», që hodhi Kongresi i 11-të i partisë kineze. Për të siguruar një «rregull» të tillë, nga njëra anë, kërkohet një rend kapitalist i tipit diktatorial fashist, nga ana tjetër, duhet të ruhen medoemos paqja e kompromisi ndërmjet grupeve rivale, që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë gjithnjë në partinë e në shtetin kinez. Sa do të sigurohen ky rregull e kjo paqe, këtë do ta tregojë koha.

Politika e udhëheqësve kinezë për ta shndërruar Kinën në një superfuqi, synon që kjo të përfitojë ekonomikisht e ushtarakisht nga Imperializmi amerikan, si dhe nga vendet e zhvilluara kapitaliste, që janë alcate të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo politikë e Kinës ka ngjallur interesimin e madh të botës kapitaliste, sidomos të imperializmit amerikan, i cili shikon në këtë politikë të Kinës një mbështetje të madhe të strategjisë së tij, të mbajtjes në këmbë të kapitalizmit e të Imperializmit, të forcimit të neokolonializmit, të shuarjes së revolucioneve e të mbytjes së socializmit, si edhe të dobësimit të rivalit të tij, Bashkimit Sovjetik.

Imperializmi amerikan, siç ka deklaruar Karteri, dëshiron «të bashkëpunojë ngushtë me kinezët». Ai ka nënvizuar se «ne i konsiderojmë marrëdhëniet ame-

rikano-kineze si një element qendror të politikës sonë globale dhe Kinën e konsiderojmë një forcë kyçe për paqen». Kina është për një bashkekzistencë paqësore sa më të afrueshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me këto pikëpamje e qëndrime Kina radhitet me ato shtete borgjezo-kapitaliste që qenien e tyre si shtet e mbështetin tek imperializmi amerikan. Kjo kthesë e Kinës drejt imperializmit, ashtu siç bënë më parë Bashkimi Sovjetik dhe të tjerë, tanimë çdo ditë e më shumë po bëhet realitet. Këtë e shohin edhe vetë imperialistët, të cilët, të gëzuar nga ky «realitet i ri», deklarojnë se «konfliktet ideologjike që ndanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën në vitet 50-të, janë më pak të dukshme sot dhe kanë një nevojë gjithnjë në rritje për bashkëpunim midis superfuqive...».

Imperialistët amerikanë me presidentin Karter tregohen të gatshëm për t'i dhënë ndihmë Kinës që të forcojë ekonominë dhe ushtrinë e saj, sigurisht, deri në atë shkallë që u intereson atyre. Ata u fërkojnë krahët udhëheqësve revizionistë kinezë, sepse strategjia e Kinës përbën një ndihmë të rëndësishme për synimet hegjemoniste të imperializmit amerikan.

Pikëpamjet dhe veprimet amerikane kundër Bashkimit Sovjetik revizionist, Kina i duartroket, sepse do të tregojë që ato gjoja i shërbejnë revolucionit, i shërbejnë dobësimit të fuqisë së madhe më të rrezikshme në botë, socialimperializmit sovjetik. Nga ana e vet imperializmi amerikan i duartroket pikëpamjet dhe veprimet e Kinës kundër Bashkimit Sovjetik revizionist,

pse, siç është shprehur një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Karterit, «konflikti kino-sovjetik krijon një lloj strukture globale më pluraliste», të cilën imperia- lizmi amerikan e preferon, e konsideron të pajtueshme me nocionin e vet «se si duhet të organizohet bota», pra se si të ndërsehen të tjerët për t'i ngrënë kokën njëri-tjetrit dhe pastaj Shtetet e Bashkuara të Ameri- kës të sundojnë më lehtë mbi gjithë botën.

Politika pragmatiste dhe e çoroditur e Kinës e ka çuar atë të bëhet aleate e imperializmit amerikan dhe të shpallë si armik e rrezik kryesor socialimperializmin sovjetik. Nesër, kur Kina të shohë se ia ka arritur që- llimit të vet për dobësimin e socialimperializmit sovje- tik, kur të shohë, sipas logjikës së vet, se imperializmi amerikan po forcohet, atëherë, meqenëse mbështetet te një imperializëm për të luftuar imperializmin tjetër, mund ta vazhdojë luftën në krahun e kundërt. Në këtë rast mund të bëhet imperializmi amerikan më i rre- zikshëm dhe atëherë Kina, automatikisht, të kthehet në të kundërtën e qëndrimit të mëparshëm.

Kjo është një mundësi reale. Në Kongresin e tyre të 8-të më 1956 revizionistët kinezë konsideronin rre- zik kryesor imperializmin amerikan. Më pas, në Kon- gresin e 9-të, në prill të vitit 1969, ata deklaruan se rrezik kryesor përbënin të dyja superfuqitë, imperia- lizmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. Më vo- në, pas Kongresit të 10-të, që u bë në gusht të vitit 1973, dhe në Kongresin e 11-të, armik kryesor shpallën vetëm socialimperializmin sovjetik. Me të tilla lëkund- je, me një politikë të tillë pragmatiste nuk është e pamundur që Kongresi i 12-të apo i 13-ti të mbështetë

socialimperializmin sovjetik dhe të shpallë armik kryesor imperializmin amerikan dhe kjo derisa t'ia arrijë edhe Kina qëllimit të saj që të bëhet një fuqi kapitaliste e madhe botërore. Ç'rol do të luajë në këtë rast Kina në arenën ndërkombëtare? Roli i saj nuk do të jetë kurrë revolucionar, po regresiv, kundërrivolucionar.

Një drejtim i rëndësishëm i politikës së jashtme kineze është aleanca me Japoninë. Kjo aleancë raciste e këtyre dy shteteve, si me thënë, të verdha, që u vulos tash së fundi edhe me Traktatin kino-japonez, synon, siç e theksuam më sipër, të realizojë planet strategjike të Kinës dhe të Japonisë për të dominuar së toku Azinë, vendet e ASEAN-it dhe Oqeaninë. Ky traktat dhe miqësia me Japoninë u duhen revizionistëve kinezë që së bashku me militaristët japonezë të kërcënojnë socialimperializmin sovjetik, mundësisht ta likuidojnë këtë dhe influencën e tij në Azi.

Por Kina, nga lidhjet me Japoninë, kërkon të përfitojë edhe për të marrë prej saj kredi, për të importuar teknikë, teknologji dhe armatime për realizimin e ambicieve të veta të fuqisë së madhe. Kaq rëndësi i jep Kina bashkëpunimit të gjithanshëm ekonomik me Japoninë, saqë më shumë se gjysma e tregtisë së jashtme të saj zhvillohet me të.

Kina socialimperialiste në realizimin e politikës së saj ekspansioniste punon që ta shtrijë sa më shumë influencën e vet në Azi. Aktualisht ajo nuk ka asnjë influencë në Indi, ku si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik kanë interesa të veçantë dhe të përbashkët në kuadrin e ndryshimeve e të aleancave që mund të ngjasin në të ardhmen. Kina

dëshiron që të fillojë të ketë marrëdhënie diplomatike disi më të mira me Indinë. Por pretendimet e Indisë ndaj Tibetit janë të mëdha. India do të luftojë që edhe atë influencë të paktë që mund të ketë Kina në Pakistan ta likujdijë, për arsye se Pakistani është një vend strategjik në krah të Iranit dhe të Afganistanit. Këtu fillojnë rivalitetet për pellgun e madh të vajgurit të Lindjes së Mesme, ku dominon imperializmi amerikan. Kina e ka shumë të vështirë që të depërtojë atje. Ajo do të bëjë një politikë kundër interesave të popujve arabë dhe pro interesave amerikanë, derisa të vijë koha që të fuqizohet vetë. Kina, njëkohësisht, do t'i ndihmojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që tok me vende të tilla si Irani, Arabia Saudite etj., të bëhen një barrierë e fuqishme kundër një depërtimi politiko-ekonomik dhe ushtarak sovjetik në këtë zonë jetike për imperializmin amerikan dhe për imperializmin evropian.

Socialimperialistët kinezë për realizimin e qëllimeve të tyre një vëmendje të veçantë i kushtojnë Evropës Perëndimore. Objektivi i tyre është t'ia kundërvënë këtë socialimperializmit sovjetik. Prandaj ata mbështetin me të gjitha mënyrat NATO-n dhe aleancën e vendeve evropiane me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar».

Në planin e saj strategjik Kina socialimperialiste synon të shtrijë në vendet e «botës së tretë», siç i quan ajo, influencën dhe hegjemoninë e saj. Teoria e «botës së tretë» ka një rëndësi të madhe për Kinën. Këtë



«teori» Mao Ce Duni nuk e shpalli si një ëndërrues, por me qëllime të caktuara hegjemoniste, që Kina të dominojë botën. Pasardhësit e tij ndjekin të njëjtën strategji të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait.

Synimet strategjike kineze shtrihen edhe mbi atë që quhet «botë e paangazhuar», të cilën e predikon titizmi. Në mes këtyre «botëve» nuk ka ndonjë ndryshim, njëra interferohet në tjetrën. Është e zorshme të dallosh cilat shtete janë të «botës së tretë» dhe ç'i dallon këto nga «vendet e paangazhuara», cilat shtete bëjnë pjesë në «të paangazhuarit» dhe ç'i dallon këto nga ato të «botës së tretë». Pra, sido që t'ua vësh emrin, këto janë të njëjtat shtete.

Kjo është edhe një nga arsytet që udhëheqja kineze u jep një rëndësi aq të madhe marrëdhënieve shtetërore e partie shumë miqësore me Titon e me Jugosllavinë në të gjitha fushat, ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake.

Bashkësia në pikëpamjet e revizionistëve kinezë e të revizionistëve jugosllavë nuk i pengon ata të shfrytëzojnë miqësinë e përzemërt midis tyre për qëllimet e veçanta të secilit.

Titoja mundohet të shfrytëzojë deklaratat e Hua Kuo Fenit mbi besnikërinë e tij e të partisë jugosllave ndaj marksizëm-leninizmit, mbi karakterin socialist të vetadministrimit, mbi politikën e brendshme e të jashtme «marksiste-leniniste» që gjoja ndjekin titistët, për të treguar se demaskimi që i është bërë Titos për deviacione antimarksiste, për politikë shoviniste, reaksionare, proimperialiste, për revizionizëm nuk qenka gjë tjetër veçse shpifje e stalinistëve dhe, mbi këtë

bazë, kërkon të rritë namin e tij në shkallë ndërkom-bëtare.

Hua Kuo Feni, nga ana e tij, i shfrytëzon marrëdhëniet me Jugosllavinë për të ashtuquajturën hapje të Kinës drejt Evropës. Gjithashtu miqësinë me titistët, që mbahen si kampionë të «mosangazhimit», revizionistët kinezë përpiqen ta shfrytëzojnë si një kanal të rëndësishëm nëpërmjet të cilit të mund të depërtojnë në «vendet e paangazhuara» dhe të vendosin atje sundimin e tyre. Jo pa qëllim Hua Kuo Feni, gjatë vizitës së tij në Jugosllavi, e ngriti në qiell lëvizjen e «të paangazhuarve» si «forcën shumë të rëndësishme në luftën e popujve të botës kundër imperializmit, kolonializmit dhe hegjemonizmit». Ai i thuri lëvdata kësaj lëvizjeje dhe Titos, sepse ëndërron që ta shtjerë në dorë këtë lëvizje dhe qendra e saj të bëhet Pekini.

Politika e socialimperializmit kinez në të gjitha drejtimet e saj është politika e një fuqie të madhe imperialiste, ajo është një politikë kundërrevolucionare e luftënxitëse, prandaj do të urrehet, do të kundërshtohet e do të luftohet gjithnjë e më shumë nga popujt.



Superfuqitë imperialiste, për të cilat folëm më lart, do të mbeten imperialiste dhe luftënxitëse dhe në mos sot, nesër do ta futin botën në një luftë të madhe atomike.

Imperializmi amerikan përpiqet t'i thellojë gjith-

një e më shumë ganxhat e tij në ekonominë e popujve të tjerë, kurse socialimperializmi sovjetik, që porsa i ka hapur thonjtë e vet, përpiqet t'i ngulë ata në vende të ndryshme të botës për të krijuar dhe për të forcuar edhe ai nga ana e vet pozita neokolonialiste e imperialiste. Por ekziston edhe «Evropa e Bashkuar», e lidhur në NATO me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ka tendenca imperialiste, jo të koncentruara, por të veçanta. Nga ana tjetër, në valle ka hyrë dhe Kina, që kërkon të bëhet superfuqi, si dhe militarizmi japonez që është ngritur. Këta dy imperializma po lidhen në aleancë me njëri-tjetrin për të formuar një fuqi imperialiste në kundërshtim me të tjerët. Në këto kushte shtohet rreziku i madh i luftës botërore. Aleancat aktuale ekzistojnë, por këto do të shkojnë duke u dislokuar, në kuptimin e ndryshimit të drejtimeve, por jo të brendisë së tyre.

Fjalët e bukura që thuhet për çarmatimin në OKB e në konferenca të ndryshme ndërkombëtare që organizojnë imperialistët, janë demagogji. Ata kanë krijuar dhe mbrojnë monopolin e armëve strategjike, zhvillojnë tregtinë e madhe të armëve, jo për të garantuar paqen e sigurinë e kombeve, por për të nxjerrë superfitime dhe për të shtypur revolucionin e popujt, për të shpërtëyer luftërat agresive. Stalini ka thënë:

*«Shtetet borgjeze armatosen dhe riarmatosen me tërbim. Përse? Sigurisht, jo për muhabet, po për luftë. Dhe lufta u nevojitet imperialistëve, sepse ajo është mjeti i vetëm për rindarjen e botës, për rindarjen e tregjeve të shitjes,*

*e burimeve të lëndëve të para dhe të sferave të përdorimit të kapitalit»<sup>1</sup>.*

Në rivalitetin e tyre, që i çon drejt luftës, superfuqitë, sigurisht do të shkaktojnë shumë luftëra të pjesshme, të cilat do t'i nxitin në mes shteteve të ndryshme të «botës së tretë», të «vendeve të paangazhuara» ose të «vendeve në zhvillim».

Presidenti Karter ka shprehur mendimin se lufta mund të ndodhë vetëm në dy pika të globit tokësor, në Lindjen e Mesme e në Afrikë. Dhe kuptohet pse, se pikërisht në këto dy rajone të botës aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa më të mëdhenj. Në Lindjen e Mesme ndodhet nafta dhe në Afrikën e pasur përplasen interesat e mëdhenj ekonomikë dhe strategjikë neokolonialistë për ndarjen e tregjeve dhe të zonave të influencës në mes superfuqive, të cilat kërkojnë të ruajnë e të forcojnë pozitat e tyre dhe të fitojnë pozita të tjera.

Por zona të tilla ku përplasen interesat e superfuqive, veç Lindjes së Mesme dhe Afrikës, ka edhe të tjera, si, për shembull, në Azinë Juglindore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik plus Kina, përpiqen të vendosin zonat e tyre të influencës dhe të ndajnë tregjet. Kjo krijon edhe konflikte, të cilat herë pas here kthehen në luftëra lokale, që nuk kanë aspak për qëllim çlirimin e popujve, por vendosjen ose zhvendosjen e klikave sunduese të kapitalit vendas, që janë herë me njëjërën superfuqi dhe

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 12, f. 242-243.

herë me tjetrën. Socialimperializmi sovjetik dhe imperializmi amerikan janë dy kuçedra ndaj të cilave popujt nuk kanë besim. Po kështu popujt nuk kanë besim as te Kina.

Kur superfuqitë të mos arrijnë t'i realizojnë interesat e tyre grabitqarë me mjetet ekonomike, ideologjike dhe diplomatike, kur kontradiktat të jenë aca-ruar në shkallën më të mprehtë, kur marrëveshjet dhe «reformat» të mos jenë në gjendje t'i zgjidhin këto kontradikta, atëherë fillon lufta ndërmjet tyre. Prandaj popujt, që do të gjakosen në këtë luftë, duhet të përpiqen me të gjitha forcat të mos kapen në be-fasi, që luftën grabitqare ndër imperialiste ta sabotojnë, që ajo të mos marrë përmasa botërore dhe, në qoftë se s'ia arrijnë dot kësaj, ta kthejnë në luftë çlirimtare dhe të fitojnë.

## **Roli i titizmit dhe i rrymave të tjera revizioniste në strategjinë globale të imperializmit e të socialimperializmit**

Në luftën e egër që bëjnë imperializmi dhe social-imperializmi, kapitalizmi botëror dhe reaksioni, kundër revolucionit, socializmit dhe popujve ata kanë përkrah revizionistët modernë të të gjitha rrymave. Këta renegatë e tradhtarë ndihmojnë në zbatimin e strategjisë globale të imperializmit duke minuar nga brenda, duke përçarë e duke sabotuar përpjekjet e proletariatit dhe luftën e popujve për të hequr qafe zgjedhën shoqërore e kombëtare. Revizionistët moder-

në kanë marrë përsipër të denigrojnë e të shtrembërojnë marksizëm-leninizmin, të çoroditin mendjet e njerëzve dhe t'i largojnë këta nga lufta revolucionare, të ndihmojnë kapitalin për ruajtjen e përjetësimin e sistemit të tij të shtypjes e të shfrytëzimit.

Krahas revizionistëve sovjetikë dhe atyre kinezë, për të cilët folëm më sipër, në lojën e madhe e të rrezikshme kundërrevolucionare një rol të dorës së parë luajnë revizionistët titistë jugosllavë.

Titizmi është një agjenturë e vjetër e kapitalit, një armë e preferuar e borgjezisë imperialiste në luftën kundër socializmit e lëvizjeve çlirimtare.

Popujt e Jugosllavisë luftuan me vetëmohim kundër pushtuesve nazifashistë për liri, demokraci e socializëm. Ata arritën të çlirojnë vendin, por udhëheqësit revizionistë nuk i lanë të vazhdonin revolucionin në rrugën e socializmit. Udhëheqja revizioniste jugosllave, me Titon në krye, që gjatë kohës së luftës hiqej sikur ruante tiparet e një partie të Internacionales së Tretë, në fakt kishte synime të tjera, në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me aspiratat e popujve të Jugosllavisë për ndërtimin e një shoqërie me të vërtetë socialiste në Jugosllavi.

Partia Komuniste e Jugosllavisë që erdhi në fuqi, kishte trashëguar mjaft gabime të natyrës deviancioniste. Pas Luftës së Dytë Botërore ajo manifestoi tipare të theksuara nacionalshoviniste, të cilat kishin nxjerrë kokën që në kohën e luftës. Këto tipare u dukën në largimin e saj nga ideologjia marksiste-leniniste, në qëndrimet e saj ndaj Bashkimit Sovjetik e Sta-

llnit, në qëndrimet e veprimet e saj shoviniste kundrejt Shqipërisë e të tjera.

Sistemi i demokracisë popullore që u vendos në Jugosllavi, ishte i përkohshëm, ai nuk i përshtatej klikës në fuqi, megjithëse kjo klikë vazhdonte të vetëqehet «marksiste». Titistët nuk ishin për ndërtimin e socializmit, ata nuk ishin për atë që Partia Komuniste e Jugosllavisë të udhëhiqej nga teoria marksiste-leniniste dhe nuk pranonin diktaturën e proletariatit. Këtu e kishte burimin konflikti që shpërtheu midis Byrosë Informative të Partive Komuniste e Punëtore dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ky ishte një konflikt ideologjik në mes marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit dhe jo një konflikt midis personash për arsye «dominimi», siç duan ta paraqesin revizionistët. Stalini mbante pastërtinë e teorisë marksiste-leniniste, Titoja mbante rrymën devacioniste, revizioniste, antimarksishte të revizionizmit modern, duke ecur në gjurmët e Brauderit e të oportunistëve të tjerë, që dolën në prag të gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Udhëheqja jugosllave, në vitet e para të çlirimit, hiqej sikur po merrte si shembull ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe shpalli se gjoja po ndërtonte socializmin në Jugosllavi. Kjo bëhej për të mashtruar popujt e Jugosllavisë që kishin derdhur gjak dhe aspironin për socializmin e vërtetë.

Në fakt, titistët as ishin e as mund të ishin për rëndin shoqëror socialist dhe për formën e organizimit të shtetit sovjetik, sepse Titoja ishte për sistemin kapitalist dhe për një shtet në thelb demokratiko-borgjez, ku fuqinë ta kishte klika e tij. Ky shtet do të shërbente

për të krijuar idenë se në Jugosllavi po ndërtohej socializmi, veç një socializëm «specifik» i një «tipi më human», pikërisht ai farë «socializmi» që do të shërbente si një kolonë e pestë në vendet e tjera socialiste. Gjithçka ishte e llogaritur dhe e koordinuar mirë nga imperialistët anglo-amerikanë dhe grupi titist. Kështu revizionistët jugosllavë, duke bërë lojën e imperializmit dhe të kapitalizmit botëror e duke ardhur në ujdi me ta, u vunë në kundërshtim me Bashkimin Sovjetik.

Imperializmi anglez, dhe më pas ai amerikan, në vazhdim të planeve të tyre të vjetra, që në kohën e luftës antifashiste nacionalçlirimtare, e ndihmuan Titon jo vetëm që ky të shkëputej nga Bashkimi Sovjetik, por që të ndërmernte edhe veprime sabotimi kundër tij e sidomos të punonte për të shkëputur nga kampi socialist edhe vende të tjera të demokracisë popullore, me qëllim që ta izolonte Bashkimin Sovjetik nga të gjitha këto vende dhe t'i bashkonte ato me Perëndimin. Kjo ishte politika e kapitalizmit botëror dhe e agjenturës së tij, titizmit.

Çerçilli, ky antikomunist i tërbuar, u interesua drejtpërsëdrejti dhe personalisht për ta vënë Titon dhe grupin e tij në shërbim të kapitalizmit. Gjatë luftës ai dërgoi në shtabin e Titos «miqtë e tij më të besueshëm», siç shprehet vetë lideri britanik, pastaj djalit e vet. Më në fund u takua vetë me të në Napoli të Italisë, në gusht 1944, për t'u siguruar plotësisht se Titoja nuk ia kishte me dredhi. Në kujtimet e tij, Çerçilli shkruan se në bisedimet me Titon, ky i fundit u tregua i gatshëm të bënte më vonë edhe një dekla-



ratë të hapët se «komunizmi nuk ka për t'u vendosur në Jugosllavi pas luftës».

Titoja veproi me energji të madhe për t'u shërbyer padronëve të tij, saqë Çerçilli, duke ia çmuar shërbimet e mëdha, i pati deklaruar: «Unë tash e kuptoj që ju kishit të drejtë, prandaj jam me ju, unë ju dua shumë e më shumë nga ç'ju kam dashur përpara». Nuk ka si të bëhen deklarata më të ngrohta nga një dashnor për dashnoren e tij.

Pa u shkëputur mirë nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, Jugosllavisë i erdhën ndihmat e mëdha ekonomike, politike, ideologjike, ushtarake nga imperialistët, sidomos nga imperializmi amerikan, ndihma të cilat më vonë u bënë më të shpejta e të vazhdueshme.

Këto ndihma u dhanë vetëm me kusht që vendi të zhvillohej në rrugën kapitaliste. Borgjezia imperialiste nuk ishte kundër që Jugosllavia të ruante nga jashtë format socialiste, përkundrazi i interesonte shumë që kjo të mbante një bojë socialiste në sipërfaqe, sepse do të shërbente si një armë më efikase në luftën kundër socializmit e lëvizjeve çlirimtare. Ky lloj «socializmi» jo vetëm do të ndryshonte krejt, por edhe do të dilte kundër socializmit të parashikuar e të realizuar nga Lenini e Stalini.

Brenda një kohe relativisht të shkurtër Jugosllavia u bë zëdhënësja «socialiste» e imperializmit amerikan, një agjenturë diversioniste në ndihmë të kapitalit botëror. Që nga viti 1948 e deri tash, titizmi karakterizohet nga një veprimtari e ethshme kundër marksizëm-leninizmit, për organizimin kudo në botë të

një fushate propagandistike që ta paraqesë sistemin jugosllav si formën e një rendi «socialist të vërtetë», si një «shoqëri të re», një «socializëm të paangazhuar», që nuk është më si ai që kishin ndërtuar Lenini dhe Stalini në Bashkimin Sovjetik, por një rend socialist «me fytyrë njerëzore» që provohet për herë të parë në botë dhe që jep «rezultate të shkëlqyeshme». Kjo propagandë ka synuar e synon të futë në rrugë pa krye popujt dhe forcat përparimtare, që luftojnë për liri e pavarësi kudo në botë.

Revizionistët jugosllavë adoptuan në vendin e tyre ato forma qeverisjeje që u përpoqën të adoptonin në kohën e Leninit në Bashkimin Sovjetik trockistët dhe elementët e tjerë anarkistë të nxitur nga borgjezia kapitaliste për të sabotuar ndërtimin e socializmit. Duke adoptuar këto forma, Titoja, ndërsa fliste se ndërtonte gjoja socializmin, i deformoi krejt parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të industrisë, të bujqësisë etj.

Republikat e Jugosllavisë morën një fizionomi të atillë administrimi dhe drejtimi organizativo-politik, saqë centralizmi demokratik u likuidua, roli i Partisë Komuniste të Jugosllavisë u venit. Partia Komuniste e Jugosllavisë ndërroi emër, ajo u shndërrua në «Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë», term ky marksist në dukje, po antimarksist në përmbajtje, në normë, në kompetenca dhe në qëllime. Lidhja u bë një front pa kolonë vertebrale, u zhvesh nga tiparet dalluese të një partie marksiste-leniniste, ruajti formën e vjetër, por nuk luante më rolin e pararojës së klasës punëtore, nuk ishte më forcë politike që udhëhiqte Republikën

Federative të Jugosllavisë, por kryente gjoja, siç thoshin revizionistët, vetëm funksione «edukuese» të përgjithshme.

Udhëheqja titiste e vuri partinë nën vartësinë dhe kontrollin e UDB-së, e ktheu atë në një organizatë fashiste, kurse shtetin në një diktaturë fashiste. Rreçikshmërinë e madhe të këtyre veprimeve ne e njohim mirë, sepse të njëjtën gjë synoi të realizonte edhe në Shqipëri agjenti i titistëve, Koçi Xoxe.

Titoja, Rankoviçi dhe agjentura e tyre likuiduan krejtësisht çdo gjë që mund të kishte ngjyrën e vërtetë të socializmit. Një luftë e rreptë u bë nga ana e titizmit kundër orvatjeve të atyre elementëve të brendshëm që kërkonin ta hidhnin në erë këtë agjunkturë dhe këtë organizatë kapitalisto-revizioniste, si edhe kundër gjithë propagandës marksiste-leniniste që zhvillohej jashtë dhe që demaskonte këtë regjim, i cili e hiqte veten socialist.

Udhëheqja titiste e braktisi shpejt kolektivizimin e bujqësisë, që kishte nisur të bëhej në vitet e para, krijoi format shtetërore kapitaliste, nxiti zhvillimin e pronës private në fshat, la të lirë shitblerjen e tokave, rchabilitoi kulakët, i la fushë të lirë lulëzimit të tregut privat në qytet e në fshat, bëri reformat e para që forconin drejtimin kapitalist të ekonomisë.

Ndërkohë, borgjezia titiste ishte në kërkim të një forme «të re» për maskimin e rendit kapitalist jugosllav dhe kjo formë u gjet. Emrin ia vunë vetadministrimi jugosllav. I veshën këtij një petk «marksist-leninist», duke pretenduar se ky sistem është socializmi më autentik.

Në fillim vetadministrimi lindi si një sistem ekonomik, pastaj u shtri në fushën e organizimit shtetëror dhe në të gjitha fushat e tjera të jetës së vendit.

Teoria dhe praktika e vetadministrimit jugosllav janë një mohim i hapur i mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe i ligjeve të përgjithshme të ndërtimit të socializmit. Sistemi ekonomik e politik vetadministrues është një formë anarkosindikaliste e diktaturës borgjeze, që sundon në Jugosllavinë e varur nga kapitali ndërkombëtar.

Sistemi vetadministrues me të gjitha tiparet e tij dalluese, siç janë eliminimi i centralizmit demokratik, i rolit të drejtimit unik të shtetit, federalizmi anarkist, ideologjia antishtet në përgjithësi, ka sjellë në Jugosllavi një rrëmujë e një konfuzion të përhershëm ekonomik, politik e ideologjik, një zhvillim të dobët e të pabarabartë midis republikave e krahinave të saj, diferencime të mëdha shoqëro-klasore, grindje e shtypje kombëtare dhe degjenerim të jetës shpirtërore. Ai ka krijuar një copëtim të madh të klasës punëtore, duke vënë nën njëri repart të saj në konkurrencë kundër tjetrit, duke ushqyer frymën sektoriale, lokaliste e individualiste borgjeze. Klasa punëtore në Jugosllavi jo vetëm nuk ka rolin hegjemon në shtet e në shoqëri, por sistemi i vetadministrimit e vë në kushte të atilla që të mos jetë në gjendje të mbrojë interesat e vet të përgjithshëm, të mos veprojë e bashkuar e kompakte.

Në Jugosllavi janë derdhur në formë investimesh, kredish e borxhesh, kapitale të mëdha të botës kapitaliste, sidomos të imperializmit amerikan. Janë këto kapitale që përbëjnë bazën materiale të «zhvillimit» të

«socializmit vetadministrues» kapitalist jugosllav. Vetëm borxhet arrijnë mbi 11 miliardë dollarë. Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës Jugosllavia ka marrë mbi 7 miliardë dollarë kredi.

Me gjithë kreditë e shumta që merr nga jashtë udhëheqja titiste, popujt e Jugosllavisë nuk i provuan dhe nuk po i provojnë «rezultatet e shkëlqyera» të «socializmit» specifik. Përkundrazi, në Jugosllavi ka një kaos politik dhe ideologjik, atje mbretëron një sistem që krijon papunësi të madhe brenda dhe emigrim të madh të krahut të punës jashtë, gjë që e bën Jugosllavinë krejtësisht të varur nga fuqitë imperialiste. Popujt e jugosllavisë shfrytëzohen deri në palcë për interesat e klasës në fuqi dhe për interesat e të gjitha fuqive imperialiste që kanë bërë investime në këtë vend.

Shtetit jugosllav nuk i bëhet vonë kur çdo ditë emimet ngrihen, kur varfëria e masave punonjëse shtohet vazhdimisht dhe kur vendi është kredhur jo vetëm në borxhe, por është zhytur thellë në krizën e madhe të botës kapitaliste. Jugosllavia ka një pavarësi dhe një sovranitet të cinguar, pse, veç të tjerave, nuk ka një potencial ekonomik krejt të vetin. Pjesën kryesore e ka të përbashkët me firma dhe me shtete të ndryshme kapitaliste të huaja, prandaj ajo nuk mund veçse të provojë në kurrizin e saj efektet shkatërrimtare të krizës dhe të shfrytëzimit të huaj.

Por kapitalizmi botëror jo rastësisht e mbështet kaq shumë politikisht dhe financiarisht vetadministrimin jugosllav dhe i mban iso propagandës titiste për ta shitur këtë sistem si «formë të re të sprovuar të ndërtimit të socializmit» për të gjitha vendet.

Këtë e bën pse forma e vetadministrimit jugosllav është një rrugë subversioni e diversioni ideologjik e politik kundër lëvizjeve revolucionare çlirimtare të proletariatit e të popujve, është një mënyrë për t'i hapur shtigjet depërtimit politik dhe ekonomik të imperializmit në vendet e ndryshme të botës. Për rrethana të ndryshme dhe për vende të ndryshme, imperializmi dhe borgjezia duan ta mbajnë vetadministrimin si një sistem rezervë për t'i zgjatur jetën kapitalizmit, që nuk jep shpirt kollaj, por përpiket të gjejë forma të ndryshme qeverisjeje në kurriz të popujve.

Një shërbim të madh u sjellin imperialistëve të ndryshëm teoritë dhe praktikat jugosllave të «mosangazhimit», pse ato ndihmojnë për mashtrimin e popujve. Kjo u intereson si imperialistëve, ashtu edhe socialimperialistëve, sepse i ndihmon për të vendosur e për të forcuar influencën e tyre në «vendet e paangazhuara», për të larguar popujt liridashës nga rruga e çlirimit kombëtar dhe e revolucionit proletar. Prandaj, si Karteri, si Brezhnjevi, ashtu edhe Hua Kuo Feni e mburrin politikën titiste të «të paangazhuarve» dhe përpiqen ta shfrytëzojnë për qëllimet e tyre.

Titizmi ka qenë dhe mbetet një armë e borgjezisë imperialiste, një zjarrfikës i revolucionit. Ai qëndron në një radhë, ka të njëjtat qëllime dhe është në unitet ideologjik me revizionizmin modern në përgjithësi dhe me variantet e ndryshme të tij. Rrugët, format, taktikat që përdorin në luftë kundër marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit mund të jenë të ndryshme, por qëllimet kundërrevolucionare janë të njëjta.

Në përpjekjet që bëjnë borgjezia dhe reaksioni për të shuar luftën revolucionare të proletariatit dhe të popujve, një shërbim të madh u sjellin atyre partitë revizioniste të Evropës, në radhë të parë, si dhe të vendeve të tjera në të gjitha kontinentet.

Partitë revizioniste të vendeve të Evropës Perëndimore po bëjnë përpjekje për të ngritur në këmbë një teori për një «shoqëri të re» të ashtuquajtur socialiste, e cila do të arrihet me «reforma strukturore» dhe në koalicion të ngushtë me partitë socialdemokrate, deri edhe me partitë e djathta. Kjo shoqëri, sipas tyre, do të ndërtohet në baza të reja, me «reforma sociale», me «paqe sociale», me «rrugë parlamentare», me «kompromisin historik» me partitë borgjeze.

Partitë revizioniste të Evropës, si ajo e Italisë, e Francës dhe e Spanjës, e pas tyre të gjitha partitë e tjera revizioniste të Perëndimit, mohojnë leninizmin, luftën e klasave, revolucionin dhe diktaturën e proletariatit. Ato janë futur të tëra në një rrugë kompromisi me borgjezinë kapitaliste. Kjo vijë antimarksiste emërtohet prej tyre eurokomunizëm. Eurokomunizmi është një rrymë e re pseudokomuniste që është edhe s'është në kundërshtim me bllokun revizionist sovjetik. Ky qëndrim i lëkundshëm shpjegohet me qëllimin për të pasur një bashkëzistencë idesh me socialdemokracinë evropiane; me të gjitha pikëpamjet e ndryshme që ziejnë në kazanin e Evropës. Eurokomunistët mund të bashkohen me cilindo, me përjashtim të atyre që luftojnë për triumfin e revolucionit dhe për pastërtinë e ideologjisë marksiste-leniniste.

Të gjitha rrymat revizioniste, oportuniste, social-

demokrate punojnë si e si që të ndihmojnë superfuqitë në veprimet djallëzore për shtypjen e revolucionit dhe të popujve. Mbështetja nga këto rryma e organizmave gjoja të rinj të borgjezisë ka të vetmin qëllim të mbytë revolucionin, duke i nxjerrë këtij një mijë e një pengesa materiale, politike, ideologjike. Ato punojnë që të çoroditin dhe të përçajnë proletariatin dhe aleatët e tij, se e dinë që të ndarë e të përçarë në luftëra fraksionale këta nuk do të mundin të krijojnë as brenda një vendi, as në platformën ndërkombëtare atë unitet ideologjik, politik dhe luftarak që është i domosdoshëm për të përballuar sulmet e kapitalizmit botëror në kalbëzim.

Koalicioni i revizionizmit modern me socialdemokracinë i trembet ardhjes së fashizmit, sidomos në disa vende që kërcënohen nga e djathta ekstreme. Për të evituar diktaturën fashiste, revizionistët e socialdemokratët bëjnë përpjekje për «zbutjen» e kontradiktave e të luftës klasore në mes masave të popullit dhe proletariatit, nga njëra anë, dhe borgjezisë kapitaliste, nga ana tjetër. Pra, që të sigurojnë një «paqe shoqërore», këta subjektë të koalicionit duhet t'i bëjnë lëshime njëri-tjetrit dhe të bien në kompromis me borgjezinë kapitaliste, të bien në ujdi me të për njëfarë regjimi të përshtatshëm për të dyja palët. Kështu, ndërsa borgjezia kapitaliste dhe partitë e saj vazhdojnë hapur luftën e tyre kundër komunizmit, partitë revizioniste përpiqen të shtrembërojnë marksizëm-leninizmin, ideologjinë udhëheqëse të revolucionit.

Mbështetje të partive revizioniste të Evropës janë bërë sindikatat reformiste, të edukuara dhe të stërvi-



tura posaçërisht në kompromise me patronatin dhe vetëm për reklamime lëmshash ekonomike e jo për greva me kërkesa politike dhe me synime për marrjen e pushtetit nga proletariati. Natyrisht, pazarllëku drejtohet në balancimin e kërkesës dhe të ofertës, një pjesë kërkon lëmshë dhe pjesa tjetër përcakton masën e kësaj lëmoshe. Të dyja palët, si sindikatat reformiste e partitë revizioniste, ashtu dhe patronati me partitë, me pushtetin dhe me sindikatat e tij, kërcënohen nga revolucioni, nga proletariati, nga partitë e tij të vërteta marksiste-leniniste. Prandaj ato janë në kërkim të një kompromisi reaksionar, zgjidhje kjo që nuk mund të jetë e njëlojtë në të gjitha vendet kapitaliste, për arsye të ndryshimeve të forcës së kapitalit, të përmaseve të thellimit të krizës dhe të gjerësisë së kontradiktave që i brejnë nga brenda.

## **Revolucioni — arma e vetme për të shkatërruar strategjinë e armiqve të proletariatit dhe të popujve**

Të gjithë armiqtë, imperialistët, socialimperialistët dhe revizionistët e ndryshëm, së toku dhe veç e veç luftojnë për të gënjyer njerëzimin përparimtar, për të diskredituar marksizëm-leninizmin dhe veçanërisht për të shtrembëruar teorinë leniniste të revolucionit, për të shtypur revolucionin, çfarëdo rezistencë popullore e luftë nacionalçlirimtare.

Arsenali i armiqve të marksizëm-leninizmit është i madh, por edhe forcat e revolucionit janë kolosale.

Janë pikërisht këto forca që ziejnë, që ndeshen, që luftojnë, që ua kanë prishur gjumin dhe ua bëjnë të pamundur jetën botës kapitaliste dhe reaksionit botëror.

*«Një fantazëm sillot nëpër Evropë — fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës plakë... janë bashkuar për t'i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme»<sup>1</sup>.*

Ky konstatim i Marksit dhe i Engelsit është aktual edhe në ditët tona. Imperializmi, socialimperializmi dhe revizionizmi modern mendojnë se rreziku i komunizmit është eliminuar për ta, sepse, duke kujtuar se goditja e rëndë që ka pësuar revolucioni nga tradhtia revizioniste është e pandreqshme, ata e nënvleftësojnë forcën e marksizëm-leninizmit, mbivlerësojnë forcat materiale, ushtarake shtypëse dhe forcën ekonomike që kanë në dispozicionin e vet. Ky është vetëm një iluzion i tyre.

Proletariati botëror po i mbledh forcat. Ai dhe popajt liridashës po e kuptojnë çdo ditë e më shumë nga vetë përvoja e tyre tradhtinë e revizionistëve modernë titistë, hrushovianë, kinezë, eurokomunistë e të tjerë. Koha punon për revolucionin, për socializmin dhe jo për borgjezinë dhe imperializmin, jo për revizionizmin modern e reaksionin botëror. Zjarri i revolucionit zien kudo në zemrat e popujve të shtypur që dëshirojnë të fitojnë lirinë, demokracinë, sovran-

---

1. K. Marks e F. Engels, «Manifesti i Partisë Komuniste», Tiranë, 1974, f. 13.

tetin e vërtetë, të marrin fuqinë në duart e tyre dhe të shkojnë në rrugën e socializmit, duke shkatërruar imperializmin dhe shërbëtorët e tij.

Aktualisht po ndodh ai fenomen i kohës së Leninit, kur ndarja nga Internacionalja e Dytë u pasua nga krijimi i partive të reja marksiste-leniniste. Tradhtia revizioniste ka sjellë dhe do të sjellë doemos krijimin e forcimin kudo të partive të vërteta komuniste, të cilat kanë marrë në dorë dhe kanë ngritur lart flamurin e marksizëm-leninizmit e të revolucionit, të flakur poshtë e të shkelur me këmbë nga revizionistët. Atyre u bie barra që strategjisë globale të imperializmit botëror e të revizionizmit t'i kundërvënë strategjinë e lavdishme leniniste të revolucionit, teorinë e madhe të marksizëm-leninizmit. Atyre u bie barra të bëjnë plotësisht të ndërgjegjshme masat për qëllimet dhe rrugën e drejtë të luftës, për sakrificat që nevojiten, t'i bashkojnë ato, t'i organizojnë, t'i udhëhoqin dhe t'i çojnë në fitore.

Ne, marksistë-leninistët, që jemi në ballë të luftës titanike që po zhvillohet sot në mes proletariatit dhe popujve të shtypur që aspirojnë për liri, nga njëra anë, dhe imperialistëve të egër e gllabërues, nga ana tjetër, duhet të kuptojmë mirë qëllimet, taktikat, mënyrat dhe format e luftës së armiqve të përbashkët dhe të armiqve të veçantë të çdo vendi. Këtë gjë ne nuk mund ta shohim si duhet, në rast se nuk mbështetemi fort në teorinë marksiste-leniniste të revolucionit, në qoftë se nuk shohim se në situatat aktuale dhe në të ardhmen ekzistojnë dhe do të ekzistojnë një sërë hallkash të dobëta të zinxhirit kapitalist botëror,

në të cilat revolucionarët dhe popujt duhet të zhvillojnë një veprimtari të pandërprerë, një luftë të organizuar, të paepur e të guximshme që këto hallka të çahen njëra pas tjetrës. Kjo, natyrisht, kërkon punë, kërkon luftë, sakrifica dhe vetëmohim. Popujt dhe njerëzit e guximshëm, të udhëhequr nga interesat e revolucionit, mundet dhe do t'u bëjnë ballë forcave të mëdha të imperializmit, socialimperializmit dhe reaksionit, të cilat po lidhen me njëra-tjetrën, po krijojnë aleanca të reja dhe kërkojnë rrugëdalje nga situatat e vështira që u krijojnë. Këto situata të vështira këtyre forcave regresive ua krijojnë revolucionarët, marksistë-leninistët, lufta e popujve në të gjitha kontinentet, në të gjitha vendet.

Komunistët, kudo në botë, s'kanë pse të tremben nga mitet false që kanë predominuar në mendimin revolucionar për një kohë. Komunistët duhet të luftojnë për të fituar ata që gabojnë me qëllim që t'i ndreqin, duke bërë për këtë përpjekje të mëdha, natyrisht, pa rënë vetë në oportunizëm. Në procesin e luftës parimore, në fillim do të ketë disa reperkusione lëkundjesh, po lëkundjet do të duken në të lëkundurit, kurse tek ata që janë të vendosur dhe e zbatojnë drejt teorinë marksiste-leniniste, që i shohin drejt interesat e proletariatit të vendit të tyre, të proletariatit botëror dhe të revolucionit, nuk do të ketë lëkundje, përkundrazi, kur ata të shohin se shokët qëndrojnë të paturdur në mendimet e tyre revolucionare marksiste-leniniste, do të forcohen më tej në luftën e tyre.

Në rast se marksistë-leninistët e zbatojnë drejt e me vendosmëri teorinë marksiste-leniniste, në bazë të

kushteve të sotme ndërkombëtare dhe të kushteve kombëtare të çdo vendi, në rast se e forcojnë pa pushim unitetin internacionalist proletar, në luftë të pamëshirshme kundër imperializmit dhe revizionizmit modern të të gjitha rrymave, ata me siguri do t'i kapërcojnë të gjitha vështirësitë që do të hasin në rrugën e tyre, qofshin këto edhe shumë të mëdha. Marksizëm-leninizmi dhe parimet e tij të pavdekshme, të zbatuara si duhet, do të sjellin në mënyrë të pashmangshme shkatërrimin e kapitalizmit botëror dhe fitoren e diktaturës së proletariatit, me anën e së cilës klasa punëtore do të ndërtojë socializmin dhe do të shkojë drejt komunizmit.

## II

### TEORIA LENINISTE MBI IMPERIALIZMIN MEETET GJITHNJË AKTUALE

Në kushtet e sotme, kur, me pretekstin se situatat kanë ndryshuar, çështja e revolucionit dhe e çlirimit të popujve sulmohet nga revizionistët hrushovianë, titistë, eurokomunistë, kinezë dhe rrymat e tjera antimarksiste, thellimi në studimin e veprave të Leninit mbi imperializmin merr një rëndësi të dorës së parë.

Ne duhet t'u rikthehemi këtyre veprave dhe të studiojmë thellë e me imtësi, veçanërisht veprën gjerniale të Leninit «Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit». Duke studiuar me vëmendje këtë vepër, do të shohim edhe si e shtrembërojnë revizionistët, midis tyre edhe udhëheqësit kinezë, mendimin leninist mbi imperializmin, si i kuptojnë qëllimet, strategjinë dhe taktikat e këtij. Shkrimet, deklaratat, qëndrimet e veprimet e tyre tregojnë se ata e shikojnë krejtësisht gabim natyrën e imperializmit, e shikojnë nga pozita kundërrevolucionare dhe antimarksiste, ashtu siç bënin edhe të gjitha partitë e Internacionales së Dytë

e Ideologët e tyre, Kautski e kompani, të cilët i ka demaskuar pa mëshirë Lenini.

Në qoftë se e studiojmë me vëmendje këtë vepër të Leninit dhe u përmbahemi me besnikëri analizës dhe konkluzioneve gjeniale të tij, do të shohim se imperializmi i ditëve tona ruan plotësisht po ato karakteristika që ka dhënë për të Lenini, se qëndron i patundur përcaktimi leninist i epokës sonë si epoka e imperializmit dhe e revolucioneve proletare, se fitorja e revolucionit është e pashmangshme.

Siç dihet, Lenini e fillon analizën e vet mbi imperializmin me koncentrimin e prodhimit, të kapitalit dhe monopolet. Fenomenet e koncentrimit dhe të centralizimit të prodhimit e të kapitalit edhe sot mund të analizohen drejt e në mënyrë shkencore vetëm duke u bazuar në analizën leniniste të imperializmit.

Karakteristikë e kapitalizmit të sotëm është përqendrimi gjithnjë e më i madh i prodhimit dhe i kapitalit, gjë që ka çuar në bashkimin ose në thithjen e ndërmarrjeve të vogla nga ndërmarrjet e fuqishme. Kjo ka sjellë si pasojë edhe grumbullimin masiv të fuqisë punëtore në truste e në koncerne të mëdha. Këto ndërmarrje kanë përqendruar, gjithashtu, në duart e tyre edhe kapacitete të mëdha prodhuese, burime energjetike dhe lëndë të para në përpjesëtime të palogaritshme. Në kohën e sotme në ndërmarrjet e mëdha kapitaliste po shfrytëzohen edhe energjia bërthamore e teknologjia më e re, që u takojnë ekskluzivisht këtyre ndërmarrjeve.

Organizma të tillë gjigantë kanë karakter kombë-

tar dhe ndërkombëtar. Brenda vendit këta e kanë shkaktërruar shumicën e pronarëve ose të industrialistëve të vegjël, kurse në planin ndërkombëtar janë rritur në koncerne kolosale, që përfshijnë degë të tëra të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimit, të transportit etj. të shumë vendeve. Kudo ku koncertet kanë hedhur kthe-trat e tyre, ku është realizuar përqendrimi i prodhimit nga një grusht i vogël kapitalistësh miliarderë, po zgjerohet dhe thellohet tendenca e likuidimit të pronarëve dhe të industrialistëve të vegjël. Kjo rrugë ka çuar në forcimin e mëtejshëm të monopoleve.

*«Ky shndërrim i konkurrencës në monopol — ka thënë Lenini — është një nga fenomenet më të rëndësishme — në mos fenomeni më i rëndësishëm — në ekonominë e kapitalizmit të sotëm...»<sup>1</sup>.*

Duke folur për këtë tipar të imperializmit, ai shton se

*«... lindja e monopoleve nga koncentrimi i prodhimit është përgjithësisht një ligj i përgjithshëm dhe kryesor i fazës së sotme të zhvillimit të kapitalizmit»<sup>2</sup>.*

Zhvillimi i kapitalizmit në kushtet e sotme vërton plotësisht konkluzionin e sipërm të Leninit. Në ditët tona monopolet janë bërë fenomni më tipik dhe më

1. V. I. Lenini, Veprat, vëll. 22, f. 237.

2. Po aty, f. 241.



i zakonshëm, që përcakton fizionominë e imperializmit, thelbin ekonomik të tij. Në vendet imperialiste, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Republikën Federale të Gjermanisë, në Angli, në Japoni, në Francë etj., koncentrimi i prodhimit ka marrë përpjesëtime të papara.

Kështu, për shembull, në vitin 1976, në 500 korporatat më të mëdha amerikane ishin zënë në punë afër 17 milionë njerëz, të cilët përfaqësonin mbi 20 për qind të fuqisë punëtore të zënë në punë. Atyre u përkitnin 66 për qind e mallrave të shitura. Në kohën kur Lenini shkroi veprën «Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit», në botën kapitaliste ekzistonte vetëm një shoqëri e madhe amerikane, «Junajtid Stejts Still Korpërejshën», që dispononte aktive me vlera mbi një miliard dollarë, kurse në vitin 1976 numri i shoqërive miliardere ishte rreth 350. Trusti i automobilave «Xhenerëll Motërs Korpërejshën», ky supermonopol, në vitin 1975, kishte një kapital të përgjithshëm që i kalonte të 22 miliardë dollarët dhe shfrytëzonte një armatë punëtorësh prej afro 800 000 vetash. Pas tij vijnë me radhë: monopoli «Stëndërd Oil ov Nju Xhërsi», që sundon në industrinë e naftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera dhe që shfrytëzon mbi 700 000 punëtorë; në industrinë e automobilave ka tri monopole të mëdha që realizojnë më se 90 për qind të prodhimit në këtë degë; në industrinë e avionit dhe në atë të metaleve të zeza katër shoqëri shumë të mëdha japin përkatësisht 65 për qind dhe 47 për qind të prodhimit.

I njëjti proces ka ndodhur e po ndodh edhe në

vende të tjera imperialiste. Në Republikën Federale të Gjermanisë 13 për qind e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve kanë përqendruar rreth 50 për qind të prodhimit dhe 40 për qind të fuqisë punëtore të vendit. Në Angli sundojnë 50 monopole të mëdha. Korporata britanike e çelikut përfshin mbi 90 për qind të prodhimit të çelikut të vendit. Në Francë dy shoqëri kanë përqendruar në duart e tyre tri të katërtat e prodhimit të çelikut, katër monopole zotërojnë gjithë prodhimin e automobilave, kurse katër të tjera gjithë prodhimin e produkteve të naftës. Në Japoni dhjetë kompani të mëdha të metalurgjisë së zezë prodhojnë gjithë gizen dhe mbi tri të katërtat e çelikut, ndërsa në metalurgjinë me ngjyra veprojnë tetë kompani. Po kështu ndodh edhe në degë e sektorë të tjerë<sup>1</sup>.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që ende vazhdojnë të ekzistojnë në këto vende, janë në vartësi të drejtpërdrejtë të monopoleve. Ato marrin porosi nga monopolet e punojnë për to, marrin kredi e lëndë të parë, teknologji etj. Praktikisht ato janë shndërruar në shtojca të tyre.

Koncentrimi e centralizimi i prodhimit dhe i kapitalit, duke krijuar monopole gjigante që nuk kanë një unitet teknologjik, sot janë përhapur shumë. Brenda këtyre monopoleve gjigante «konglomerate» veprojnë ndërmarrje dhe degë të tëra të prodhimit industrial, të ndërtimit, të transportit, të tregtisë, të shërbimit, të

---

1. Të dhënat janë nxjerrë nga «Monthly Bulletin of Statistics», United Nations, 1977; nga «Statistical Yearbook»; nga revista amerikane «Fortune», 1976 etj.

Infrastrukturës etj. Këto prodhojnë që nga lodrat e fëmijëve e deri te raketat ndërkontinentale.

Forca ekonomike e monopoleve dhe koncentrimi i kapitalit që është rritur dhe vazhdon të rritet, bëjnë që viktima të luftës së konkurrencës të mos jenë vetëm «foshnjat e vogla», domethënë ndërmarrjet e pamonopolizuara, siç kanë qenë tipike në të kaluarën, por edhe ndërmarrje e grupe të mëdha financiare. Për shkak të etjes së shfrenuar të monopoleve për fitime të larta monopoliste dhe të ashpërsimit në kulm të konkurrencës, ky proces gjatë dy dekadave të fundit ka arritur përpjesëtime kolosale. Shkrirjet dhe gllabërimet sot në botën kapitaliste janë 7 deri 10 herë më të mëdha sesa ato të viteve para Luftës së Dytë Botërore.

Shkrirja dhe bashkimi i ndërmarrjeve industriale, tregtare, bujqësore dhe bankare kanë çuar në krijimin e formave të reja të monopoleve; në krijimin e komplekseve të mëdha industrialo-tregtare ose industrialo-agrarë, forma që po zbatohen gjerësisht jo vetëm në vendet kapitaliste të Perëndimit, por edhe në Bashkimin Sovjetik, në Çekosllovakë, në Jugosllavi dhe në vende të tjera revizioniste. Në të kaluarën bashkimet monopoliste kryenin transportimin dhe shitjen e mallrave me ndihmën e firmave të tjera të pavarura, sot monoilet kanë në dorë si prodhimin, ashtu edhe transportin e tregun.

Monoilet përpiqen jo vetëm të mënjanojnë konkurrencën midis ndërmarrjeve që përfshijnë, por ato kanë hedhur thonjtë për të monopolizuar edhe të gjitha burimet e lëndëve të para, të gjitha zonat e pasura me minerale kryesore, si hekur, qymyr, bakër, ura-

nium etj. Ky proces zhvillohet në planin kombëtar e ndërkombëtar.

Koncentrimi i prodhimit e i kapitalit mori përmasa kolosale, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, me zgjerimin dhe me zhvillimin e sektorit të kapitalizmit monopolist shtetëror.

Kapitalizmi monopolist shtetëror përfaqëson nënshtrimin e aparatit shtetëror ndaj monopoleve, vendosjen e sundimit të plotë të tyre në jetën ekonomike, politike e shoqërore të vendit. Në këtë mënyrë shteti ndërhyr drejtpërsëdrejti në ekonomi në interes të oligarkisë financiare, për të siguruar fitimin maksimal për klasën në fuqi nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë punonjësve si dhe për të mbytur revolucionin dhe luftërat çlirimtare të popujve.

Prona monopoliste shtetërore, si një element bazë më karakteristik i kapitalizmit monopolist shtetëror, përfaqëson jo pronën e një kapitalisti ose të një grupi kapitalistësh të veçantë, por pronën e shtetit kapitalist, pronën e klasës borgjeze që është në fuqi. Në vende të ndryshme imperialiste sektori kapitalist monopolist shtetëror zë 20 deri 30 për qind të prodhimit të përgjithshëm.

Kapitalizmi monopolist shtetëror, që përfaqëson shkallën më të lartë të koncentrimin të prodhimit e të kapitalit, është forma kryesore e pronës që sundon sot në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Ky kapitalizëm monopolist shtetëror është në shërbim të klasës së re borgjeze në fuqi.

Edhe në Kinë, nëpërmjet një varg reformash, siç janë vendosja e fitimit si qëllim kryesor i veprimtarisë

në ndërmarrjet, zbatimi i praktikave kapitaliste të organizimit, të drejtimit dhe të shpërblimit, krijimi i rajoneve ekonomike, i trusteve e i kombinateve që ngjajnë shumë me ato sovjetike, jugosllave e japoneze, hapja e dyerve për kapitalin e huaj, lidhjet e drejtpërdrejta të ndërmarrjeve me monopolet e huaja etj., ekonomia po merr forma tipike të kapitalizmit monopolist shtetëror.

Aktualisht në botën kapitaliste e revizioniste koncentrimi e centralizimi i prodhimit dhe i kapitalit kanë arritur deri në shkallë ndërshtetërore. Këtë tendencë e nxitin dhe e realizojnë në praktikë edhe Tregu i Përbashkët Evropian, KNER-i etj., që përfaqësojnë bashkimin e monopoleve të fuqive të ndryshme imperialiste.

Në kohën e vet Lenini, duke analizuar format e monopoleve ndërkombëtare, fliste për kartelet dhe sindikatat. Në kushtet e sotme, kur koncentrimi i prodhimit dhe i kapitalit ka arritur përpjesëtime shumë të mëdha, borgjezia monopoliste ka gjetur edhe forma të tjera shfrytëzimi të punonjësve. Të tilla janë shoqëritë shumëkombëshe.

Në paraqitjen e jashtme këto shoqëri duan të krijojnë përshtypjen sikur janë në pronësi të përbashkët të kapitalistëve të shumë vendeve. Në të vërtetë, shoqëritë shumëkombëshe, për sa u përket kapitalit dhe kontrollit, i përkasin kryesisht një vendi, ndërsa veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në shumë vende. Ato zgjerohen gjithnjë e më tepër nëpërmjet përfshirjes brenda tyre të shoqërive e të firmave të vogla e të mëdha lokale, që nuk i bëjnë dot ballë konkurrencës së egër.

Shoqëritë shumëkombëshe çelin filiale dhe i shtrijnë ndërmarrjet e tyre në ato vende ku është më e garantuar perspektiva e fitimeve maksimale. Shoqëria shumëkombëshe amerikane «Ford», për shembull, ka vendosur 20 uzina në vende të tjera, ku punojnë 100 mijë punëtorë të kombësive të ndryshme.

Midis shoqërive shumëkombëshe dhe shtetit borgjez ka lidhje të ngushta dhe një vartësi reciproke, që e kanë bazën në karakterin e tyre klasor e shfrytëzues. Shteti kapitalist përdoret si një vegël në shërbim të tyre për qëllime sundimi, ekspansioni, si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Për rolin e madh ekonomik dhe peshën e rëndësishme që zënë në gjithë jetën e vendit, disa shoqëri shumëkombëshe, të marra veças, përbëjnë një forcë të madhe që arrin apo tejkalon në shumë raste buxhetin apo prodhimin e disa vendeve kapitaliste të zhvilluara të marra së bashku. Një ndër shoqëritë e fuqishme shumëkombëshe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, «Xhenërëll Motërs Korpërejshën», e kalon prodhimin industrial të Holandës, të Belgjikës e të Zvicrës të marra së bashku. Ato ndërhyjnë për të siguruar favore dhe privilegje të veçanta në vendet ku veprojnë. Kështu, për shembull, më 1975 pronarët e industrisë elektronike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i kërkuan qeverisë meksikane të ndryshonte kodin e punës që parashikonte disa masa mbrojtëse, ndryshe do ta transferonin industrinë në Kosta-Rika, dhe, për të bërë presion, mbyllën shumë uzina ku punonin afro 12 000 punëtorë meksikanë.

Shoqëritë shumëkombëshe janë leva të imperializ-

mit dhe një nga format kryesore të ekspansionit të tij. Ato janë shtylla të neokolonializmit dhe prekin sovranitetin kombëtar e pavarësinë e vendeve ku veprojnë. Këto shoqëri, për t'i hapur rrugë sundimit të tyre, nuk ndalen përpara asnjë krimi, që nga organizimi i kompleteve, shthurja e ekonomisë e deri te blerja e thjeshtë e zyrtarëve të lartë, e udhëheqësve politikë e sindikalë etj. Skandali Lokhid e provoi këtë më së miri.

Mjaft shoqëri shumëkombëshe janë vendosur dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre edhe në vendet revizioniste<sup>1</sup>. Ato kanë filluar të futen edhe në Kinë.

Koncentrimi dhe centralizimi i prodhimit e i kapitalit, që karakterizojnë sot botën kapitaliste dhe që kanë çuar në një shoqërizim të madh të prodhimit, nuk e kanë ndryshuar aspak natyrën shfrytëzuese të imperializmit. Përkundrazi, ata kanë rritur dhe intensifikuar shtypjen dhe varfërimin e punonjësve. Këto fenomene vërtetojnë katërcipërisht tezën e Leninit se në kushtet e koncentrimit të prodhimit dhe të kapitalit, në imperializëm,

*«Kemi një përparim kolosal të shoqërizimit të prodhimit», por megjithatë «...përvetësimi*

---

1. Në Bashkimin Sovjetik janë vendosur ose kanë byrotë e tyre 17 shoqëri shumëkombëshe amerikane, 18 japoneze, 13 gjermanoperëndimore, 20 franceze, 7 italiane etj. Në Poloni janë vendosur mbi 30 shoqëri shumëkombëshe, prej tyre: 10 amerikane, 6 gjermanoperëndimore, 6 angleze, 3 japoneze etj; në Rumanë 32, në Hungari 31, në Çekosllovakë 30 e kështu me radhë edhe në vende të tjera revizioniste. (Të dhënat janë marrë nga libri «Vodka-Kola», autor Karl Levinson, vitit 1977, f. 79-82).

*mbetet privat. Mjetet shoqërore të prodhimit mbeten pronë private e një numri të vogël personash»<sup>1</sup>.*

Monopolet dhe shoqëritë shumëkombëshe mbeten armiq të mëdhenj të proletariatit dhe të popujve.

Intensifikimi i procesit të koncentrimit të prodhimit e të kapitalit që po zhvillohet në kohën tonë, e ka ashpërsuar më tej kontradiktën themelore të kapitalizmit, kontradiktën midis karakterit shoqëror të prodhimit dhe përvetësimit privat, si dhe të gjitha kontradiktat e tjera. Si në të kaluarën, ashtu edhe sot, të ardhurat dhe superfitimet kolosale që realizohen nga shfrytëzimi i egër i punëtorëve, përvetësohen nga një grusht manjatesh kapitalistë. Mjetet e prodhimit, me të cilat janë pajisur degët e bashkuara të industrisë, janë gjithashtu pronë private e kapitalistëve, ndërsa klasa punëtore mbetet skllave e zotëruesve të mjeteve të prodhimit dhe fuqia e krahut të saj mbetet një plaçkë tregu. Tani ndërmarrjet e mëdha kapitaliste nuk shfrytëzojnë më dhjetëra apo qindra punëtorë, por qindra mijë. Nga shfrytëzimi i egër kapitalist i kësaj armate të madhe punëtorësh, mbivlera e grabitur nga korporatat amerikane vetëm për vitin 1976 llogaritet mbi 100 miliardë dollarë, nga 44 miliardë që ishte në vitin 1960.

Lenini demaskoi oportunistët e Internacionales së Dytë, që predikonin mundësinë e likuidimit të kontradiktave antagonistë të kapitalizmit si rezultat i lindjes

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 247.



dhe i zhvillimit të monopoleve. Ai argumentoi shkencërisht se monopolet, si bartëse të shtypjes, të shfrytëzimit dhe të përvetësimit privat të rezultateve të punës, i ashpërsojnë akoma më shumë kontradiktat e kapitalizmit. Mbi bazën e sundimit të monopoleve ngrihet superstruktura e rendit kapitalist. Kjo superstrukturë mbron dhe përfaqëson, si në planin kombëtar, ashtu edhe në planin ndërkombëtar, interesat grabitqarë të monopoleve. Janë monopolet ato që diktojnë politikën e brendshme e të jashtme ekonomike, sociale, ushtarake etj.

Edhe realiteti i sotëm i koncentrimit të prodhimit e i kapitalit demaskon predikimet e krerëve reaksionarë të socialdemokracisë, të revizionistëve modernë e të oportunistëve të çdo kallëpi se gjoja trustet, pronat e kapitalizmit monopolist shtetëror etj., mund «të shndërrohen» në mënyrë paqësore në ekonomi socialiste, se gjoja kapitalizmi i sotëm monopolist dalngadalë «do të integrohet» në socializëm.

Koncentrimi i prodhimit dhe i kapitalit, na mëson Lenini, shërben si bazë edhe për rritjen e koncentrimit të kapitalit-para, për përqendrimin e tij në duart e bankave të mëdha, për lindjen dhe zhvillimin e kapitalit financiar. Në rrugën e zhvillimit të kapitalizmit, tok me monopolet marrin një zhvillim të madh edhe bankat, të cilat thithin kapitalin-para të monopoleve e të koncerneve, si dhe të prodhuesve ose të kursimtarëve të vegjël. Kështu bankat bëhen zotërueset e mjeteve kryesore financiare në duart e kapitalistëve dhe u shërbejnë këtyre.

I njëjti proces që u krye për eliminimin e ndërmarrjeve të vogla nga ndërmarrjet e mëdha, nga kartelet e monopolet, u vërtetua edhe në likuidimin njëra pas tjetrës të bankave të vogla. Në këtë mënyrë, ashtu si ndërmarrjet e mëdha krijuan monopolet, edhe bankat e mëdha krijuan koncernet e tyre bankare. Në këto dy dekadat e fundit ky fenomen ka marrë përpjesëtime kolosale dhe vazhdon edhe sot me ritme shumë të larta. Karakteristikë dalluese e shkrirjeve dhe e gëlltitjeve të sotme është se ato kanë përfshirë jo vetëm bankat e vogla, por edhe bankat mesatare e relativisht të mëdha. Ky fenomen shpjegohet me ashpërsimin e kontraktave të riprodhimit kapitalist, me zgjerimin e luftës së konkurrencës dhe me krizën e rëndë të sistemit financiar e valutor të botës kapitaliste.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sundojnë 26 grupe të mëdha financiare. Më i madhi prej tyre është grupi Morgan, i cili ka 20 banka të mëdha, shoqëri sigurimi etj. me aktive që arrijnë shumën prej 90 miliardë dollarësh.

Shkalla e koncentrimit dhe e centralizimit të kapitalit bankar është shumë e lartë edhe në vendet e tjera kryesore kapitaliste. Në Gjermaninë Perëndimore ndërmjet 70 bankave të mëdha tri banka zotërojnë mbi 58 për qind të të gjitha aktiveve. Në Angli i gjithë aktiviteti i bankave kontrollohet nga 4 banka, që njihen me emrin «Katërshja e madhe». Gjithashtu i lartë është niveli i koncentrimit të kapitalit bankar edhe në Japoni e në Francë.

Lenini ka argumentuar se kapitali bankar plekset me kapitalin industrial. Në fillim bankat interesohen

për fatin e kredive që u japin industrialistëve. Ato ndërmjetësojnë që industrialistët, të cilët marrin kreditë, të merren vesh midis tyre, të mos zhvillojnë konkurrencë me njëri-tjetrin, sepse nga kjo do ta pësonin edhe vetë bankat. Ky ishte hapi i parë i bankave në pleksjen me kapitalin industrial. Me zhvillimin e koncentrimit të prodhimit dhe të kapitalit-para, bankat bëhen investitore të drejtpërdrejta në ndërmarrjet e prodhimit, duke organizuar shoqëri aksionare të përbashkëta. Në këtë mënyrë, kapitali bankar depërton në industri, në ndërtim, në bujqësi, në transport, në sferën e qarkullimit e kudo gjetkë. Nga ana e tyre ndërmarrjet blejnë aksione të shumta të bankave dhe bëhen pjesëtare të tyre. Aktualisht drejtuesit e bankave dhe të ndërmarrjeve monopoliste bëjnë pjesë në këshillat administrativë të njëri-tjetrit, duke krijuar kështu atë që Lenini e quante «unioni personal». Kapitali financiar që lind nga ky proces, përfshin në vetvete të gjitha format e kapitalit: kapitalin industrial, kapitalin-para dhe kapitalin mall. Duke karakterizuar këtë proces, Lenini ka thënë:

*«Koncentrimi i prodhimit; monopolet që lindin prej tij; shkrirja ose bashkimi i bankave me industrinë — ja historia e lindjes së kapitalit financiar dhe përmbajtja e këtij nocioni»<sup>1</sup>.*

Megjithëse pas Luftës së Dytë Botërore kapitali financiar është rritur dhe ka pësuar ndryshime në stru-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 273.

kturë, ai ka po ato synime që ka pasur gjithnjë, sigurimin e fitimeve maksimale nëpërmjet shfrytëzimit të masave të gjera punonjëse, brenda e jashtë vendit. Këtë rol kanë edhe shoqëritë e sigurimit, që janë shtuar mjaft këto vitet e fundit në vendet kryesore kapitaliste dhe janë bërë konkurrente serioze të bankave. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shembull, në vitin 1970 aktivet e bankave u rritën tri herë e gjysmë në krahasim me nivelin e vitit 1950, ndërsa aktivet e shoqërive të sigurimit, po për këtë periudhë, u rritën gjashtë herë e gjysmë.

Këto shoqëri, me kapitalet që grumbullojnë nga grabitja e popullit, kanë arritur t'u kreditojnë monopoleve shuma të mëdha, që arrijnë në qindra milionë dollarë. Në këtë mënyrë shoqëritë e sigurimit shkrihen e pleksen me monopolet industriale dhe bankare, duke u bërë pjesë organike e kapitalit financiar.

Borgjezia monopoliste, e shtyrë nga etja e pangopur për fitime, shndërron në kapital çdo burim të mjetëve monetare përkohësisht të lira, siç janë kuotat e lëna për pensione nga punonjësit, kursimet e popullsisë etj.

Kapitali financiar i përçendruar nxjerr të ardhura jashtëzakonisht të mëdha jo vetëm nga fitimi që vjen prej thithjes së parave nga koncernet, nga industrialistët e vegjël etj., etj., por edhe nga nxjerrja e letrave me vlerë dhe huatë që praktikon. Aëhtu si për depozitat e kursimeve, edhe për këto jepet një përqindje e vogël fitimi në favor të huadhënësit, por nga këto veprime banka nxjerr për vete fitime kolosale, me të cilat e shton kapitalin e vet, shton investimet që, na-

tyrisht, i sjellin kapitalit financiar fitime të tjera të vazhdueshme. Kapitali financiar investon më shumë në industri, por ai e ka shtrirë rrjetin e spekulimit edhe mbi pasuritë e tjera — mbi tokën, mbi hekurudhat dhe degë e sektorë të tjerë.

Bankat kanë mundësi reale për të dhënë shuma të konsiderueshme kredish, që kërkojnë nga niveli i lartë i koncentrimit të prodhimit dhe i sundimit të monopoleve. Bashkimeve të mëdha monopoliste u krijohen në këtë mënyrë kushte të favorshme për një shfrytëzim më të egër të masave punonjëse brenda vendit, ashtu dhe jashtë tij, për të siguruar fitime maksimale.

Me restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera revizioniste, bankat morën të gjitha tiparet karakteristike monopoliste. Në këto vende ato shërbejnë njëllë si në të gjitha vendet e tjera kapitaliste për shfrytëzimin e masave të gjera punonjëse, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Në vendet kapitaliste e revizioniste gjatë viteve të fundit ka marrë një rritje të shpejtë tregtia me kredi që u jepet konsumatorëve për blerjen e mallrave të konsumit dhe sidomos të mallrave me afat të gjatë përdorimi. Dhënia e kësaj kredie i siguron borgjezisë tregje për shitjen e mallrave, kapitalistët sigurojnë fitime kolosale nëpërmjet përqindjeve të larta të interesit, borxhlinjtë lidhen kokë e këmbë me kreditorët e firmat kapitaliste.

Borxhet e detyrimet e punonjësve ndaj bankave e institucioneve të kreditit në kohën e sotme janë rritur shumë. Vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1976 detyrimet e popullatës për këto lloje kre-

dish kishin arritur shumën prej 167 miliardë dollarësh nga 6 miliardë që ishin në vitin 1945; kurse në Republikën Federale të Gjermanisë detyrimet e popullatës kapnin shumën mbi 46 miliardë marka.

Rritja e koncentrimit dhe e centralizimit të kapitalit bankar ka çuar në rritjen e sundimit ekonomik e politik të oligarkisë financiare dhe në përdorimin e një vargu formash e metodash për të shtuar zgjedhën ekonomike, varfërimin e mjerimin e masave të gjera punonjëse.

Zhvillimi i kapitalit financiar bëri të mundur që në duart e një grushti të vogël kapitalistësh industrialistë e bankierë të fuqishëm të përqendrohet jo vetëm një pasuri e madhe, por edhe një pushtet i vërtetë ekonomik e politik që vepron mbi gjithë jetën e vendit. Këta njerëz të plotfuqishëm janë ata që qëndrojnë në krye të monopoleve e të bankave dhe që përbëjnë atë që quhet oligarkia financiare. Apologjetët e kapitalizmit, nga fakti që shoqëritë e mëdha tani janë kthyer në shoqëri aksionare dhe ku edhe ndonjë punëtor mund të disponojë disa aksione simbolike, përpiqen të vërtetojnë se kapitali tani gjoja e ka humbur karakterin e tij privat që kishte në kohën kur Marksi shkroi «Kapitalin» ose kur Lenini analizoi imperializmin, se ai na qenka bërë popullor. Por kjo është një përrallë. Si më parë, edhe sot, në vendet imperialiste sundojnë grupet e fuqishme industrialo-financiare private, të Rokfele-rëve, Morganëve, Dyponëve, Melonëve, Fordëve, grupi i Çikagos, Teksasit, Kalifornisë etj. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; grupet financiare të Rotshildëve, të Beringëve, të Samuelëve etj. në Angli; të Krupit,

Siemensit, Manesmanit, Tissenit, Gerlingut etj. në Gjermaninë Perëndimore; Fiati, Alfa-Romeo, Montedisoni, Oliveti etj. në Itali; dyqind familjet në Francë e kështu me radhë.

Oligarkia financiare, si poseduese e kapitalit industrial e financiar, ka siguruar sundimin e vet ekonomik dhe politik mbi tërë jetën e vendit. Ajo ua ka nënshtruar interesave të saj edhe aparatit shtetëror, i cili është shndërruar në një instrument në duart e plutokracisë financiare. Oligarkia financiare heq e vendos qeveritë, dikton politikën e brendshme e të jashtme. Në jetën e brendshme ajo është e lidhur me forcat reaksionare, me të gjitha ato institucione politike, ideologjike, arsimore, kulturore që mbrojnë pushtetin e saj politik e ekonomik, kurse në politikën e jashtme ajo mbron e përkrah të gjitha forcat konservatore e reaksionare që mbështetin dhe i hapin rrugën ekspansionit monopolist, që luftojnë për ruajtjen dhe konsolidimin e kapitalizmit.

Për të siguruar sundimin e vet, oligarkia financiare nuk ndalet para asnjë mjeti, duke vendosur reaksionin politik në të gjitha fushat.

*«...kapitali financiar — thoshte Lenini — përpiqet për sundim e jo për liri»<sup>1</sup>.*

Gjendja e sotme provon se shtypja nga ana e borgjezisë monopoliste kudo është rritur. Mbi këtë bazë thellohet kontradikta midis proletariatit dhe borgjezisë. Në të njëjtën kohë, ekspansioni ekonomik e financiar,

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 23, f. 124.

i shoqëruar me atë politik e ushtarak, i ka ashpërsuar më tej kontradiktat midis popujve dhe imperializmit, si dhe kontradiktat midis vetë fuqive imperialiste. Këtë realitet objektiv e të pamohueshëm propaganda e sotme revizioniste kineze e injoron.

Koncentrimi e centralizimi i kapitaleve bankare tani bëhen jo vetëm brenda një vendi, por edhe midis disa vendeve kapitaliste ose kapitaliste e revizioniste. Të këtij karakteri janë bankat e përbashkëta të Tregut të Përbashkët Evropian, ose «Banka Ndërkombëtare për Kooperimin Ekonomik» si dhe «Banka e Investimeve» të KNER-it. Po ashtu bashkime bankare të tipit kapitalist janë ato të bankave gjermanoperëndimore-polake ose të bankave anglo-rumune, franko-rumune, anglo-hungareze, ose korporatat bankare amerikano-jugosllave, anglo-jugosllave etj. Shumë banka ka çelur Bashkimi Sovjetik në mjaft vende kapitaliste, të cilat janë bërë konkurrencte e partnere të bankave kapitaliste kudo ku ato janë vendosur, si në Zurih, në Londër, në Paris, në Afrikë, në Amerikën Latine e gjetkë.

Edhe Kina po përfshihet gjithnjë e më tepër në vorbullën e këtij procesi të integritit kapitalist të bankave. Përveç bankave që ka në Hong-Kong, Makao e Singapor, nesër Kina do të krijojë banka edhe në Japoni, edhe në Amerikë e gjetkë. Në të njëjtën kohë ajo po lejon depërtimin e bankave të fuqive imperialiste në Kinë.

Lenini theksonte se kapitalizmi i sotëm karakterizohet nga eksportimi i kapitalit. Ky tipar ekonomik



I imperializmit në ditët tona është zhvilluar dhe forcuar më tej. Eksportuesit më të mëdhenj të kapitalit sot në botë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Bashkimi Sovjetik, Republika Federale e Gjermanisë, Anglia e Franca.

Në një periudhë kohe, eksportimet e kapitalit bëheshin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Anglia, nga Franca dhe nga Gjermania, ku qe zhvilluar industria, e cila thithte pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës së kolonive. Më vonë, lufta, krizat, sollën si pasojë që disa fuqi imperialiste, si Anglia, Franca, Gjermania, u dobësuan ekonomikisht dhe u pasurua imperializmi amerikan, i cili u bë superfuqi. Në situatën e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore eksportimet e kapitalit amerikan vërshuan shumë në dëm të fuqive të tjera kapitaliste.

Kapitali amerikan eksportohet sot në të gjitha vendet, bile edhe në ato të industrializuara, në formë investimesh, kredish, huash, në formë bashkëpunimi në shoqëri të përbashkëta ose nëpërmjet krijimit të kompanive të mëdha industriale. Imperializmi amerikan, kapitali monopolist investon në vendet e pazhvilluara e të varfra, sepse atje shpenzimet e prodhimit janë të ulëta, ndërsa shkalla e shfrytëzimit të punonjësve është e lartë. Ai investon për të siguruar lëndë të para, për të akaparuar tregje, për të shitur prodhimet e industrializuara.

Është e njohur se zhvillimi i vendeve kapitaliste bëhet në mënyrë jo të barabartë, prandaj monopolet dhe shoqëritë e mëdha të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të vendeve të tjera eksportojnë kapitale

pikërisht në ato vende ku zhvillimi ekonomik kërkon investime e teknologji.

Kapitalet që investohen u sjellin fitime përrallore koncerneve dhe monopoleve financiare, sepse në vendet e varfra, të pazhvilluara, toka është shumë e lirë dhe me pak të holla mund të blihet në sasi të mëdha dhe bashkë me tokën blihen edhe pasuritë e saj. Krahu i punës është gjithashtu i lirë, sepse njerëzit që vuajnë për bukë, janë të detyruar të punojnë me paga shumë të ulëta. Është llogaritur se, për çdo dollar që investohet në këto vende, fuqitë imperialiste sigurojnë një fitim prej 5 dollarësh.

Sipas të dhënave zyrtare amerikane vetëm gjatë periudhës 1971-1975 shumica e përgjithshme e investimeve të drejtpërdrejta të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në shtetet e reja ishte 6 miliardë e gjysmë dollarë, kurse fitimet që ato siguruan gjatë kësaj periudhe nga këto vende arritën afro 30 miliardë dollarë<sup>1</sup>.

Për të maskuar eksportimin e kapitaleve, fuqitë imperialiste praktikojnë edhe akordimin e kredive. Nëpërmjet këtyre të ashtuquajturave kredi ose ndihma, koncernet e mëdha kapitaliste dhe shtetet të cilave ato u përkasin u bëjnë presione të mëdha dhe i mbajnë në fre shtetet dhe popujt që i pranojnë. Ndihma ose kreditë për vendet e pazhvilluara vijnë nga grabitja e pasurive të këtyre vendeve dhe nga shfrytëzimi i masave punonjëse të vendeve të zhvilluara. Këto ndihma e kredi u jepen të pasurve të vendeve të pazhvilluara.

---

1. Revista amerikane «Survey of Business», f. 44, gusht 1976.

Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që monopolet e mëdha amerikane, për shembull, thithin djersën e popullit amerikan e të popujve të tjerë dhe, kur ato eksportojnë kapitalet e japin kredi, këto përfaqësojnë pikërisht djersën dhe gjakun e këtyre popujve. Nga ana tjetër, këto kredi që u japin monopolet e mëdha vendeve të së ashtuquajturës botë e tretë, në fakt, u shërbejnë klasave feudalo-borgjeze që sundojnë në këto vende.

Kreditë që marrin shtetet e reja, shërbejnë si hallka të zinxhirit imperialist në qafën e popujve të tyre. Siç tregojnë të dhënat statistikore, borxhet e këtyre vendeve dyfishohen në çdo pesëvjeçar. Nga afro 8 miliardë e gjysmë dollarë që ishin borxhet e vendeve të pazhvilluara ndaj fuqive imperialiste në vitin 1955, ato u rritën në mbi 150 miliardë dollarë në vitin 1977.

Kapitalizmi botëror ka zhvilluar teknikën e teknologjinë për interesin e tij, për shumëzimin e fitimeve, nëpërmjet zbulimit të burimeve të nëntokës, krijimit të një bujqësie intensive etj. Gjithë kjo teknologji, vetë revolucioni tekniko-shkencor dhe mënyrat e reja të shfrytëzimit ekonomik u shërbejnë imperializmit, monopoleve kapitaliste dhe jo popujve. Asnjëherë kapitalizmi nuk mund të investojë në vende të tjera, të japë hua, të eksportojë kapitale, pa llogaritur më parë fitimet që do të realizojë për veten e tij.

Në qoftë se monopoleve e bankave të mëdha, që janë të përhapura si rrjeta merimange në botën kapitaliste e revizioniste, nuk u paraqiten të dhëna konkrete mbi të ardhurat nga shfrytëzimi i një miniere, i tokave, i nxjerrjes së naftës apo të ujit në një shkretëtirë etj., ato nuk kreditojnë.

Ka edhe forma të tjera akordimi kredish, që praktikohen për ato shtete pseudosocialiste, të cilat kërkojnë të maskojnë rrugën e tyre kapitaliste ku po ecin. Këto kredi jepen me shuma të mëdha në forma kredish tregtare dhe kthehen, natyrisht, brenda një kohe të shkurtër. Këto jepen bashkërisht nga shumë shtete kapitaliste, të cilat kanë llogaritur më parë përfitimet ekonomike, por edhe politike, që do të nxjerrin nga shteti që i merr, duke mbajtur parasysh si potencialin ekonomik, ashtu edhe vetë mundësinë e pagimit. Në asnjë rast kreditë e tyre kapitalistët nuk i japin për të ndërtuar socializmin, por i japin për ta shkatërruar atë. Prandaj një vend i vërtetë socialist nuk pranon kurrë kredi, në çfarëdo forme që të jepet, nga një vend kapitalist, borgjez e revizionist.

Ashtu si revizionistët sovjetikë hrushovianë, edhe revizionistët kinezë përdorin shumë parulla, shumë citate, ndërtojnë shumë fraza që tingëllojnë «leniniste», «revolucionare», por veprimtaria e tyre e vërtetë është reaksionare, kundërrevolucionare. Edhe qëndrimet oportuniste dhe marrëdhëniet që udhëheqësit kinezë mbajnë me vendet imperialiste, ata përpiqen t'i paraqesin sikur janë në interes të socializmit. Këtë maskim këta revizionistë e bëjnë apostafat për t'i mbajtur masat e proletariatit dhe të popullit në errësirë, në mënyrë që pakënaqësinë e tyre të mos mundin ta kthejnë në një mjet force për të kryer revolucionin.

Të marrim, për shembull, çështjen e ndërtimit ekonomik të vendit, të zhvillimit të ekonomisë socialiste me forcat e veta. Si parim kjo është e drejtë. Çdo vend i pavarur, sovran, socialist duhet të mobilizojë

gjithë popullin e të përcaktojë drejt politikën ekonomike, të marrë të gjitha masat për shfrytëzimin si duhet e në mënyrë sa më racionale të të gjitha pasurive të vendit dhe këto pasuri t'i administrojë me ekonomi e t'i shtojë për interesin e popullit të vet dhe për të mos lejuar grabitjen nga të tjerët. Ky është një orientim kryesor bazë për çdo vend socialist, kurse ndihma nga jashtë, ndihma nga ana e vendeve të tjera socialiste, është suplementare.

Kreditë që i japin njëri-tjetrit dy vende socialiste kanë karakter krejt të ndryshëm. Këto kredi përbëjnë një ndihmë Internacionaliste, pa interes. Ndhma internacionaliste nuk krijon kurrë kapitalizmin, nuk varfëron masat popullore, përkundrazi, zhvillon industrinë dhe bujqësinë, i shërben harmonizimit të tyre, çon në përmirësimin e mirëqenies së masave punonjëse, në forcimin e socializmit.

Në radhë të parë, shtetet socialiste të zhvilluara ekonomikisht duhet të ndihmojnë vendet e tjera socialiste. Kjo nuk do të thotë që një vend socialist të mos zhvillojë marrëdhënie edhe me vende të tjera josocialiste. Por këto duhet të jenë marrëdhënie ekonomike mbi baza të interesit reciprok dhe në asnjë mënyrë të mos e vënë ekonominë e një vendi socialist ose të ndonjë vendi tjetër josocialist nën vartësinë e vendeve më të fuqishme. Në qoftë se këto marrëdhënie në mes shteteve bazohen në shfrytëzimin e shteteve të vogla e të dobëta ekonomikisht nga ana e shteteve të mëdha e të fuqishme, atëherë një «ndihmë» e tillë duhet hedhur poshtë, pse ajo është skllavëruese.

Lenini thotë se kapitali financiar ka hedhur, në

kuptimin real të fjalës, rrjetat e tij në të gjitha vendet e botës. Monopolet, kartelet dhe sindikatat e kapitalistëve punojnë me sistem, ato hedhin më parë në dorë tregun e brendshëm të vendit, hedhin në dorë industrinë, bujqësinë, skllavërojnë klasën punëtore dhe punonjësit e tjerë, nxjerrin superfitime dhe pastaj krijojnë mundësi të mëdha për të akaparuar edhe tregje në të gjithë botën. Në këtë çështje një rol të drejtpërdrejtë luan kapitali financiar.

Ne vërejmë edhe aktualisht, në përrputhje të plotë me mësimet e Leninit mbi imperializmin si fazë e fundit e kapitalizmit, se dy superfuqitë, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, luftojnë për ndarjen e botës, për pushtimin e tregjeve. Çështja e naftës, për shembull, që është bërë e mprehtë në të gjithë botën, është në radhë të parë domeni i shoqërive të mëdha monopoliste amerikane, por në to bëjnë pjesë edhe shoqëri të naftës të Anglisë, të Holandës etj. Amerikanët manovrojnë në çështjen e naftës, për ta pasur këtë monopol të tyre. Ata kanë investuar kapitale dhe kanë vendosur teknikë të madhe në vendet e naftës, siç janë Arabia Saudite, Irani etj., kanë hedhur kthetrat e tyre mbi klikat sunduese të këtyre vendeve, nëpërmjet komprometimit me shuma të mëdha dollarësh, të mbretërve, sheikëve dhe imamëve. Sundimtarët e vendeve të naftës lejohen nga plutokracia financiare të investojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli e gjetkë, duke blerë bile edhe aksione në kompani të ndryshme monopoliste, si dhe hotele luksoze, fabrika etj.

Arabia Saudite, për shembull, është vend gjysmë-

feudal, ku sundon varfëria dhe obskurantizmi, megjithëse atje nxirren 420 milionë tonë naftë në vit. Ndërsa masat punonjëse jetojnë në varfëri, mbreti dhe klasa e çifligarëve të mëdhenj kanë depozituar në bankat e Uoll Stritit mbi 40 miliardë dollarë. E njëjta gjendje është edhe në Kuvajt, në Emiratet e Bashkuara Arabe etj. Këto klika u bëjnë fuqive imperialiste të gjitha lëshimet për grabitjen e pasurive të popujve të vendeve ku ato sundojnë, me qëllim që të marrin një pjesë të fitimeve për vete.

Investimet që bëhen nga vendet prodhuese të naftës e që janë pronë e klikave sunduese, përbëjnë një bashkim, natyrisht në një shkallë shumë të vogël, të kapitalit të këtyre klikave me kapitalin amerikan ose anglez. Në pamjen e parë duket sikur klikat sunduese të vendeve ku del nafta paskan njëfarë ortakërie investimesh me imperializmin amerikan, anglez ose francez dhe ndikokan në ekonominë e tyre. Në të vërtetë ngjet krejt e kundërta. Fitimet e imperialistëve amerikanë dhe të imperialistëve të tjerë janë jashtëzakonisht të mëdha në krahasim me fitimet shumë të vogla që u jepen këtyre klikave. Kjo është një karakteristikë e neokolonializmit të sotëm, i cili, që të mund të shfrytëzojë në maksimum pasuritë e disa vendeve, bën disa lëshime të matura edhe në favor të grupeve sunduese borgjezo-kapitaliste, feudale, por sigurisht jo në dëm të tij. Ky shembull vërteton drejtësinë e tezës së Leninit, i cili thotë se fare lehtë mund të pleksen interesat e borgjezive të vendeve të ndryshme, ashtu si dhe interesat e monopoleve private me ata të monopoleve shtetërore. Monopolet e mëdha mund të plek-

sen edhe me monopole më pak të fuqishme, por që kanë nën sundimin e tyre pasuri të mëdha, sidomos nëntokësore, si miniera hekuri, kromi, bakri, uraniu-mi etj.

Një nga format shumë të përhapura të eksportimit të kapitaleve sot janë bërë huatë, kreditë dhe ndihmat qeveritare. Këtë lloj eksportimi e praktikojnë në mënyrë të veçantë Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera revizioniste.

Përveç nxjerrjes së fitimeve kapitaliste, këto kredi, «ndihma» dhe hua kanë dhe qëllime politike. Shtetet që i japin kreditë synojnë të përkrahin dhe të konsolidojnë pushtetin politik dhe ekonomik të klikave të caktuara, që mbrojnë interesat ekonomikë, politikë e ushtarakë të vendit që i jep ato. Meqenëse marrëveshjet për këto lloje kredish përfundohen midis qeverive, ato forcojnë edhe më tepër vartësinë ekonomike e politike të huamarrësit nga huadhënësi. Një shembull klasik për këtë formë të eksportimit të kapitalit përbën «Plani Marshall», i cili pas Luftës së Dytë Botërore u bë baza ekonomike e ekspansionit politik e ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendet e Evropës Perëndimore. Të tilla janë të ashtuquajturat ndihma që revizionistët sovjetikë japin gjoja për zhvillimin e ekonomisë dhe krijimin e sektorit shtetëror të industrisë në vende të tilla si në Indi, në Irak e gjetkë.

Aktualisht imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe kapitalizmi në vendet e industrializuara kanë arritur në një shkallë të tillë zhvillimi, sa fitimi, që realizojnë nga grumbullimi i kapitaleve, është ngritur jashtëzakonisht shumë. Grumbullimi i kapita-



leve krijon fitime të mëdha, që shkojnë në xhepin e monopolistëve, të oligarkisë financiare, të cilët nuk i vënë këto të ardhura në shërbim të popullit punëtor, të varfër e të mjeruar, po i eksportojnë në ato vende prej nga mund t'u vijnë fitime të tjera më të mëdha. Këto vende janë ato që Kina i quan «bota e tretë». Por investime të këtij lloji ata bëjnë edhe në vendet e zhvilluara kapitaliste.

Mbi procesin e depërtimit të kapitaleve amerikane në Evropë e të qëllimeve politike dhe ekonomike të tij janë shkruar mjaft libra. Një tablo të qartë jep edhe libri i autorit amerikan Xhofrej Ouen. Në fillim të kapitullit «Shoqëritë ndërkombëtare» ai thotë se zhvillimi i investimeve amerikane jashtë është bërë sipas konceptit se amerikanët përfaqësojnë jo një shoqëri me interesa përtej detit, po një shoqëri ndërkombëtare. Kuartieri i përgjithshëm i kësaj shoqërie gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo do të thotë se firmat e ndryshme të mëdha amerikane nuk mendojnë vetëm për të mbuluar vendin e vet dhe nevojat e industrisë e të klientëve brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të shtrijnë rrjetat e tyre në vende të huaja. Këto shoqëri «kapitalet e tepërta» investojnë në vende të tjera për të nxjerrë fitime më të mëdha. Korporata të tilla gjigante si «Sokoni Mobil», «Stëndërd Oil ov Nju Xhërsi» etj. gati gjysmën e fitimeve e nxjerrin nga grabitja dhe shfrytëzimi i vendeve të huaja. Rreth 500 kompani sigurojnë afro 10 miliardë dollarë fitime jashtë vendit çdo vit. Të tilla ndërmarje që kanë bërë investime në vende të huaja numërohen më tepër se 3 000. Kështu që formulat

dhe termat «shoqëri shumëkombëshe» ose «kapitalizmi ndërkombëtar» etj. janë bërë të ditës, kanë hyrë në gazetari dhe në veprimet bankare.

Xhofrej Oucni thotë se më 1929 mbi 1 300 shoqëri evropiane ishin pasuri e firmave amerikane ose të kontrolluara prej tyre. Kjo ishte etapa e parë e sulmit amerikan në drejtim të industrisë evropiane. Presioni i Luftës së Dytë Botërore që po përgatitej, e ndaloi përkohësisht invazionin e kapitaleve amerikane. Nga viti 1929 e deri më 1946 vlera e investimeve të drejtpërdrejta nga shoqëritë amerikane në vendet e tjera të botës u ul nga 7 miliardë e gjysmë dollarë në 7 miliardë e 200 milionë. Por, pas Luftës së Dytë Botërore, më 1950, sasia e investimeve amerikane jashtë u ngjiti në 11 miliardë e 200 milionë, gjysma e të cilave ishte koncentruar në vendet e Amerikës Latine dhe në Kanada. Investimet në Amerikën Latine u bënë për të shfrytëzuar lëndët e para: naftën, bakrin, mineralin e hekurit, boksitet, bananet, si dhe prodhime të tjera bujqësore. Në Kanada ato u bënë më shumë në miniera dhe në naftë dhe zhvilloheshin në një shkallë të gjerë për arsye të afërsisë dhe të kushteve të tjera lehtësuese për depërtim.

Gjithashtu edhe Evropa në vitet pesëdhjetë u bë një objekt tjetër i rëndësishëm për investimet amerikane. Investimet në këtë kontinent u shtrinë me shpejtësi në komunikacion, në prodhimet në seri të mëdha, në pajisjet e ndërlikuara. Bashkë me to vërshuan dhe mallrat e prodhimet amerikane.

Autori në fjalë vë në dukje se gjendja që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore në tregun kapitalist u dha

një shtytje akoma më të madhe investimeve amerikane. Dhe ja të dhënat për shtimin e këtyre investimeve jashtë: totali i tyre më 1946 ishte 7 miliardë e 200 milionë dhe pastaj fillon të ngjitet më 1950 në 11 miliardë e 200 milionë, më 1964 arrin në 44 miliardë e 300 milionë dhe sot arrin mbi 60 miliardë dollarë.

Shoqëritë amerikane, duke zgjeruar vazhdimisht operacionet në shkallë botërore, kanë bërë që konkurrenca të ashpërsohet me firmat e çdo vendi dhe të zmadhohet frika e dominimit nga gjigantët amerikanë. Ky problem bëhet akoma më i mprehtë në vendet e pazhvilluara ku firmat amerikane janë të specializuara në degët kyç të industrisë dhe kanë një influencë *prépondérante* mbi ekonomitë kombëtare. Me fjalë të tjera, këto shoqëri gjigante amerikane kanë në dorë dhe në fakt janë ato që drejtojnë ekonomitë dhe qeveritë lokale.

Është e njohur lufta e gjatë e zhvilluar në mes shoqërive amerikane të vajgurit dhe qeverisë mexikane, e cila mbaroi më 1938 me falimentimin e politikës së kundërshtimit nga ana e qeverisë së Meksikës. Të njëjtin fat pati edhe lufta midis monopolit anglez të vajgurit dhe qeverisë iraniane, e cila përfundoi me rrëzimin e Mosadokut. Të tilla luftëra janë të vazhdueshme dhe dërrmuese dhe përfundojnë me fitimin e trusteve të mëdha amerikane.

Kompanitë e mëdha të vajgurit veprojnë në shkallë botërore. Atyre u është bërë e zakonshme dhe e nevojshme të kontrollojnë plotësisht të gjitha kapitalet dhe prodhimin e kësaj dege në vendet ku kanë investuar, të kontrollojnë qeveritë etj., mbasi, po të

mos i kenë këto mundësi, atëherë krijohen vështirësi në koordinimin botëror të aktiviteteve të tyre. Është kjo arsyeja që kompanitë e mëdha të huaja luftojnë kundër përpjekjeve të kapitalistëve vendas, që synojnë të marrin pjesë më shumë në fitimet nga sa u jepen nga Investitorët amerikanë apo të vendeve të tjera imperialiste.

Shoqëritë amerikane në Evropë, në Kanada, në Azi, në Afrikë etj., kanë krijuar një situatë të tillë që praktikisht kontrollojnë ekonominë e mjaft vendeve. Qeveritë e këtyre vendeve kanë frikë të madhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat janë bërë lidhësi i ekonomisë evropiane, sikundër janë bërë edhe në çështjet ushtarake. Prandaj vendet kapitaliste të industrializuara evropiane përpiqen të pengojnë invadimin e kapitaleve amerikane që kanë vërshuar e po vërshojnë gjithnjë e më shumë në to.

Udhëheqja kineze pretendon se shtetet e Evropës, të industrializuara që nga shekulli i 19-të, po bëjnë më shumë investime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por dihet se, ndërsa investimet e kapitaleve evropiane në Shtetet e Bashkuara janë kryesisht në formën e letrave me vlerë, të aksioneve, obligacioneve, depozitave etj., investimet amerikane në Evropë kanë pozita dominuese në degët më të rëndësishme të ekonomisë së Evropës.

Xhofrej Ouen, duke u përpjekur të justifikojë shtimin e investimeve amerikane, pretendon se vendet evropiane dëshirojnë dhe bëjnë përpjekje të zhvillojnë industrinë e tyre në baza shkencore, si për shembull atë të elektronikës dhe të ordinatorëve. Këto industri

në njëfarë mase kontribuojnë në progresin teknik, në rritjen e eksportimeve dhe në atë të ekonomisë në përgjithësi të këtyre vendeve. Por shoqëritë amerikane janë më të përparuara në këtë fushë sesa rivalët e tyre evropianë dhe ato e kontrollojnë sipas interesave të tyre këtë progres teknik.

Për ordinatorët, për shembull, shoqëritë përkatëse evropiane janë lidhur ngushtë për t'u mbrojtur nga konkurrenca e korporatës amerikane «Intërnëshënëll Biznes Mëshin» (IBM), që përfshin më tepër se 70 për qind të tregut amerikan dhe një pjesë akoma më të madhe të tregut botëror.

Po ashtu tendenca e shoqërive të mëdha amerikane është edhe ortakëria e tyre me ndërmarrjet lokale. Për të maskuar shfrytëzimin, mjaft firma evitojnë të kenë filiale qind për qind dhe krijojnë shoqëri me investime të përbashkëta në raport 49 për qind me 51 për qind ose 50 për qind me 50 për qind. Kështu kanë vepruar amerikanët në Japoni, kështu kanë vepruar ata edhe në Jugosllavi, e cila përpiqet të japë përshtypjen sikur ndërton socializmin me forcat e veta, kurse në realitet ekonomikisht titistët ua kanë ndarë Jugosllavinë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe firmave të mëdha të vendeve industriale të zhvilluara. Me këtë titistët kanë argjnuar, po ashtu, edhe lirinë e pavarësinë e Jugosllavisë.

Tendenca e shumë prej këtyre shoqërive të mëdha amerikane, si «Xhenërëll Motërs», «Ford», «Krajsler», «Xhenërëll Illektrik» etj., është të vënë faktikisht në posedim të tyre qind për qind filialet e veta në vendet e huaja. Megjithëkëtë këto filiale, sipas Ouenit,

nuk harrojnë problemin e nacionalizimit dhe përgjigjja është se «nuk është çështja të formojmë shoqëri me investitorë lokalë, por të inkurajojmë pronësinë ndërkombëtare të aksioneve të shoqërive mëma». Ky është koncepti i «internacionales» së kapitalizmit, mbrojtësi i zjarrtë i të cilit është veçanërisht «Xhenërell Motërs».

Këto orientime të kapitalit imperialist amerikan ose të fuqisë së industrisë amerikane, që investon jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të krijuar kolonitë dhe perandorinë e vet, janë disa nga faktet që ilustrojnë qartë tezën se imperializmi amerikan nuk është dobësuar aspak, siç pretendojnë revizionistët kinezë. Përkundrazi, ai është forcuar, ka fituar koncesione të mëdha në vende të huaja, drejton shumë degë të rëndësishme të ekonomisë së tyre. Ai ka futur, gjithashtu, qeveri të vendeve të tjera në vështirësi të panumërta, mjaft herë bën ligjin në këto vende, shumë qeveri i ka nën kontrollin dhe drejtimin e vet. Natyrisht në këtë proces ka edhe ngritje edhe zbritje, por eja e përgjithshme nuk flet për dobësimin e imperializmit amerikan.

Aktualisht ne jetojmë në një kohë kur një tjetër superfuqi, socialimperializmi sovjetik, po eksporton kapitalet e veta dhe përpiqet për shfrytëzimin e popujve të ndryshëm. Kapitalet që eksporton kjo superfuqi rrjedhin nga mbivlera që realizohet në Bashkimin Sovjetik, i cili është shndërruar në një vend kapitalist.

Rivendosja e kapitalizmit ka çuar në një polarizim të shoqërisë së sotme sovjetike, ku një pjesë e vogël e saj sundon e shfrytëzon shumicën dërrmuese të popullit. Tashmë është krijuar dhe ka marrë formën

e një klase më vete borgjeze, shfrytëzuese, shtresa e përbërë nga burokratët, teknokratët e inteligjencia krijuese e lartë, e cila përvetëson dhe ndan midis saj mbivlerën që nxjerr nga shfrytëzimi i egër i klasës punëtore dhe i masave të gjera punonjëse. Ndryshe nga vendet e kapitalizmit klasik, ku kjo mbivlerë përvetësohet në proporcion me madhësinë e kapitalit të secilit kapitalist, në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera revizioniste ajo shpërndahet në raport me shkallën që zënë njerëzit e shtresës së lartë borgjeze në hierarkinë shtetërore, ekonomike, shkencore, kulturore etj. Rrogat e larta, shpërblimet e zakonshme e të posaçme, çmimet e stimujt, favorizimet etj., janë ngritur në një institucion të tërë për të përvetësuar mbivlerën e nxjerrë nga djersa e punonjësve. Shtresa që përfaqëson «kapitalistin kolektiv» e ruan këtë grabitje nëpërmjet një mori ligjesh, normash, të cilat sigurojnë shtypjen e shfrytëzimin kapitalist.

Ekonomia sovjetike tashmë është integruar në sistemin e kapitalizmit botëror. Ndërsa kapitalet amerikane, gjermanoperëndimore, japoneze etj. kanë hyrë thellë në Bashkimin Sovjetik, kapitalet sovjetike po eksportohen në vende të tjera dhe në forma të ndryshme po shkrihen me kapitalet vendase.

Është e njohur se Bashkimi Sovjetik shfrytëzon ekonomikisht, në radhë të parë, vendet satelite. Por tani ai konkurren e lufton me shtetet e tjera kapitaliste për tregje, për sfera investimesh, për grabitjen e lëndëve të para, për ruajtjen e ligjeve neokolonialiste në tregtinë botërore etj.

Për të shtrirë hegjemoninë e saj, borgjezia e re

sovjetike eksporton kapitale, por në këtë veprim ndeshet me konkurrencën jo vetëm të imperializmit amerikan, e cila është shumë e fuqishme, por edhe me atë të shteteve të tjera të zhvilluara kapitaliste, siç janë Japonia, Anglia, Gjermania Perëndimore, Franca etj. Këto shtete, për të nxjerrë superfitime, eksportojnë kapitale jo vetëm në Afrikë, në Azi dhe në Amerikën Latine, por edhe në vendet e Evropës Lindore që janë nën tutelën e Bashkimit Sovjetik revizionist, bile eksportojnë kapitale edhe në vetë Bashkimin Sovjetik.

Klikat sunduese të vendeve të ashtuquajtura socialiste, si Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia, Polonia etj., tani edhe Kina, lejojnë vërshimin e kapitaleve të huaja në vendet e tyre, pse këto kapitale u shërbejnë klikave sunduese, ndërsa rëndojnë në kurriz të popujve. Vendet e KNER-it janë mbytur në borxhe të mëdha. Ato u kanë një borxh prej 50 miliardë dollarësh vendeve të Perëndimit.

Jugosllavia është një nga vendet e para revizioniste që lejoi depërtimin e kapitaleve të huaja në ekonominë e saj. Në fillim ajo mori kredi, pastaj patenta dhe më vonë kaloi në ndërtimin e ndërmarrjeve të përbashkëta. Në vitin 1967 në Jugosllavi u miratua një ligj që lejonte krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta ku 49 për qind e kapitalit ishte pronë e shoqërive të huaja. Në vitin 1977 në Jugosllavi numëroheshin 170 ndërmarrje të tilla. Jugosllavia u ka siguruar kushtet më të favorshme firmave kapitaliste për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe për sigurimin e fitimeve maksimale.

Fenomeni jugosllav vërteton se kapitalet e huaja,



që janë investuar në Jugosllavi, janë një ndër faktorët vendimtarë që e kanë kthyer këtë në një vend kapitalist. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera të pasura kapitaliste nuk kanë humbur nga këto investime, përkundrazi ato kanë realizuar fitime të mëdha, duke shtuar mjerimin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë së Jugosllavisë. Lenini ka thënë se eksportimi i kapitalit është një bazë e shëndoshë për shfrytëzimin e shumicës së kombeve dhe të vendeve të botës, për parazitizmin kapitalist të një grushti shtetesh shumë të pasura.

Fitime të mëdha do të realizojnë shtetet kapitaliste edhe nga Kina. Ne po shohim se atje tani po vërshojnë me miliarda dollarë kapitalet amerikane, japoneze, gjermanoperëndimore etj. Me japonezët u nënshkruan marrëveshje për shfrytëzimin e përbashkët të fushave vajguore dhe të kapaciteteve energjetike të lumit Jance. Me gjermanët u nënshkrua marrëveshje për ndërtimin e minierave të qymyrgurit etj. Investimet që bëhen e do të bëhen në Kinë do të sjellin medoemos fitime të kënaqshme për kapitalistët e huaj, por njëkohësisht ato do të forcojnë edhe bazat e kapitalizmit në Kinë.

Eksportimi i kapitalit nga një vend kapitalist në një vend tjetër kapitalist ose revizionist, i madh ose i vogël qoftë shteti që e jep dhe shteti që e merr, mbetet gjithnjë një nga format e shfrytëzimit të popujve nga kapitali. Ky shfrytëzim sjell me vete vartësi ekonomike dhe politike për atë që e merr.

Lenini ka theksuar se monopolet, pasi pushtojnë tregun e brendshëm, luftojnë për të rindarë dhe për të pushtuar ekonomikisht tregun botëror të produkteve të industrializuara dhe të lëndëve të para. Konkurrenca dhe lakmia për fitime i shtyjnë monopolistët e vendeve të ndryshme të arrijnë në marrëveshje të përkohshme, të hyjnë në aleanca dhe bashkime midis tyre për të ndarë tregjet në plan ndërkombëtar, për shitjen e produkteve të gatshme dhe për blerjen e lëndëve të para. Shtetet e zhvilluara kapitaliste, edhe kur posedojnë rezerva lëndësh të para dhe energjetike, u vërsulen vendeve të tjera, sepse shpenzimet e prodhimit në këto vende janë më të vogla në krahasim me vendet e tyre dhe sidomos paga e punëtorëve është disa herë më e ulët.

Është e njohur lufta që është bërë dhe bëhet për pushtimin e burimeve e të tregjeve të naftës. Si rezultat i kësaj lufte janë shkatërruar dhjetëra dhe qindra ndërmarrje e shoqëri private dhe u arrit që karteli ndërkombëtar i naftës, që bashkon 7 monopole të mëdha (nga këto 5 amerikane, 1 anglez dhe 1 anglo-holandez, të famshmet Esso, Teksako, Shell etj.) të kontrollojë mbi 60 për qind të nxjerrjes dhe të shitjes së naftës në vendet kapitaliste të botës perëndimore dhe të përpunojë rreth 54 për qind të saj.

Një ndarje e tillë e burimeve të prodhimit dhe e tregjeve të shitjes është bërë sot edhe për mineralet e bakrit e të kallajit, për uraniumin dhe për minerale të tjera të çmuara e strategjike.

Shumë nga vendet e vjetra kolonialiste, si Anglia dhe Franca, kanë përfunduar me vendet ish-koloniale

marrëveshje të posaçme të ashtuquajtura preferenciale, bashkëpunimi etj., të cilat u sigurojnë privilegje ekonomike e tregtare gati ekskluzive. Zonat e ashtuquajtura të dollarit, të sterlinës, të frangut, të rublës tregojnë për një ndarje ekonomike të botës midis monopoleve e shteteve të ndryshme imperialiste.

Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe fuqitë e tjera imperialiste, nëpërmjet rrugëve të ndryshme, nëpërmjet tregtisë diskriminuese e të parabarabartë që zhvillojnë me këto vende, sigurojnë fitime maksimale. Vetëm «vendet në zhvillim», duke përjashtuar vendet e OPEK-ut, kanë sot një saldo pasive që arrin në gati 34 miliardë dollarë.

Monopolet në kushtet aktuale, sidomos tani në kushtet e krizës ekonomike, përfundojnë marrëveshje të drejtpërdrejta edhe me qeveritë e vendeve kapitaliste, për kuota të prodhimit, për çmime, për tregje të shitjes etj. Edhe ekzistenca e organizmave të tillë si Tregu i Përbashkët Evropian, KNER-i etj., flet qartë për ndarjen ekonomike që ekziston sot në botë.

Kjo ndarje ekonomike e botës, dominimi i monopoleve, diktati i tyre mbi jetën e zhvillimin ekonomik të vendeve të tjera, ashpëron më shumë, veç kontradiktës midis punës e kapitalit, edhe kontradiktat midis popujve e imperializmit, si dhe kontradiktat ndërimperialiste.

Teoria kineze e «tri botëve» që kërkon të pajtojë «botën e tretë» me «botën e dytë» dhe me imperializmin amerikan, është jashtë këtlj realiteti. Ajo nuk dëshiron ta shikojë se ofensiva e pandalshme e monopoleve amerikane, angleze, gjermane, japoneze, franceze

etj., drejt asaj që Kina e quan «botë e tretë», shton rezistencën e popujve ndaj të gjitha fuqive imperia-  
liste e hegjemoniste dhe zgjeron kushtet objektive të  
luftës së papajtueshme midis tyre. Nga ana tjetër,  
zhvillimi i pabarabartë i fuqive imperialiste, i cili është  
një ligj objektiv i zhvillimit të kapitalizmit, i nxit këto  
në një konkurrencë dhe fërkime të papajtueshme midis  
njëra-tjetrës për të shtrirë ekspansionin ekonomik kudo  
në botë.

Teoria kineze e «tri botëve», e cila kërkon t'i paj-  
tojë këto kontradikta dhe predikon po atë që kanë  
predikuar prej kohësh socialdemokracia dhe revizionis-  
tët e të gjitha ngjyrave, është në kundërshtim flagrant  
me strategjinë leniniste, e cila synon jo t'i mohojë, por  
t'i thellojë këto kontradikta, për të përgatitur prole-  
tariatit për revolucion dhe popujt për çlirim.

Lenini në analizën që i bëri imperializmit vuri në  
dukje se, me kalimin e kapitalizmit paramonopolist  
në fazën e tij më të lartë dhe të fundit, në fazën e im-  
perializmit përfundon ndarja territoriale e botës midis  
fuqive të mëdha imperialiste.

*«...tipari karakteristik i kësaj periudhe është  
ndarja definitive e tokës, definitive jo në kuptimin se nuk mund të ketë rindarje, — përkundrazi, rindarje mund të ketë, rindarja është e pashmangshme, — por në kuptimin që politika koloniale e vendeve kapitaliste i dha fund pushtimit të tokave të papushtuara në planetin tonë. Për herë të parë bota u nda, kështu që*

*paskëtaj do të kemi vetëm rindarje, domethënë se tokat do të shkojnë nga një «pronar» tek tjetri...»<sup>1</sup>.*

Kolonializmi i vjetër klasik, që shfrytëzonte shumicën e popujve të botës fizikisht, ekonomikisht, politikisht dhe ideologjikisht, pas Luftës së Dytë Botërore, është transformuar në një kolonializëm të ri. Ky kolonializëm i ri përfshin një sistem të tërë masash ekonomike, politike, ushtarake dhe ideologjike, të cilin imperializmi e ka ngritur me qëllim që të mbajë sundimin e tij dhe të sigurojë kontrollin politik e shfrytëzimin ekonomik të vendeve ish-koloniale dhe të shumë vendeve të tjera, duke iu përshtatur kushteve të reja që u krijuan pas luftës.

**Cilat janë këto kushte të reja?**

Vendet imperialiste — Franca, Anglia, Italia, Gjermania, Japonia dhe Amerika, nuk ishin në gjendje të ruanin me forcë pas luftës atë situatë që ekzistonte para luftës. Franca, për shembull, nuk mund t'i mbante më koloni si më përpara Marokun, Algjerinë, Tunizinë dhe vende të tjera të Afrikës. Kështu mund të themi edhe për imperializmin anglez, italian etj.

Lufta e Dytë Botërore shkaktoi një ndryshim rrënjësor në raportin e forcave në botë. Ajo çoi në shkatërrimin e fuqive të mëdha fashiste, por tronditi nga themelet e dobësoi shumë edhe fuqitë e vjetra kolonialiste. Lufta antifashiste zgjoi kudo, edhe në vendet që nuk u përfshinë në vorbullën e saj, problemin e çli-

rimit kombëtar. Ata popuj të vendeve ish-koloniale, që morën pjesë në luftë së bashku me vendet e koalicionit antifashist për të shpëtuar nga zgjedha fashiste, nuk mund të ktheheshin më mbrapsht dhe të duronin më gjatë zgjedhën koloniale. Fitorja e Bashkimit Sovjetik mbi nazizmin, krijimi i kampit socialist, çlirimi i Kinës, u dhanë një shtytje shumë të fuqishme zgjimit të ndërgjegjes kombëtare dhe luftës çlirimtare të popujve. Masat e gjera të popujve të kolonizuar arritën të kuptonin se situata e mëparshme duhej të ndryshonte. Shpërthyen luftërat çlirimtare në Indokinë, në Afrikën e Veriut etj.

Të detyruara nga kjo situatë, shumë vende kolonialiste e kuptuan se mënyrës së vjetër të shfrytëzimit dhe të administrimit të kolonive, pa asnjëfarë lirie e pavarësie, i kishte kaluar koha. Fuqitë imperialiste, kolonialiste arritën në këtë përfundim jo nga ndjenjat e tyre demokratike dhe nga dëshira për t'u dhënë liri popujve, por nga shtytja e popujve të kolonizuar dhe nga dobësia ushtarake, ekonomike, politike, ideologjike e këtyre fuqive për të ruajtur kolonializmin e vjetër. Por imperializmi francez, anglez, italian, amerikan etj. nuk donte të hiqte dorë nga shfrytëzimi i këtyre popujve e vendeve. Secila fuqi imperialiste u detyrua, nga rrethanat e krijuara, t'u jepte autonomi ose t'u premtonte liri e pavarësi këtyre popujve pasnjëfarë kohe. Në këtë periudhë, që ata e lanë gjoja sa të krijohej ndërgjegjja e vetëqeverisjes dhe të përgatiteshin për këtë kuadrot vendas, në të vërtetë synonin përgatitjen e formave të tjera të reja të shfrytëzimit imperialist, të kolonializmit të ri, duke u lënë

përshtypjen e rreme vendeve dhe popujve se gjoja ata e fituan lirinë.

Kjo ishte një fazë pas luftës kur imperializmi botëror pësoi një disfatë të madhe, kur kriza e sistemit kolonial të imperializmit u theksua edhe më shumë. Në këtë periudhë kalbëzimi të kapitalizmit, si rezultat i dobësimit të imperializmit nga Lufta e Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës përfituan dhe krijuan një shfrytëzim të ri e të thellë të popujve kolonialë, gjoja të lirë dhe të pavarur. Ato e shtrinë fuqinë e tyre imperialiste në vendet që ishin koloni të fuqive të tjera imperialiste, por që tani, në një mënyrë ose në një tjetër, ishin dobësuar.

Mjaft popuj ish-kolonialë, ndonëse e fituan këtë «pavarësi» dhe këtë «liri», ashtu siç ua dhanë ish-fuqitë kolonialiste, u detyruan të rrëmbenin armët, sepse imperialistët nuk ishin të dispozuar ta jepnin këtë «liri» dhe këtë «pavarësi» menjëherë. Sidomos imperialistët francezë kërkonin edhe pas luftës të ruanin forcën e Francës ose «madhështinë» e saj. Në këtë mënyrë populli i Algjerisë, i Vietnamit e shumë popuj të tjerë filluan luftën e gjatë të çlirimit dhe më në fund e fituan këtë. Këtu nuk po hyjmë në detaje si e qysh e arritën, cilat ishin forcat shoqërore që luftuan etj. Fakt është se imperializmi i vjetër francez dhe anglez u dobësua. U vërtetuan kështu tezat e Leninit se imperializmi ishte në kalbëzim, se shoqëria e vjetër kapitalisto-imperialiste po gërryhej nga lëvizjet revolucionare dhe nga aspiratat lridashëse të popujve që deri në atë kohë ishin të shtypur e të robëruar.

Gjatë kësaj periudhe imperializmi amerikan u

majni, zgjeroi zonën e dollarit, vuri nën kontrollin e vet territore të zonës së frangut e të sterlinës dhe, për të ruajtur fuqinë e tij hegjemone imperialiste, që konsistonte në shfrytëzimin maksimal të popujve, krijoi baza të shumta ushtarake dhe vendosi klika politike proamerikane në shumë nga ato vende të botës, që gjoja kishin fituar lirinë dhe pavarësinë. Ky shfrytëzim, natyrisht, shoqërohej edhe me një sërë ndryshimesh të strukturës dhe të superstrukturës.

Kapitali financiar ka krijuar edhe një ideologji më vete, e cila i paraprin atij për shfrytëzimin e proletariatit dhe për pushtimin e botës. Sundimin e popujve, përligjjen e këtij sundimi, ai i kompletton me forma të ndryshme të sheqerosura, duke predikuar e duke dhënë njëfarë lirie, njëfarë pavarësie, si dhe duke krijuar disa parti të ashtuquajtura demokratike etj.

Tok me investimet e kapitaleve amerikane, me krijimin e bankave dhe të të ashtuquajturave shoqëri shumëkombëshe, eksportohet edhe mënyra e jetesës amerikane, bashkë me degjenerimin që mban në vetvete.

Eksportimi i kapitaleve nga fuqitë e mëdha imperialiste krijon kolonitë, të cilat sot janë ato vende ku sundon neokolonializmi. Këto vende kanë gjoja një pavarësi, por ajo s'është veçse formale. Me fjalë të tjera, tani, ashtu si edhe më parë, po zhvillohet i njëjti proces i eksportimit të kapitalit, por në forma të ndryshme, me shpjogime dhe propagandë «të ëmbël». Shfrytëzimi deri në palcë i popujve të këtyre vendeve qëndron kurdoherë i njëjtë dhe më i egër akoma; gjithashtu vazhdon grabitja e pasurive natyrore.

Fuqia më e madhe neokolonialiste e kohës sonë



janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë tre vjetëve, 1973-1975, investimet kapitale qeveritare dhe private të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendet ish-koloniale, të varura e gjysmë të varura, përfaqësojnë afro 36 për qind të të gjitha investimeve të vendeve kapitaliste e revizioniste më të zhvilluara në këto rajone<sup>1</sup>.

Traktatet e marrëveshjet ekonomike, politike e ushtarake midis fuqive imperialiste dhe vendeve ish-koloniale janë robëruese, janë armë në duart e imperializmit për mbajtjen në skllavëri të këtyre vendeve. Sot, ashtu si edhe dje, janë shumë aktuale fjalët e Leninit që theksonte se

*«...është e domosdoshme të demaskohet dhe t'u shpjegohet vazhdimisht masave më të gjera punonjëse të të gjitha vendeve, sidomos të vendeve të prapambetura, gënjeshtër që përdorin në mënyrë sistematike fuqitë imperialiste, të cilat, duke bërë sikur krijojnë shtete politikisht të pavarura, krijojnë në të vërtetë shtete plotësisht të varura prej tyre si nga pikëpamja ekonomike, ashtu edhe nga pikëpamja financiare dhe ushtarake...»<sup>2</sup>.*

Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe fuqitë e tjera imperialiste të vjetra e të reja, për t'i mbajtur nën sundim popujt, nxitin, kudo ku mun-

1. Anuari statistikor i RFGJ, viti 1977.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 159.

den, grindjet midis shteteve fqinje apo midis grupeve të ndryshme shoqërore brenda vendit dhe, pastaj, në rolin e gjykatësit apo të përkrahësit të njëres ose tjetrës palë, ndërhyjnë në punët e brendshme të të tjerëve, justifikojnë praninë e tyre ekonomike, politike e ushtarake. Faktet tregojnë se, kur superfuqitë janë përzier në punët e brendshme të popujve të tjerë, çështjet kanë mbetur pa u zgjidhur; ose kanë përfunduar me konsolidimin e pozitive të imperializmit e të socialimperializmit në këto vende. Për këtë dëshmojnë ngjarjet e Lindjes së Mesme, konflikti midis Somalisë dhe Etiopisë, lufta midis Kamboxhias e Vietnamit etj.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet e tjera kapitaliste tok me investimet konsolidojnë edhe pozitat e tyre në vendet që i pranojnë këto investime, ato luftojnë për tregje dhe zona influence. Kjo krijon fërkime në mes shteteve të ndryshme kapitaliste, në mes koncerneve të mëdha që nuk janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra-tjetra. Këto fërkime nxitin luftërat lokale dhe mund të arrijnë deri edhe në luftë të përgjithshme. Lufta e shpërthyer nga këto shkaqe, qoftë ajo lokale, qoftë e përgjithshme, siç na mëson leninizmi, ka karakter grabitqar dhe jo çlirimtar. Vetëm kur popujt ngrihen kundër pushtesve të huaj, kur ngrihen kundër borgjezisë kapitaliste të vendit, që është e lidhur ngushtë me imperializmin, socialimperializmin e kapitalin botëror, kjo luftë është e drejtë, është çlirimtare.

Përfaqësuesit e kapitalit të madh botëror flasin shumë për gjoja nevojën e ndryshimit të sistemit të lidhjeve të tanishme ekonomike ndërkombëtare dhe për

krijimin e një «rendi të ri ekonomik botëror», të cilin e përkrahin edhe udhëheqësit kinezë. Sipas tyre, ky «rend i ri ekonomik» do të shërbejë si «bazë për stabilitetin global». Revizionistët sovjetikë nga ana e tyre flasin për krijimin e të ashtuquajturës strukturë të re të marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare.

Këto janë përpjekje e plane të fuqive imperialiste e neokolonialiste, të cilat duan ta mbajnë gjallë e t'i zgjatin jetën neokolonializmit, të ruajnë shtypjen dhe grabitjen e popujve. Por ligjet e zhvillimit të kapitalizmit e të imperializmit nuk u nënshtrohen dëshirave, as shpikjeve teorike të borgjezisë dhe të revizionistëve. Siç ka thënë Lenini, rruga e daljes nga këto kontradikta është lufta konsekuente kundër kolonializmit e neokolonializmit, revolucioni.

Duke analizuar tiparet ekonomike themelore të imperializmit, Lenini përcaktoi edhe vendin historik të tij. Ai theksoi se imperializmi është jo vetëm faza më e lartë, por edhe faza e fundit e kapitalizmit, është pragu i revolucionit proletar. Lenini ka thënë se

*«Imperializmi është një fazë historike e veçanë e kapitalizmit... është (1) — kapitalizëm monopolist; (2) — kapitalizëm parazitarr ose në kalbëzim; (3) — kapitalizëm që jep shpirt»<sup>1</sup>.*

Realiteti i botës së sotme kapitaliste e vërteton plotësisht këtë konkluzion.

Baza ekonomike e të gjitha plagëve ekonomiko-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 23, f. 122.

-sociale të imperializmit, siç e ka vërtetuar Lenini, është monopoli. Monopolet janë të pafuqishme për të kapërcyer kontradiktat e ekonomisë kapitaliste. Parazitizmin dhe kalbëzimin e imperializmit Lenini i lidhte organikisht me tendencën e monopolit për të frenuar në përgjithësi zhvillimin e forcave prodhuese, për të thelluar zhvillimin disproporcional midis degëve dhe në shkallën e të gjithë ekonomisë kombëtare, për të mos shfrytëzuar kapacitetet prodhuese njerëzore e materiale, me prirjen për të penguar zbatimin e të re-jave të shkencës dhe të teknikës në dobi të masave dhe të përparimit të të gjithë shoqërisë.

Lakmia për fitime, konkurrenca i detyrojnë monopolet të investojnë për futjen e teknikës së përparuar në procesin e prodhimit. Por në tërë procesin historik të zhvillimit të imperializmit ajo që sundon është tendenca e zhvillimit disproporcional dhe e frenimit.

Shpenzimet e kërtimeve dhe të zhvillimeve shkencore të bëra në fushën e industrisë, veçanërisht në atë të luftës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shembull, kanë kaluar nga 2 miliardë dollarë në vitin 1950, në afër 11 miliardë më 1965 dhe në rreth 30 miliardë më 1972. Shumë herë firmat e mëdha gjejnë edhe vështirësi për kërkimet shkencore, por, sapo i zbulojnë këto të fundit, blejnë patenta, pajtojnë me mëditje punëtorë të kualifikuar dhe, vetëm kur ua do interesi, i vënë në zbatim.

Natyrisht, sektorët më kryesorë e që paraqesin më shumë interes për investime në drejtim të zhvillimit dhe të revolucionit teknik, kanë prioritet sepse sigurojnë më tepër fitime. Vending e parë këtu e zë industria

e luftës për faktin se në këtë sektor është edhe norma më e lartë e fitimit. Për shembull, në vitin 1964 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për kërkime shkencore në sektorin e aviacionit dhe të raketave janë investuar 3 miliardë e 565 milionë dollarë. Po në këtë vit në industrinë elektrike dhe të telekomunikacioneve janë investuar 1 miliard e 537 mijë, në industrinë kimike — 196 milionë, në atë të makinave — 136 milionë, të automobilave — 174 milionë, të instrumenteve shkencore — 172 milionë, në atë të prodhimeve prej kauçuku — 38 milionë, të vajgurit — 8 milionë, të metanit — 9 milionë etj.

Në kushtet e sotme, militarizimi i ekonomisë, si shfaqje e kalbëzimit të imperializmit, është bërë një tipar karakteristik për të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste. Por në mënyrë të veçantë procesi i militarizimit të ekonomisë ka marrë përpjesëtime të papara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Sovjetik. Shpenzimet direkte ushtarake nga të dyja palët kanë marrë përpjesëtime astronomike, që kapin bashkërisht shumën mbi 240 miliardë dollarë në vit.

Në politikën e tyre për hegjemoni dhe sundim botëror Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik përdorin në shkallë të gjerë edhe tregtinë e armëve, e cila është një shprehje tjetër e qartë e kalbëzimit të imperializmit. Ato shesin armë çdo vit me një vleftë prej mbi 20 miliardë dollarësh. Armë shesin edhe shtetet e tjera imperialiste, si Anglia, Gjermania Perëndimore, Franca, Italia etj. Klientë të rregullt të kësaj tregtie imperialiste janë klika të tilla reaksionare e fashiste, si ato të Kilit, Izraelit, Koresë së Jugut, Ro-

dezisë, Bashkimit Jugafrikan etj. Klientë të tillë janë edhe ato vende të pasura me lëndë të para strategjike ose naftë e që imperialistët kërkojnë t'i joshin me armë kundrejt grabitjes së pasurive të tyre.

Për kalbëzimin e parazitizmin e kapitalizmit të sotëm monopolist dëshmon qartë shpërthimi gjithnjë më i dendur i krizave ekonomike të superprodhimit. Shpërthimi i krizave që tani janë bërë shumë të thella, vërteton drejtësinë e teorisë marksiste mbi karakterin anarkik, spontan e disproporcional të prodhimit e të konsumit dhe hedh poshtë «teoritë» borgjeze të zhvillimit të kapitalizmit «pa kriza», apo të shndërrimit të kapitalizmit në «kapitalizëm të rregulluar».

Në shoqërinë e sotme kapitaliste po vepron me forcë akoma më të madhe ligji i përgjithshëm i akumulimit kapitalist i zbuluar nga Marksi, se, ndërsa nga njëra anë shtohet varfëria e punonjësve, nga ana tjetër rriten fitimet e kapitalistëve. Po thellohet procesi i polarizimit të shoqërisë në proletarë dhe borgjezë, që përfaqësojnë një numër të kufizuar njerëzish.

Sistemi i sotëm imperialist, i cili ka mundësi ekonomike më të shumta për të korrptuar shtresat e larta të proletariatit, aristokracinë punëtore e ka rritur në përmasa shumë të mëdha.

Aktualisht oligarkia financiare e përdor gjerësisht këtë aristokraci që të mashtrojë e të çoroditë proletariatin, të shuajë hovin revolucionar të tij. Nga aristokracia punëtore zakonisht dalin ata që Lenini i quan socialistë me fjalë, por imperialistë me vepra. Në këtë karakterizim të Leninit përfshihen socialdemokracia, «partitë punëtore borgjeze», udhëheqësit oportunistë të

sindikatave, revizionistët modernë etj. Lenini thekson se imperializmi lidhet me oportunizmin, se oportunistët e ndihmojnë ruajtjen dhe fuqizimin e imperializmit. Ai thotë se

*«...më të rrezikshëm janë ata që nuk duan të kuptojnë se lufta kundër imperializmit, po të mos lidhet ngushtë me luftën kundër oportunizmit, bëhet një frazë e zbrazët dhe e rreme»<sup>1</sup>.*

Kalbëzimi i imperializmit shihet qartë edhe në shtimin e thellimin e reaksionit në të gjitha fushat e, sidomos, në ato politike e shoqërore. Borgjezia monopoliste, siç vërteton praktika, kur shikon se lufta klasore ashpërsohet, i flak tutje maskat, duke u mohuar masave punonjëse edhe ato pak të drejta që i kanë fituar me gjak. Për këtë dëshmojnë regjimet dhe diktaturat fashiste që janë vendosur në mjaft vende të botës.

I gjithë ky sistem i kalbur, i cili është në një gjendje kaotike, mbahet në këmbë nga një ushtri e madhe pretoriane, nga një polici në numër shumë të madh, e mobilizuar dhe e armatosur deri në dhëmbë. Të gjitha këto forca ushtarake policeske vihen në veprim për të evituar dhe për të shtypur çfarëdo rezistence që kapërcen caqet e përcaktuara nga një pyll ligjesh të bëra nga borgjezia në fuqi. Kuadrot e ushtrisë dhe të armëve të tjera shtypëse rrojnë në bollëk dhe marrin rroga të majme. Në Itali, për shembull, nuk

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 307.

dëgjon të flitet për gjë tjetër veçse për ushtri, për polici, për karabinieri, për agjentë të sigurimit që deko-rohen, por edhe që vriten.

Në këtë situatë kaq konfuze, që sundon në shtetet borgjeze, është zhvilluar dhe përhapur banditizmi, i cili është pjellë e vetë sistemit kapitalist, shprehje e degjenerimit të tij, pasqyrim i dëshpërimit dhe i çorientimit që shkakton sistemi borgjez i shtypjes dhe i shfrytëzimit. Borgjezia përpiqet të pengojë ato shfaqje të banditizmit që i hapin probleme dhe që krijojnë shqetësime për shtetin borgjez. Por ajo nxit dhe e përdor banditizmin për të terrorizuar masat e gjera punonjëse, që rrojnë në mjerim. Banditizmi në shumë vende kapitaliste është bërë një industri dhe është përhapur që nga vjedhjet e bankave, të dyqaneve, deri te rrëmbimi i qytetarëve, duke u kërkuar shuma të mëdha të hollash që t'i lirojnë. Banditizmi në disa vende është organizuar në grupime të ndryshme. Këto grupime kanë nga një emër që tingëllon si «revolucionar», si «komunist» etj. Borgjezia këtyre u lë dorë të lirë të vepronë për të përgatitur situatën e për të justifikuar kryerjen e një grushti shteti fashist. Për të diskredituar revolucionin dhe socializmin, kjo veprimtari banditeske propagandohet sikur zhvillohet nga «grupe komuniste» që gjoja veprojnë kundër rendit borgjez.

Si konkluzion mund të themi se në gjendjen aktuale të imperializmit në tërësi, të imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik, si dhe të imperializmave të tjerë, imperializmi, i çfarëdo ngjyre qoftë, është në fazën e dobësimit e të kalbëzimit. Shoqëria e vjetër nëpërmjet revolucionit do të përmbysset nga themelet



dhe do të zëvendësohet nga një shoqëri e re, nga shoqëria socialiste. Kjo shoqëri e re socialiste ekziston dhe do të zgjerohet, do të zhvillohet, do të fitojë terren, pavarësisht se revizionistët sovjetikë tradhtuan socializmin në Bashkimin Sovjetik, pavarësisht se në Kinë sundon oportunitizmi dhe po ngrihet një socialimperializëm i ri, pavarësisht se në vendet e ish-demokracisë popullore është rivendosur kapitalizmi. Socializmi do të ndjekë rrugën e vet dhe do të fitojë me luftë e me përpjekje kundër imperializmit dhe kapitalizmit botëror, por kurrë e në asnjë mënyrë me reforma, me rrugë parlamentare e paqësore, siç predikonte Hrushovi dhe siç po predikojnë të gjithë revizionistët. Ai do të triumfojë duke i qëndruar besnik teorisë leniniste mbi imperializmin e revolucionin proletar dhe kurrë simbas teorisë të sotme revizioniste që e shpallin kapitalizmin monopolist shtetëror si gjoja një fazë të re të veçantë të kapitalizmit, si «lindje të elementëve socialistë në gjirin e kapitalizmit».

Duke u nisur nga konkluzionet e Leninit mbi natyrën e imperializmit dhe vendin historik të tij, gjithë imperializmi botëror si sistem shoqëror, si rezultat i kontradiktave që e brejnë nga brenda dhe i luftërave çlirimtare e revolucionare të popujve, nuk e ka atë fuqi dominuese e të pandashme si më parë. Kjo është dialektika e historisë dhe ajo vërteton tezën marksist-leniniste se imperializmi është në rënie, është në dekadencë, është në kalbëzim.

Tendenca e dobësimit të kapitalizmit dhe të imperializmit është sot tendenca kryesore e historisë botërore. Këtë e kanë argumentuar Marksi dhe Lenini, të

bazuar në të dhëna konkrete, në ngjarjet e historisë, në dialektikën materialiste. Tendenca për bashkimin e përpjekjeve të shteteve që kundërshtojnë imperializmin çon edhe kjo në dobësimin e imperializmit. Por kjo tendencë e dytë, ashtu siç e absolutizon Kina, pa bërë diferencimet e nevojshme, pa studiuar situatat e veçanta, nuk të çon në rrugë të drejtë. Duke pretenduar se imperializmi amerikan është në rënie e më pak i fuqishëm se socialimperializmi sovjetik, duke shpallur «botën e tretë» si forcën kryesore lëvizëse të epokës, udhëheqësit kinezë praktikisht nxitin kapitullimin e nënshtrimin përpara borgjezisë.

Është e vërtetë që popujt kërkojnë çlirim, por këtë çlirim ata duhet ta fitojnë vetëm me luftë, me përpjekje dhe duke pasur në krye një udhëheqje luftarake. Marks, Engels, Lenini dhe Stalini na mësojnë se kjo udhëheqje është proletariati i çdo vendi. Por proletariati dhe partitë e tij marksiste-leniniste duhet t'i bëjnë mirë analizat politike, ekonomike dhe ushtarake, t'i hedhin të gjitha në balancë, të marrin vendime e të caktojnë një strategji dhe një taktikë të përshtatshme. duke pasur kurdoherë parasysh përgatitjen dhe kryerjen e revolucionit. Pa e pasur parasysh revolucionin, siç bëjnë kinezët, as analizat, as veprimet, as strategjia dhe as taktikat nuk mund të jenë marksiste-leniniste, revolucionare.

Asnjë iluzion nuk mund të kemi ne për imperializmin e çfarëdolloji, qoftë ky i fortë ose më pak i fortë. Natyra e imperializmit krijon kushtet për ekspansion ekonomik e politik, për shpërthimin e luftërave, pse në brendinë e vet karakteri i tij është shfrytëzues, agresiv.

Prandaj të gënjesht masat e gjera të popujve që kërkojnë çlirim, se këtë do ta arrijnë duke u udhëhequr nga teori të tilla revizioniste si ajo e «tri botëve», është një krim që u bëhet popujve dhe revolucionit.

Epoka jonë, siç na mëson Lenini, është epoka e imperializmit dhe e revolucioneve proletare. Me këtë duhet të kuptojmë që ne, marksistë-leninistët, duhet ta luftojmë me ashpërsinë më të madhe imperializmin botëror, cilindo imperializëm, cilëndo fuqi kapitaliste, që shfrytëzon proletariatin dhe popujt. Ne theksojmë tezën leniniste, sipas së cilës revolucionit është sot në rendin e ditës. Bota do të ecë përpara drejt një shoqërie të re që do të jetë shoqëria socialiste. Kapitalizmi botëror, imperializmi dhe socialimperializmi do të kalbëzohen akoma më shumë e do të marrin fund nëpërmjet revolucionit.

Lenini na mëson ta luftojmë deri në fund imperializmin, ta kritikojmë atë në kuptimin e gjerë të fjalës dhe të ngremë klasat e shtypura kundër politikës së imperializmit, kundër borgjezisë. Analiza marksiste-leniniste e zhvillimit të sotëm të imperializmit tregon qartë se asgjë nuk mund t'u ndryshohet analizës dhe konklucioneve të Leninit mbi imperializmin, mbi natyrën e tiparet e tij, mbi revolucionin. Përpyekjet e të gjithë oportunistëve, duke filluar që nga socialdemokratët e deri te revizionistët hrushovianë e ata kinezë, për të shtrembëruar tezat leniniste mbi imperializmin, janë kundërrevolucionare. Qëllimi i tyre është të mohojnë revolucionin, të zbukurojnë imperializmin, t'i zgjatin jetën kapitalizmit.

Kur Lenini demaskon imperializmin dhe apologjetët e tij si Bernshtajnin, Kautskin, Hilferdingun dhe gjithë oportunistët e tjerë të Internacionales së Dytë, vëren se

*«Ideologjia imperialiste po hyn edhe në klasën punëtore. Nuk ka një mur kinez në mes saj dhe klasave të tjera»<sup>1</sup>.*

Mirëpo, për fat të keq, edhe «muri kinez» tani është prishur dhe në Kinë kanë depërtuar propaganda dhe ideologjia imperialiste. Oportunistët kinezë nuk janë aspak origjinalë. Duke ecur në rrugën e Kautskit e kompani, edhe ata e zbukurojnë imperializmin në përgjithësi dhe atë amerikan në veçanti, duke e paraqitur si një imperializëm që është në tërheqje dhe tek i cili popujt duhet të mbështeten për t'u mbrojtur nga socialimperialistët sovjetikë.

Ngjashmëria e «teorive» të revizionistëve kinezë me ato të Kautskit është tepër e dukshme. Në kohën e vet ky i fundit orvatej të mbronte politikën koloniale të imperializmit, të mbulonte shfrytëzimin dhe ekspansionin e tij, duke deformuar teorinë marksiste mbi zhvillimin e kapitalizmit. Këtë gjë po e bëjnë sot edhe udhëheqësit kinezë, të cilët, duke dashur të përkrahin imperializmin amerikan dhe politikën e tij neokolonialiste, nxjerrin teori absurde, gjoja të mbështetura te Marksi ose te Lenini. Por, po të flitet me gju-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 347. /

hën e Leninit, «teoria» kineze është një zhytje në pellgun e revizionizmit e të oportunitizmit.

Teoria e Kautskit përhapte iluzionin se gjoja në kushtet e kapitalizmit monopolist ekziston mundësia e një politike tjetër jopushtuese. Lidhur me këtë Lenini theksonte:

*«Thelbi i çështjes është se Kautski e shkëput politikën e imperializmit nga ekonomia e tij, duke interpretuar aneksimet si një politikë «të preferuar» të kapitalit financiar dhe duke e vënë atë në kundërshtim me një politikë tjetër borgjeze, gjoja të mundshme, po mbi bazën e kapitalit financiar. Del sikur monopolet në ekonomi mund të pajtohen me veprime jomonopoliste, pa dhunë, pa pushtime në politikë. Del sikur ndarja territoriale e tokës, që ka marrë fund pikërisht në epokën e kapitalit financiar dhe që përbën bazën e origjinalitetit të formave të sotme të garës midis shteteve të mëdha kapitaliste, mund të pajtohet me një politikë joimperialiste. Si pasojë, kemi mbulimin, dobësimin e kontradiktave më kryesore të shkallës së sotme të kapitalizmit, në vend që të zbulohet thellësia e këtyre kontradiktave, kemi reformizëm borgjez në vend të marksizmit»<sup>1</sup>.*

Revizionistët kinezë, duke injoruar faktin se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën ekonomike

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 328.

sundojnë monopolet, kapitali financiar, dhe se janë pikërisht këta që diktojnë politikën e brendshme e të jashtme, flasin për një imperializëm paqësor, që nuk kërkon më ekspansion, bile është edhe në tërheqje. Udhëheqësit kinezë «harrojnë» atë që ka thënë Stalini se tiparet dhe kërkesat kryesore të ligjit ekonomik themelor të kapitalizmit të sotëm janë

*«...sigurimi i fitimit kapitalist maksimal me anë të shfrytëzimit, të rrënimit dhe të varfërimit të shumicës së popullsisë së vendit, me anë të skllavërimit dhe të grabitjes sistematike të popujve të vendeve të tjera, sidomos të vendeve të prapambetura, më në fund me anë të luftërave dhe të militarizimit të ekonomisë kombëtare, të cilat përdoren për të siguruar fitime sa më të mëdha»<sup>1</sup>.*

Kështu, teorinë «e reja» të udhëheqësve kinezë dëshmojnë se ata këndojnë këngën e vjetër të Kautskit me avaz të ri.

Duke demaskuar krerët e Internacionales së Dytë, të cilët donin të bënin dallim midis fuqive imperialiste se cilat ishin më agresore dhe cilat më pak agresore, Lenini theksonte se ky qëndrim ishte antimarksist. Ky qëndrim i shpuri partinë e Internacionales së Dytë në pozitë të shovinizmit, në tradhti të hapur ndaj çë-

---

1. J. V. Stalin, «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», Tiranë, 1974, f. 45.

shtjes së proletariatit e të revolucionit. Në epokën tonë, thoshte Lenini, s'mund të shtrohet problemi se cili nga shtetet imperialiste, që u përfshinë në Luftën e Parë Botërore, me njërin ose me tjetrën palë, është «e keqja kryesore».

*«Demokracia e sotme — thotë ai — do t'i qëndrojë besnike vetvetes vetëm në qoftë se nuk do të bashkohet me asnjë borgjezi imperialiste, në qoftë se do të thotë: «të dyja janë më të këqija», në qoftë se në çdo vend do të kërkojë dështimin e borgjezisë imperialiste. Çdo zgjidhje tjetër do të jetë në të vërtetë nacional-liberale, që s'ka asgjë të përbashkët me internacionalizmin e vërtetë»<sup>1</sup>.*

Në kushtet e sotme, në qoftë se do të pranohej teza kineze sipas së cilës socialimperializmi sovjetik është më agresiv se imperializmi amerikan, do të kalohej në tradhti të hapur ndaj revolucionit, ndaj misionit historik të klasës punëtore, do të kalohej në pozitë e Internacionales së Dytë. Të dyja superfuqitë imperialiste përfaqësojnë në të njëjtën shkallë armikun dhe rrezikun kryesor për socializmin, për lirinë e pavarësinë e popujve, për sovranitetin e kombeve. Ato janë mbrojtëset kryesore të kapitalizmit botëror.

Udhëheqësit kinezë, për të fshehur tradhtinë e tyre ndaj popujve, thonë se marrëdhëniet e monopoleve të mëdha me disa vende që kanë pasuri të shum-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 21, f. 145-146.

ta krijojnë një gjendje që mund të evitohet bile edhe konfliktet midis fuqive monopoliste e popujve. Ky është një absurditet i madh, është një orvatje që synon ta paraqesë të butë egërsinë imperialiste, të krijojë një situatë euforike e të rreme se gjoja me investimin e kapitaleve do të krijohet mirëqenia e popullit të vendit ku bëhet investimi dhe kështu nuk do të ekzistojnë më ato kontradikta antagonistike në mes imperialistëve dhe popujve të këtyre vendeve. Kjo teori false, që tani trumbetohet nga udhëheqësit kinezë, është krijuar nga imperializmi për të shtrirë sundimin e tij kudo në botë dhe për të ndihmuar klikat reaksionare sunduese në vende të ndryshme, që të shtypin popullin e tyre dhe të shesin vendin tek i huaji.

Këto «teorira» janë një përsëritje në forma të reja e të rafinuara të teorive reaksionare të oportunistëve të Internacionales së Dytë. Në kohën e Luftës së Parë Botërore, Lenini demaskoi teorinë antimarksiste të Kautskit të «ultraimperializmit». Kautski thoshte se gjoja në kushtet e imperializmit, me anë të një marrëveshjeje midis kapitalistëve të vendeve të ndryshme, mund të ndalohen luftërat.

Në polemikë me Kautskin, Lenini thoshte se

*«...aleancat «interimperialiste» ose «ultraimperialiste» në realitetin kapitalist, dhe jo në fantazinë borgjeze vulgare të priftërinjve anglezë ose të «marksistit» gjerman Kautski, — në çdo formë që të bëhen këto aleanca, në formë të një koalicioni imperialist kundër një koalicioni*



*tjetër imperialist, apo në formën e një aleance të përgjithshme të të gjitha fuqive imperialiste — janë në mënyrë të pashmangshme vetëm «pushime» në mes të luftërave»<sup>1</sup>.*

Këto mësimë të Leninit janë shumë aktuale në kushtet e sotme kur revizionistët kinezë flasin e bëjnë përpjekje të ethshme për krijimin e një aleance e të një fronti të madh botëror me të gjitha shtetet e regjimet fashiste e feudale, kapitaliste e imperialiste, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër socialimperializmit sovjetik.

Aleanca midis vendeve imperialiste, theksonte Lenini, mund të krijohen, por ato krijohen vetëm me qëllim që të shtypin së bashku revolucionin, socializmin, për të grabitur së bashku kolonitë e vendet e varura e gjysmë të varura.

Revizionistët kinezë, ashtu si krerët e Internacionales së Dytë, parullën e Manifestit Komunist «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» e kanë zëvendësuar me parullën pragmatiste «Të bashkohemi me të gjithë ata që mund të bashkohen» kundër socialimperializmit sovjetik.

Teoria e «tri botëve», e shpikur nga udhëheqësit kinezë, nuk analizon zhvillimin historik të imperializmit në prizmin marksist-leninist, por e shikon atë në një prizëm global, duke i injoruar kontradiktat e kohës sonë, të cilat i kanë përcaktuar aq qartë Marksi dhe Lenini. Duke ndjekur këtë «teori», Kina «socialiste»

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 22, f. 359-360.

bashkohet me imperializmin amerikan dhe me «botën e dytë», domethënë me imperialistë të tjerë, që shfrytëzojnë popujt, dhe i bën thirrje «botës së tretë», popujve që aspirojnë të luftojnë kundër imperializmit dhe kapitalizmit botëror, qoftë ky amerikan ose socialimperializëm sovjetik, të bashkohen vetëm kundër socialimperializmit sovjetik.

Edhe teoria titiste e «vendeve të paangazhuara» është po aq antimarksiste sa edhe teoria e «tri botëve».

Këto dy «teori» janë shina të të njëjtës hekurdhë mbi të cilat ecën treni i imperializmit amerikan dhe i socialimperializmit sovjetik, tren që ka si ngarkesë pasuritë e grabitura të popujve të botës. Titistët e revizionistët kinezë përpiqen të hapin disa vrima në vagonët e këtij treni imperialist e socialimperialist që t'u kullojë pak vaj, pak sheqer, ndonjë dollar, ndonjë sterlinë, ndonjë frang a ndonjë rubël. Këto shina, që janë shtruar mbi kurrizin e popujve të shtypur e që përpiqen t'i mbajnë këta popuj vazhdimisht nën zgjedhë, janë dy teori po aq reaksionare siç janë gjithë teoritë e tjera antimarksiste, të trockistëve, anarkistëve, buharinistëve, hrushovianëve, toliatistëve, karrijoistëve, marsheistëve etj., etj.

Tezat gjeniale të Leninit mbi imperializmin i vërteton jeta vazhdimisht. Kapitalizmi ka hyrë në fazën e kalbëzimit të tij. Kjo situatë ngjall revoltën e popujve dhe i shtyn ata në revolucion. Lufta e popujve kundër imperializmit dhe kundër klikave kapitaliste borgjeze po shtohet në forma të ndryshme, me intensitet të ndryshëm. Sasia do të kthehet patjetër në cilësi. Më parë kjo do të ndodhë në ato vende ku hallka e zinxhirit

kapitalist është më e dobët, ku ndërgjegjja dhe organizimi i klasës punëtore kanë arritur në një shkallë të lartë, ku kuptimi politik dhe ideologjik i problemit është thelluar.

Imperializmi ka intensifikuar shtypjen e shfrytëzimin barbar të popujve. Por në të njëjtën kohë edhe popujt e botës po bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm se nuk mund të rrohet më në shoqërinë e sotme kapitaliste, ku masat punonjëse shtypen e shfrytëzohen jo më pak se në kohën e paraluftës.

Imperializmi, me gjithë përpjekjet e tij dhe të adepteve të vet, as tani, por as edhe më vonë, nuk mund të gjejë stabilitet në luftën e tij për të vendosur hegjemonizmin mbi popujt. Ai nuk mund ta gjejë këtë për shkak të zgjimit të ndërgjegjes së klasës punëtore dhe të masave të shtypura punonjëse që duan çlirim, si dhe për shkak të kontradiktave të pashmangshme ndër-imperialiste.

Popujt po shikojnë, dhe më vonë do ta shohin edhe më mirë, se imperializmi dhe kapitalizmi botëror nuk mbështeten vetëm në forcën ekonomike, ushtarake, politike, ideologjike të dy superfuqive, por mbështeten edhe në klasat e pasura që i mbajnë popujt e vendeve të tyre nën zgjedhë, në shfrytëzim, nën frikën për të mos u ngritur në këmbë që të fitojnë lirinë dhe pavarësinë e vërtetë.

Masat e gjera të popujve të ndryshëm të botës kanë filluar, gjithashtu, të kuptojnë se shoqëria aktuale borgjezo-kapitaliste, sistemi shfrytëzues i imperializmit botëror duhen përmbysur. Për popujt, kjo nuk

është vetëm një aspiratë, ata në mjaft vende kanë rrokur edhe armët.

Prandaj nuk është nevoja të teorizohet duke e ndarë botën në tri apo në katër pjesë, në «të angazhuar» e në «të paangazhuar», por të shikohet dhe të interpretohet drejt procesi i madh historik, objektiv, sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit. Bota është e ndarë më dysh, bota e kapitalizmit dhe bota e re e socializmit, që janë në luftë të pamëshirshme midis tyre. Në këtë luftë do të fitojë e reja, bota socialiste, kurse shoqëria e vjetër kapitaliste, shoqëria borgjeze e imperialiste, do të rrëzohet.

### III

## REVOLUCIONI DHE POPUJT

Marksit i ka argumentuar shkencërisht domosdoshmërinë e shkatërrimit të shoqërisë kapitaliste dhe ndërtimin e një shoqërie më të përparuar, të socializmit dhe pastaj të komunizmit. Në veprën «Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit», duke zhvilluar mendimin e Marksit, Lenini tregoi se epoka e sotme është epoka e imperializmit dhe e revolucioneve proletare. Kjo është epoka e shkatërrimit të rendit të vjetër kapitalist, të kolonializmit e të imperializmit, e marrjes së pushtetit nga ana e proletariatit dhe e çlirimit të popujve të shtypur, periudha e fitores së socializmit në shkallë botërore.

Kjo do të thotë se sot jetojmë në epokën e zëvendësimit të shoqërisë së vjetër shfrytëzuese, të padurueshme për shumicën e njerëzimit, për të shtypurit e të shfrytëzuarit, me një shoqëri të re, ku zhduket një herë e përgjithmonë shfrytëzimi i njeriut nga njeriu. Pikërisht nga këto mësimet themelore dhe nga analiza marksiste-leniniste e procesit të zhvillimit të sotëm botëror është nisur Partia jonë kur në Kongresin e saj të 7-të shtroi tezën se bota ndodhet në një fazë

kur çështja e revolucionit dhe e çlirimit të popujve është një problem i shtruar për zgjidhje.

Lufta e proletariatit kundër borgjezisë është një luftë e ashpër, e pamëshirshme dhe që zhvillohet vazhdimisht. Përballë njëra-tjetrës qëndrojnë dy forca shoqërore të mëdha: Në njërën anë është borgjezia kapitaliste imperialiste, që është klasa më e egër, më mashtruese dhe më gjakpirëse që njih historia. Në anën tjetër është proletariati, klasa e zhveshur krejt prej mjeteve të prodhimit, e shtypur dhe e shfrytëzuar pa mëshirë nga borgjezia, njëkohësisht klasa më e përparuar e shoqërisë, e cila mendon, krijon, punon e prodhon, por nuk i gëzon frytet e djersës së saj.

Të dyja këto klasa përpiqen të grumbullojnë secila rreth vetes forca dhe t'i përgatitin këto për qëllimet e veta: proletariati për çlirimin shoqëror dhe kombëtar, për të bërë revolucionin; borgjezia për të ruajtur sundimin e vet e për të shtypur revolucionin. Borgjezia grumbullon rreth saj forcat më të errëta, më regresive dhe më kriminale, kurse proletariati përpiqet të bëjë për vete të gjitha forcat revolucionare, përparimtare.

Marksizëm-leninizmi na mëson se lufta në mes proletariatit dhe borgjezisë vjen vazhdimisht në rritje dhe do të kurorëzohet me siguri me fitoren e proletariatit dhe të aleatëve të tij. Por, që kjo luftë të kurorëzohet me sukses, është e nevojshme që proletariati të jetë i organizuar, të ketë partinë e vet pararojë, t'i bëjë masat e gjera të popullit të ndërgjegjshme për revolucion dhe t'i udhëheqë në luftën për marrjen e pushtetit, për vendosjen e diktaturës së vet, për ndërtimin

e socializmit dhe të komunizmit, shoqërisë pa klasa.

Ka në botë shumë elementë të ekzaltuar, me qëllime të mira ose të këqija, që mendojnë se revolucioni mund të kryhet në çdo kohë, në çdo moment, kudo. Por njerëz të tillë gabohen. Revolucioni nuk mund të realizohet në çdo kohë, kudo, sipas dëshirës. Revolucioni shpërthen e realizohet në atë hallkë të zinxhirit kapitalist që është më e dobët. Për shpërthimin e filloren e tij duhet të ekzistojnë kushtet e përshtatshme objektive e subjektive dhe të gjendet çasti i favorshëm për t'u hedhur në revolucion. Kryesorja është që masat e gjera të popullit, me proletariatin në ballë, kur ta shpërthejnë revolucionin, të jenë të vendosura e të përgatitura për ta çuar atë deri në fund.

Lenini thekson se revolucionin e bën populli i çdo vendi, se ai nuk eksportohet. Kjo nuk do të thotë që marksistë-leninistët, kudo ku militojnë, të mos e ndiejnë veten solidarë, të mos jenë të lidhur me njëri-tjetrin me ndjenjat e internacionalizmit proletar më të kulluar dhe të mos e ndihmojnë luftën e proletariatit dhe të popujve të vendeve të tjera për çlirimin e tyre. Përkundrazi, me propagandë, me agjitacion, me ndihmë materiale, me shembullin e vendosmërisë e të vetëmohimit të tyre dhe duke ndjekur me besnikëri marksizëm-leninizmin, të gjithë komunistët, proletarët, të gjitha forcat revolucionare të vendeve të ndryshme kanë detyrë të ndihmojnë revolucionin në çdo vend të veçantë dhe në të gjithë botën. Natyrisht, shfrytëzimi me sukses i kësaj ndihme varet, para së gjithash, nga përgatitja e proletariatit dhe e partisë së tij, nga zhvi-

llimi i luftës revolucionare në njërin ose në tjetrin vend.

Marksit dhe Engelsi në «Manifestin e Partisë Komuniste» tregojnë se interesat e proletariatit e të popullit të një vendi janë të pandara nga interesat e proletariatit dhe të popujve të të gjithë botës.

Revolucioni, siç mëson Lenini dhe siç e ka vërtetuar jeta, fiton në çdo vend të veçantë. Prandaj, para së gjithash, kjo fitore varet nga klasa punëtore dhe partia e saj revolucionare e çdo vendi, nga zotësia e tyre për të zbatuar, në kushtet konkrete, mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit mbi revolucionin.

Mirëpo rreth këtyre mësimëve, e sidomos rreth teorisë leniniste të revolucionit, kanë krijuar shumë konfuzion, kanë vënë shumë mina revizionistët modernë, titistë, sovjetikë, eurokomunistë, kinezë etj., të cilët kanë marrë përsipër të çoroditin njerëzit lidhur me çështjen e revolucionit dhe të ndalojnë shpërthimin e tij.

Sot, kur kjo çështje është shtruar për zgjidhje, është një detyrë imperative që të shpërndahet mjegulla që kanë përhapur revizionistët për revolucionin, të demaskohen manovrat e spekulimet që bëjnë ata rreth kësaj çështjeje, të zbulohen qëllimet e tyre kundërrevolucionare, shoviniste, hegjemoniste, të kuptohen e të zbatohen drejt mësimet e marksizëm-leninizmit mbi revolucionin.



## Të mbrojmë e të zbatojmë mësimet marksiste-leniniste mbi revolucionin

Marksizëm-leninizmi na mëson dhe përvoja e të gjitha revolucioneve e ka vërtetuar se, që të shpërthejë e të fitojë revolucionin, duhet të ekzistojnë faktorët objektivë e subjektivë.

Këtë mësim Lenini e ka formuluar në veprën «Dështimi i Internacionales së Dytë» dhe e ka zhvilluar më tej në veprën «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm» e në shkrime të tjera të tij.

Duke u ndalur në situatën revolucionare, si faktor objektiv i revolucionit, Lenini e karakterizon atë kështu:

*«1) Pamundësia për klasat sunduese që ta ruajnë të pandryshuar sundimin e tyre»<sup>1</sup> për shkak të krizës së thellë që ka përfshirë ato klasa, krizë që shkakton pakënaqësi e zemërim të klasave të shtypura. «Për shpërthimin e revolucionit — thotë ai — zakonisht nuk mjafton që «shtresat e ulëta të mos duan», por duhet gjithashtu që «shtresat e larta të mos kenë më mundësi» të rrojnë si më parë. 2) Acarimi... i varfërisë dhe i mjerimeve të klasave të shtypura. 3) Shtimi i madh, për shkak të arsyeve të mësipërme, i aktivitetit të masave, të cilat... tërhiqen... në veprime historike të pavarura»<sup>2</sup>.*

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 21, f. 223.

2. Po aty.

«Me fjalë të tjera kjo e vërtetë mund të shprehet kështu: revolucionari nuk mund të bëhet pa një krizë të përgjithshme nacionale (që të përfshijë edhe të shfrytëzuarit dhe shfrytëzuesit)»<sup>1</sup>.

«Pa këto ndryshime objektive — thekson ai — që nuk varen jo vetëm nga vullneti i grupeve dhe partive të veçanta, por as i klasave të veçanta, revolucionari — sipas rregullit të përgjithshëm — është i pamundur»<sup>2</sup>.

Por jo nga çdo situatë revolucionare lind revolucioni, thotë Lenini. Në mjaft raste, tregon ai, situatat revolucionare, si ato të viteve 1860-1870 në Gjermani, të viteve 1859-1861 dhe 1879-1880 në Rusi nuk janë shndërruar në revolucione, sepse ka munguar faktori subjektiv, domethënë ndërgjegjja e lartë dhe gatishmëria e masave për revolucion,

«. . . aftësia e klasës revolucionare — siç shprehet Lenini — për veprime revolucionare në masë, aq të forta saqë ta thyejnë (ose ta lodhin) qeverinë e vjetër, e cila kurrë, as në kohë krize, nuk do të «bjerë», po të mos e «përmbysin»»<sup>3</sup>.

Për përgatitjen e faktorit subjektiv, siç ka shkruar Lenini që në veprat e hershme të tij, rol vendimtar lu-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 83.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 21, f. 223.

3. Po aty.

an partia revolucionare e klasës punëtore, udhëhoqja, edukimi e mobilizimi nga ana e saj e masave revolucionare. Partia e arrin këtë si me anën e përpunimit të një vije të drejtë politike, që u përgjigjet kushteve konkrete dhe dëshirave e kërkesave revolucionare të masave, ashtu edhe nëpërmjet një pune shumë të madhe, të veprimeve revolucionare të dendura e të studiuara thellë politikisht, që i bëjnë të ndërgjegjshëm proletariatin dhe masat punonjëse për gjendjen në të cilën rrojnë, për shtypjen, për shfrytëzimin, për ligjet barbare të borgjezisë, për domosdoshmërinë e revolucionit, si mjet për ta përmbysur rendin skllavëruës.

Në këtë mënyrë shtresat e varfra do të reagojnë me atë intensitet saqë edhe të pasurit, borgjezia në fuqi, të tronditur edhe nga kontradiktat e tjera të brendshme e të jashtme, do ta kenë të vështirë të vazhdojnë të sundojnë si më përpara. Kur këto kushte plotësohen, kur ekzistojnë faktorët objektivë e subjektivë, që janë të lidhur njëri me tjetrin, atëherë revolucioni jo vetëm ka mundësi të pëlçasë, por edhe të fitojë.

Revolucionarët reflektojnë kurdoherë thellë mbi këto teza gjeniale të Leninit dhe jo vetëm reflektojnë, por edhe i analizojnë në mënyrë konkrete e të gjithëanshme situatat. Ata veprojnë që të mos zihen kurrë në befasi nga situatat revolucionare, të mos ndodhen të çarmatosur në këto momente vendimtare, por të dinë t'i shfrytëzojnë ato për përgatitjen e shpërthimit e revolucionit.

Ç'tregon analiza e gjendjes aktuale në botë? Par-

tia e Punës e Shqipërisë, duke u nisur nga teoria leniniste e revolucionit, nxjerr konkluzionin se sot situata në botë është në përgjithësi revolucionare, se në shumë vende kjo situatë është pjekur ose po piqet me shpejtësi, kurse në vende të tjera ky proces ndodhet në zhvillim.

Kur themi se situata sot është revolucionare, kemi parasysh se bota e sotme është në lëvizje drejt shpërthimesh të mëdha. Në përgjithësi gjendja i ngjan sot një vullkani në erupsion, një zjarri që përvëlon, zjarr që do të djegë pikërisht klasat e larta sunduese, shtypëse e shfrytëzuese.

Bota kapitaliste e revizioniste është mbërthyer nga një krizë e rëndë ekonomike e politike, financiare e ushtarake, ideologjike e morale. Kriza e tanishme, që ka tronditur të gjitha strukturat e superstrukturat e rendit borgjez e revizionist, ka acaruar e thelluar akoma më tepër krizën e përgjithshme të sistemit kapitalist.

Pasojat e krizës duken shumë të rënda dhe shkatërrimtare sidomos në fushën e ekonomisë. Që nga viti 1974 ka filluar kriza më e rëndë ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo ka sjellë rënien e prodhimit industrial në përmasa të konsiderueshme: në Japoni 20 për qind, në Britaninë e Madhe 15 për qind, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 14 për qind, në Francë e në Itali 13 për qind, në Republikën Federale të Gjermanisë 10 për qind etj. Kriza ka shkaktuar një depresion shumë të thellë. Në mjaft vende kapitaliste mosshfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në disa degë kyç të ekonomisë ka arritur nga 25 deri në 40 për qind

dhe kjo gjendje po zgjatet me vite të tëra. Për këtë arsye prodhimi industrial vazhdon të qëndrojë në amulli. Sasi kolosale mallrash «tepricë» kanë mbetur stoqe pa u shitur.

Por me gjithë këto stoqe, edhe pse nuk shfrytëzohen shumë kapacitete prodhuese, fitimet e monopoleve vazhdojnë të rriten për shkak të ngritjes së çmimeve. Çmimet rriten nga dita në ditë, kurse inflacioni në vende të veçanta ka arritur në shifra shumë të larta.

Rritja e çmimeve dhe, sidomos, inflacioni janë bërë një mjet shumë i përshtatshëm në duart e monopoleve e të shtetit kapitalist e revizionist për ta hedhur barrën e rëndë të krizës mbi kurrizin e klasës punëtore e të punonjësve të tjerë.

Nën maskën gjoja të frenimit të inflacionit, shtetet kapitaliste e borgjezo-revizioniste ngrenë taksat mbi të ardhurat e masave punonjëse, bllokojnë pagat e tyre dhe, në të njëjtën kohë, ulin tatimet mbi fitimet e monopoleve, zhvleftësojnë monedhat etj. Këto masa drejtohen kundër klasës punëtore dhe gjithë punonjësve, shtojnë shfrytëzimin dhe ulin nivelin e jetesës së tyre.

Zgjatja e krizës ekonomike ka keqësuar dhe rënduar shumë jetesën e klasës punëtore dhe të masave fshatare. Si rrallëherë është shtuar papunësia, e cila tanimë është bërë kronike, është kthyer në një plagë të madhe të shoqërisë borgjeze e revizioniste. Në botën kapitalisto-revizioniste janë flakur në udhë 110 milionë veta. Vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka jo më pak se 7-8 milionë të papunë. Miliona njerëz jetojnë sot në pragun e urisë ose në uri të vërtetë. Qin-

dra milionë veta torturohen nga ankthi i pasigurisë për të nesërmen.

Skamja dhe pasiguria për masat e gjera punonjëse, si edhe politika reaksionare, antipopullore, e brendshme dhe e jashtme, që ndjekin regjimet kapitaliste e borgjezo-revizioniste, kanë shtuar e po shtojnë vazhdimisht pakënaqësinë e shtresave të gjera të popullsisë. Kjo gjendje e rëndë ka ngjallur në këto shtresa zemërim të papërmbajtur që shprehet nëpërmjet grevash, protestash, demonstratash, përleshjesh me organet shtypëse të rendit borgjez e revizionist, në shumë raste edhe revoltash të vërteta. Masat popullore po armiqësohen gjithnjë e më shumë me regjimet që kanë mbi krye.

Qeveritë e vendeve imperialiste, kapitaliste e revizioniste, duke u përpjekur që edhe në këtë situatë krize të ruajnë për vete fitimet maksimale, të zbutin pakënaqësitë e zemërimin e masave dhe t'i bëjnë ato që ta heqin mendjen nga revolucioni, bëjnë lloj-lloj premtimesh e propozimesh mashtruese.

Ndërkaq, të varfrit varfërohen edhe më shumë, të pasurit pasurohen edhe më tepër, hendeku midis shtresave të varfra e shtresave të pasura shoqërore, midis vendeve kapitaliste të zhvilluara dhe vendeve të pazhvilluara thellohet pa pushim.

Kriza e sotme është shtrirë edhe në jetën politike, duke futur zjarrin në qarqet drejtuese të shteteve kapitaliste e revizioniste. Dëshmi e qartë e kësaj është shtimi i madh i krizave qeveritare dhe ndërrimi i ekipeve në fuqi.

Borgjezia dhe klikat sunduese janë të detyruara

t'i ndërrojnë gjithnjë e më shpesh kuajt e karrocave qeveritare, me qëllim që të mashtrojnë punonjësit dhe t'i mbajnë me shpresa se të rinjtë do të jenë më të mirë se të vjetrit, se fajin e krizës e të mosdaljes nga ajo e kanë të parët, kurse të dytët do ta përmirësojnë gjendjen e kështu me radhë. I gjithë ky mashtrim që zhvillohet në proporcione të gjera, mbulohet me parulla false të lirisë, të demokracisë, të fushatave elektorale etj. Në të njëjtën kohë borgjezia, në vendet kapitaliste e revizioniste, përforcon armët e saj të egra të dhunës, ushtrinë, policinë, shërbimin e fshehtë, organet gjyqësore, kontrollin e diktaturës së vet mbi çdo lëvizje dhe përpjekje të proletariatit. Tendencë që duket qartë sot në vendet kapitaliste e revizioniste është shtimi i dhunës borgjeze dhe kufizimi i të drejtave demokratike. Gjithnjë e më shumë po vihen re prirja për fashistizimin e jetës së vendit dhe përgatitja e vendosjes së fashizmit, në momentin kur borgjezia do ta shohë të pamundur të sundojë me metoda dhe mjete «demokratike».

Kriza ekonomiko-financiare e politike ka përfshirë jo vetëm monopolet, qeveritë, partitë e forcat politike brendapërbrenda vendit, por edhe alcancat ndërkombëtare, blloqet ekonomike, politike e ushtarake, siç janë Tregu i Përbashkët Evropian e KNER-i, Komuniteti Evropian, NATO-ja e Traktati i Varshavës. Kontradiktat, fërkimet, kontestimet, grindjet midis partnerëve të këtyre aleancave e blloqeve po manifestohen më hapur e më ashpërsisht.

Tjetër shprehje e krizës dhe e përpjekjeve për të dalë nga ajo është gara e armatimeve, përgatitja e gjith-

anshme për luftë dhe nxitja nga ana e superfuqive dhe e fuqive të tjera imperialiste e luftërave lokale, siç janë ato në Lindjen e Mesme, në Bririn e Afrikës, në Saharanë Perëndimore, në Indokinë e gjetkë. Kjo rrugë u shërben planeve hegjemoniste dhe ekspansioniste të njërës ose tjetrës fuqi imperialiste. Ajo mban gjallë dhe zhvillon industrinë ushtarake dhe tregtinë e armëve, që sot kanë marrë përpjesëtime të papara.

Por të gjitha këto mjete politike e ushtarake s'janë veçse ilaçe paliative që s'e shërojnë e s'mund ta shërojnë dot sistemin kapitalisto-revizionist të sëmurë rëndë.

Krizës së sotme ekonomike dhe politike të botës kapitaliste e revizioniste duhet t'i shtohet edhe kriza e paparë ideologjike e morale. Asnjëherë s'kanë ekzistuar një rrëmujë dhe çoroditje ideologjike e morale siç po shihen në periudhën aktuale. Asnjëherë s'ka pasur kaq shumë variante teorish borgjeze, të djathta, të mesit e «të majta», të veshura me lloj-lloj petkash, laike e fetare, klasike e moderne, antikomuniste të hapëta e të ashtuquajtura komuniste e marksiste. Asnjëherë s'është parë një shthurje e tillë morale, një mënyrë kaq e degjeneruar jetese, një depresion kaq i madh shpirtëror. Teoritë borgjeze e revizioniste, të ndërhuara me aq mundim e të trumbetuara me aq bujë si «udhërrëfyese për shpëtimin nga të këqijat e shoqërisë së vjetër», siç janë teoritë e «stabilizimit përfundimtar të kapitalizmit», të «kapitalizmit popullor», të «shoqërisë së konsumit», të «shoqërisë pasindustriale», të «mënjanimit të krizave», të «revolucionit tekniko-shkencor», të «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane, të «botës pa ushtri, pa armë e pa luftë», të «socializmit me fyty-



rë njeriu» etj., etj., tashmë janë tronditur nga themelet.

Të gjitha këto aspekte të krizës së përgjithshme i gjen jo vetëm në Jugosllavi, ku pasojat e krizës janë më të dukshme, por edhe në Bashkimin Sovjetik socialimperialist dhe në vendet e tjera revizioniste. Gjithkund në këto vende janë shtuar shtypja e shfrytëzimi, të gjitha vuajnë nga sëmundjet e kapitalizmit, nga grindjet e konfliktet për pushtet e për privilegje në radhët e udhëheqësve e të shtresave të larta, kudo ziejnë pakënaqësitë e zemërimi i masave popullore. Edhe në këto vende, pra, ekzistojnë mundësi të mëdha për revolucion. Ligji i revolucionit është edhe aty njësoj veprues si në çdo vend tjetër borgjez.

Është pikërisht kjo gjendje e krizës së sotme të përgjithshme të kapitalizmit, që ka prirje thellimi të vazhdueshëm dhe na bën të nxjerrim konkluzionin se situata revolucionare ka përfshirë ose është duke përfshirë shumicën e vendeve kapitaliste e revizioniste dhe që kjo situatë, rrjedhimisht, ka vënë në rend të ditës revolucionin.

Borgjësia e revizionistët, të ndodhur nën presionin gjithnjë e më të madh të krizës dhe të disfatave që kanë pësuar në profetizimet e tyre dhe në manovrat për të mbytur revolucionin, përpiqen të gjejnë ekspedientë të rinj dhe të fabrikojnë teori të tjera mashtruese.

Flamurin e mbrojtjes së sistemit kapitalist, të shtypjes e të shfrytëzimit të popujve, të përçarjes së lëvizjes revolucionare e çlirimtare, përgjithësisht të mashtrimit të masave, sot e kanë ngritur revizionistët

modernë. Por edhe këta do të pësojnë atë fat që kanë pësuar socialdemokratët dhe të gjithë oportunistët e tjerë të së kaluarës, të cilët u shndërruan në shërbëtorë të thjeshtë të borgjezisë.

Në situatën e sotme të krizave të saj të rënda ekonomike, politike e ideologjike, borgjezia u kërkon shërbëtorëve të vet revizionistë t'i dalin më hapur në mbrojtje. Kjo i detyron ata t'i heqin gjithnjë e më shumë maskat, por edhe të diskreditohen më shumë. Lenini thotë:

*«Oportunistët janë armiqtë borgjezë të revolucionit proletar, të cilët në kohë paqeje e bëjnë punën e tyre borgjeze tinëz, duke u strehuar në gjirin e partive punëtore, kurse në kohë krize dalin menjëherë si aleatë të hapur të të gjithë borgjezisë së bashkuar, nga ajo konservatore deri te më radikalja dhe demokratikja, nga ajo liberale deri te fetarja dhe klerikalja»<sup>1</sup>.*

Ky konkluzion shkencor i Leninit vërtetohet plotësisht nga shërbimi që i bëjnë sot revizionistët modernë sistemit kapitalist në krizë.

Të marrim, për shembull, Italinë, që është vendi tipik ku pasqyrohet kalbëzimi i kapitalizmit në bazën e në superstrukturën e tij. Që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe deri tani në Itali në fuqi janë demokristianët, partia e borgjezisë së madhe, partia e

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 21, f. 100.

Vatikanit, që ka grumbulluar rreth saj gjithë borgjezinë fetaro-reaksionare dhe elementët e djathtë. Qeveria e tyre sundon në një vend që është në gjendje falimentimi. Shtresat e borgjezisë së lartë që nga viti 1945 e deri tani kanë hyrë në një krizë aq të rëndë, saqë nga ajo kohë janë ndërruar rreth 40 qeveri, qeveri «monokolore» demokristiane, qeveri demokristiane-socialiste, qeveri tripalëshe, demokristiane-socialiste-socialdemokrate, qeveri «centro sinistra», qeveri «centro destra» etj.

Kriza e thellë qeveritare në Itali përfaqëson atë situatë të krizës së përgjithshme të brendshme, e cila nuk gjen asnjë rrugëdalje. Pasoja të saj janë grindjet, konfliktet, vrasjet dhe skandalet politike që po bëhen më të shpeshta, si rrëzimi i presidentit Leone, vrasja e kryetarit të Partisë Demokristiane, Moro etj.

Italia është bërë plasdarmë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ekonomia e saj e falimentuar, e vënë nën kthetrat e imperializmit amerikan, është ndërlikuar edhe me Tregun e Përbashkët Evropian, ku ajo është partneri i fundit.

Si rrjedhim i kësaj situatë, masat e gjera punonjëse të Italisë janë varfëruar dhe vazhdojnë të varfërohen. Atje ekziston papunësia më e madhe në krahasim me të gjitha vendet e tjera të Tregut të Përbashkët Evropian. Italia ka emigracionin më të madh të krahut të punës dhe importimet në këtë vend janë më të mëdha nga eksportimet. Vendet e Tregut të Përbashkët Evropian, veçanërisht Gjermania Perëndimore dhe Franca, duke kufizuar blerjen në Itali të produkteve ushqimore, kanë krijuar në bujqësinë ita-

liane një gjendje të vështirë. Çmimet e eksportit të gjalpfit, qumështit dhe frutave italiane kanë rënë shumë, ndërsa jetesa në vend është shtrenjtësuar së tepërmi. Italia është bërë vendi i grevave të mëdha, në të cilat marrin pjesë që nga punëtorët e industrisë së rëndë e të lehtë, të transportit e deri te postierët e aviatorët, bile edhe te policia.

Në një situatë të tillë që zien, ku interesat e masave dhe të revolucionit kërkojnë që gjithë kjo pakënaqësi e madhe e proletariatit dhe e mbarë popullit të kanalizohet në luftë kundër borgjezisë reaksionare, kundër përgatitjes së sulmit fashist që kjo përpigjet të shpërthejë, revizionistët italianë dhe sindikatat reformiste, tërë aristokracia punëtore, si dhe përkrahësit e teorisë kineze të «tri botëve», veprojnë si zjarrfikës të revolucionit dhe mbrojtës të rendit borgjez.

Ky rend borgjez i kalbur mbrohet nga të gjitha partitë, që nga partia fashiste e deri te partia revizioniste e Berlinguerit. Partia revizioniste italiane bashkohet me borgjezinë pikërisht për ta mbajtur në fuqi këtë rend borgjez të tronditur nga themelet. Ajo përpigjet ta mposhtë dhe ta fishkë hovin revolucionar të proletariatit italian, duke u orvatur ta gënjejë këtë se gjoja ndjek dhe zbaton një marksizëm të përshtatshëm për kushtet e vendit të vet.

Berlingueri ka hyrë me kohë jo vetëm në traktativa me demokristianët, por ka rënë edhe në ujdi, bile për shumë probleme ai, pa bërë pjesë zyrtarisht në qeveri, po qeveris bashkë me ta. Qeveria e mbështet këtë parti dhe njëkohësisht, sa për sy e faqe, lë të

kuptojë sikur gjoja nuk është dakord me të. Edhe partia revizioniste italiane bën të njëjtën lojë.

Revizionistët italianë bëjnë shumë zhurmë rreth një programi qeveritar, të përfunduar midis pesë partive të shumicës parlamentare italiane, të cilin ata e reklamojnë si një «fitore me rëndësi», si një «fazë të re politike» në vendin e tyre. Por kjo fazë politike, për të cilën flet Berlingueri, është inkuadrimi i partisë revizioniste në planet e kapitalit italian. Berlingueri këtë e cilëson si një marrëveshje serioze, realiste dhe jodogmatike. Ai pretendon se kjo marrëveshje do të bëhet shkak i një ndryshimi real, jo vetëm në marrëdhëniet politike midis partive, por për gjithë jetën ekonomike, shoqërore dhe shtetërore të vendit.

Revizionistët italianë vijnë kështu pikërisht në atë rrugë që ka parashikuar Lenini për oportunistët e ndryshëm, të cilët kërkojnë unitet me kapitalin për të penguar hovin revolucionar të masave. Me këtë unitet ata mendojnë se ia arritën deri në njëfarë shkalle qëllimit të tyre për të shkuar në socializëm nëpërmjet pluralizmit. Kuptohet se kjo është një ëndërr dhe kryetari i Senatit Italian, Amintore Fanfani, nuk e ka hiç gabim që marrëveshjen e pesë partive e cilëson si një koleksion ëndrrash. Ky është një koleksion ëndrrash nga ana e revizionistëve italianë, kurse nga ana e forcave të kapitalit nuk është aspak një ëndërr, por një punë e thellë për të likuiduar idetë e komunizmit në Itali, për të hedhur poshtë rivendikimet e popullit dhe të proletariatit italian, luftën e tij revolucionare për ndërtimin e një shoqërie të re. Revizionistët italianë po marrin tash disa thërrime, por, duke pretenduar se

qeveria ka nevojë për pjesëmarrjen në të të partisë revizioniste, ata kërkojnë që ajo të inkuadrohet e tëra brenda, të futet si peshku në ujë. Me një fjalë, partia revizioniste italiane përpiket të futet e tëra në shtjellimin reaksionar të kapitalit monopolist italian.

Partia e Berlinguerit është një parti krejt e degjeneruar ideologjikisht, me një program socialdemokrat krejtësisht reformist dhe parlamentarist. Ajo mbështet rendin e vendosur nga kushtetuta pseudodemokratike, në formulimin e së cilës kanë marrë pjesë edhe vetë «komunistët» italianë me Toliatin në krye. Pikërisht në emër të kësaj kushtetute, gjatë këtyre tri dekadave, borgjezia reaksionare dhe klerikale bën ligjin në Itali, shtyp proletariatin dhe masat e gjera të popullit. Këtë shtypje të ashtuquajturit komunistë italianë e gjejnë të drejtë dhe konform kushtetutës.

Partia revizioniste italiane, tok me partitë e tjera të borgjezisë, me atë demokristiane në krye, në parlamentin italian ose jashtë këtij, në organet e shtypit, nëpërmjet televizionit e radios, po zhvillojnë një politikë dhe një demagogji të shfrenuar, që e hutojnë opinionin italian, e çorientojnë dhe e çoroditin atë çdo ditë për të dobësuar vullnetin revolucionar të proletariatit dhe ndërgjegjen politike të masave punonjëse.

Gjithë kjo veprimtari u nevojitet shumë reaksionit italian dhe Vatikanit. Partia revizioniste italiane përpiket të shtypë lëvizjen revolucionare të masave popullore, me proletariatin në krye, për të penguar revolucionin, për të ndihmuar borgjezinë që të dalë nga situata dhe të evitohet përmbysja e rendit ekzistues.

Të marrim një shembull tjetër, Spanjën. Me vde-

kjen e Frankos në Spanjë erdhi në fuqi mbreti Huan Karlos. Ky është përfaqësuesi i borgjezisë së madhe spanjolle, e cila, duke parë se sundimi i gjatë i regjimit fashist e kishte futur vendin në një krizë të rëndë, arriti në mendimin se Spanja nuk mund të qeverisej më si në kohën e Frankos. Duhej, pra, të bëheshin disa ndryshime në formën e qeverisjes dhe në fuqi të mos qëndronte më falanga e komprometuar e Frankos. Pas një peripecie ndryshimi kryetarësh të qeverisë, fuqinë e morën njerëzit më të besuar të mbretit të ri, vazhdues i frankizmit të reformuar.

Në Spanjë demonstratat dhe grevat shpërthyen si kurrë më parë. Njëpërmjet tyre populli kërkonte ndryshime, natyrisht jo këtë «ndryshim» që u arrit, por ndryshime të thella e rrënjësore. Grevat, demonstratat e përleshjet atje nuk pushuan e as po pushojnë. Masat kërkojnë liri e të drejta, kombësitë e ndryshme autonome. Në këtë situatë, qeveria e Huan Karlosit, për të mashtruar masat e revoltuara, legalizoi edhe partinë revizioniste të Ibarruri-Karriljos. Krerët e kësaj partie u bënë shërbëtorë të bindur të regjimit monarkist spanjoll, u shndërruan në grevëthyes për të ulur hovin e madh revolucionar që është rritur në situatën e krijuar, për të shtypur, së bashku me borgjezinë, të gjithë elementët me mendime revolucionare të Luftës së Spanjës dhe dashamirës të republikës.

Edhe këtu shohim rolin zjarrfikës të partisë revizioniste spanjolle njësoj si roli që luan partia revizioniste italiane, por me një fuqi më të paktë se kjo e fundit.

Të tillë rol luajnë edhe partitë revizioniste në Fra-

ncë, në Japoni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, në Portugali e në të gjitha vendet e tjera kapitaliste, për të mbrojtur rendin borgjez, për të kapërcyer krizat dhe situatat revolucionare, për të trullësuar e për të paralizuar proletariatin dhe masat e tjera të shtypura e të shfrytëzuara, që po e kuptojnë gjithnjë e më qartë se nuk mund të jetohet më në «shoqërinë e konsumit» e në shoqëri të tjera shfrytëzuese dhe po ngrenë krye kundër rendit politik e ekonomik kapitalist.

Partitë revizioniste janë armike veçanërisht të leninizmit. Kjo do të thotë se janë armike të revolucionit, pasi është Lenini ai që përpunoi në mënyrë të përkryer teorinë mbi revolucionin proletar dhe e vuri atë në zbatim në Rusi. Në bazë të kësaj teorie fitoi revolucionin socialist në Shqipëri dhe në vende të tjera. Teoria leniniste, që tregon rrugën për triumfin gjithkund të revolucionit, ua nxjerr kallajin teorive kundërrevolucionare revizioniste të kalimit paqësor në socializëm me anë të rrugës parlamentare, pa shkatërruar aparatin shtetëror borgjez, bile, sipas tyre, duke e përdorur atë për transformime paqësore socialiste, pa pasur nevojë as për udhëheqje të proletariatit e të partisë së tij pararojë, as për diktaturën e proletariatit.

Pikërisht në këto momente kaq revolucionare, kur ka shumë mundësi që në hallkat më të dobëta të zinxhirit kapitalist të shpërthejë revolucionin, kur ndihet nevoja tepër e madhe që të rritet ndërgjegjja klasore e proletariatit, të përgatitet faktori subjektiv, të forcohet besimi në drejtësinë dhe në karakterin universal



të teorisë marksiste-leniniste, e cila tregon rrugën e vërtetë si të merret pushteti nga ana e proletariatit dhe e masave të tjera të shtypura, revizionistët i bëjnë një shërbim të paçmueshëm borgjezisë për të përballuar e për të mënjanuar revolucionin. Prandaj borgjezia përpiqet me çdo mënyrë t'i inkuadrojë partitë revizioniste dhe sindikatat që ndikohen prej tyre në luftën kundër revolucionit e komunizmit. Gjithë vija e imperializmit amerikan, e kapitalizmit botëror, e borgjezisë së çdo vendi synon pikërisht realizimin e këtij objekti. Borgjezia kërkon që partitë revizioniste të vihen hapur dhe plotësisht në shërbim të kapitalit, duke vepruar me ngjyrë «komuniste» dhe duke luftuar gjoja për ndryshimin e gjendjes, për krijimin e një shoqërie të re hibride, ku do ta kenë fjalën jo vetëm patronati dhe klasat e pasura, por gjoja edhe klasat e varfra, përfaqësuese e mbrojtëse të të cilave paraqiten partitë «komuniste» revizioniste e partitë socialiste.

Një shërbim shumë të madh në luftën për të frenuar e për të shuar revolucionet i bëjnë kapitalizmit botëror sidomos revizionistët që janë në pushtet, ata jugosllavë, sovjetikë e kinezë.

Revizionistët jugosllavë janë armiq të deklaruar të leninizmit, janë propagandistët më të zjarritë të mohimit të karakterit universal të ligjeve të revolucionit socialist, të mishëruara në Revolucionin e Tetorit dhe të pasqyruara në teorinë leniniste mbi revolucionin. Ata predikojnë se gjoja bota e sotme shkon në mënyrë spontane drejt socializmit, prandaj nuk ka nevojë për revolucion, për luftë klasash etj. Revizionistët jugos-

llavë paraqesin si model të socializmit të vërtetë sistemin e tyre kapitalist të vetadministrimit, i cili, simbas tyre, qenka si një *panacé* kundër «të këqijave» të socializmit «stalinist», ashtu edhe kundër të këqijave të kapitalizmit. Vendosija e këtij sistemi, sipas tyre, s'ka nevojë as për revolucion me dhunë, as për diktaturë të proletariatit, as për pronë socialiste shtetërore, as për centralizëm demokratik. «Vetadministrimi» mund të vendoset urtë e butë, në marrëveshje e në bashkëpunim midis qarqeve sunduese, midis punëdhënësve e punëtorëve, midis qeverisë e pronarëve! Pikërisht pse revizionizmi jugosllav është armik i leninizmit dhe saboton revolucionin, kapitalizmi ndërkombëtar, sidomos imperializmi amerikan, tregohet aq «bujar» për t'i dhënë ndihma financiare, materiale, politike, ideologjike Jugosllavisë titiste.

Revizionistët sovjetikë me fjalë nuk e hedhin poshtë leninizmin dhe teorinë leniniste të revolucionit, por e luftojnë atë në praktikë me qëndrimet dhe veprimtarinë e tyre kundërrevolucionare. Ata nuk kanë më pak frikë nga revolucioni proletar se imperialistët amerikanë dhe borgjezia e njërit ose e tjetrit vend, sepse në vendin e vet revolucionin i përmbys nga fronti, i zhvesh nga pushteti e privilegjet klasore, kurse në vendet e tjera ua djeg planet strategjike për sundimin botëror.

Ata përpiqen ta paraqesin veten si vazhdues të Revolucionit të Tetorit, si ndjekës të leninizmit, për të mashtruar proletariatin e masat punonjëse si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në vendet e tjera. Ata flasin për «socializëm të zhvilluar» e «kalim në komu-

nizëm» për të shuar çdo pakënaqësi, revoltë e lëvizje revolucionare të masave punonjëse në vendin e tyre kundër sundimit revizionist dhe për t'i shtypur ato si akte «kundërrevolucionare», «antisocialiste». Për jash-të vendit maskën e «leninizmit» ata e përdorin për të mbuluar teoritë e praktikën e tyre antimarksiste, antileniniste, për t'u hapur rrugë planeve ekspansioniste dhe hegjemoniste të socialimperializmit.

Revizionistët sovjetikë e paraqesin revolucionin me dhunë në vendet e zhvilluara kapitaliste shumë të rrezikshëm në kohën e sotme, kur çdo shpërthim revolucionar, sipas tyre, mund të shndërrohet në një luftë botërore e termobërthamore, që do të shfarosë njerëzimin. Prandaj ata rekomandojnë, si rrugën më të përshtatshme sot, revolucionin në rrugë paqësore, shndërrimin e parlamentit «nga një organ i demokracisë borgjeze në një organ të demokracisë për punonjësit». Edhe «detantën», të ashtuquajturën ulje të tensionit, që u shërben synimeve të politikës së jashtme sovjetike, ata e paraqesin si «prirje të përgjithshme të zhvillimit të sotëm botëror», e cila do të çojë gjoja në triumfin paqësor të revolucionit në shkallë botërore.

Për qëllime demagogjike ata nuk e mohojnë diktaturën e proletariatit, dalin bile teorikisht në mbrojtje të saj, thonë se, në raste të veçanta, mund të përdoret edhe revolucioni me dhunë. Por këto deklarata u nevojiten sidomos për të përlligjur kompletet e puçet e armatosura që organizojnë në njërin ose në tjetrin vend për të vendosur aty regjime dhe klika reaksionare prosovjetike, për t'i larguar nga rruga e drejtë

dhe për t'i vënë nën hegjemoninë e tyre lëvizjet nacionalçlirimtare etj.

Tashmë zjarrfikëse e zellshme e revolucionit është bërë edhe Kina revizioniste.

Gjithë politika e brendshme dhe e jashtme e revizionistëve kinezë drejtohet kundër revolucionit, sepse revolucioni ua përmbys strategjinë për ta bërë Kinën superfuqi imperialiste.

Brenda Kinës udhëheqja revizioniste shtyp egërsisht çdo shpërthim revolucionar të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse kundër qëndrimeve dhe veprimeve borgjezo-kundërrevolucionare të saj. Ajo përpiqet të mbulojë me çdo mënyrë kontradiktat e epokës së sotme, sidomos kontradiktën midis punës e kapitalit, midis proletariatit e borgjezisë. Revizionistët kinezë thonë se bota sot ka vetëm një kontradiktë, kontradiktën midis dy superfuqive, të cilën e paraqesin si kontradiktë midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të gjitha vendeve të tjera të botës me socialimperializmin sovjetik. Duke u mbështetur në këtë tezë të sajuar, ata u bëjnë thirrje proletariatit e popullit të çdo vendi të bashkohen me borgjezinë e vet për «mbrojtjen e atdheut e të pavarësisë kombëtare» kundër rrezikut që vjen vetëm nga socialimperializmi sovjetik. Me këtë revizionistët kinezë u predikojnë masave idenë e heqjes dorë nga revolucioni e lufta çlirimtare.

Për revizionistët kinezë çështja e revolucionit proletar dhe e atij nacionalçlirimtar nuk shtrohet fare në kohën e sotme, edhe sepse, sipas tyre, nuk paska kurrkund në botë një situatë revolucionare. Prandaj ata e

këshillojnë proletariatin të mbyllet në biblioteka e të studiojë «teorinë», pasi nuk ka ardhur koha për aksione revolucionare. Në këtë kuadër duket qartë sa armiqtë-sore dhe kundërrevolucionare është politika e revizionistëve kinezë, që përçajjnë lëvizjen marksiste-leniniste dhe pengojnë bashkimin e klasës punëtore në luftën kundër kapitalit.

Shtypi e propaganda kineze, si dhe fjalimet e udhëheqësve kinezë, nuk i zënë fare në gojë demonstratat e grevat e mëdha që po bën sot gjithë proletariati në vende të ndryshme kapitaliste. Ata e bëjnë këtë pse nuk duan që të inkurajojnë revoltën e masave, pse nuk duan që proletariati t'i shfrytëzojë këto situata kundër shtypjes e shfrytëzimit. Sa hipokrite tingëllojnë parullat e tyre bombastike e boshe se «vendet duan pavarësi, kombet duan çlirim dhe popujt duan revolucion»!

Revizionistët kinezë, duke pretenduar se sot në botë nuk ka situatë revolucionare, jo vetëm janë në kundërshtim me realitetin, por edhe kërkojnë që proletariati me partinë e tij marksiste-leniniste të rrijë duarkryq, të mos ndërmarrë asnjë aksion revolucionar, të mos punojë për përgatitjen e revolucionit. Lenini prej kohësh, qysh në Kongresin e 2-të të Internacionales Komuniste, i pati kritikuar pikëpamje të tilla kapitulluese të shprehura nga italianii Serrati, sipas të cilit nuk duhet të zhvillohen aksione revolucionare kur s'ka situatë revolucionare.

*«Ndryshimi midis socialistëve dhe komunistëve  
— thoshte Lenini — është pikërisht se socia-*

*listët nuk pranojnë të veprojnë ashtu, siç veprojmë ne në çfarëdo situatë, dhe pikërisht — të zhvillojnë veprimtari revolucionare»<sup>1</sup>.*

Kjo kritikë e Leninit është një shuplakë e fortë edhe për revizionistët modernë kinezë e për të gjithë revizionistët e tjerë, të cilët, njësoj si socialdemokratët, janë kundër aksioneve revolucionare të proletariatit e të masave të tjera punonjëse.

Lenini e quante Kautskin renegat, sepse

*«...ai e kishte shtrembëruar fund e krye doktrinën e Marksit, ia kishte përshtatur atë oportunitizmit, «e kishte mohuar revolucionin me vepra duke e pranuar atë me fjalë»»<sup>2</sup>.*

Udhëheqësit revizionistë kinezë bëjnë diçka më tepër se Kautski. Ata nuk e pranojnë as me fjalë nevojën e revolucionit.

Me këtë vijë reaksionare shpjegohen ajo politikë dhe ato qëndrime thellësisht kundërrevolucionare të udhëheqjes revizioniste kineze, e cila kërkon me çdo mënyrë të lidhë aleanca e të bashkëpunojë me imperializmin amerikan e vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, mbështet Tregun e Përbashkët Evropian dhe NATO-n.

Duke hyrë në aleancë dhe duke kërkuar unitetin me imperialistët amerikanë, që, tok me socialimperia-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 277.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 28, f. 257.

listët sovjetikë, janë shtypësit e shfrytëzuesit më të egër, armiqtë më të mëdhenj të proletariatit dhe të popujve, si dhe me sunduesit e tjerë imperialistë, me reaksionin më të zi botëror, duke i kërkuar proletaria-tit të vendeve evropiane dhe të vendeve të tjera të zhvilluara kapitaliste të shtrojë kurrizin e të pranojë shtypjen nga ana e borgjezisë, revizionistët kinezë marrin edhe vetë pjesë në këtë shtypje e bashkohen me kapitalizmin botëror në luftën kundër revolucionit, kundër socializmit, kundër çlirimit të popujve.

Siç shihet, kapitalizmi botëror me revizionizmin modern dhe me të gjitha veglat e tjera të tij zhvillon një luftë frontale, të ashpër e të shumanshme për të ndaluar shpërthimin e revolucioneve.

Ata përpiqen me të gjitha forcat të kapërcejnë krizat, të zbutin ose të shuajnë situatat revolucionare që ato të mos shndërrohen në revolucion. Mirëpo, kri-zat e situatat revolucionare janë fenomene objektive që s'varen nga vullneti e dëshirat as të kapitalistëve, as të revizionistëve dhe as të tjetërkujt. Ato mund të mënjanohen vetëm kur të zhduket rendi kapitalist shtypës e shfrytëzues që i lind ato në mënyrë të pa-shmangshme.

Imperialistët, kapitalistët e tjerë dhe revizionistët e dinë mirë se revolucionit nuk shpërthen vetvetiu në periudhat e krizave e të situatave revolucionare. Prandaj vëmendjen e goditjet kryesore ata i drejtojnë kundër faktorit subjektiv. Nga njëra anë, mundohen të trullosin e të mashtrojnë proletaria-tin, masat e tjera punonjëse, popujt të mos i lejojnë të bëhen të ndër-gjegjshëm për domosdoshmërinë e revolucionit dhe të

mos i lënë të bashkohen e të organizohen, nga ana tjetër, ata luftojnë që të shkatërrojnë lëvizjen marksiste-leniniste ndërkombëtare, që kjo të mos ngrihet e të fuqizohet, të mos bëhet një forcë e madhe politike udhëheqëse e revolucionit, që partitë marksiste-leniniste të vërteta të çdo vendi të mos fitojnë aftësi të tilla politike e ideologjike që të jenë në gjendje t'i bashkojnë, t'i organizojnë, t'i mobilizojnë, t'i udhëheqin masat në revolucion e në fitore.

Por sado të përpiqen e të luftojnë imperialistët, kapitalistët, revizionistët e reaksionarët, ata s'mund ta ndalin rrotën e historisë të ecë përpara. Përpjekjet dhe lufta e tyre do të ndeshin në përpjekjet dhe në luftën revolucionare të proletariatit e të popujve liridashës, kurse revizionistët modernë do të pësojnë të njëjtin fat që kanë pësuar socialdemokratët e të gjithë oportunistët e së kaluarës, të gjithë shërbëtorët e borgjezisë e të imperializmit.

## **Lufta çlirimtare e popujve — pjesë përbërëse e revolucionit botëror**

Kur flasim për revolucionin nuk nënkuptojmë vetëm revolucionin socialist. Në epokën e sotme të kallimit revolucionar nga kapitalizmi në socializëm, siç e kanë shpjeguar Lenini e Stalini, edhe lufta çlirimtare e popujve, revolucionet nacionaldemokratike, antiimperialiste, lëvizjet nacionalçlirimtare janë pjesë përbërëse të një procesi të vetëm revolucionar, të revolucionit proletar botëror.



*«Leninizmi — thotë Stalini — provoi... se çështja nacionale mund të zgjidhet vetëm në lidhje me revolucionin proletar dhe mbi bazën e tij, se rruga e fitores së revolucionit në Perëndim kalon nëpërmjet aleancës revolucionare me lëvizjen çlirimtare të kolonive dhe të vendeve të varura kundër imperializmit. Çështja nacionale është një pjesë e çështjes së përgjithshme të revolucionit proletar, një pjesë e çështjes së diktaturës së proletariatit»<sup>1</sup>.*

Kjo lidhje është bërë sot edhe më e qartë, më e natyrshme, kur shumica e popujve, me shembjen e sistemit të vjetër kolonial, bënë një hap të madh përpara drejt pavarësisë, duke krijuar shtetet e veta kombëtare, dhe kur, pas këtij hapi, aspirojnë të shkojnë më tej. Ata duan zhdukjen e sistemit neokolonialist, të çdo varësie imperialiste, të çdo shfrytëzimi të kapitalit të huaj, duan sovranitetin dhe pavarësinë e plotë, ekonomike e politike. Tashmë është vërtetuar se aspirata të tilla mund të përmbushen, objektiva të tillë mund të arrihen vetëm me zhdukjen e çdo sundimi e varësie të huaj, si edhe me zhdukjen e shtypjes e të shfrytëzimit të sundimtarëve borgjezë e çifligarë të vendit.

Këtej rrjedh lidhja e ndërthurja e revolucionit nacionaldemokratik, antiimperialist, nacionalçlirimtar me revolucionin socialist, sepse këto revolucione, duke goditur imperializmin e reaksionin që janë armiç të për-

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 144.

bashkët të proletariatit dhe të popujve, u hapin rrugën edhe transformimeve të mëdha shoqërore, ndihmojnë fitoren e revolucionit socialist. Dhe anasjelltas, revolucioni socialist, duke goditur borgjezinë imperialiste, duke shkatërruar pozitat e saj ekonomike e politike, krijon kushte të favorshme dhe lehtëson triumfin e lëvizjeve çlirimtare.

Kështu e shikon Partia e Punës e Shqipërisë çështjen e revolucionit. Ajo e shikon nga pozita marksiste-leniniste, prandaj mbështet dhe përkrah me të gjitha forcat luftërat e drejta të popujve liridashës kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe fuqive të tjera imperialiste, kundër neokolonializmit, për arsye se ato ndihmojnë kauzën e përbashkët të shkatërrimit të imperializmit, të sistemit kapitalist dhe fitoren e socializmit në çdo vend e në shkallë botërore.

Prandaj kur nxjerrim konkluzionin se revolucioni është një çështje e shtruar për zgjidhje, se ai është vënë në rendin e ditës, kemi parasysh jo vetëm revolucionin socialist, por edhe revolucionin demokratik antiimperialist.

Shkalla e pjekjes së situatës revolucionare, karakteri dhe zhvillimi i revolucionit nuk mund të jenë të njëjtë për të gjitha vendet. Ata varen nga kushtet konkrete historike të çdo vendi të veçantë, nga stadi i zhvillimit të tij ekonomik e shoqëror, nga raporti i klasave, nga gjendja dhe niveli i organizimit të proletariatit e të masave të shtypura, nga shkalla e ndërhyrjes së fuqive të huaja në vende të ndryshme etj. Secili vend e popull ka shumë probleme të veçanta të revolucionit, që janë mjaft të ndërlikuara.

Aktualisht flitet shumë për gjendjen në Afrikë, Azi, Amerikën Latine etj. dhe për realizimin e revolucionit atje. Udhëheqësit kinezë çështjen e revolucionit, të pavarësisë e të çlirimit kombëtar të këtyre vendeve e shohin në mënyrë globaliste, sikur mund të zgjidhet nëpërmjet bashkimit të të gjithë «botës së tretë», pra të shteteve, klasave, qeverive etj., duke injoruar situatat e problemet konkrete të secilit vend e rajon. Ky shikim metafizik tregon se udhëheqësit kinezë në fakt janë kundër revolucionit dhe çlirimit të popujve të Afrikës, Azisë, Amerikës Latine etj., se ata janë për ruajtjen e statukuosë, për ruajtjen e sundimit imperialist e neokolonialist në këto vende.

Edhe ne flasim për çështjen e çlirimit të popujve afrikanë, aziatikë, arabë e të tjerë. Këta popuj kanë mjaft çështje të përbashkëta që duhet t'i zgjidhin, por për secilin ekzistojnë edhe probleme të veçanta e shumë të koklavitura.

E përgjithshmeja dhe e përbashkëta e këtyre popujve është zhdukja e çdo zgjedhe të huaj imperialiste, koloniale e neokoloniale, e shtypjes nga ana e borgjezisë vendase. Këta popuj në Afrikë, në Amerikën Latine, në Azi e gjetkë ziejnë nga zemërimi dhe urrejtja kundër zgjedhës së huaj, po ashtu edhe kundër asaj të klikave sunduese borgjeze ose çifligaro-borgjeze të brendshme, të shitura tek imperialistët amerikanë, te socialimperialistët sovjetikë ose tek imperialistët e tjerë. Ata tani janë zgjuar dhe nuk durojnë dot më të grabiten pasuritë, djersa e gjaku i tyre, nuk mund të pajtohen më me prapambetjen ekonomike, shoqërore e kulturore në të cilën ndodhen.

Lufta kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, armiqve kryesorë të revolucionit, të çlirimit kombëtar e shoqëror të popujve, lufta kundër borgjezisë e reaksionit bëjnë që popujt të kenë shumë interesa të përbashkët, shumë probleme të përbashkëta dhe, mbi këtë bazë, të bashkohen me njëri-tjetrin.

Lufta kundër Izraelit, veglës më gjakatare të imperializmit amerikan, që është bërë një pengesë e madhe për ecjen përpara të popujve arabë, është një problem i përbashkët për të gjithë këta popuj. Megjithëkëtë, shtetet arabe në praktikë nuk janë të gjitha të një mendjeje për luftën që duhet t'i bëjnë bashkërisht Izraelit dhe për karakterin që duhet të ketë kjo luftë kundër këtij armiku të përbashkët. Shpesh kjo luftë nga disa prej tyre shihet në prizmin e ngushtë nacionalist. Ne nuk mund të jemi dakord me një qëndrim të tillë. Ne jemi për atë që Izraeli të futet në strofkën e vet dhe të zhduken nga ana e tij qëndrimet dhe veprimet shoviniste, provokuese, sulmuese dhe agresive kundër shteteve arabe. Ne kërkojmë që Izraeli t'u lirojë tokat arabëve, që palestinczët të fitojnë të gjitha të drejtat e tyre kombëtare, por nuk jemi kurrë për atë që të zhduket populli izraelit.

Të përbashkëta për popujt e vendeve arabe janë po ashtu përpjekjet për çlirimin e plotë nga kthetrat e imperializmit dhe të socialimperializmit, për forcimin e lirisë e të sovranitetit të tyre.

Megjithatë çdo popull i veçantë arab ka karakteristikat e veta, ka probleme specifike, që janë të ndryshme nga ato të të tjerëve dhe që rrjedhin nga zhvillimi

ekonomiko-shoqëror, niveli kulturor, organizimi i tyre shtetëror, shkalla e lirisë dhe e sovranitetit, e unifikiimit të fiseve dhe të tribuve në shumë prej tyre etj. Të gjitha këto elemente të veçanta është e pamundur të konfondohen dhe të kërkohen që problemi i lirisë, i pavarësisë, i demokracisë dhe i socializmit në të gjitha këto vende të zgjidhet për të tërë njësoj dhe në të njëjtën kohë.

Në ato vende arabe ku interesat e borgjezisë kanë qenë më të mëdhenj, imperialistët e ndryshëm kanë investuar shuma të konsiderueshme për shfrytëzimin e pasurive natyrore e të popujve. Për këtë është dashur të krijohen disa kushte punc si për kolonët, ashtu edhe për të kolonizuarit. Atje ku pasuritë natyrore kanë qenë më të shumta dhe interesat e kolonizatorëve kanë qenë më të mëdhenj, aty edhe shfrytëzimi i popullit dhe i pasurive ka qenë më intensiv. Shfrytëzimi i pasurive, natyrisht, ka sjellë edhe njëfarë zhvillimi, por ky nuk mund të konsiderohet si një zhvillim i përgjithshëm edhe harmonik i ekonomisë së këtij ose të atij vendi. Nga ana e kolonizatorëve janë financuar dhe janë ndihmuar kryetarët e tribuve më kryesore, të cilët shpirtin e tyre dhe pasuritë e popujve ua kishin shitur pushtesve imperialistë. Atyre u jepej vetëm një përqindje e vogël nga fitimet kolosale që realizonin kolonizatorët.

Me këto fitime dhe të ndihmuar nga padronët e tyre të jashtëm, krerët e tribuve, sipas rastit e sipas fuqisë së shtetit që i kishte skllavëruar, krijuan njëfarë shteti, gjoja të pavarur, me mbështetjen dhe nën kontrollin e vendit kolonizues. Në këtë mënyrë, me

ndihmën e kolonizatorëve, kryetarët e tribuve u shndërruan në shtresa të borgjezisë së pasur të sheikëve, të cilët shitën për hiçgjë tokat e tyre e bashkë me të shitën dhe popujt, duke i vënë nën një zgjedhë të dyfishtë, të kolonizatorëve të huaj dhe të tyren. Në vendet arabe u krijuan kështu dhe qëndronin përballë njëra-tjetrës shtresa e borgjezisë së madhe, e feudalëve të mëdhenj të tokave, e mbretërve mesjetarë dhe skllëvërit, proletariati që punonte në koncesionet e huaja. Shtresat e larta, me të hollat e fitimet që u akordonin shfrytëzuesit e huaj, adoptuan mënyrat e jetesës së borgjezisë evropiane dhe amerikane. Bijtë e tyre shkuan edhe në shkollat e kolonizatorëve, ku morën njëfarë kulture perëndimore. Ata hiqeshin si përfaqësuesit e kulturës së popullit të tyre, por në fakt u përgatitën për të mbajtur nën zgjedhë masat punonjëse dhe për t'i lejuar kolonizatorët t'i shfrytëzonin këto dëri në palcë e vazhdimisht.

Ai shtet arab që kishte më shumë pasuri, pati një zhvillim më të shpejtë, një tjetër që ishte më pak i pasur, zhvillimin e pati më të ngadalshëm, kurse ai që ishte i varfër, mbeti në një stad zhvillimi shumë të ulët.

Kolonializmi, pushteti i mbretërve feudalë dhe i borgjezisë së madhe latifondiste, duke pasur një organizim të përshtatshëm për një shtypje radikale, duke pasur gjithashtu në dorë edhe forcat e armatosura, shtypnin që në vezë çdo përpjekje për revoltë, çdo rivendikim, qoftë edhe për disa të drejta shumë të kufizuara ekonomike, pa folur pastaj për kërkesa politike dhe për revolucion.

Zhvillimi i shteteve arabe në ditët e sotme nuk shtron përpara tyre të njëjtat probleme për të zgjidhur. Të tjera probleme ka dhe me tjetër sy i shikon çështjet ekonomike, politike, organizative, ushtarake, fjala vjen, mbreti i Arabisë Saudite, me një sy krejt tjetër dhe me tjetër diapazon i shikojnë këto çështje emirët e Gjirit Persik. Po ashtu me tjetër sy i shikojnë problemet e veta Iraku, Siria, Egjipti, Libia, Tunizia, Algjeria, Maroku, Mauritania etj.

Prandaj, kur flasim për popujt arabë, arrijmë në konkluzionin se problemet e tyre, megjithëse ata kanë shumë interesa të përbashkët, nuk janë të njëjta dhe nuk mund të zgjidhen njësoj si në njërin e në tjetrin vend. Po kështu nuk mund të themi se në mes këtyre vendeve ekzistojnë një aleancë dhe një mendim i njëjtë për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Për secilin shtet arab problemet ndryshojnë jo vetëm për arsye të qëndrimeve të ndryshme të qeverive të njërit e të tjetrit vend, por edhe për arsye të qëndrimeve të shteteve koloniale ose neokoloniale që vazhdojnë akoma të bëjnë ligjin në shumicën e tyre.

Si për popujt arabë mund të flitet edhe për popujt e kontinentit afrikan. Afrika është një mozaik popujsh me një kulturë të lashtë. Çdo popull i saj ka kulturën, zakonet, mënyrën e jetesës së vet, që janë, ku më pak e ku më shumë, në një stad mjaft të prapambetur, për shkaqet që dihen. Zgjidhimi i pjesës më të madhe të këtyre popujve s'ka shumë që ka filluar. *De jure* popujt afrikanë përgjithësisht kanë fituar lirinë dhe pavarësinë. Por nuk mund të flitet për liri e pava-

rësi të vërtetë, pasi shumica ndodhen akoma në kushtet e një gjendjeje koloniale ose neokoloniale. Shumë prej këtyre vendeve qeverisen nga udhëheqjet e tribuve të vjetra që kanë marrë fuqinë dhe mbështeten te kolonialistët e vjetër ose tek imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë. Metodrat e kësaj qeverisjeje në këto shtete, në këtë stad nuk janë dhe nuk mund të jenë veçse një mbeturinë e theksuar e kolonializmit. Imperialistët përsëri sundojnë në pjesën më të madhe të vendeve afrikane nëpërmjet koncerneve, kapitaleve industriale të investuara, nëpërmjet bankave etj. Pjesa dërrmuese e pasurive të këtyre vendeve vazhdon të shkojë në metropole.

Atë liri dhe pavarësi që gëzojnë vendet afrikane, disa e kanë siguruar me luftë, kurse të tjerat e kanë marrë pa luftuar. Kolonizatorët anglezë, francezë e të tjerë, gjatë kohës së sundimit të tyre kolonial në Afrikë, i kanë shtypur popujt, por kanë krijuar edhe një borgjezi indigjene pak a shumë të edukuar në mënyrë oksidentale. Nga kjo borgjezi janë formuar edhe personalitetet. Ndër këto ka mjaft elementë antiimperialistë, luftëtarë për pavarësinë e vendit të vet, por shumica ose u qëndrojnë besnikë kolonizatorëve të vjetër, për të ruajtur marrëdhëniet e ngushta me ta edhe pas zhdukjes formale të kolonializmit, ose janë futur në varësi ekonomike e politike të imperialistëve amerikanë ose të socialimperialistëve sovjetikë.

Në të kaluarën kolonizatorët nuk kanë bërë investime të mëdha. Kështu ka ndodhur, për shembull, në Libi, në Tunizi, në Egjipt e gjetkë. Megjithatë, në të gjitha këto vende, kolonizatorët kanë thithur pasu-



ritë, kanë hedhur në dorë toka të gjera dhe kanë zhvilluar një proletariat jo të vogël në numër në disa degë të veçanta të industrisë, si në ato të nxjerrjes dhe të përpunimit të lëndëve të para. Ata kanë tërhequr gjithashtu në metropolet, si në Francë, për shembull, por edhe në Angli, një numër të madh krahë pune të lirë që punonte në minierat dhe në fabrikat e kolonizatorëve.

Në pjesët e tjera të Afrikës, sidomos në Afrikën e Zezë, zhvillimi industrial ka mbetur më prapa. Tërë vendet e këtij pellgu kanë qenë të ndara, sidomos në mes Francës, Anglisë, Belgjikës e Portugalisë. Prej kohësh këtu janë zbuluar pasuri të mëdha të nëntokës, si diamantet, hekuri, bakri, floriri, kallaji etj., dhe është krijuar një industri nxjerrëse dhe përpunuese mineralesh.

Në shumë vende të Afrikës janë ndërtuar qytete të mëdha, tipike koloniale, ku kolonizatorët rronin në mënyrë përrallore. Tani atje po rritet e po zhvillohet, nga njëra anë, borgjezia e madhe vendase dhe pasuria e saj, ndërsa, nga ana tjetër, rritet akoma më shumë varfëria e masave të gjera punonjëse. Në këto vende është krijuar pak a shumë njëfarë zhvillimi kulturor, por ai ka më tepër karakter evropian. Kultura vendase nuk është zhvilluar, ajo ka mbetur në stadin e arritur nga ana e tribuve dhe nuk përfaqësohet jashtë tyre, në qendrat ku ngrihen gratacielet. Kjo ka ardhur se jashtë qendrave të mëdha ku jetonin kolonizatorët, ekzistonin mizerja më e zezë, mjerimi më i madh, mbretëronte uria, sëmundjet, injoranca dhe shfrytëzimi i njerëzve deri në palcë me tërë kuptimin e fjalës.

Popullsia afrikane ka mbetur e pazhvilluar nga ana kulturore dhe ekonomike dhe ka shkuar vazhdimisht duke u pakësuar, duke rënë, për arsye të luftërave koloniale, të persekutimit të egër racial, të shitjes së zezakëve afrikanë dhe të çuarjes së tyre në metropole, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në vende të tjera, për të punuar si kafshë në plantacionet e pambukut e të kulturave të tjera, si dhe në punët më të rënda të industrisë e të ndërtimit.

Për këto arsye popujt afrikanë kanë akoma një luftë të madhe përpara për të bërë. Kjo është e do të jetë një luftë shumë e ndërlikuar, e ndryshme nga njëri vend tek tjetri, për arsye të kushteve të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe arsimor, të shkallës së zgjimit të tyre politik, të influencës së madhe që ushtrojnë në masat e këtyre popujve fetë e ndryshme, si feja kristiane, myslimane, besimet e vjetra pagane etj. Kjo luftë bëhet akoma më e vështirë mbasi në shumë nga këto vende qëndron aktualisht sundimi neokolonialist i bashkuar me atë të klikave vendase borgjezo-kapitaliste. Ligji atje bëhet nga ato shtete të fuqishme kapitaliste dhe imperialiste që subvencionojnë ose që kanë nën varësinë e tyre klikat sunduese, të cilat i vënë dhe i heqin kur e duan interesat e neokolonizatorëve ose kur balanca e këtyre interesave priset.

Politika e latifondistëve, e borgjezisë reaksionare, e imperialistëve dhe e neokolonialistëve synon që popujt afrikanë t'i mbajë vazhdimisht nën zgjedhë, në errësi, të pengojë zhvillimin e tyre shoqëror, politik dhe ideologjik, të pengojë luftën e tyre për t'i fituar këto të drejta. Aktualisht shohim se po ata imperialis-

të që i kanë sunduar këta popuj në të kaluarën, si dhe imperialistë të tjerë të rinj, përpiqen të depërtojnë në kontinentin afrikan, duke u përzier me të gjitha mënyrat në punët e brendshme të popujve. Kjo ka bërë që atje përditë e më shumë të acarohen kontradiktat midis imperialistëve, midis popujve e udhëheqjeve borgjezo-kapitaliste të shumicës së këtyre vendeve, midis popujve e kolonizatorëve të rinj.

Këto kontradikta është e nevojshme të shfrytëzohen nga popujt si për t'i thelluar ato, ashtu edhe për të përfituar prej tyre. Por kjo mund të arrihet vetëm me luftë të vendosur nga ana e proletariatit, e fshatarësisë së varfër, e të gjithë të shtypurve dhe skllëvërve, kundër imperializmit e neokolonializmit, kundër borgjezisë së madhe vendase, latifondistëve; dhe kundër gjithë organizmave që këta kanë krijuar. Një rol i veçantë në këtë luftë u takon njerëzve përparimtarë e demokratë, të rinjve revolucionarë e intelektualëve patriotë, të cilët aspirojnë t'i shohin vendet e tyre të ecin të lira e të pavarura në rrugën e zhvillimit e të progresit. Vetëm me luftë të vazhdueshme e të organizuar do t'u bëhet jeta e vështirë dhe qeverisja e pamundur shtypësve dhe shfrytëzuesve vendas e të huaj. Kjo situatë do të përgatitet në rrethanat e veçanta të secilit shtet afrikan.

Imperializmi anglez dhe imperializmi amerikan nuk u kanë dhënë ndonjë liri popujve të Afrikës. Të gjithë e shohim, për shembull, ç'po ndodh në Afrikën e Jugut. Atje sundojnë racistët e bardhë, kapitalistët anglezë, sundojnë shfrytëzuesit, të cilët shtypin egërsisht popujt me ngjyrë të këtij shteti, ku mbretëron li-

gji i xhunglës. Në mjaft vende të tjera të Afrikës sundojnë koncernet dhe kapitalet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë, të Francës, të Belgjikës, të kolonizatorëve dhe të imperialistëve të tjerë të vjetër, që janë dobësuar deri diku, por që vazhdojnë të mbajnë në dorë kyçet e ekonomisë së këtyre vendeve.

Një rrugë plot vuajtje e mundime, shtypjeje e shfrytëzimi të pamëshirshëm imperialist kanë kaluar edhe popujt e Azisë. Në prag të Luftës së Dytë Botërore nëntë të dhjetat e popullsisë të këtij kontinenti, pa Azinë Sovjetike, ndodheshin në gjendjen e shtypjes dhe të shfrytëzimit kolonial e gjysmëkolonial të fuqive imperialiste të Evropës, të Japonisë e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vetëm Britania e Madhe zotëronte në Azi 5 milionë e 635 mijë km<sup>2</sup> koloni me më tepër se 420 milionë frymë. Shtypja dhe shfrytëzimi kolonial i shumicës dërrmuese të vendeve të Azisë i kishin lënë këto vende në një prapambetje të theksuar ekonomiko-shoqërore e kulturore dhe në mjerim të thellë. Ato shërbenin vetëm si burime furnizimi të metropoleve imperialiste me lëndë të parë, si naftë, qymyrguri, krom, manganez, magnezit, kallaj, kauçuk etj.

Pas luftës edhe në Azi u shkatërrua rendi kolonial. Në vendet koloniale u ngritën shtete kombëtare më vete. Shumica e këtyre vendeve këtë fitore e arritën me luftë të përgjakshme të masave popullore kundër kolonizatorëve dhe pushtuesve japonezë.

Një rëndësi të veçantë për shembjen e kolonializmit në Azi pati lufta çlirimtare e popullit kinez, e cila

çoi në çlirimin e Kinës nga sundimi imperialist japonez, në shkatërrimin e forcave reaksionare të Çan Kai Shisë dhe në fitoren e revolucionit demokratik. Kjo fitore, në një vend të madh si Kina, ushtroi për një kohë një ndikim të gjerë në luftën çlirimtare të popujve aziatikë dhe të vendeve të tjera të sunduara ose të varura nga fuqitë imperialiste. Por ky ndikim shkoi vazhdimisht duke rënë, për shkak të vijës që ndoqi udhëheqja kineze pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës.

Udhëheqja kineze shpalli se Kina hyri në rrugën e zhvillimit socialist. Revolucionarët dhe popujt liri-dashës të botës, që dëshironin dhe prisnin që ajo të bëhej një kështjellë e fuqishme e socializmit dhe e revolucionit botëror, e përshëndetën me zjarr këtë shpallje. Por dëshirat dhe shpresat e tyre nuk po vërtetoheshin. Njerëzit s'donin të besonin, por faktet dhe gjendja shumë e trazuar dhe e turbullt që sundonte në Kinë tregonin se kjo nuk ecte në rrugën e socializmit.

Ndërkaq, lufta e popujve aziatikë s'kishte marrë fund me shkatërrimin e kolonializmit. Kolonizatorët anglezë, francezë, holandezë e të tjerë, duke qenë të detyruar të njihnin pavarësinë e vendeve ish-koloniale, donin të ruanin në këto vende pozitat e tyre ekonomike e politike për të vazhduar sundimin dhe shfrytëzimin me forma të tjera, neokolonialiste. Gjendjen e rëndoi veçanërisht depërtimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Azi, sidomos në Lindjen e Largme, në Azinë Juglindore dhe në ishujt e Paqësorit. Kjo zonë kishte dhe ka rëndësi të madhe ekonomike e ushtarako-strategjike për imperializmin amerikan. Ai

vendosì atje baza dhe flota të mëdha ushtarake. Paralelisht me këtë kapitali amerikan nguli në ekonominë e atjeshme kthetrat e tij të gjakosura. Ndërkohë, imperialistët amerikanë ndër morën operacione ushtarake dhe veprime diversioniste në shkallë të gjerë për të shtypur lëvizjet nacionalçlirimtare në vendet aziatike. Ata arritën të ndanin më dysh Korenë dhe Vietnamin, duke vendosur në pjesët jugore të këtyre vendeve regjime reaksionare, kukulla. Regjime çifligaro-borgjeze proimperialiste u vendosën edhe në mjaft vende ish-koloniale e gjysmëkoloniale të Azisë. Në këtë mënyrë u ruajtën atje skllavëria mesjetare, sundimi i egër i maharaxhëve, i mbretërve, i sheikëve, i samurajve, i zotërinjve kapitalistë «të modernizuar». Këto regjime i shitën përsëri vendet tek imperialistët, sidomos tek imperializmi amerikan, duke frenuar kështu pa masë zhvillimin ekonomik-shoqëror e kulturor të këtyre vendeve.

Në këto kushte popujt e Azisë, mbi zverkun e të cilëve rëndonte prapë zgjedha e rëndë imperialiste dhe çifligaro-borgjeze, qenë të detyruar të mos i lëshonin armët, por të vazhdonin luftën e vet çlirimtare për ta likuiduar këtë zgjedhë. Kjo luftë udhëhiqej përgjithësisht nga partitë komuniste. Atje ku këto parti kishin mundur të krijonin lidhje të shëndosha me masat, t'i bënë të ndërgjegjshme ato për qëllimet çlirimtare të luftës, t'i mobilizonin dhe t'i organizonin në luftë të armatosur revolucionare, kjo luftë dha rezultate pozitive. Fitorja historike që arritën popujt e Indokinës, veçanërisht populli vietnamez mbi imperialistët amerikanë dhe mbi shërbëtorët e tyre çifligaro-borgjezë

vendas, i tregoi gjithë botës se imperializmi, qoftë ky edhe superfuqi, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me gjithë potencialin e tij të madh ekonomik e ushtarak, me gjithë mjetet moderne të luftës që disponon e që përdor për të shtypur lëvizjet çlirimtare, nuk është në gjendje t'i nënshtrojë popujt e vendet, të mëdhenj ose të vegjël, kur këta janë të vendosur të bëjnë çdo sakrificë e të luftojnë me vetëmohim e deri në fund për lirinë e pavarësinë e tyre.

Luftëra të armatosura çlirimtare janë zhvilluar dhe vazhdojnë akoma të zhvillohen në mjaft vende të tjera të Azisë, si në Birmani, Malajzi, Filipine, Indonezi e gjetkë. Këto luftëra do të kishin korrur me siguri suksese e fitore më të mëdha, po të mos qenë penguar nga ndërhyrja dhe qëndrimet antimarksiste e shoviniste të udhëheqjes kineze, ndërhyrje e qëndrime që kanë sjellë përçarje e çoroditje në forcat revolucionare dhe në partitë komuniste, udhëheqëse të këtyre forcave. Nga njëra anë, udhëheqësit kinezë shpallnin përkrahjen e luftërave çlirimtare në këto vende, nga ana tjetër, përkrahnin regjimet reaksionare, prisnin e përcillnin me një mijë nderime e lavdërime krerët e këtyre regjimeve. Gjithnjë ata kanë ndjekur strategjinë e taktikën e nënshtimit të lëvizjeve çlirimtare në vendet aziatike ndaj politikës së tyre pragmatiste dhe ndaj interesave të tyre hegjemonistë. Gjithnjë kanë bërë presion mbi forcat revolucionare dhe mbi udhëheqjen e këtyre forcave për t'u imponuar atyre këtë politikë. Ata, në të vërtetë, s'i ka preokupuar çështja e çlirimit të popujve dhe e revolucionit në vendet e Azisë, por çështja e realizimit të synimeve të tyre shoviniste. Ata

s'i kanë ndihmuar këta popuj, veç i kanë penguar.

Çështja e revolucionit dhe e luftës çlirimtare në Azi, asnjëherë s'ka qenë shtruar për zgjidhje me kaq forcë e në mënyrë kaq imperative, si tani, asnjëherë s'ka qenë më e koklavitur dhe më e vështirë për t'u zgjidhur.

Kjo koklavitje dhe këto vështirësi kanë rrjedhur kryesisht nga synimet dhe veprimtaria e imperialistëve amerikanë, si dhe nga synimet dhe veprimtaria anti-marksiste, antipopullore, hegjemoniste dhe ekspansioniste e revizionistëve dhe e socialimperialistëve sovjetikë e kinezë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës synojnë dhe përpiqen me të gjitha mënyrat e forcat që të ruajnë e të forcojnë pozitat e tyre strategjike, ekonomike e ushtarake në Azi, pasi i vlerësojnë këto pozita si jetësore për interesat e tyre imperialistë.

Bashkimi Sovjetik synon e përpiqet edhe ky me të gjitha mënyrat e forcat të zgjerojë pozitat që tashmë ka zënë në Azi.

Kina, nga ana e saj, ka shfaqur hapur pretendimin për t'u bërë sunduesja e vendeve aziatike, duke lidhur aleancë për këtë qëllim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sidomos me Japoninë, dhe duke iu kundërvënë drejtpërdrejt Bashkimit Sovjetik.

Synim për sundim në Azi ka edhe Japonia, synim ky i vjetër i imperializmit japonez.

Prandaj Bashkimi Sovjetik ia ka aq shumë frikën aleancës kino-japoneze dhe e lufton atë me aq shumë forcë. Por edhe imperializmi amerikan nuk dëshiron që kjo aleancë të trashet e të kalojë caqet që mund të



prekin interesat e tij, megjithëse ai e inkurajoi dhe i dha «viston» nënshkrimin të Traktatit ndërmjet Kinës e Japonisë duke gjykuar nga këndi që ky traktat mund t'i vërë fre ekspansionit sovjetik në dëm të sundimit amerikan.

India, që është një vend i madh, ka gjithashtu ambicie të kthehet në një fuqi të madhe me bomba atomike e me peshë në Azi, të luajë një rol të veçantë, sidomos me pozitën strategjike që zë në kryqëzimin e interesave ekspansionistë të të dy superfuqive imperialiste, amerikane dhe sovjetike, në Oqeanin Indian, në Gjirin Persik e në kufijtë e saj veriorë e lindorë.

Nuk ka hequr dorë nga synimi për sundim në vendet aziatike as imperializmi anglez. Të tilla synime kanë edhe disa shtete të tjera kapitalisto-imperialiste.

Për këtë arsye Azia është bërë sot njëra nga zonat e rivaliteteve më të ashpra ndër imperialiste, rrjedhimisht atje janë krijuar plot vatra të rrezikshme për konflagracione botërore, harxhet e të cilave do t'i paguajnë popujt.

Që të shuajnë revolucionet dhe luftën çlirimtare në vendet e Azisë dhe t'u çelin rrugën planeve të tyre hegjemoniste dhe ekspansioniste, revizionistët sovjetikë e kinezë, në konkurrencë të ethshme me njëri-tjetrin, kanë bërë e po bëjnë një punë shumë të ndyrë përçarëse e shkatërrimtare në gjirin e partive komuniste dhe të forcave revolucionare e lirishtetëse të këtyre vendeve. Kjo punë ka qenë një nga shkaqet kryesore të katastrofës që pësoi Partia Komuniste e Indonezisë, të përçarjes dhe të shpartallimit të Partisë Komuniste të Indisë etj. Ata predikojnë aleancën dhe

unitetin e proletariatit e të masave të gjera popullore me borgjezinë reaksionare vendase, duke u përpjekur secili, për llogari të vet, të fitojë miqësinë me këtë borgjezi sunduese.

Ndërhyrja e socialimperialistëve sovjetikë e kinezë në vendet e ndryshme të Azisë nga pozitrat dhe pikësynimet e tyre hegjemoniste e ekspansioniste ka vënë përpara rreziqeve të mëdha lëvizjet çlirimtare të këtyre popujve, ka vënë në rrezik të drejtpërdrejtë edhe fitoret e luftës çlirimtare në Vietnam, në Kamboxhia e në Laos.

Forcave revolucionare e liridashëse të vendeve aziatike, të udhëhequra nga partitë komuniste, marksiste-leniniste, u duhet të përballojnë e të shkatërrojnë si rrezikun që u vjen nga reaksioni vendas, që armatoset nga padronët imperialistë, ashtu edhe rreziqet që u vijnë nga veprimtaria përçarëse e minuese, dhe nga planet hegjemoniste e ekspansioniste të revizionistëve sovjetikë e kinezë. Atyre u duhet të çlirohen edhe nga një varg idesh e konceptesh të vjetra reaksionare, fetare, mistike, budiste, brahmaniste etj., që frenojnë lëvizjen. Atyre u duhet, gjithashtu, të mos lejojnë të rrënjosen ide e koncepte «të reja» reaksionare, siç janë idetë revizioniste hrushoviane, maoiste e teori të tjera po aq reaksionare, që i çoroditin masat, i gënjejnë, i zhveshin nga fryma luftarake klasore, i futin në rrugë të shtrembra e pa krye.

Lufta çlirimtare që kanë përpara popujt e Azisë, vërtet është e vështirë, vërtet ka shumë pengesa, por s'ka e s'do të ketë kurrë luftë çlirimtare e revolucion të lehtë, pa vështirësi e pa pengesa të mëdha që du-

hen kapërcyer, pa gjak e pa sakrifica të shumta për të arritur fitoren finale.

Vendet e Amerikës Latine në përgjithësi kanë një zhvillim kapitalist më të lartë se vendet e Afrikës dhe të Azisë. Por shkalla e varësisë nga kapitali i huaj i vendeve latino-amerikane nuk është më e ulët nga ajo e shumicës dërrmuese të vendeve afrikane dhe aziatike.

Pjesa më e madhe e vendeve në Amerikën Latine, ndryshe nga vendet afrikane dhe aziatike, janë shpallur shtete më vete shumë më herët, që në gjysmën e parë të shekullit të 19-të, si rezultat i luftërave çlirimtare të popujve të atij kontinenti kundër kolonizatorëve spanjollë e portugezë. Këto vende do të kishin ecur shumë më përpara po qe se nuk do të kishin rënë, fill pas zhdukjes së zgjedhës koloniale spanjolle e portugeze, nën një zgjedhë tjetër, gjysmëkoloniale të kapitalit të huaj, anglez, francez, gjerman, amerikan etj. Deri në fillim të këtij shekulli gjendjen në kontinent e zotëronin kolonialistët anglezë. Ata grabitnin që andej sasi kolosale lëndësh të para, ndërtonin porte, hekurudha, centrale elektrike në shërbim ekskluziv të shoqërive të tyre koncesionare dhe tregtonin aty mallra industriale të prodhuara në Britani.

Kjo gjendje ndryshoi, por jo në dobi të popujve latino-amerikanë, me depërtimin në Amerikën Latine të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në stadin e zhvillimit imperialist të tyre. Imperializmi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përdori parullën «Amerika për amerikanët», që ishte mishëruar në doktrinën

«Monro», për të vendosur sundimin e pandarë në gjithë hemisferën perëndimore. Depërtimi ekonomik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë hemisferë u bë si me anën e forcës ushtarake e të shantazhit politik, ashtu edhe të diplomacisë së dollarit, me anë të kërbaçit e të kulaçit. Kështu më 1930 investimet e kapitaleve amerikane dhe angleze në Amerikën Latine u barazuan, kurse pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bënë zotërit e vërtetë të ekonomisë në këtë pjesë të rruzullit tokësor. Monopolet e mëdha të tyre shtinë në dorë degët kyç të ekonomisë në Amerikën Latine. Vendet e saj u futën në perandorinë «e padukshme» të imperializmit amerikan, i cili filloi të bënte ligjin kudo në këto vende, të vendoste e të zhvendoste kryetarët e shteteve dhe qeveritë, t'u diktonte atyre politikën e vet ekonomike e ushtarake, të brendshme e të jashtme.

Nga shfrytëzimi i burimeve të pasura natyrore dhe i punës, i djersës e i gjakut të popujve latino-amerikanë shoqëritë monopoliste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nxirrnin fitime përralore: nga një dollar që investonin në vendet e ndryshme të kontinentit merrnin katër-pesë dollarë fitime. Kjo gjendje vazhdon edhe në ditët e sotme.

Megjithëse investimet e kapitaleve të shteteve imperialiste në Amerikën Latine çuan në ngritjen e njëfarë industrie moderne, veçanërisht të industrisë nxjerrëse, gjithashtu të industrisë së lehtë e ushqimore, këto investime e kanë frenuar së tepërmi zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendeve të saj. Monopolet e huaja dhe politika neokolonialiste e shteteve imperia-

liste i dhanë zhvillimit ekonomik të këtyre vendeve një formë të shëmtuar, të njëanshme, një karakter monokulture, i kthyen ato në furnizuese të thjeshta e të specializuara lëndësh të para: Venezuela për naftën, Bolivia për kallajin, Kili për bakrin, Brazili e Kolumbia për kafënë, Kuba, Haiti e Dominika për sheqerin, Uruguai dhe Argjentina për produkte blegtorale, Ekuadori për banane e kështu me radhë.

Karakter i njëanshëm e bënte ekonominë e këtyre vendeve krejt të paqëndrueshme, krejt të pazonjën për një zhvillim të shpejtë e të përgjithshëm të saj, e varte atë plotësisht nga koniunkturat dhe lëkundjet e çmimeve në tregun botëror kapitalist. Çdo rënie prodhimi e çdo shfaqje krize ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e tjera kapitaliste do të pasqyrohej medoemos negativisht, bile në një shkallë më të madhe edhe në ekonominë e vendeve të Amerikës Latine.

Mbas Luftës së Dytë Botërore metropolet imperialiste filluan të bëjnë investime të mëdha të drejtpërdrejta në degë të ndryshme të industrisë, në miniera, në bujqësi, të blejnë ndërmarrje nacionale etj. Ato sunduan sektorë të tërë të prodhimit dhe e thelluan në maksimum grabitjen e vendeve të Amerikës Latine. Në të njëjtën kohë nxitën dhënien e borxheve dhe të financimit me përqindje të larta interesi, duke i lidhur akoma më shumë këto vende me sundimin e huaj dhe në radhë të parë me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vetëm Brazili u ka borxh bankave të huaja gati 40 miliardë dollarë dhe Meksika gati 30 miliardë.

Zhvillimi kapitalist në Amerikën Latine ka ngelur përgjithësisht prapa, edhe për shkak se atje ka akoma mjaft mbeturina të latifondeve, që nuk janë zhveshur krejt nga karakteri i tyre feudal, prandaj disa ndër vendet latino-amerikane kanë një prapambetje shumë të theksuar, si ato të Azisë e të Afrikës. Në varësi nga politika ekonomike dhe nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë imperialiste, në vendet e Amerikës Latine është krijuar një oligarki, një borgjezi e madhe monopoliste mjaft e fuqishme, e cila së bashku me pronarët e mëdhenj të tokave ka në dorë pushtetin dhe, gjithnjë me përkrahjen e imperializmit amerikan dhe së bashku me të, shtyp e shfrytëzon pa mëshirë klasën punëtore, fshatarësinë dhe shtresat e tjera të punonjësve, që bëjnë një jetesë të mjeruar.

Ky zhvillim ka krijuar edhe një proletariat mjaft të madh industrial, i cili, së bashku me proletariatin bujqësor dhe me punëtorët e ndërtimit e të shërbimeve, zë afër gjysmën e popullsisë, ndryshe nga Afrika dhe Azia ku, në pjesën më të madhe të vendeve, klasa punëtore është shumë e vogël.

Veç kësaj, në Amerikën Latine fshatarësia dhe klasa punëtore, e dalë nga radhët e saj, kanë tradita luftarake revolucionare të pasura, të fituara në luftërat e pareshtura për liri, për tokë, për punë e për bukë, tradita që janë zhvilluar më tej në betejat kundër oligarkisë vendase dhe kundër monopoleve të huaja, kundër imperializmit amerikan. Popujt e Amerikës Latine radhiten ndër popujt që janë përleshur e gjakosur më shumë me shtypësit e me shfrytëzuesit e brendshëm e të jashtëm. Fitoret e tyre në këto përleshje

s'kanë qenë të pakta e të vogla, por fitore të plota të lirive demokratike, të zhdukjes së shfrytëzimit, të sigurimit të pavarësisë e të sovranitetit kombëtar s'ka pasur ende në asnjë vend. Popujt latino-amerikanë ushqyen shumë shpresa, patën shumë iluzione për fitoren e popullit kuban, e cila u bë një frymëzim dhe inkurajim në luftën për të hequr qafe zgjedhën e sunduesve vendas kapitalistë e çifligarë dhe të imperialistëve amerikanë. Mirëpo këto shpresa dhe ky frymëzim u venitën shpejt, kur panë se Kuba kastriste s'u zhvillua në rrugën e socializmit, por të kapitalizmit të tipit revizionist, aq më tepër kur ajo u bë vasale dhe mercenare e socialimperializmit sovjetik.

Si në të gjitha kontinentet edhe në Amerikën Latine, situatat sot janë të ndërlikuara.

Në shumicën e vendeve këto situata janë revolucionare dhe shtrojnë në rendin e ditës revolucionet për përmbysjen e rendit borgjezo-çifligar dhe për likuidimin e varësisë imperialiste. Natyrisht, këto revolucione nuk mund të kenë gjithkund të njëjtin karakter, të njëjtin proces e të njëjtën zgjidhje, për arsyet që dihen, të kushteve e të problemeve të veçanta që ka çdo vend ose grup vendesh, të shkallëve të ndryshme të zhvillimit ekonomik-shoqëror, të varësisë nga imperializmi e socialimperializmi, të regjimeve borgjeze më pak ose më shumë të moderuara, më pak ose më shumë fashiste etj. Veç një gjë duket e domosdoshme, ndërthurja, më tepër se në shumë vende të Afrikës e të Azisë, e detyrave antiimperialiste, demokratike e socialiste të revolucionit.

Në Amerikën Latine ka shumë avantazhe edhe për

përgatitjen e faktorit subjektiv të revolucionit, për shkak të një ndërgjegjeje mjaft të lartë e të gatishmërisë së masave të gjera popullore për luftë kundër shtypjes e shfrytëzimit të brendshëm e të huaj, për liri, demokraci e socializëm. Mirëpo përgatitjen e plotë të këtij e pengojnë, e ngatërrojnë dhe e luftojnë me të gjitha forcat jo vetëm imperialistët, sidomos ata amerikanë me reaksionin e brendshëm, por edhe revizionistët vendas me shërbëtorët e tjerë oportunistë të kapitalizmit, po ashtu edhe revizionistët sovjetikë e kinezë.

Imperializmi amerikan, duke ndjekur gjithnjë politikën për ta pasur Amerikën Latine çiflig të tij, nga i cili nxjerr superfitime kolosale, manovron me të gjitha mjetet, ushtarake, diversioniste, demagogjike, mashtruese për të mos lejuar asnjë imperializëm tjetër të predominojë, për të siguruar që në asnjë vend të mos shpërthejë e të mos fitojë revolucionin. Ai do që të ruhen kështu si varësia e plotë e vendeve latino-amerikane nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ashtu edhe rendi borgjezo-çifligar në këto vende.

Një armë e rëndësishme në duart e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për këtë qëllim është e ashtuquajtura Organizata e Shteteve Amerikane, që komandohet nga presidenti, nga Pentagoni dhe nga Departamenti i Shtetit Amerikan. Statuti i kësaj organizate u jep atyre të drejtë të ndërhyjnë me çdo mënyrë e mjet edhe ushtarakisht për të ruajtur statukuonë, si të brendshme, ashtu edhe të jashtme, të vendeve të Amerikës Latine.

Ndërkaq, monopolet e mëdha amerikane e kanë përsosur mënyrën e shfrytëzimit në këto vende, duke



organizuar shoqëritë monopoliste shumëkombëshe, të cilat i kanë qendrën dhe fijet e komandimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe duke përdorur në përmasa të larta kapitalizmin shtetëror, me anën e të cilit sigurojnë edhe komandimin e qeverive e të aparatit shtetëror vendas në përgjithësi.

Por këto dhe shumë mjete të tjera që përdorin Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk i zgjidhin dot problemet e krizës së rëndë ekonomike e politike që ka përfshirë edhe vendet e Amerikës Latine.

Në një kohë kur kapitalistët dhe çifligarët vendas nuk rrojnë dot pa varësinë dhe pa mbështetjen e imperializmit amerikan, ideja e revolucionit, si mjet i vetëm i domosdoshëm për të siguruar çlirimin kombëtar e shoqëror, po hyn gjithnjë më thellë dhe më gjerë në ndërgjegjen e proletariatit, të fshatarësisë punonjëse, të inteligjencias përparimtare, të masave të rinisë të këtyre vendeve.

Për të mënjeluar revolucionet, imperialistët amerikanë me kapitalistët vendas përdorin dy rrugë kryesore. Njëra është rruga e vendosjes së regjimeve ushtarako-fashiste me anë të një «pronunsiamento militar» (puç ushtarak), kur e shohin se rrezikohen në mënyrë më iminente pozitat e tyre. Kështu bënë në Brazil, në Kili, në Uruguai, në Bolivi e gjetkë. Rruga tjetër është organizimi i regjimeve demokratiko-borgjeze, me kufizime të theksuara dhe me mungesa të mëdha të lirive themelore, si në Venezuelë, Meksikë, ose siç po bëjnë tani në Brazil, duke u përpjekur në këtë mënyrë të zbutin tensionet revolucionare dhe të japin përshtypjen se gjoja borgjezia e këtyre vendeve, dhe në masë më

të madhe administrata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe presidenti i tyre, tregojnë kujdes për «të drejtat e njeriut».

Mirëpo të tilla mjete e manovra nuk i zgjidhin dot problemet e krizës, s'i mënjanojnë dot situatat revolucionare, s'e fshijnë dot nga rendi i ditës revolucionin.

Proletariati me të gjitha forcat revolucionare në vendet latino-amerikane ndodhen përpara detyrash shumë të rëndësishme revolucionare. Për të zgjidhur të tilla detyra, të kryejnë revolucionin, të fitojnë pavarësinë e plotë kombëtare, të vendosin liritë demokratike e socializmin, atyre u duhet të luftojnë në shumë drejtime, kundër oligarkisë borgjeze e latifondiste vendase, kundër imperializmit amerikan, gjithashtu edhe kundër shërbëtorëve të ndryshëm të kapitalit, të imperializmit e të socialimperializmit, siç janë revizionistët prosovjetikë e kastristë, revizionistët prokinezë, trockistë e të tjerë. Atyre u del e nevojshme jo vetëm të përballojnë veprimtarinë diversioniste e përçarëse të oportunistëve e të revizionistëve të ngjyrave të ndryshme, por edhe të çlirohen nga ndikimet mikroborgjeze, siç janë disa koncepte e praktika puçiste, fokiste, aventuriste, që janë bërë si njëfarë tradite, por që s'kanë asgjë të përbashkët me revolucionin e vërtetë, përkundrazi, e dëmtojnë shumë atë. Veçse kjo çështje kërkon një trajtim të kujdesshëm.

Për sa i përket traditës luftarake të popujve të Amerikës Latine, në të mbisundon ana pozitive, revolucionare, e cila përbën një faktor shumë të rëndësishëm e që ka nevojë të përdoret sa më mirë e më gjerë në përgatitjen dhe në zhvillimin e revolucionit, duke i

dhënë traditës një përmbajtje të re, të zhveshur nga elementët negativë pistolerostë e fokistë.

Për të kryer të tilla detyra të mëdha, rol vendimtar do të luajnë partitë marksiste-leniniste të klasës punëtore. Tashmë të tilla parti jo vetëm janë krijuar gati në çdo vend të Amerikës Latine, por shumica e tyre kanë bërë edhe hapa të rëndësishëm përpara në punën për përgatitjen e proletariatit e të masave popullore për revolucion. Në luftë të papajtueshme me revizionistët dhe oportunistët e tjerë, me të gjithë shërbëtorët e borgjezisë e të imperializmit, me pikëpamjet e praktikat kastriste, hrushoviane, trockiste, tribotiste etj., ato kanë përpunuar një vijë politike të drejtë dhe kanë grumbulluar një eksperiencë mjaft të madhe të luftës për ta vënë në jetë këtë vijë, duke u bërë bartëse e gjithë traditës revolucionare të mëparshme, për ta përdorur e për ta zhvilluar atë më tej në dobi të lëvizjes punëtore e çlirimtare, të përgatitjes dhe të ngritjes së masave në revolucion.

Situatat e sotme revolucionare shtrojnë përpara këtyre partive domosdoshmërinë për të mbajtur lidhje sa më të ngushta dhe për t'u këshilluar sa më shpesh midis tyre, që të kenë mundësi të përfitojnë sa më shumë nga përvoja e njëra-tjetrës dhe të bashkërendojnë qëndrimet e veprimet e tyre për çështjet e përbashkëta të luftës kundër borgjezisë reaksionare dhe imperializmit, kundër revizionizmit modern sovjetik, kinez etj., për të gjitha problemet e revolucionit.

Tani që popujt janë zgjuar dhe nuk pranojnë të jetojnë më nën zgjedhën imperialiste e koloniale, që kërkojnë liri, pavarësi, zhvillim e përparim, që ziejnë

nga zemërimi kundër shtypësve të huaj e të brendshëm, tani që Afrika, Amerika Latine, Azia janë kthyer në një kazan që zien, kolonizatorët, të vjetër e të rinj, e kanë vështirë, në mos të pamundur, të sundojnë e të shfrytëzojnë popujt e këtyre vendeve me metodat e format e mëparshme. Ata s'mund të bëjnë dot pa grabitur e pa shfrytëzuar pasuritë, djersën dhe gjakun e këtyre popujve.

Prandaj bëhen gjithë ato përpjekje për të gjetur metoda e forma të reja mashtrimi, grabitjeje e shfrytëzimi, për të shpërndarë lëmosha, të cilat prapë nuk shkojnë në dobi të masave, por të klasave sunduese borgjezo-çifligare.

Ndërkaq, çështja është komplikuar edhe më shumë, sepse në ish-kolonitë e gjysmëkolonitë prej kohësh ka filluar të depërtojë e të futet gjithnjë e më thellë socialimperializmi sovjetik, sepse ka filluar përpjekjet në mënyrë të etshme për të hyrë aty edhe Kina socialimperialiste.

Bashkimi Sovjetik revizionist e bën ndërhyrjen ekspansioniste nën maskën e politikës gjoja leniniste të ndihmës për luftën çlirimtare të popujve, duke e hequr veten gjoja si aleat të natyrshëm të këtyre vendeve e popujve. Revizionistët sovjetikë, si mjet për të depërtuar në Afrikë e gjetkë, përdorin dhe përhapin parulla me ngjyrë socialiste, për t'i mashtruar popujt që aspirojnë të çlirohen, të zhdukin shtypjen e shfrytëzimin dhe që e dinë se rruga e vetme e çlirimit të plotë kombëtar e shoqëror është socializmi.

Në ndërhyrjen e vet Bashkimi Sovjetik tërheq edhe aleatët ose, më mirë, satelitët e tij. Këtë po e sho-

him konkretisht në Afrikë, ku socialimperialistët sovjetikë dhe mercenarët e tyre kubanë ndërhyjnë me pretekstin se ndihmojnë revolucionin. Kjo është një gënjeshtër. Ndërhyrja e tyre s'është gjë tjetër veçse veprim kolonialist, që ka qëllim pushtimin e tregjeve dhe nënshtrimin e popujve.

E tillë është ndërhyrja e Bashkimit Sovjetik dhe e mercenarëve kubanë në Angolë. Ata s'kanë pasur dhe s'kanë aspak qëllim të ndihmojnë revolucionin anglez, por për të ngulur thonjtë e tyre në këtë vend afrikan, që kishte fituar njëfarë pavarësie pas shporrjes së kolonizatorëve portugezë. Mercenarët kubanë janë ushtria koloniale e dërguar nga Bashkimi Sovjetik për të zënë tregje dhe pozita strategjike në vendet e Afrikës së Zezë, për të kaluar nga Angola në shtete të tjera, që edhe socialimperialistët sovjetikë të mund të krijojnë një perandori koloniale moderne.

Bashkimi Sovjetik dhe mercenari i tij, Kuba, nën maskën e ndihmës për çlirimin e popujve, ndërhyjnë në vendet e tjera me ushtri të pajisura me topa e mitraloza, gjoja për të ndërtuar socializmin që nuk ekziston as në vetë Bashkimin Sovjetik e as në Kubë. Këto dy shtete borgjezo-revizioniste u futën në Angola për të ndihmuar një klikë kapitaliste të merrte fuqinë, në kundërshtim me synimet e popullit anglez, që luftoi për të fituar lirinë nga kolonizatorët portugezë. Agostino Netoja bën lojën e sovjetikëve. Duke qenë në luftë kundër fraksionit tjetër, për të marrë vetë fuqinë, ai thirri sovjetikët në ndihmë. Përpjekjet e dy klaneve angleze në luftë me njëri-tjetrin nuk kishin aspak karakter revolucionar popullor. Ndeshja midis tyre ishte

një luftë klikash për pushtet. Secila prej tyre mbështetej nga shtete imperialiste të ndryshme. Në këtë ndeshje fitoi Agostino Netoja, ndërsa në Angola jo vetëm nuk fitoi socializmi, por, pas ndërhyrjes nga jashtë, atje u vendos neokolonializmi sovjetik.

Edhe Kina socialimperialiste po bën përpjekje të mëdha për t'u futur në vendet ish-koloniale e gjysmë-koloniale.

Një shembull se si ndërhyjnë Kina është Zairja, ku sundon klika më gjakatare dhe më pasanike e kontinentit afrikan, me Mobutun në krye. Në luftimet e fundit, që u zhvilluan në Zaire, Mobutus, vrasësit të Patris Lumumbës, i erdhën përnjëherë në ndihmë marokenët e mbretërisë sherifiane të Marokut, i erdhi në ndihmë edhe aviacioni francez, i erdhi gjithashtu në ndihmë edhe Kina. Është e kuptueshme ndihma e dhënë nga francezët, pse me ndërhyrjen e tyre ata mbrojnë në Katanga koncesionet dhe koncernet e tyre, mbrojnë njëkohësisht njerëzit e tyre, Mobutun dhe klikën e tij. Po revizionistët kinezë çfarë duan në Katanga? Kë ndihmojnë ata atje? Mos ndihmojnë vallë popullin e Zairesë që shtypet nga Mobutu, nga klika e tij dhe nga koncesionarët francezë, belgë, amerikanë e të tjerë? A nuk ndihmojnë edhe këta klikën gjakatare të Mobutus? Fakt është se udhëheqja revizioniste kineze jo tërthorazi, por fare hapur, e ndihmon këtë klikë. Për ta bërë më konkrete e më demonstrative këtë ndihmë, ajo dërgoi atje ministrin e Punëve të Jashtme, Huan Huanë, dërgoi ekspertë ushtarakë, ndihma ushtarake dhe ekonomike. Ajo veproi kështu në mënyrë antimarksiste, antirevolucionare. Ndërhyrja e saj ka të njëjtat tipare

si ato të mbretit Hasan të Marokut dhe ato të Francës.

Jo vetëm në këtë çështje, por socialimperialistët kinezë po përzihen edhe në çështje të tjera të popujve e të vendeve të Afrikës e të kontinenteve të tjera, sidomos në ato vende ku përpiqen të depërtojnë me çdo mënyrë për të krijuar baza ekonomike, politike dhe strategjike.

As Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk dalin ta ndihmojnë kaq haptazi Pinoçetin, xhelatin fashist të Kilit, ashtu siç po e ndihmon Kina. Bile amerikanët nuk ndihmojnë në këtë mënyrë as sundimtarët reaksionarë të vendeve të tjera, ku interesat e tyre janë të mëdhenj. Kjo nuk do të thotë se imperialistët amerikanë po i hedhin poshtë interesat e tyre. Ata i mbrojnë, dhe bile i mbrojnë fort këta interesa, por në forma të stërholluara.

Me qëndrimin që mban Kina, e ashtuquajtur socialiste, ecën kundër interesave dhe aspiratave të popujve, të komunistëve, të elementëve revolucionarë, kundër aspiratave të të gjithë njerëzve përparimtarë të Amerikës Latine.

Kina merr në mbrojtje diktatorët e ndryshëm që sundojnë mbi popujt dhe që me terror e me çdo mjet shtypin përpjekjet e revolucionarëve, të proletariatit dhe të partive marksiste-leniniste, të cilët luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror. Me të tilla qëndrime ajo ka hyrë në rrugën e kundërrevolucionit. Nën maskën e marksizëm-leninizmit përpiqet të tregojë se eksporton në vende të ndryshme gjoja idenë e revolucionit, por në fakt Kina po eksporton idenë e kundërrevolucionit.

Me këtë ajo ndihmon imperializmin amerikan dhe klikat fashiste në fuqi.

Fuqitë imperialiste ose socialimperialiste përpiqen njëlloj të mos i lejojnë popujt afrikanë, aziatikë, latino-amerikanë të zhvillojnë luftën e tyre revolucionare, etapë pas etape, kundër shtypjes, kundër shfrytëzimit të egër të udhëheqjeve të tyre dhe të imperialistëve që sundojnë në akord me ta dhe u pinë gjakun.

Detyra e njerëzve revolucionarë, përparimtarë, patriotë në vendet me zhvillim të ulët ekonomiko-shoqëror dhe të varura prej fuqive imperialiste e socialimperialiste është t'i bëjnë të ndërgjegjshëm popujt për këtë shtypje e shfrytëzim, t'i edukojnë, t'i mobilizojnë, t'i organizojnë, t'i hedhin në luftë çlirimtare, duke mbajtur parasysh kurdoherë se revolucionin e bëjnë masat e gjera, popujt. Për këtë është e nevojshme të analizohen mirë gjendja e brendshme dhe e jashtme e çdo vendi, zhvillimi ekonomiko-shoqëror, raporti i forcave klasore, antagonizmat midis klasave si edhe antagonizmat midis popullit dhe klikave reaksionare në fuqi, po ashtu midis popullit dhe shteteve imperialiste. Mbi këtë bazë mund të nxirren konkluzione të drejta për hapin që duhet të hedhin dhe taktikat që duhet të përdorin. Nga forcat revolucionare kërkohet punë e dendur, vendosmëri e zgjuarsis, kërkohet para së gjithash të kuptohet mirë se lufta çlirimtare në vendet e tyre mund të arrijë fitoren e vërtetë vetëm duke e lidhur këtë luftë me kauzën e proletariatit, me kauzën e socializmit.

Prandaj proletariatit të secilit vend i duhet të krijojë partinë e vet revolucionare, e cila të jetë e aftë



të zbatojë me besnikëri mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, në lidhje të ngushtë me kushtet e secilit vend, me gjendjen e çdo populli të veçantë. Këto parti është e domosdoshme të njohin mirë mentalitetin e masave, zhvillimin ekonomik, politik, ideologjik e kulturor të secilit vend dhe jo të veprojnë në mënyrë fantaziste e aventuriste, në mënyrë blankiste, por të luftojnë me këmbëngulje për të grumbulluar rreth vetes aleatët e proletariatit, masat e gjera të popullit.

Revolucionarët dhe masat e popullit kanë nevojë të përgatiten me këmbëngulje, të mbajnë parasysh veprimet e borgjezisë reaksionare e të latifondistëve të mëdhenj që sundojnë, të shtypësve të huaj, si edhe intrigat e neokolonialistëve. Këta janë faktorë të rëndësishëm që duhet të përballohen nga ana e elementëve revolucionarë dhe e popujve me pjekuri, me një organizim të shëndoshë dhe me taktika revolucionare.

Natyrisht, jo vetëm nuk përjashtohet, por është edhe e domosdoshme që në mes forcave dhe elementëve revolucionarë të vendeve të ndryshme të vendosen lidhje bashkëpunimi, koordinimi dhe shkëmbimi eksperience. Kjo lehtësohet për arsye të shumë kushteve të njëjta, siç janë shtypja e shfrytëzimi neokolonial dhe i borgjezisë reaksionare, kultura e përbashkët, si dhe qëllimi i përbashkët i çlirimit nga kjo shtypje e shfrytëzim. Kushtet dhe interesat e përbashkët i shtyjnë elementët revolucionarë e përparimtarë të të gjitha këtyre vendeve të zhvillojnë konsultime, të bashkëpunojnë e të koordinojnë veprimet e tyre, të cilat u kundërvihen veprimeve të armiqve që i shtypin.

Duke e parë gjendjen e popujve që ndodhen nën sundimin neokolonialist nga pozita marksiste-leniniste, për të gjithë revolucionarët e vërtetë shtrohet detyra që të mbështetet e të përkrahet pa rezerva lufta revolucionare e çlirimtare e këtyre popujve, që ajo të ecë vazhdimisht përpara, që revolucioni të shkojë kurdoherë në ngjitje, deri në fitoren e tij të plotë.

### **Revolucionarët e vërtetë u bëjnë thirrje proletarëve e popujve të ngrihen për botën e re, për botën socialiste**

Kriza e përgjithshme e kapitalizmit, siç shpjeguar më sipër, po shkon gjithnjë duke u thelluar. Kjo bën që proletariati, klasat dhe popujt e shtypur të mos e durojnë dot shfrytëzimin, të kërkojnë ndryshimin e jetës së tyre, përmbyshjen e rendit borgjez, zhdukjen e neokolonializmit, të imperializmit. Por këto dëshira mund të realizohen vetëm me anë të revolucionit. Asnjë fitore nuk mund të arrihet pa u ndeshur dhe pa u goditur me armiqtë e klasës, të brendshëm e të jashtëm.

Proletariatit, masat punonjëse, popujt i bëjnë të ndërgjegjshëm dhe i përgatitin politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht për këto ndeshje partitë e vërteta marksiste-leniniste të klasës punëtore si udhëheqëse të revolucionit.

Partitë marksiste-leniniste, gjithë revolucionarët, sado të paktë qofshin në numër, futen në popull, organizojnë sistematikisht, me kujdes dhe me durim të madh masat, i bindin ato për forcën e tyre të madhe,

se janë në gjendje ta rrëzojnë kapitalin, ta marrin vetë fuqinë në dorë dhe ta përdorin atë në interes të proletariatit dhe të popullit. Të tilla parti nuk mendojnë se, meqë janë të vogla, nuk mund t'i bëjnë dot ballë koalicionit të partive të borgjezisë dhe opinionit të formuar prej tyre. Detyra e revolucionarëve është të vërtetojnë përpara masave të gjera të popullit se ky opinion, i krijuar nga borgjezia, është i gabuar, se ai duhet rrëzuar dhe duhet formuar opinionin e vërtetë revolucionar, i cili përfaqëson një forcë të madhe transformuese.

Që ta kryejnë me sukses misionin e tyre, partitë marksiste-leniniste, para së gjithash, llogaritin të kenë një strategji e një taktikë revolucionare, një vijë të drejtë politike që t'u përgjigjet interesave dhe aspiratave të masave të gjera popullore, zgjidhjes revolucionare të problemeve e të detyrave që shtron përpara lufta për shkatërrimin e rendit borgjez dhe të sundimit të huaj imperialist.

Marksizëm-leninizmi është e vetmja shkencë që i jep mundësi partisë revolucionare të klasës punëtore të përpunojë një vijë politike të drejtë, të përcaktojë qartë qëllimin dhe detyrat strategjike, të zbatojë taktikë dhe metoda revolucionare për realizimin e tyre.

E ndriçuar nga marksizëm-leninizmi dhe në përshtatje me kushtet konkrete ekonomiko-shoqërore e politike të vendit, si dhe me rrethanat ndërkombëtare partia marksiste-leniniste di të orientohet dhe të qëndrojë në krye të masave në çdo kohë e në çdo etapë të revolucionit, qoftë ai demokratik, nacionalçlirimtar ose

socialist. Një strategji revolucionare dhe një vijë e drejtë politike, e bazuar në marksizëm-leninizmin, në praktikën revolucionare të proletariatit botëror dhe të luftërave klasore të vendit të vet, bëjnë të mundur që të përcaktohet qartë qëllimi strategjik në etapën e dhënë, të përcaktohen cilët janë armiqtë kryesorë të brendshëm e të jashtëm, kundër të cilëve duhet të jepet goditja kryesore, cilët janë aleatët e brendshëm e të jashtëm të proletariatit etj.

Partitë marksiste-leniniste kanë si pikësynim përmbysjen e rendit kapitalist dhe fitoren e socializmit, ndërsa kur përpara revolucionit në vendin e tyre qëndrojnë detyra të karakterit demokratik e antiimperialist ato synojnë zhvillimin e tij të pandërprerë, rritjen e tij në revolucion socialist, kalimin sa më parë në zgjidhjen e detyrave socialiste.

Si qëllimi strategjik i partive marksiste-leniniste, ashtu edhe rrugët për arritjen e tij, ndryshojnë krejtësisht nga ato të partive false komuniste e punëtore. Të parat s'mund ta kuptojnë arritjen e këtij qëllimi veçse duke përmbysur marrëdhëniet kapitaliste në prodhim dhe duke shkatërruar nga themelet aparatin e vjetër shtetëror, gjithë superstrukturën borgjeze. Ato u përmbahen mësimëve të Leninit, i cili thotë:

*«Thelbi i revolucionit është se proletariati shkatërron «aparin administrativ» dhe gjithë aparatin shtetëror, duke e zëvendësuar me një aparat të ri, të përbërë nga punëtorët e armatosur»<sup>1</sup>.*

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 577.

Të dytat predikojnë ruajtjen e aparatit të vjetër shtetëror, megjithëse me fjalë shprehen se gjoja janë për socializmin. Sipas tyre, socializmi mund të vendoset me reforma, me rrugë parlamentare, bile edhe duke përdorur makinën e vjetër shtetërore.

Një varg partish, të ashtuquajtura komuniste, aktualisht tregohen edhe më të zellshme se partitë e deklaruara borgjeze në mbrojtjen e rendit ekzistues kapitalist. Kështu, për shembull, partia revizioniste e Ibarruri-Karriljos mbron pa pikë turpi regjimin monarkik të Huan Karlosit, në një kohë kur disa parti borgjeze spanjolle kërkojnë zëvendësimin e tij me një regjim republikan. Gjithashtu partia revizioniste e Berlinguerit del si mbrojtëse e flaktë e ligjeve shtypëse të shtetit kapitalist italian, që drejtohen kundër lirive demokratike, në një kohë kur parti të ndryshme borgjeze këtë nuk e bëjnë hapur. Revizionistët kinezë, nga ana e tyre, udhëzojnë partitë që ndjekin vijën kineze, në vendet kapitaliste, që të luftojnë së bashku me qarqet më militariste për forcimin e ushtrive dhe të aparatit borgjez të dhunës për të mbrojtur gjoja atdheun, por në të vërtetë për të shtypur revolucionin, në rast se shpërthen.

Në synimet e tyre për të minuar lëvizjen revolucionare e çlirimtare dhe për të përjetësuar kapitalizmin e sëndimin imperialist, borgjezia dhe adeptët e saj, në mënyrë të veçantë revizionistët modernë, përpiqen me të gjitha mënyrat të çorientojnë e të përçajnë forcat revolucionare duke fshirë dallimin midis miqve e armiqve të revolucionit. Tipike janë predikimet e revizionistëve kinezë, të cilët paraqesin si aleatë të proletar-

riatit e të popujve të shtypur borgjezinë e madhe monopoliste, regjimet reaksionare e fashiste, NATO-n e Tregun e Përbashkët Evropian dhe deri imperializmin amerikan.

Për sa u përket partive marksiste-leniniste, ato si kusht të domosdoshëm për ndërtimin e një strategjie të vërtetë revolucionare konsiderojnë vendosjen e një kufiri të prerë midis forcave lëvizëse të revolucionit e armiqve të tij, si dhe përcaktimin e qartë të armikut kryesor të brendshëm e të jashtëm, kundër të cilit, siç theksonte Stalini, duhet drejtuar goditja kryesore, pa nënvleftësuar e pa harruar edhe luftën kundër armiqve të tjerë.

Në kohën tonë, në kushtet e imperializmit, jo vetëm në vendet kapitaliste të zhvilluara, por edhe në vendet e shtypura e të varura, armiku kryesor i brendshëm i revolucionit është borgjezia e madhe vendase, e cila qëndron në krye të rendit kapitalist dhe lufton me të gjitha mjetet, me dhunë e shtypje, si dhe me demagogji e mashtrim, të ruajë sundimin e privilegjet e saj, të mbytë e të shuajë çdo lëvizje të punonjësve që cenon sadopak pushtetin dhe interesat e saj klasorë. Ndërsa armiku kryesor i jashtëm i revolucionit dhe i popujve, në kushtet aktuale, është imperializmi botëror, sidomos superfuqitë imperialiste. T'u këshillosh e t'u bësh thirrje proletariatit e popujve të shtypur të mbështeten te njëra superfuqi për të luftuar tjetrën, ose të hyjnë në aleancë me fuqitë imperialiste në emër gjoja të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë kombëtare, siç predikojnë revizionistët kinezë, kjo nuk është tjetër veçse tradhti ndaj çështjes së revolucionit.

Revizionistët kanë vënë veçanërisht në shenjë rolin hegjemon të klasës punëtore në revolucion, që përbën një ndër çështjet themelore të strategjisë revolucionare.

*«Kryesorja në doktrinën e Marksit — ka shkruar Lenini — është sqarimi i rolit historik botëror të proletariatit, si krijues i shoqërisë socialiste»<sup>1</sup>.*

Lenini e quante mohimin e idesë së hegjemonisë së proletariatit në lëvizjen revolucionare pamjen më vulgare të reformizmit.

Ndër revizionistët modernë një palë përpiqen të provojnë se klasa punëtore gjoja po shproletarizohet dhe po shndërrohet në «bashkëdrejtuese» të ndërmarrjeve, prandaj s'ka më vend për revolucion proletar, s'ka nevojë për një rend shoqëror të ndryshëm nga ai ekzistues. Të tjerë pretendojnë se proletarë tashmë s'janë vetëm punëtorët, por të gjithë njerëzit e punës e të kulturës, të gjithë rrogëtarët, dhe se për socializmin s'është e interesuar vetëm klasa punëtore, por edhe klasa e shtresa të tjera të shoqërisë. Prandaj, konkludojnë ata, roli hegjemon i klasës punëtore në lëvizjen e sotme revolucionare e ka humbur kuptimin. Revizionistët sovjetikë me fjalë nuk e mohojnë rolin udhëheqës të klasës punëtore, kurse në praktikë e kanë likuiduar atë, sepse e kanë zhveshur këtë klasë nga çdo mundësi për të udhëhequr. Por edhe teorikisht e

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 18, f. 651.

eliminonjë këtë rol gjersa mbrojnë teorinë famëkeqe «të partisë e të shtetit të të gjithë popullit». Revizionistët kinezë, si pragmatistë që janë, vënë në krye të «revolucionit», sipas rastit, herë fshatarësinë, herë ushtrinë, herë nxënësit e studentët etj.

Partia e Punës e Shqipërisë mbron në mënyrë të vendosur tezën marksiste-leniniste se klasa punëtore përbën forcën vendimtare të zhvillimit të shoqërisë, forcën udhëheqëse për shndërrimin revolucionar të botës, për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste.

Klasa punëtore mbetet forca kryesore prodhuese e shoqërisë, klasa më e përparuar dhe më e interesuar se kushdo tjetër për çlirimin kombëtar e shoqëror, për socializmin, bartësja e traditave më të mira të organizimit e të luftës revolucionare. Ajo ka teorinë e vetme shkencore për transformimin revolucionar të shoqërisë dhe partinë e saj luftarake marksiste-leniniste që e udhëheqin drejt këtij qëllimi. Objektivisht historia i ka ngarkuar asaj misionin të udhëheqë gjithë luftën për kalimin nga kapitalizmi në komunizëm.

Hegjemonia e proletariatit në revolucion është vendimtare për të zgjidhur në favor të tij e të masave popullore çështjen themelore të revolucionit, çështjen e pushtetit politik.

Pushteti i ri mund të kalojë nëpër faza të ndryshme dhe të marrë emra të ndryshëm, në përputhje me kushtet konkrete në të cilat zhvillohet revolucioni dhe me etapat e ndryshme që mund të kalojë ai, por s'mund të ketë zhvillim të revolucionit drejt fitores së socializmit pa vendosjen e diktaturës së proletariatit.



Këtë na mëson marksizëm-leninizmi, këtë na tregon edhe përvoja e gjithë revolucioneve socialiste ngadhënjimtare. Prandaj partia marksiste-leniniste, në çdo rrethanë që të zhvillohet revolucioni, nuk heq dorë kurrë nga pikësynimi për të vendosur diktaturën e proletariatit.

Revizionistët e ngjyrave e të rrymave të ndryshme, në një mënyrë ose në një tjetër, të gjithë, pa përjashtim, e mohojnë nevojën e vendosjes së diktaturës së proletariatit, sepse janë kundër revolucionit, sepse janë për ruajtjen e përjetësimin e rendit kapitalist.

Proletariati me partinë e tij marksiste-leniniste shkon në luftë së bashku me aleatët e tij. Edhe kjo është një nga çështjet më të rëndësishme të strategjisë revolucionare.

Aleat i natyrshëm dhe i ngushtë i proletariatit është fshatarësia e varfër, të cilën e lidh me të jo vetëm qëllimi strategjik i afërt, por edhe i largët e përfundimtar. Po i tillë aleat janë edhe shtresat e varfra të punonjësve të qytetit. Proletariati me fshatarësinë e varfër dhe me punonjësit e tjerë të shtypur e të shfrytëzuar përbëjnë forcat kryesore lëvizëse të revolucionit.

Aleat mund e duhet të bëhet edhe borgjezia e vogël e qytetit, që ndodhet në mënyrë të përhershme në darën e kapitalit të madh dhe nën kanosjen e shpronësimit të plotë.

Proletariati kërkon e lufton për të bërë aleate edhe shtresa të tjera të popullsisë, siç është pjesa përparlmtare e inteligjencies, e cila shfrytëzohet nga ka-

pitali i brendshëm dhe i jashtëm. Pesha e inteligjencies është rritur në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Por me gjithë ndryshimet që kanë pësuar pozita, karakteri dhe roli i punës së saj, ajo nuk është e nuk mund të përbëjë kurrë një klasë më vete, as nuk është e nuk mund të shkrihet me klasën punëtore, siç pretendojnë revizionistë të ndryshëm. Prandaj, siç ka treguar Lenini dhe e ka provuar historia, inteligjencia s'mund të jetë një forcë shoqërore politike e pavarur. Roli dhe vendi i saj në shoqëri përcaktohen nga gjendja ekonomiko-shoqërore dhe nga bindjet e saj ideologjike e politike. Sado të ndryshojnë kjo gjendje e këto bindje, inteligjencia nuk mund të zëvendësojë asnjëherë rolin udhëheqës të klasës punëtore në revolucion. Detyra e proletariatit është ta bëjë për vete pjesën përparimtare të saj, ta bindë në pashmangësinë e shembjes së sistemit kapitalist dhe në fitoren e socializmit, ta bëjë aleatë në revolucion.

Në vendet e Afrikës, Amerikës Latine, Azisë etj. me zhvillim të paktë ekonomiko-shoqëror e më të varura prej kapitalit të huaj dhe ku detyrat demokratike dhe antiimperialiste të revolucionit kanë rëndësi të veçantë, aleatë të proletariatit mund të jenë fshatarësia e mesme dhe ajo pjesë e borgjezisë që nuk është e lidhur me kapitalin e huaj e që aspiron një zhvillim të pavarur të vendit.

Lidhja e kësaj pjese të borgjezisë me revolucionin demokratik e antiimperialist, varet nga strategjia e taktika e drejtë e proletariatit, nga manovrimet e shkaktata e të urta të partisë revolucionare të klasës punëtore. Proletariati me partinë e tij mund të bindë, në

këtë mënyrë, jo vetëm borgjezinë e vogël, por edhe këtë borgjezi që të vihet nën udhëheqjen e tij dhe të ngrejë krye për të zhdukur sundimin e huaj dhe borgjezinë e madhe e të egër kapitaliste, vegël e imperializmit, që shtyp e shfrytëzon, që demoralizon e bastardon ndjenjat e pastra të popullit, kulturën e tij shekullore.

Për të bërë me vete aleate klasat e shtresat e tjera, që janë të interesuara në arritjen e qëllimit strategjik në një etapë të caktuar të revolucionit, proletariatit, si për çdo çështje tjetër, i duhet të përleshet me borgjezinë e madhe dhe me reaksionarët e tjerë.

Borgjezia reaksionare dhe çifligarët, duke parashikuar disfatën e tyre, bëjnë një mijë përpjekje e manovrime që të tërheqin në anën e tyre borgjezinë e vogël, fshatarësinë dhe inteligjencien përparimtare, të mos i lënë ato të bëhen aleate të proletariatit. Ata mundohen të mashtrojnë edhe vetë klasën punëtore, me qëllim që revolucionit të mos shpërthejë dhe, në qoftë se shpërthen, të mos shkojë deri në fund, të ngelet në vend ose të bëjë prapakthehu.

Nga ana e tyre, proletariati dhe partia e tij marksiste-leniniste punojnë dhe i kanë të gjitha mundësitë që t'i bashkojnë rreth vetes aleatët e tyre kundër armiqve të përbashkët, siç janë borgjezia e madhe, çifligarët, imperialistët e socialimperialistët, dhe të mos lejojnë që shtresa të fshatarësisë dhe të borgjezisë së vogël të bëhen rezervë e kapitalit të madh ose e diktaturës fashiste, siç ngjau në kohën e Hitlerit në Gjermani, në kohën e Musolinit në Itali dhe të Frankos gjatë Luftës së Spanjës.

Partia marksiste-leniniste mban një qëndrim të kujdesshëm e të zhdërvjellët, veçanërisht ndaj aleatëve të mundshëm të lëkundur ose edhe të përkohshëm, duke përfshirë edhe shtresa të ndryshme të borgjezisë së mesme etj., të cilat janë të lidhura me fije të shumta, interesa, tradita e paragjykime të ndryshme me botën e kapitalit dhe imperializmin. Proletariati dhe para-roja e tij, partia marksiste-leniniste, duke mos lëvizur për asnjë çast nga pozitën parimore, janë të interesuar që edhe forca të tilla, me gjithë lëkundjet e paqëndrueshmërinë e tyre, të tërhiqen në anën e revolucionit a të luftës çlirimtare, ose të paktën të neutralizohen dhe të mos bëhen rezervë e armikut.

Ligjet e revolucionit, si kudo, veprojnë edhe në vendet ku në fuqi janë revizionistët. Cila është pozita e borgjezisë së re që po zhvillohet në vendet revizioniste të Evropës? Kjo aspirohet të çlirohet nga shtypja e shumanshme dhe e egër e borgjezisë sovjetike, nga socialimperializmi sovjetik, por interesat rrënjësorë të të dyja palëve janë të përbashkët. Borgjezia e këtyre vendeve nuk mund të rrojë dot e shkëputur nga borgjezia sovjetike. Edhe në qoftë se do të shkëputej nga kjo borgjezi e madhe dhe e egër socialimperialiste, s'ka dyshim se ajo do të hynte shpejt nën sundimin e borgjezisë së shteteve kapitaliste të zhvilluara të Evropës Perëndimore dhe të imperializmit amerikan.

Por edhe në vendet revizioniste, që po integrohen ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht në shtetin e madh sovjetik socialimperialist, veç proletariatit, edhe shtresa të tjera të popullsisë janë të pakënaqura nga shfrytëzimi që u bëhet prej borgjezisë së re dhe

nga sundimi i socialimperializmit sovjetik. Për këtë shkak, urrejnë si borgjezinë e vet sunduese, ashtu edhe hegjemonizmin e neokolonializmin rus. Proletariati në këto vende ka nevojë të zgjohet e të bëhet i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë historike që të zbresë përsëri në fushën e betejës, të hidhet në luftë për të përmbysur e për të shpartalluar tradhtarët, për të kryer edhe një herë revolucionin proletar, për të rivendosur diktaturën e proletariatit. Ai duhet të krijojë partitë e tij të reja marksiste-leniniste dhe të bashkojë rreth vetes të gjitha masat popullore.

Duke iu përmbajtur me konsekuencë parimit se faktori vendimtar i fitores së revolucionit është i brendshmi, është lufta revolucionare e vetë proletariatit dhe e popullit të vendit, ndërsa faktori i jashtëm është ndihmës e sekondar, partitë marksiste-leniniste nuk injorojnë e nuk nënvleftësojnë aspak aleatët e jashtëm të revolucionit. Ashtu si ndaj aleatëve të brendshëm, edhe ndaj aleatëve të jashtëm, në të njëjtën kohë, ato mbajnë një qëndrim parimor dhe elastik.

Në përputhje me mësimet e Leninit e të Stalinit dhe në përshtatje me kushtet aktuale, ato i shohin aleatët e jashtëm të natyrshëm e të sigurt të lëvizjes revolucionare në çdo vend te proletariati e te lëvizja e tij revolucionare në vendet e tjera, te lëvizja revolucionare antiimperialiste e popujve të shtypur të botës dhe te vendet e vërteta socialiste.

Në raste të veçanta mund të krijohen edhe rrethana të atilla kur një vend socialist ose një popull që lufton kundër agresionit imperialist ose socialimperialist, të gjendet në një front të përbashkët edhe me

vende të ndryshme të botës kapitaliste që luftojnë kundër të njëjtit armik, siç ndodhi në periudhën e Luftës së Dytë Botërore.

Në raste të tilla rëndësi të dorës së parë ka të mbahen kurdoherë parasysh interesat e revolucionit, të mos harrohen, errësohen e të mos sakrifikohen ata për hir të frontit të përbashkët ose të aleancës me këta aleatë të përkohshëm, të mos shndërrohet ky front ose kjo aleancë në një qëllim më vete. Sidomos, ka rëndësi të mos lejohet ndërhyrja e të tillë aleatëve për të sabotuar revolucionin e për t'i rrëmbyer atij fitoren. Eksperienca e Partisë Komuniste të Shqipërisë në qëndrimin ndaj aleatëve amerikanë e anglezë në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare është kuptimplote. Ky qëndrim që shpëtimtar për fatet e çështjes së revolucionit në Shqipëri.

**Strategjia revolucionare është e pandarë nga taktikat revolucionare që përdorin partitë marksiste-leniniste për të realizuar qëllimin dhe detyrat e revolucionit. Duke qenë pjesë e strategjisë e në shërbim të saj, taktikat mund të ndryshojnë në përshtatje me ngjitet e uljet e valës së revolucionit, me rrethanat e kushtet konkrete, por kurdoherë brenda caqeve të strategjisë revolucionare e të parimeve marksiste-leniniste.**

*«Detyra e udhëheqjes taktike — thotë Stalini — është të zotërojë të gjitha format e luftës dhe të organizimit të proletariatit dhe të sigurojë shfrytëzimin e tyre të drejtë, për arritjen e maksimumit të rezultateve në një ra-*

*port të dhënë forcash, gjë që nevojitet me-  
doemos për përgatitjen e suksesit strategjik».<sup>1</sup>*

Duke adoptuar taktika e forma lufte të shkathta për të çuar përpara çështjen e revolucionit, partitë e vërteta marksiste-leniniste u përmbahen kurdoherë me besnikëri parimeve revolucionare. Ato hedhin poshtë e luftojnë çdo prirje për të braktisur parimet për hir të taktikave, janë kundërshtarët më të vendosura të çdo politike të paprincipitë, koniunkturale e pragmatiste, që karakterizon tërë veprimtarinë e revizionistëve të të gjitha rrymave.

Revolucioni është kurdoherë vepër e masave, të udhëhequra nga pararoja revolucionare. Prandaj partia marksiste-leniniste nuk mund të mos i kushtojë një vëmendje të madhe organizimit revolucionar të masave në forma të përshtatshme, duke u nisur nga kushtet e rrethanat konkrete, nga traditat që ekzistojnë në secilin vend etj. Pa lidhje të organizuara të partisë me masat as që mund të bëhet fjalë për ngritjen, përgatitjen dhe mobilizimin e tyre në luftën revolucionare.

Pikërisht për këtë arsye partia marksiste-leniniste i vë shumë rëndësi krijimit të organizatave të masave, të drejtuara prej saj. Sigurisht kjo nuk është një çështje që zgjidhet lehtë, sidomos sot kur në të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste ekzistojnë shumë lloj organizatash sindikale, kooperativiste, kulturore, shkencore, të rinisë, të grave etj. Shumica e këtyre orga-

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 164.

nizatave ndodhen nën drejtimin e ndikimin e borgjezisë, të revizionistëve e të kishës.

Por, siç na mëson Lenini, komunistët duhet të hyjnë e të punojnë gjithkund ku ka masa. Prandaj ata nuk mund të mos punojnë edhe në organizatat e masave të drejtuara ose të ndikuara prej borgjezisë, socialdemokracisë, revizionistëve etj. Marksistë-leninistët punojnë në to për të minuar ndikimin e drejtimin e partive borgjeze e reformiste, për të përhapur në masat ndikimin e partisë revolucionare të klasës punëtore, për të demaskuar karakterin mashtrues të programeve e të veprimtarisë së krerëve të këtyre organizatave, për t'u dhënë veprimeve të masave karakter politik antikapitalist, antiumperialist, antirevizionist. Me anë të punës revolucionare, që zhvillojnë në radhët e masave, mund të formohen edhe fraksione revolucionare brenda këtyre organizatave, bile mund të krijohen mundësi për të shtënë në dorë edhe udhëheqjen e këtyre organizatave e për t'i orientuar ato në rrugë të drejtë.

Por në çdo rast partia marksiste-leniniste nuk heq kurrë dorë nga synimi për të ngritur organizata revolucionare të masave nën drejtimin e vet.

Organizatat më të rëndësishme të masave janë sindikatat ose tredunionet. Sot këto organizata në vendet kapitaliste e revizioniste në përgjithësi i shërbejnë në borgjezisë, revizionizmit, për të mbajtur nën zgjedhë proletariatin dhe të gjitha masat punonjëse. Engelsi që në kohën e vet thoshte se tredunionet në Angli, nga organizata që i kallnin tmerrin borgjezisë,



ishin kthyer në organizata që i shërbenin kapitalit. Organizatat sindikale e kanë lidhur punëtorin me një mijë fije, me një mijë hallka zinxhiri robërues, në mënyrë që punëtori i izoluar, kur revoltohet, të shtypet lehtësisht. Udhëheqësit oportunistë të sindikatave punojnë që revoltat e punëtorëve, të një ose më shumë ndërmarrjeve, që hidhen në greva e demonstrata, të mbahen nën kontroll dhe të marrin vetëm karakter ekonomik. Në këtë drejtim një punë të madhe manipuluese zhvillon aristokracia punëtorë. Kjo aristokraci në vendet kapitaliste luan një rol të madh gërryes, shtypës, mashtrues dhe është bërë prej kohësh zjarrfikëse e revolucionit.

Në të gjitha vendet kapitaliste sot partitë borgjeze e revizioniste kryesore kanë sindikatat e tyre. Këto sindikata tani veprojnë në unitet dhe kanë vendosur një bashkëpunim të ngushtë për të frenuar lëvizjen revolucionare të proletariatit, për të çoroditur klasën punëtorë politikisht dhe moralisht.

Në Francë dhe në Itali, për shembull, sindikatat e partive revizioniste janë të mëdha e të fuqishme. Por çfarë bëjnë ato? Ato përpiqen ta mbajnë nën zgjedhë proletariatin, ta nanurisin dhe, kur revoltohet dhe egërsohet, ta futin në rrugën e bisedimeve me patronatin dhe t'u zënë gojën punëtorëve me ndonjë thërrime shumë-shumë të vogël nga superfitimet kapitaliste. Atë që ua japin, ua marrin pastaj nëpërmjet ngritjes së çmimeve.

Prandaj, që të çlirohet nga kapitalizmi, proletariati i çdo vendi është e domosdoshme ta hedhë tej zgjedhën e sindikatave të sunduara nga borgjezia dhe

oportunistët, si edhe të çdo lloj organizate ose partie socialdemokrate e revizioniste. Të gjithë këta organizma mbështetin patronatin në forma të ndryshme dhe përpiqen të krijojnë iluzionin se «janë një forcë e madhe», se «janë një fre», se «mund t'u imponohen kapitalistëve të mëdhenj» gjoja në favor të proletaria-tit. Kjo nuk është gjë tjetër përveçse një rrenë e ma-dhe. Proletariati duhet t'i shkallmojë këta organizma. Po si t'i shkallmojë? T'i shkallmojë duke luftuar udhë-heqjen e këtyre sindikatave, duke ngritur krye kundër lidhjeve të pabesa të tyre me borgjezinë, duke prishur qetësinë false, «paqen shoqërore» që ata kërkojnë ta vendosin, «paqe» që maskohet me gjoja revoltimin e herëpashershëm të sindikatave kundër patronatit.

Për shkallmimin e këtyre sindikatave mund të veprohet edhe duke depërtuar në to, për t'i luftuar e për t'i gërryer nga brenda, për të kundërshtuar ven-dimet e veprimet e tyre të padrejta. Kjo veprimtari duhet të përfshijë grupe sa më të mëdha të fuqishme punëtorësh nëpër fabrika. Në çdo rast është e nevoj-shme të synohet arritja e një uniteti të çeliktë të pro-letariatit në luftë jo vetëm kundër patronatit, por edhe kundër agjentëve të tij, krerëve sindikalistë. Demaski-mi me forcë i gjithë elementëve tradhtarë në krye të sindikatave, i borgjezimit të udhëheqjes sindikale dhe i sindikatave reformiste në përgjithësi i çliron punë-torët nga shumë iluzione që kanë akoma për këtë udhë-heqje e për këto sindikata.

Duke depërtuar në sindikatat ekzistuese, mark-sistë-leninistët nuk bien kurrë në pozita tredunionistë, reformiste, anarkosindikaliste, revizioniste, që karak-

terizojnë udhëheqjen e këtyre sindikatave. Ata nuk bëhen kurrë ortakë me revizionistët dhe me partitë e tjera oportuniste e borgjeze në udhëheqjen e sindikatave. Pikësynimi i tyre është të demaskojnë karakterin borgjez dhe rolin reaksionar që kanë përgjithësisht sindikatat e sotme në vendet kapitaliste e revizioniste, t'u vënë minat këtyre organizatave për t'i çelur rrugën krijimit të sindikatave të vërteta proletare.

**Rëndësi të posaçme ka për partitë marksiste-leniniste organizimi i masave të rinisë. Roli i rinisë ka qenë kurdoherë i madh në lëvizjet revolucionare. Prej natyre rinia është për të renë kundër së vjetrës dhe tregohet e gatshme të luftojë për triumfin e çdo gjëje përparimtare, revolucionare. Mirëpo ajo nuk është në gjendje ta gjejë vetë rrugën e drejtë. Këtë rrugë mund t'ia tregojë asaj vetëm partia e klasës punëtore. Kur energjitë e pashtershme revolucionare të rinisë bashkohen me energjitë e klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse për zhdukjen e shtypjes e të shfrytëzimit, për çlirimin kombëtar e shoqëror, s'ka forcë që të ndalojë triumfin e revolucionit.**

Por sot në vendet kapitaliste e revizioniste shumica e rinisë i harxhon energjitë e saj në rrugë të gabuara, ajo mashtrohet nga borgjezia e revizionizmi dhe shpesh kalon në aventurizëm e anarkizëm ose bie në utopi e dëshpërim, ngaqë është e çoroditur dhe e trulllosur dhe e shikon të zymtë perspektivën, plotësimin e kërkesave të saj politike, materiale e shpirtërore.

Marksistë-leninistët i kushtojnë kurdoherë një

vëmendje shumë të madhe rinisë, përpiqen ta sqarojnë e ta bindin atë se vetëm në rrugën që tregon marksizëm-leninizmi dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj mund të plotësohen aspiratat e dëshirat e rinisë. Ata punojnë që ta largojnë rininë nga ndikimi i borgjezisë dhe i revizionistëve, nga lëvizjet e ashtuquajtura majtiste, trockiste, anarkiste dhe ta mobilizojnë në organizata revolucionare, ta tërheqin në rrugën e revolucionit.

Partia e vërtetë marksiste-leniniste dhe komunistët revolucionarë marrin pjesë aktive në grevat dhe në demonstratat e punëtorëve dhe luftojnë për t'i kthyer ato në greva dhe në demonstrata politike, në mënyrë që t'ua bëjnë të pamundur jetën kapitalizmit, patronatit, karteleve, monopoleve dhe krerëve sindikalistë. Gjatë kësaj veprimtarie të madhe proletariati do të përleshet më shpesh e më hapur me forcat e armatosura të rendit borgjez, por nëpërmes përleshjeve ai do të mësohet të luftojë më mirë. Në luftë e sipër ai gjen edhe format e mundshme, të drejta e të përshtatshme, të organizimit e të luftës revolucionare. «Pa u futur në ujë nuk mësohet noti», thotë një shprehje e urtë popullore. Pa luftuar me greva, me demonstrata, pa u aktivizuar në aksione kundër kapitalizmit në përgjithësi, nuk mund të organizohet dhe të intensifikohet lufta për fitoren përfundimtare, nuk mund të përmbysset rendi borgjez.

Revolucioni nuk përgatitet duke bërë llafe, siç bëjnë revizionistët e ndryshëm, ose duke teorizuar mbi «tri botët», siç bëjnë revizionistët kinezë. Ai s'fi-

ton dot me rrugë paqësore. Lenini ka folur edhe për këtë mundësi në raste të veçanta, por theksin kryesor e ka vënë gjithnjë te dhuna revolucionare, sepse borjezia kurrë nuk e dorëzon pushtetin vullnetarisht. Historia e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare, e zhvillimit të revolucioneve dhe e fitoreve të klasës punëtore në një varg vendesh ish-socialiste, dhe në vendin tonë socialist, tregon se revolucionet deri sot janë fituar vetëm me anë të kryengritjes së armatosur.

Kryengritja e armatosur revolucionare s'ka asgjë të përbashkët me puçet ushtarake. E para ka për qëllim përmbysjen rrënjësore politike, shkatërrimin nga themelet të rendit të vjetër. Të dytat nuk çojnë e s'mund të çojnë në përmbysjen e rendit shtypës e shfrytëzues ose në likuidimin e sundimit imperialist. Kryengritja e armatosur bazohet në mbështetjen e masave të gjera popullore, kurse puçi është shprehje e mosbesimit në masat, e shkëputjes nga to. Tendencat puçiste në politikën e në veprimtarinë e një partie që e quan veten parti e klasës punëtore, janë devijim nga marksizëm-leninizmi.

Në përshtatje me kushtet konkrete të një vendi dhe të situatave në përgjithësi, kryengritja e armatosur mund të jetë një shpërthim i njëhershëm ose një proces revolucionar më i gjatë, por jo pa fund e pa perspektivë, siç predikon «teoria e luftës së gjatë popullore» e Mao Ce Dunit. Po të ballafaqosh mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit mbi kryengritjen e armatosur revolucionare me teorinë

e Maos mbi «luftën popullore», duket qartë karakteri antimarksist, antileninist, antishkencor i kësaj teorie. Mësimet marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur bazohen në lidhjen e ngushtë të luftës në qytet e në fshat nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj revolucionare.

Teoria maoiste, duke qenë kundër rolit udhëheqës të proletariatit në revolucion, konsideron si bazë të vetme të kryengritjes së armatosur fshatin dhe lë pas dore luftën e armatosur të masave punonjëse në qytete. Ajo predikon se fshati duhet të mbajë të rrethuar qytetin, që shihet si kështjellë e borgjezisë kundërrevolucionare. Në këtë shprehet mosbesimi ndaj klasës punëtore, mohimi i rolit të saj hegjemon.

Duke iu përmbajtur pa lëkundje mësimëve të marksizëm-leninizmit mbi revolucionin me dhunë si ligj i përgjithshëm, partia revolucionare e klasës punëtore është kundërshtarë e vendosur e aventurizmit dhe kurrë nuk luan me kryengritjen e armatosur. Ajo zhvillon pareshtur, në të gjitha kushtet e rrethanat, luftë e veprimtari revolucionare në forma të ndryshme për të përgatitur veten dhe masat për betejat vendimtare në revolucion, për përmbysjen e sundimit të borgjezisë me anë të dhunës revolucionare. Por vetëm kur situata revolucionare është pjekur plotësisht, ajo vë drejtpërdrejt në rend të ditës kryengritjen e armatosur dhe merr të gjitha masat politike, ideologjike, organizative e ushtarake për ta çuar atë në fitore.

**Për përgatitjen e masave për revolucion, një mjet i fuqishëm në duart e partisë marksiste-leniniste është**

propaganda, që duhet të jetë e zjarrtë, e qartë dhe bindëse. Propaganda revolucionare nuk vlen po të jetë vetëm një propagandë frazash. Vetëm një propagandë që është incizive, e lidhur mirë me problemet e jetës, me problemet e përgjithshme dhe me çështjet lokale, një propagandë që të ndihmojë e të krijojë në masat e gjera iniciativën, mund t'i edukojë politikisht dhe ideologjikisht proletariatin e masat e tjera punonjëse, t'i hedhë në veprim, t'i përgatitë për revolucion.

Borgjezia kapitaliste në të gjitha vendet, përveç forcës së madhe që ka në dorë, si ushtrinë, policinë etj., ka edhe një eksperiencë të gjerë në luftën kundër proletariatit e veprimtarisë së tij. Ajo ka, gjithashtu, një rrjet të tërë propagande, shtypi, radioje, televizioni, filmash, teatros, muzike etj. E gjithë kjo propagandë është aq korruptuese, saqë ka mundësi t'i çoroditë, t'i degjenerojë dhe t'i dobësojë për një kohë përpjekjet e proletariatit dhe luftën e tij për çlirim.

Në shtetet e të ashtuquajturës demokraci borgjeze, ku ekziston edhe njëfarë «lirie demokratike», nuk është e mjaftueshme të zhvillohet vetëm një propagandë e zakonshme gazetareske kundër kapitalizmit në përgjithësi. Gazetat e partive të ndryshme borgjeze e revizioniste flasin mbarë e mbrapsht, natyrisht, jo kundër rendit borgjez, por kundër njerëzve të veçantë, kundër atyre që kërkojnë të zvogëlojnë pjesën e të tjerëve në sofrën e madhe, ku janë shtruar dhe hanë në kurrizin e popullit.

Propaganda, sidomos shtypi i partive të reja marksiste-leniniste, ka një detyrë shumë të madhe: të de-

maskojë falsitetin e «demokracisë» borgjeze, t'u çjerrë maskën gjithë manovrave të saj, si dhe demagogjisë së revizionistëve e të shërbëtorëve të tjerë të kapitalit. Propaganda e shtypi marksist-leninist tregojnë zhveshur të vërtetën, tregojnë rrugën e çlirimit shoqëror e kombëtar nëpërmjet revolucionit, kurse propaganda edhe shtypi borgjez e revizionist gënjejnë, nanurisin, çoroditin njerëzit që t'i largojnë masat nga revolucioni, t'i futin në rrugë pa krye, t'i mbajnë të skllavëruara.

Por, për t'i sqaruar masat, për t'i bindur ato në drejtësinë e vijës politike të partisë së klasës punëtore, për t'i përgatitur për revolucionin, nuk mjafton vetëm propaganda. Lenini thotë se, për të përgatitur revolucionin,

*«... nevojitet eksperiencia politike e vetë këtyre masave»<sup>1</sup>.*

Vetë propaganda bëhet e efektshme dhe zë vend kur zhvillohet tok me aksionin revolucionar. Pa veprim, mendimi vyshket. Kjo veprimtari nuk është e s'duhet të jetë aventurë, por një luftë e rreptë, një ndeshje e ashpër me armiqtë e klasës, që kalon nga një formë më e thjeshtë në një formë më të lartë, që kapërcen vështirësi të shumta dhe pranon të gjitha sakrificat që kërkon revolucioni.

Partitë e vërteta marksiste-leniniste qëndrojnë në pararojë dhe jo në bisht të aksionit revolucionar. Mu-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 92.



ndësitë përkohësisht të vogla të luftës dhe të përpjekjeve, me të cilat ato i kundërvihen dhe duhet t'i kundërvihen forcës së madhe të reaksionit kapitalist, nuk i dekurajojnë. Ato i mësojnë anëtarët e tyre të jenë të guximshëm dhe të kenë parasysh se një veprim i tyre i drejtë, i matur, i pjekur dhe i vendosur ka reperkusione të thella në masat që i shohin dhe i dëgjojnë. Kur veprohet kështu, masat e kuptojnë se qëllimet e këtij ose të atij aksioni revolucionar janë në interes të proletariatit dhe të të shfrytëzuarve. Guximi dhe pjekuria në veprime kanë rëndësi të madhe, pse kështu, pëllëmbë për pëllëmbë, fitohet terren dhe ecet përpara në ngritjen e valës së revolucionit. Aksioni revolucionar lidh partitë e klasës punëtore me masat, i nxjerr ato në krye të tyre, i bën të fitojnë mbi partitë reformiste, revizioniste.

*«Çdo hap që bën lëvizja e vërtetë — thoshte Marksi — ka më tepër rëndësi se një duzinë programesh»<sup>1</sup>.*

Në vendet kapitaliste, përveç forcave revolucionare që drejtohen nga partia marksiste-leniniste, ka edhe forca të tjera që luftojnë e ndeshen me policinë, xhandarmërinë etj. Mjaft veprime e goditje të këtyre forcave të tjera kanë karakter terrorist, aventuresk, anarkist, ato paraqiten me lloj-lloj ngjyrash dhe eti-

---

1. K. Marks e F. Engels, Vepra të zgjedhura, vëll. II, Tiranë, 1975, f. 8.

ketash dhe udhëhiqen nga ideologji të ndryshme. Të tilla veprime shpesh organizohen me nxitjen dhe financimin e shërbimeve të fshehta të vendeve kapitaliste, dhe ndër të tjera kanë qëllim të diskreditojnë partitë marksiste-leniniste, duke ua veshur të tilla veprime këtyre partive. Elementët fashistë ose agjentë të fshehtë të borgjezisë, që organizojnë dhe udhëheqin shpesh këto veprime, përpiqen të përfitojnë nga pakënaqësitë, nga zemërimi dhe nga guximi i proletariatit, i nxënësve dhe i studentëve, i rinisë në përgjithësi, për t'i hedhur grupet e lëvizjet e ndryshme që formohen nga këto masa në veprime të cilat jo vetëm s'kanë asgjë të përbashkët me lëvizjet e vërteta revolucionare, por edhe i rrezikojnë shumë këto lëvizje, krijojnë përshtypjen se proletariati është në degradim, se është kthyer në lumpenproletariat.

Partitë marksiste-leniniste, duke i kushtuar vëmendjen e duhur kësaj çështjeje, është e nevojshme, nga njëra anë, të bëjnë që masat të binden nga vetë përvoja e tyre se veprimet revolucionare kanë karakter krejt të ndryshëm nga veprimet terroriste dhe anarkiste, nga ana tjetër, të luftojnë për të shpëputur elementët revolucionarë, që kanë rënë viktimë, nga radhët e grupeve terroriste e anarkiste, nga elementët fashistë dhe agjentët e fshehtë të borgjezisë në këto grupe.

Partitë marksiste-leniniste janë parti të revolucionit. Në kundërshtim me teoritë e praktikat e partive revizioniste, që janë zhytur kokë e këmbë në legalizëm borgjez e «kretinizëm parlamentar», ato nuk

e reduktojnë luftën e tyre në punën thjesht legale dhe as e shohin këtë si veprimtarinë kryesore të tyre. Në kuadrin e përpjekjeve për të zotëruar të gjitha format e luftës, ato i kushtojnë rëndësi të veçantë kombinimit të punës legale me atë ilegale, duke i dhënë prioritet kësaj të fundit si vendimtare për përmbysjen e borgjezisë dhe si garancia e vërtetë për arritjen e fitores. Ato i edukojnë e i mësojnë kuadrot, anëtarët e simpatizantët e tyre që të dinë të veprojnë me zgjuarsi, shkathtësi e trimëri si në kushte legale dhe ilegale. Por edhe kur veprojnë në kushtet e klandestinitetit të thellë, duke u përpjekur të mos i ekspozojnë forcat para armikut dhe ta ruajnë organizatën revolucionare nga goditjet e tij, partitë marksiste-leniniste nuk mbyllen në vetvete, nuk i dobësojnë e nuk i shkëputin lidhjet me masat, nuk e ndërpresin për asnjë çast veprimtarinë e gjallë midis masave dhe as nuk lënë pa përdorur në dobi të çështjes së revolucionit të gjitha mundësitë legale që lejojnë kushtet e rrethanat.

Partia marksiste-leniniste, e zhveshur nga çdo iluzion për marrjen e pushtetit me rrugë parlamentare, mund ta gjejë me vend të marrë pjesë, në raste të veçanta e të favorshme, edhe në aktivitete të tilla legale, siç janë zgjedhjet për këshillat bashkiakë, parlamentare etj., me synim të vetëm që të propagandojë vijën e saj në masat dhe të demaskojë rendin politik borgjez. Por këtë pjesëmarrje partia nuk e shndërron në vijë të përgjithshme të luftës së saj, siç bëjnë revizionistët, nuk i shndërron këto lloje for-

mash në kryesore ose, aq më keq, në forma të vetme të luftës.

Duke shfrytëzuar mundësitë legale, partia kërkon, gjen e përdor forma e metoda me karakter revolucionar, që nga më të thjeshtat deri te më të ndërlikuarat, pa përfillur sakrificat, duke u përpjekur t'i bëjë të tilla forma e metoda sa më popullore, sa më të pranueshme nga masat. Në veprimtarinë e vet marksistë-leninistët s'bëhen merak se shkelin e cenojnë me veprimet e tyre revolucionare kushtetutën, ligjet, rregullat, normat, rendin borgjez. Ata luftojnë që t'i vënë minat këtij rendi, të përgatitin revolucionin. Prandaj partia marksiste-leniniste përgatit veten dhe masat t'u bëjnë ballë kundërgoditjeve që borgjezia mund t'u japë në përgjigje të veprimeve revolucionare të proletariatit e të masave popullore.

Në kushtet aktuale të zhvillimit të lëvizjes revolucionare e çlirimtare, si një proces i komplikuar e me një bazë sociale të gjerë, në të cilin marrin pjesë forca të shumta klasore e politike, partia revolucionare e proletariatit ndeshet jo rrallë me problemin e bashkëpunimit e të fronteve të përbashkëta me parti e organizata të tjera politike në këtë ose në atë fazë të revolucionit, për këto ose për ato çështje të interesit të përbashkët. Qëndrimi i drejtë, parimor e njëkohësisht i shkathët, larg çdo oportunitizmi e sektarizmi, në këtë çështje është me rëndësi të madhe për tërheqjen, përgatitjen dhe mobilizimin e masave në revolucion e në luftën çlirimtare. Partia marksiste-leniniste nuk është e nuk mund të jetë në parim kundërshtarë e bashkëpunimit ose e

fronteve të përbashkëta me parti e forca të tjera politike, kur këtë e kërkojnë interesat e çështjes së revolucionit dhe e imponojnë situatat. Veçse ajo kurrë nuk e sheh këtë si një koalicion krerësh e si një qëllim në vetvete, por si një mjet për të bashkuar e për të ngritur në luftë masat. Rëndësi ka që në fronte të tilla të përbashkëta partia proletare të mos humbasë në asnjë moment nga këndi i vështrimit interesat klasorë të proletariatit, qëllimin final të luftës së tij, të mos shkrihet në front, por të ruajë aty individualitetin e saj ideologjik dhe pavarësinë e vet politike, organizative e ushtarake, të luftojë për të siguruar në front rolin udhëheqës e për të zbatuar aty një politikë revolucionare.

Që partia marksiste-leniniste të mund të përpujë e të zbatojë një strategji e një taktikë revolucionare, një vijë të drejtë politike, të dijë të orientohet drejt në situatat e vështira, të jetë e zonja të përballojë armiqtë e të kapërcejë pengesat, është e domosdoshme që ajo të zhvillojë një punë të madhe e të gjerë për studimin e përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste.

Një nga arsyet që partitë ish-komuniste në vendet kapitaliste u shndërruan në parti revizioniste është pikërisht se mësimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit ishte lënë nga ato krejt pas dore. Doktrina marksiste-leniniste përdorej vetëm si lustër, që kthyer në fjalë boshe, në slogane, ajo nuk ishte futur thellë në ndërgjegjen e anëtarëve të partisë, nuk ishte bërë gjaku e mishi i tyre, s'ishte bërë armë për veprim. Ndonjë punë e vogël që bëhej në studimin e marksizëm-leninizmit synonte vetëm ta njihnte anëtarin e partisë

me disa formula të thata, vetëm sa për të thënë se quhej komunist, ta donte komunizmin në mënyrë sentimentale, por se si e qysh do të vinte deri këtu, ai nuk dinte asgjë, sepse këtë s'ia kishin mësuar.

Udhëheqësit e atyre partive, që kishin vetëm fjalë dhe asgjë në trastë, rronin në një ambient borgjez dhe e molepsnin proletariatin e vendeve të tyre me ide liberale e reformiste.

Në këtë mënyrë, kthesa drejt borgjezisë e partive revizioniste është një evolucion socialdemokrat oportunist i përgatitur me kohë nga liderët socialdemokratë, nga aristokracia punëtore që udhëhiqte këto parti të ashtuquajtura komuniste.

Këtë përvojë negative s'mund të mos e mbajnë parasysh partitë marksiste-leniniste për të nxjerrë që andej mësimë që të organizojnë studimin e përvetësimit e marksizëm-leninizmit mbi baza të shëndosha, duke e lidhur gjithnjë këtë studim me veprimin revolucionar.

**Në përgatitjen për revolucion rëndësi të veçantë kanë uniteti e bashkëpunimi i partive marksiste-leniniste të vendeve të ndryshme, mbi bazën e parimeve të internacionalizmit proletar.**

Ky unitet do të forcohet dhe ky bashkëpunim do të zgjerohet në luftë kundër imperializmit e social-imperializmit, kundër borgjezisë e revizionizmit modern të çdo ngjyre, hrushovian, titist, eurokomunist, kinez etj.

Revizionistët, si armiq të revolucionit, e luftojnë

me të gjitha forcat e mjetet internacionalizmin proletar për t'ia hequr nga duart proletariatit botëror dhe proletariatit të çdo vendi këtë armë të fuqishme në luftë kundër borgjezisë e imperializmit.

Partitë marksiste-leniniste kanë detyrë të demaskojnë manovrat si të revizionistëve titistë dhe curokomunistë që e quajnë sot të vjetruar e të kapërcyer internacionalizmin proletar, ashtu edhe të revizionistëve sovjetikë e të revizionistëve kinezë, që e kanë deformuar dhe përpiqen ta përdorin atë si armë për qëllimet e tyre hegjemoniste, socialimperialiste.

Partia Komuniste e Kinës, e cila nuk ndjek parimet e internacionalizmit proletar dhe nuk mbështet luftërat revolucionare e çlirimtare të popujve, është vënë në rrugën e afrimit e të miqësisë me partitë socialdemokrate dhe ato borgjeze, deri tek ato më të djathtat e reaksionaret. Në të njëjtën kohë, ajo përpiget të krijojë grupe të ndryshme të varura e të drejtuara nga ajo vetë. Asaj i duhen të tilla grupime për të sabotuar pikërisht partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe elementët përparimtarë, që i janë vënë punës për të zgjuar popullin, për ta ngritur këtë në revolucion kundër klikave që sundojnë dhe që janë të lidhura me superfuqitë.

Grupet e vogla që quhen parti e që ndjekin vijën kineze, si oportuniste që janë, nuk bëjnë gjë tjetër veçse mbrojnë dhe propagandojnë teoritë revizioniste të grupit të Hua Kuo Fenit e Ten Hsiao Pinit si dhe veprimet kundërrevolucionare të tij. Këto grupe nuk kanë kurrfarë personaliteti dhe as vendosmëri për të luftuar sipas teorisë marksiste-leniniste.

Parulla kryesore e këtyre partive që është edhe slogani bazë i politikës kineze, është se në situatën e sotme proletariati ka si detyrë themelore e të vetme mbrojtjen e pavarësisë kombëtare, që kërcënohet gjoja vetëm nga socialimperializmi sovjetik. Ata përsëritin gati fjalë për fjalë parullat e krerëve të Internacionales së Dytë, të cilët çështjen e revolucionit e braktisën dhe e zëvendësuan me tezën e mbrojtjes së atdheut kapitalist. Lenini e ka demaskuar këtë parullë false e antimarksiste që i shërben jo mbrojtjes së pavarësisë së vërtetë, por nxitjes së luftërave ndër imperialiste. Ai ka përcaktuar qartë se cili duhet të jetë qëndrimi i revolucionarit të vërtetë në konfliktet midis grupeve imperialiste. Ai ka shkruar:

*«Në qoftë se lufta është luftë reaksionare imperialiste, domethënë luftë që bëhet nga dy grupe botërore të borgjezisë reaksionare imperialiste, dhunuese dhe grabitqare, atëherë çdo borgjezi (edhe ajo e një vendi të vogël) bëhet pjesëmarrëse e grabitjes dhe detyra ime, detyrë e përfaqësuesit të proletariatit revolucionar, është të përgatis revolucionin botëror proletar, i vetmi shpëtim nga tmerret e një kasap-hane botërore...»*

*Ja se ç'është internacionalizmi, ja cila është detyra e internacionalistit, e punëtorit revolucionar, e socialistit të vërtetë»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 28, f. 324-325.



Partitë e vijës kineze janë bërë apologjete të rritjes dhe të fuqizimit të ushtrive borgjeze, duke u justifikuar se gjoja kjo nevojitet për mbrojtjen e pavarësisë. Ato u bëjnë thirrje punonjësve të bëhen ushtarë të bindur dhe së bashku me borgjezinë dalin kundër të gjithë atyre që luftojnë për dobësimin e kësaj arme kryesore, të sundimit e të shfrytëzimit kapitalist. Me një fjalë, ata dëshirojnë që proletariati dhe masat punonjëse të bëhen mish për top në luftërat grabitqare që përgatitin imperializmi dhe socialimperializmi.

Në të njëjtën kohë, këto bishtra kineze janë bërë mbrojtëse të zjarra të institucioneve shtetërore kapitaliste borgjeze, sidomos të NATO-s, të Tregut të Përbashkët Evropian etj., të cilat i konsiderojnë si faktorë kryesorë për «mbrojtjen e pavarësisë». Ato, ashtu si udhëheqësit kinezë, i zbardhin dhe i lustrojnë këto shtylla të sundimit dhe të ekspansionit kapitalist. Ato ndihmojnë pikërisht ata organizma që në realitet kanë cenuar rëndë pavarësinë dhe sovranitetin e vendeve të tyre.

Aleanca me borgjezinë e madhe, mbrojtja e ushtrisë borgjeze, përkrahja e NATO-s, e Tregut të Përbashkët Evropian etj. është për këta pseudomarksistë një rrugë pa asnjë telash, mbasi ajo jo vetëm nuk i çon në ndeshje me borgjezinë, por u siguron edhe favorët e saj.

Këto pozita të këtyre elementëve grupashë pa të ardhme i çojnë ata drejt unifikimit me partitë e eurokomunizmit e të borgjezisë dhe kjo do të ndodhë,

sepse vetë Kina bën thirrje që proletariati të bashkohet me borgjezinë. Midis këtyre pseudomarksistë-leninistëve e Marshesë tanimë nuk ka asnjë diferencë.

Marksistë-leninistët duhet të ruhen shumë nga frazat që përdorin revizionistët modernë, socialdemokratët e pseudomarksistë-leninistët për internacionalizmin proletar, për bashkimin e proletarëve për të mbrojtur paqen e të tjera profka të tilla. Internacionalizmi proletar është i vërtetë kur njerëzit punojnë me vetëmohim për të ndihmuar dhe për të zhvilluar veprimet revolucionare, për të krijuar një situatë të vërtetë lufte revolucionare, në radhë të parë në vendin e vet. Në të njëjtën kohë, siç thotë Lenini, ata duhet ta mbështetin, me propagandë, me simpati dhe me një ndihmë materiale këtë luftë, këtë vijë në të gjitha vendet, pa përjashtim. Çdo gjë tjetër, siç na mëson ai, është gënjeshtër dhe manilovizëm.

Prandaj duhet të ruheni shumë nga elementë të tillë pseudomarksistë, pseudorevolucionarë, pseudointernationalistë, qofshin këta individë të veçantë ose grupe të vogla njerëzish, apo parti që vetëquhen marksiste-leniniste, por që në fakt nuk janë të tilla, janë socialshoviniste, centriste, borgjeze të vogla. Të gjitha këto parti që i bien gjoksit për internacionalizmin proletar, për mbrojtjen e paqes, për reforma etj., i shërbejnë kapitalit.

Edhe revizionistët kinezë flasin ngandonjëherë për internacionalizmin proletar, por ata janë në pozita nacionaliste e shoviniste. Udhëheqësit kinezë janë nga ata që rrahin gjoksin dhe betohen «për perëndinë»

se janë për internacionalizmin proletar, janë për paqen, se janë për luftërat e proletariatit dhe për rivendikimet e tij, por në praktikë lidhin duart dhe nuk lëshojnë veçse fraza mashtruese për të shkaktuar përçarjen e forcave revolucionare.

Detyra e rëndësishme që qëndron përpara partive marksiste-leniniste, është forcimi i internacionalizmit proletar, i cili duhet të zhvillohet ndërmjet gjithë partive, të mëdha ose të vogla, të vjetra ose të reja qofshin. Të gjitha këto duhet të forcojnë unitetin në mes tyre dhe të bashkërendojnë veprimet politike, ideologjike dhe luftarake.

Duke theksuar këtë vijë të rëndësishme, që është një detyrë primordiale e partive marksiste-leniniste për të goditur frontalisht kapitalizmin botëror, politikën e tij skllavëruese, si dhe intrigat, djallëzitë dhe aleancat e tij me revizionizmin modern sovjetik, titist, kinez, italian, francez, spanjoll e të tjerë, ato do të krijojnë një front të fuqishëm që do të bëhet çdo ditë e më i pathyeshëm. Në qoftë se ato veprojnë në unitet dhe godasin të gjitha së bashku forcat e reaksionit, në qoftë se demaskojnë të gjitha intrigat që bëjnë në mënyra të ndryshme kapitalizmi dhe revizionizmi modern për të shuar revolucionin, për të shuar luftën klasore, fitorja e tyre do të jetë e sigurt.

Ne, marksistë-leninistët, duhet të luftojmë dhe t'u bëjmë thirrje punëtorëve, kudo që janë, të ngrihen në këmbë kundër armiqve të tyre shekullorë dhe të këputin zinxhirët, të bëjnë revolucionin e të mos u nënshtrohen monopoleve dhe kapitalistëve, siç pre-

dikojnë revizionistët modernë. Detyra e marksistë-leninistëve, e revolucionarëve të vërtetë është t'u bëjnë thirrje proletarëve e popujve të ngrihen për botën e re, për botën e tyre, për botën socialiste.

## PJESA E DYTE

### I

#### TEORIA E «TRI BOTËVE» — TEORI KUNDËRREVOLUCIONARE DHE SHOVINISTE

Sot kundër teorisë dhe strategjisë leniniste të revolucionit e të luftës çlirimtare të popujve kanë dalë hapur dhe luftojnë në front të gjerë edhe revizionistët kinezë. Kësaj teorie e strategjie të lavdishme shkencore ata përpiqen t'i kundërvënë teorinë e tyre të «tri botëve», që është një teori false, kundërrevolucionare e shoviniste.

Teoria e «tri botëve» bie në kundërshtim me teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, ose më saktë, ajo është një mohim i teorisë së tyre. Nuk ka rëndësi të dihet se kush e ka shpikur i pari termin «botë e tretë», kush e ka ndarë i pari botën në tri pjesë, por është e sigurt se Lenini nuk e ka bërë një ndarje të tillë, ndërsa Partia Komuniste e Kinës reklamon atësinë e saj dhe thotë se teorinë e «tri botëve» e ka shpikur Mao Ce Duni. Në qoftë se është ky autori që e ka formuluar për herë të parë këtë të ashtuquajtur teori, kjo është një tjetër dëshmi se Mao Ce Duni nuk

është marksist. Por edhe vetëm sikur ta ketë adoptuar këtë teori nga të tjerët, edhe kaq mjafton për të mos qenë marksist.

## Koncepti mbi «tri botët» — mohim i marksizëm-leninizmit

Nocioni i ekzistencës ose i ndarjes më trish të botës bazohet në një botëkuptim racist e metafizik, që është pjellë e kapitalizmit botëror dhe e reaksionit.

Por teza raciste që i vendos vendet në tri shkallë ose në tri «botë» nuk bazohet thjesht në ngjyrën e lëkurës. Ajo bën një klasifikim që vë në themel nivelin e zhvillimit ekonomik të vendeve dhe synon të përcaktojë «racën e zotërinjve të mëdhenj», nga njëra anë, dhe «racën e pariave e të plebës», nga ana tjetër, të krijojë një ndarje të palëvizshme dhe metafizike, siç i intereson borgjezisë kapitaliste. Kjo i konsideron kombet e popujt e ndryshëm të botës si një kopë dhensh, si një tërësi amorge.

Revizionistët kinezë e pranojnë dhe predikojnë që «raca e zotërinjve» të ruhet dhe «raca e pariave dhe e plebës» t'i shërbejë me urtësi e devocion së parës.

Dialektika marksiste-leniniste na mëson se zhvillimi nuk ka kurrë kufi, se asgjë nuk mbaron së ndryshuari. Në këtë proces të pandërprerë zhvillimi drejt së ardhmes kryhen ndryshime në sasi e në cilësi. Epoka jonë, si çdo epokë tjetër, karakterizohet nga kontradiktatë të thella, të cilat i kanë përcaktuar atë qartë Mar-

ksi, Engelsi, Lenini e Stalini. Ajo është epoka e imperializmit dhe e revolucioneve proletare, pra, epoka e shndërrimeve të mëdha sasiore dhe cilësore, që çojnë në revolucion dhe në marrjen e pushtetit nga klasa punëtore, për të ndërtuar shoqërinë e re socialiste.

E gjithë teoria e Marksit është bazuar në luftën e klasave dhe në materializmin dialektik e historik. Marksi ka vërtetuar se shoqëria kapitaliste është një shoqëri me klasa shfrytëzuesë dhe të shfrytëzuara, se klasat do të zhduken vetëm kur të arrihet në shoqërinë pa klasa, në komunizëm.

Aktualisht ne jetojmë në stadin e shembjes së imperializmit dhe të fitores së revolucioneve proletare. Kjo do të thotë se në shoqërinë e sotme kapitaliste ekzistojnë dy klasa kryesore, proletariati dhe borgjezia, që janë në luftë të papajtueshme për jetë a për vdekje me njëra-tjetrën. Kush do të fitojë prej tyre? Marksi dhe Lenini, shkenca marksiste-leniniste, teoria dhe praktika e revolucionit na vërtetojnë e na bindin se, në fund të fundit, do të fitojë proletariati, i cili do ta shkatërrojë, do ta përmbysë pushtetin e borgjezisë, imperializmin, gjithë shfrytëzuesit dhe do të ndërtojë një shoqëri të re, shoqërinë socialiste. Ata na mësojnë, gjithashtu, se edhe në këtë shoqëri të re do të ekzistojnë për një kohë shumë të gjatë klasat: klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse, që janë në aleancë të ngushtë me njëra-tjetrën, por do të ekzistojnë edhe mbeturina të klasave të përmbysura e të shpronësuar. Gjatë gjithë kësaj periudhe, këto mbeturina, si dhe elementët që degjencerojnë e i kundërvihen ndërtimit socialist, do të përpiqen të rimarrin fuqinë e humbur.

Pra edhe në socializëm do të ekzistojë e ashpër lufta e klasave.

Marksistë-leninistët mbajnë kurdoherë parasysh se në të gjitha vendet, me përjashtim të atyre ku ka triumfuar revolucioni dhe është vendosur rendi socialist, ekzistojnë klasat e varfra, me proletariatin në krye dhe klasat e pasura, me borgjezinë në krye.

Në çdo shtet kapitalist, kudo që ndodhet, qoftë ky edhe demokratik ose progresist, ka të shtypur dhe shtypës, ka të shfrytëzuar dhe shfrytëzues, ka antagonizma, ka luftë të pamëshirshme klasore. Intensiteti i ndryshëm i kësaj lufte nuk e ndryshon këtë realitet. Kjo luftë kalon nëpër zigzage, por ajo ekziston dhe nuk mund të shuhet. Ajo ekziston kudo, ekziston në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, midis proletariatit dhe borgjezisë imperialiste, ekziston po ashtu në Bashkimin Sovjetik, ku u tradhtua marksizëm-leninizmi dhe u krijua një klasë e re borgjezo-kapitaliste, e cila shtyp punonjësit e këtij vendi. Klasat dhe lufta e klasave ekzistojnë edhe në «botën e dytë», si në Francë, në Angli, në Itali, në Gjermaninë Perëndimore, në Japoni. Ato ekzistojnë, gjithashtu, edhe në «botën e tretë», në Indi, në Zaire, në Burundi, në Pakistan, në Filipine etj.

Vetëm sipas teorisë së «tri botëve» të Mao Ce Dunit nuk ekzistojnë në asnjë vend klasat dhe lufta e klasave. Ajo nuk i sheh këto, pse i gjykon vendet e popujt sipas koncepteve borgjeze gjeopolitike dhe shkallës së zhvillimit të tyre ekonomik.

Ta shikosh botën të ndarë më trish, në «botë të parë», «botë të dytë» dhe «botë të tretë», jo në prizmin



klasor, siç bëjnë revizionistët kinezë, do të thotë të devijosh nga teoria marksiste-leniniste e luftës klasore, do të thotë të mohosh luftën e proletariatit kundër borgjezisë për të kaluar nga një shoqëri e prapambetur në një shoqëri të re, në shoqërinë socialiste dhe më vonë në shoqërinë pa klasa, në shoqërinë komuniste. Tashmë botën më trish do të thotë të mos i njohësh karakteristikat e epokës, të pengosh proletariatin dhe popujt që të ecin drejt revolucionit dhe çlirimit kombëtar, të pengosh luftën e tyre kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër kapitalit dhe reaksionit në çdo vend e në çdo skaj. Teoria e «tri botëve» predikon paqen shoqërore, pajtimin klasor, ajo përpiqet të krijojë aleanca midis armiqve të papajtueshëm, midis proletariatit e borgjezisë, të shtypurve dhe shtypësve, popujve dhe imperializmit. Ajo përpiqet që t'i zgjatet jeta botës së vjetër, botës kapitaliste dhe ta mbajë gjallë atë pikërisht duke kërkuar shuarjen e luftës së klasave.

Por lufta e klasave, lufta e proletariatit dhe e aleatëve të tij për të marrë fuqinë dhe lufta e borgjezisë për të ruajtur pushtetin e vet nuk mund të shuhen kurrë. Këtë nuk e luan topi, këtë nuk e ndryshojnë as teorizimet boshe mbi «botërat»: «bota e parë», «bota e dytë», «bota e tretë», «bota e paangazhuar» ose «bota e njëzetë». Të pranosh një ndarje të tillë do të thotë të heqësh dorë dhe të braktisësh teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit mbi klasat e luftën e klasave.

**Lenini dhe Stalini, pas fitores së Revolucionit të**

Tetorit, kanë thënë se në kohën tonë ekzistojnë dy botë: bota socialiste dhe bota kapitaliste, megjithëse socializmi atëherë ishte vendosur vetëm në një vend.

*«... tani në botë — shkruante Lenini në vitin 1921 — ka dy botë: bota e vjetër — kapitalizmi, i cili është zhytur në konfuzion, i cili nuk do të tërhiqet kurrë, dhe bota e re që pritet, e cila është akoma shumë e dobët, por e cila do të rritet, sepse ajo është e pathyeshme»<sup>1</sup>.*

Ky kriter klasor mbi ndarjen e botës është i vlefshëm edhe për sot, pavarësisht se socializmi nuk ka fituar në shumë vende dhe shoqëria e re s'e ka zëvendësuar shoqërinë e vjetër borgjezo-kapitaliste. Një gjë e tillë do të ndodhë me doemos nesër.

Fakti që në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera ish-socialiste u tradhtua socializmi, nuk e lëviz asnjë grimë kriterin leninist mbi ndarjen e botës. Si më parë, ashtu edhe tani, ekzistojnë vetëm dy botë dhe lufta midis këtyre dy botëve, midis dy klasave antagonistë, midis socializmit dhe kapitalizmit, ekziston jo vetëm në shkallë kombëtare, por edhe ndërkombëtare.

Revizionistët kinezë, të cilët nuk pranojnë ekzistencën e botës socialiste nën pretekstin se nuk ekziston më kampi socialist, për arsye se Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera ish-socialiste tradhtuan, me qëllim injorojnë një gjë, se dalja në dritë e revizionizmit modern nuk e ndryshon aspak tendencën e përgjithshme të historisë drejt revolucionit, drejt shembjes së im-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 153-154.

perializmit, pavarësisht se kapitalizmi vazhdon të ekzistojë akoma. Në të njëjtën kohë ata injorojnë faktin se ekzistojnë, zhvillohen dhe fitojnë idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ekzistojnë partitë marksiste-leniniste, ekziston Shqipëria socialiste, ekzistojnë popujt që luftojnë për lirinë, për pavarësinë dhe për sovranitetin e tyre kombëtar, ekziston dhe lufton proletariati botëror.

Komuna e Parisit nuk fitoi, ajo u shtyp, por i dha proletarietit botëror një shembull të madh. Marksi ka thënë se eksperiencia e saj vërtetoi dobësinë për një kohë të proletarietit francez, mirëpo ajo përgatiti proletariatin e të gjitha vendeve për revolucionin botëror dhe dha një mësim të madh se ç'kushte nevojiten që të arrihet fitorja. Këtë eksperiencë të madhe të komunarëve «që sulmuan qiejt», Marksi e ngriti në teori dhe e mësoi proletariatin se ai duhet të thyejë me violencë revolucionare aparatit e shtetit borgjez dhe diktaturën e tij.

Revizionistët modernë janë frikamanë. Ata mendojnë se forcat kundërrevolucionare janë sot shumë të fuqishme. Por kjo nuk është aspak e vërtetë. Ato janë më të dobëta. Popujt, me proletariatin në krye, janë më të fortë. Këta do t'i shtypin forcat kundërrevolucionare, forcat e reaksionit, të imperializmit dhe të socialimperializmit. Kjo është një pikëpamje e bazuar në analizën klasore të botës. Çdo pikëpamje tjetër është e gabuar, pavarësisht se veprimtaria dhe frika e revizionistëve maskohen me fraza revolucionare.

Kur ne, marksistë-leninistët, themi se ekzistojnë dy dhe jo tri e pesë botë, jemi në rrugë të drejtë dhe

në bazë të marksizëm-leninizmit duhet ta ndërtojme luftën tonë kundër borgjezisë kapitaliste, kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, kundër imperializmave të tjerë. Kjo luftë duhet të çojë në shkatërrimin e botës së vjetër borgjezo-kapitaliste dhe në vendosjen e rendit të ri socialist.

**Forca lëvizëse shoqërore e epokës sonë është proletariati. Lenini ka theksuar se forcën lëvizëse që çon përpara historinë e përfaqëson ajo klasë që qëndron.**

*«...në qendrën e kësaj ose të asaj epoke, duke përcaktuar brendinë e saj kryesore, drejtimin kryesor të zhvillimit të saj, veçoritë kryesore të kushteve historike të kësaj epoke të caktuar etj.»<sup>1</sup>.*

Kurse revizionistët kinezë, në kundërshtim me këtë tezë të Leninit, përpiqen që «botën e tretë» ta konsiderojnë si «forcën e madhe lëvizëse që çon përpara rrotën e historisë». Të deklarosh një gjë të tillë do të thotë të japësh një përcaktim teorikisht e praktikisht të gabuar mbi forcën lëvizëse. Si mundet që në epokën e zhvillimit të sotëm shoqëror, e cila ka në qendër klasën më revolucionare — proletariatin, të quhet forcë lëvizëse një grupim shtetesh ku, në pjesën dërrmuëse, sundojnë borgjezia e feudalët, bile edhe reaksionarë e fashistë të hapët? Ky është një shtrembërim trashanik i teorisë së Marksit.

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 21, f. 147.

Udhëheqja kineze nuk mban parasysh se në «botën e tretë» ekzistojnë të shtypur dhe shtypës, ekzistojnë proletariat e fshatarësi e skllavëruar, e varfër dhe e mjeruar, nga njëra anë, dhe kapitalistë e çifligarë, që shfrytëzojnë e rrjepin popullin, nga ana tjetër. Të mos e vësh në dukje këtë situatë klasore në të ashtuquajturën botë e tretë, të mos vësh në dukje antagonizmat që ekzistojnë, kjo do të thotë të revizionosh marksizëm-leninizmin dhe të mbrosh kapitalizmin. Në të gjitha vendet e të ashtuquajturës botë e tretë, në përgjithësi, në fuqi është borgjezia kapitaliste. Kjo borgjezi shfrytëzon vendin, shfrytëzon e shtyp popullin e varfër për interesin e klasës së vet, për të nxjerrë fitime sa më të mëdha për vete dhe për ta mbajtur popullin vazhdimisht skllav e në mjerim.

Në shumë vende të «botës së tretë» qeveritë në fuqi janë borgjeze, kapitaliste, natyrisht me nuanca të ndryshme politike, janë qeveri të klasës armike të proletariatit dhe të fshatarësisë së varfër e të shtypur, armike të revolucionit dhe të luftërave çlirimtare. Borgjezia, që ka pushtetin në këto vende, ruan pikërisht atë shoqëri kapitaliste, të cilën proletariati në aleancë me shtresat e varfra të fshatit dhe të qytetit kërkon ta rrëzojë. Ajo përbën atë klasë të lartë, e cila, duke u nisur nga interesat e saj të ngushtë, është e gatshme, në çdo moment, në çdo kthesë, të shesë te kapitalizmi i huaj pasuritë e vendit, të mbitokës dhe të nëntokës, të shesë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut. Kjo klasë, kudo që është në fuqi, është në kundërshtim me luftën dhe me aspiratat e proleta-

riatit dhe të aleatëve të tij, klasave dhe shtresave të shtypura.

Shumë prej shteteve që udhëheqja kineze i fut në «botën e tretë» nuk janë kundër imperializmit amerikan dhe kundër socialimperializmit sovjetik. T'i quash të tilla shtete «forca kryesore lëvizëse e revolucionit dhe e luftës kundër imperializmit», siç predikon Mao Ce Duni, është një gabim aq i madh, sa edhe mali i Himalajës. Ka edhe të tjerë pseudomarksistë, por të paktën ata dinë të fshihen dhe të maskohen prapa teorie të tyre borgjeze.

Të njëjtin vizion antimarksist kanë revizionistët kinezë jo vetëm për «botën e tretë», por edhe për atë që ata e quajnë «botë e dytë», ku sundon borgjezia e madhe kapitaliste, ku sundojnë imperialistët e mëdhenj të djeshëm e që kanë mbetur përsëri imperialistë. Në vendet e kësaj të ashtuquajture botë e dytë ekziston një proletariat i madh e i fuqishëm që shfrytëzohet deri në palcë, që shtypet nga ligjet dërrmuese, nga ushtria, nga policia, nga sindikatat, nga të gjitha këto armë të diktaturës së borgjezisë. Si në vendet e «botës së tretë», ashtu edhe në ato të «botës së dytë», është klasa borgjeze kapitaliste, janë të njëjtat forca shoqërore që sundojnë mbi proletariatin e mbi popujt dhe që duhen shkatërruar. Forca kryesore lëvizëse edhe këtu është proletariati.

Kurse revizionistët kinezë, ashtu si në «botën e tretë», edhe në «botën e dytë», si edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në Bashkimin Sovjetik, injorojnë pikërisht proletariatin, i cili përfaqëson ushtrinë e madhe të revolucionit, ata mohojnë pikërisht forcën

kryesore lëvizëse të shoqërisë, atë forcë që duhet të godasë borgjezinë monopoliste, armikun klasor të saj dhe të mbarë revolucionit botëror.

Teoria e «tri botëve» e Mao Ce Dunit e mohon këtë realitet të madh dhe proletariatin evropian e të vendeve të tjera të zhvilluara e dekonsideron. Është e vërtetë se në radhët e proletariatit, goftë të botës së ashtuquajtur të tretë, goftë të botës së ashtuquajtur të dytë e të parë, ka edhe degjenerim, pse borgjezia nuk rri duarlidhur, ajo lufton kundër armikut të vet jo vetëm me armë e me shtypje, por edhe politikisht e ideologjikisht, me mënyrën e jetesës që krijon etj. Por fakti që degjeneron ndonjë shtresë e proletariatit, siç është aristokracia punëtore, nuk mund të bëjë që të hiqet dorë nga marksizëm-leninizmi dhe të mohohet roli vendimtar i klasës punëtore në procesin revolucionar botëror. Me edukimin e drejtë marksist-leninist, me veprimtarinë e përditshme revolucionare komuniste e vërtetë e ruajnë proletariatin e çdo vendi dhe të çdo «bote» nga degjenerimi dhe e mobilizojnë atë për luftë kundër shtypësve së tij, qofshin këta anglezë ose francezë, italianë ose gjermanë, portugezë ose spanjollë, amerikanë ose japonezë e të tjerë.

Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë koka e imperializmit botëror, okziston një proletariat i madh. Duke qenë një nga vendet më të industrializuara të botës, ato janë në të njëjtën kohë vendi më i pasur, kështu që thërrimet e kapitalit për të gënjyer proletariatin janë një çikë më të mëdha se në vendet e tjera borgjeze. Mënyra e jetesës në Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës ushtron një influencë më të madhe mbi proletariatin, por ne nuk mund ta hedhim poshtë, qoftë edhe një grimë, rolin e kontributin e proletariatit amerikan për revolucionin në vendin e tij. Në fakt, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekziston një opinion kundër imperializmit, kundër luftërave grabitqare, kundër shtypjes së kapitalistëve, të trusteeve, të bankave etj. Ka në këtë vend, bile edhe në shtresat e borgjezisë së vogël, një rezistencë kundër shtypjes së kapitalit të madh.

Teoria kincze e «tri botëve», duke mohuar luftën e klasave, mohon edhe luftën e popujve për t'u çliruar nga sundimi i huaj, për të fituar të drejtat e liritë demokratike, mohon luftën e tyre për socializmin. Kjo teori kundërrevolucionare e antishkencore i vë kryq luftës së popujve kundër armiqve të tij, që janë imperializmi, socialimperializmi, tërë borgjezia e madhe ndërkombëtare.

T'i futësh popujt në «tre dollapë» dhe të predikosh që vetëm «bota e tretë» aspiron çlirimin nga imperializmi, se vetëm ajo qenka «forca kryesore lëvizëse kundër imperializmit», është një mashtrim dhe një devijim flagrant nga marksizëm-leninizmi. Po të jetë se në «botën e parë» e në «botën e dytë» futen imperialistët dhe kapitalistët, atëherë lind pyetja: Ku futen popujt e këtyre «dy botëve», të cilët luftojnë, gjithashtu, për çlirimin e vet kundër po atyre shtypësve që shtypin edhe «botën e tretë»? Kësaj pyetjeje nuk i përgjigjen dot shpikësit dhe partizanët e ndarjes së botës më trish, sepse ata, sipas konceptit të



tyre antimarksist dhe antileninist, i shkrijnë në një imperialistët, sundimtarët dhe popujt.

Marksistë-leninistët nuk mund t'i identifikojnë popujt sovjetikë me bataqinjtë antimarksistë, social-imperialistë dhe kapitalistë të rinj që sundojnë mbi ta. Po ashtu nuk mund të përziejnë e të ngatërrojnë popullin amerikan me imperializmin amerikan. Në qoftë se do të vepronin ashtu siç bëjnë revizionistët kinezë, atëherë revolucionarët do të bënin një gabim të madh teorik dhe do të viheshin kundër revolucionit, do të mbështetnin pikërisht imperializmin dhe socialimperializmin, forcat e kapitalit, kundër të cilave luftojnë edhe proletariati dhe populli brenda strofkës së armiqve të tyre.

Ç'kuptim ka thirrja kineze që «bota e tretë», në aleancë me «botën e dytë», të bashkohen për të luftuar gjysmën e «botës së parë», kur një ndarje e tillë e botës konfondon personalitetin e popujve, aspiratat dhe zhvillimin e tyre, që janë të ndryshme dhe në luftë me oligarkinë që i shtyp? Shkalla e rezistencës dhe e luftës revolucionare të popujve është po ashtu e ndryshme, por qëllimi i fundit i tyre, komunizmi, është i njëjtë. Në këto kushte ne, marksistë-leninistët, duhet të propagandojmë dhe të mobilizohemi që, nëpërmjet luftërave klasore të vazhdueshme kundër imperializmit, socialimperializmit, kapitalizmit dhe ideologjive të tyre mashtruese, të arrijmë qëllimin final.

Revizionistët kinezë shkrijnë e bashkojnë në një jo vetëm popujt me sundimtarët në vendet kapitaliste, por ata duan të likuidojnë edhe personalitetin e ven-

deve socialiste, kur predikojnë se edhe këto vende mund të futen në «botën e tretë».

Si mund të identifikohet një vend socialist me «botën e tretë», ku ekzistojnë klasat antagonistë, shtypja e shfrytëzimi dhe të vihet në një radhë «me mbretër dhe me princër», siç e pohojnë udhëheqësit kinezë? Revizionistët kinezë, që e quajnë vendin e tyre socialist, thonë se hyjnë në «botën e tretë» gjoja për të ndihmuar popujt e kësaj «bote». Ky është një mashtrim, me anën e të cilit ata duan të fshehin qëllimin e tyre ekspansionist. Për të ndihmuar e për të përkrahur luftën e popujve, një vend i vërtetë socialist nuk ka nevojë ta ndajë botën më trish, as të futet në «botën e tretë».

Me qëndrimet tona, duke u udhëhequr nga kritere klasore, ne, marksistë-leninistët, ndihmojmë popujt, proletariatin, demokracinë, sovranitetin dhe lirinë e vërtetë dhe jo shtetin ku sundojnë mbretërit, shahët dhe klikat reaksionare. Ne ndihmojmë ata popuj dhe ato shtete demokratike që duan të çlirohen nga zgjedha e superfuqive, por theksojmë se kjo nuk mund të bëhet si duhet dhe në rrugën e drejtë e me kritere klasore, në rast se nuk luftohen edhe mbretërit, edhe monopolet ndërkombëtare që janë pleksur me superfuqitë. Udhëheqësit kinezë pretendojnë se e kanë zgjidhur këtë problem klasor të koklavitur «duke u shkri-rë» në këtë «botë të tretë» fantaziste. Por kjo është një zgjidhje antimarksiste. Shtetet e qeveritë e «botës së tretë», në shumicën e tyre, nuk janë, ashtu siç pretendojnë udhëheqësit kinezë, për luftën kundër «botës së parë», ose «të dytë», as për luftën kundër

imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik.

Korrenti i popujve të botës ecën drejt luftës për çlirim, për revolucion, për socializëm, por në këtë korrent nuk përfshihen qeveritë e mbretërve, të emirëve dhe të klikave reaksionare të tipit të Mobutus e të Pinoçetit të «botës së tretë», ku edhe Kina e ka futur veten.

Lidhur me shtetet e të ashtuquajturës botë e tretë udhëheqja kineze nuk bën dallimin klasor, sipas parimeve të internacionalizmit proletar dhe të interesave të revolucionit botëror. Ajo nuk mban parasysh faktin se këto shtete kombëtare, që në shumicën e tyre udhëhiqen nga shtresat e borgjezisë së lartë, janë nën ndikimin dhe lidhen ngushtë me shumë fije me imperializmin amerikan, por edhe me socialimperializmin sovjetik.

Në këto shtete ekzistojnë kontradikta të thella të brendshme në mes proletariatit dhe fshatarësisë së varfër e të shtypur, nga njëra anë, dhe borgjezisë e gjithë skllavëruesve, nga ana tjetër. Ndihma që u jep popujve të këtyre shteteve një vend socialist, duhet të jetë një stimul i madh për ecjen e tyre përpara, për të arritur në krijimin e një shteti demokratik të vërtetë, pa errësuar perspektivën, çështjen e fitores së revolucionit proletar dhe të marrjes së pushtetit nga ana e proletariatit. Revolucioni nuk importohet, ai do të kryhet nga proletariati dhe populli i secilit vend. Natyrisht, marrja e pushtetit nuk do të bëhet sot me nesër, por duhen krijuar ato kushte, siç na mëson Lenini, që në çdo kthesë të historisë proletariati të gjendet në ballë të luftës për të rrëzuar pushtetin e

degjeneruar të diktatorëve e të borgjezisë reaksionare dhe të vendosë sundimin e popullit.

Ndarja që i bëjmë ne, komunistët, botës së sotme, duke u bazuar në kriterin klasor leninist, nuk na pengon të luftojmë superfuqitë dhe të përkrahim të gjithë popujt e shtetet që kërkojnë çlirim e që kanë kontradikta me superfuqitë. Shqipëria socialiste e ka përkrahur me gjithë zëmër dhe fuqimisht luftën e popujve të Azisë, Afrikës, Amerikës Latine, pse ajo u përgjigjet interesave të vetë atyre dhe drejtohet kundër imperializmit e sundimit të huaj kolonial. Por, të fshehësh parimet dhe të shtrembërosh marksizëm-leninizmin, ideologjinë e politikën e partisë së proletariatit, siç predikojnë udhëheqësit kinezë, kjo është antimarkiste, ky është një bluf, një mashtrim. Partia e Punës e Shqipërisë s'e ka bërë dhe s'do ta bëjë kurrë një gjë të tillë, pse do të ishte një krim i pafalshëm ndaj popullit të saj, ndaj popujve të tjerë, ndaj proletariatit ndërkombëtar dhe revolucionit botëror.

**Ndarja e botës më trish që bën Partia Komuniste e Kinës, predikon pajtimin klasor.**

Marksistë-leninistët e vërtetë nuk i harrojnë kurrë mësimet e Leninit, i cili thekson se oportunistët dhe revizionistët përpiqen si e si të zbutin luftën e klasave, të gënjejnë klasën punëtore dhe njerëzit e shtypur me formula «revolucionare», duke e zbrazur doktrinën marksiste-leniniste nga përmbajtja revolucionare. Këtë gjë bën edhe udhëheqja revizioniste kineze, kur predikon pajtimin dhe bashkëjetesën në paqe të klasës punëtore me borgjezinë.

Kontradiktat midis klasave ose forcave shoqërore me interesa themelore të kundërt, siç na mësojnë Engelsi dhe Lenini, jo vetëm nuk mund të pajtohen, por ato ashpërsohen vazhdimisht dhe përfundojnë në konflikte politiko-shoqërore. Vetë ekzistenca e shtetit provon që antagonizmat e klasave janë të papajtueshëm. Prandaj, të përpiqesh t'i zbutësh këta antagonizma klasorë, që vihen re në vende të ndryshme borgjeze e revizioniste të «botës së tretë», «të dytë» ose «të parë», duke predikuar bashkim pa princip, do të thotë të mohosh karakterin objektiv të ekzistencës së kontradiktave, ta trajtosh këtë problem në mënyrë antimarksiste.

«Teoricienët» kinezë orvaten të pajtojnë klasa që kurrë nuk mund të pajtohen, gjë që do të thotë se ata janë në pozita revizioniste, oportuniste. Deformimi i teorisë së Marksit nga ana e revizionistëve kinezë duket qartë kur ata i konsiderojnë vendet që futin në «botën e tretë» si vende ku mbretëron paqja klasore dhe shtetin e tyre si organizëm të pajtimit klasor.

Të pranosh nocionin e «botës së tretë», të atillë siç e reklamojnë udhëheqësit kinezë, do të thotë të punosh për të krijuar një opinion që të shërbejë për të mbrojtur ata organizma shtetërorë që i nevojiten borgjezisë për të shtypur klasën punëtore dhe masat e popullit. Teza e zbutjes së luftës së klasave, siç thoshte Lenini kur sulmonte revizionistët, legalizon dhe afirmon shtypjen. Të kërkosh unitetin brenda «botës së tretë» do të thotë të kërkosh në fakt unitetin e klasës së shtypur me klasën shtypëse, pra, të përpiqesh të zbutësh antagonizmat midis masave punonjëse dhe

borgjezisë, midis popullit dhe shtypësve të huaj. Këto predikime të revizionistëve kinezë janë në kundërshtim me interesat e çlirimit kombëtar e shoqëror të popujve, me aspiratat e tyre për liri, pavarësi e drejtësi shoqërore.

Shumica e shteteve, që gjoja formojnë «botën e tretë» ose «të paangazhuar», janë të varura nga kapitali i huaj financiar, i cili është aq i fortë, aq i gjerë, sa ka një peshë vendimtare në gjithë jetën e tyre. Këto shtete nuk gëzojnë pavarësi të plotë, përkundrazi, janë të varura nga ky kapital i madh financiar, i cili bën atë politikë dhe përhap atë ideologji që justifikon shfrytëzimin e popujve.

Borgjezia dhe imperializmi bëjnë përpjekje të mëdha për ta fshehur këtë realitet dhe, kur demaskohen, krijojnë «teorira» të ndryshme kundër pavarësisë e sovranitetit të shteteve. Teoricienët borgjezë e revizionistë, me qëllim që të shuajnë aspiratat e popujve për liri, pavarësi e sovranitet, i paraqesin këto aspirata si «anakronike», u japin këtyre interpretime të ndryshme metafizike dhe u kundërvënë parullën e «ndërvarësisë botërore», që gjoja shpreh tendencat e zhvillimit aktual të shoqërisë njerëzore, ose parullën e «sovranitetit të kufizuar», që gjoja shpreh interesat më të lartë të së ashtuquajturës bashkësi socialiste etj.

Realiteti borgjezo-revizionist i shkeljes së lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të kombeve dhe të shteteve, në të gjitha format dhe në të gjitha drejtimet, tregon kalbëzimin e sistemit kapitalist. Ne jetojmë në një epokë kur borgjezia si klasë sunduese po humbet terren, kurse proletariati botëror është bërë një forcë

kolosale dhe ka hyrë në luftë të pandërprerë, të pamëshirshme për të hequr qafe atë klasë që e shfrytëzon. Borgjezia, nën goditjet e popujve e të luftës klasore të proletariatit, u detyrua të heqë dorë *de jure* nga kolonializmi dhe t'u njohë, formalisht, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin shumë vendeve, të cilat, për një kohë të gjatë, i kishte pushtuar dhe shfrytëzuar deri në palcë.

Por liria, pavarësia e sovraniteti, të njohur juridikisht nga shtetet kapitaliste për ish-kolonitë e tyre, sot e kësaj dite për shumë vende kanë mbetur formalë, sepse kapitalistët dhe imperialistët përsëri sundojnë atje në forma të reja. Për të zgjatur sundimin në ish-kolonitë, këto forca regresive të kohës sonë praktikojnë në masë të gjerë komplotet dhe intrigat për të përçarë e për të sunduar, që gjejnë terren akoma në këto vende, duke shfrytëzuar prapambetjen ekonomike, politike e ideologjike të popujve dhe mungesën e organizimit të forcave revolucionare.

Në trajtimin e këtij problemi nuk duhet menduar se, meqë vendet ish-koloniale nuk kanë fituar ende pavarësinë dhe sovranitetin e plotë, atëherë lufta e tyre ka qenë e padobishme. Në asnjë mënyrë. Lufta e popujve për emancipimin e vendeve të tyre të vogla nga diktati dhe tutela e të mëdhenjve, e imperializmit dhe e socialimperializmit, nuk duhet nënvleftësuar. Përkundrazi, Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti shqiptar e kanë përkrahur e do ta përkrahin pa rezerva këtë luftë të drejtë revolucionare e çlirimtare, që e kanë konsideruar si një fitore të popujve për forcimin e pavarësisë politike, për shkëputjen nga sundimi kolonial

e neokolonial. Por ne jemi kundër atyre teoricienëve revizionistë që predikojnë se tani gjithë lufta revolucionare u dashka reduktuar në luftë për pavarësinë kombëtare, për ta fituar dhe për ta ruajtur këtë pavarësi nga agresioni i fuqive imperialiste, duke mohuar luftën për çlirimin shoqëror. Vetëm fitorja e kësaj lufte siguron edhe lirinë, pavarësinë e sovranitetin e plotë e të vërtetë kombëtar. Këta avokatë të rendit shfrytëzues «harrojnë» se lufta e klasave në mes proletariatit e aleatëve të tij, nga njëra anë, dhe borgjezisë së vendit e aleatëve të saj të jashtëm, nga ana tjetër, vazhdon gjithmonë e ashpër dhe se kjo do të çojë një ditë në ato momente, në ato situata revolucionare, siç i quan Lenini, kur revolucioni pëlçet. Kushtet gjithnjë më të favorshme që po krijohen në botë për zhvillimin e gjerë të revolucioneve antiimperialiste e demokratike dhe për udhëheqjen e tyre nga proletariati, duhen shfrytëzuar për të kaluar nga lufta për pavarësinë kombëtare në një fazë tjetër më të avancuar, në luftën për socializëm. Lenini na mëson se revolucioni duhet çuar deri në fund, duke likuiduar borgjezinë dhe pushtetin e saj. Vetëm mbi këtë bazë mund të bëhet fjalë për liri, pavarësi e sovranitet të vërtetë.

Sipas konceptit tonë marksist-leninist, në një shoqëri me klasa antagoniste ku sundon klasa feudale ose borgjeze, populli nuk mund të ketë liri e sovranitet. Liria, pavarësia dhe sovraniteti kanë përmbajtje politiko-shoqërore konkrete. Liria e sovraniteti i vërtetë e i plotë sigurohen në kushtet e diktaturës së proletariatit. Kurse atje ku shteti është në duart e klasës shfrytëzuese, marrëdhëniet ekonomike dhe politike të



pabarabarta midis shfrytëzuesve e të shfrytëzuarve dhe midis vendeve çojnë në humbjen ose në kufizimin e lirisë e të sovranitetit të popullit. Si rrjedhim, për vendet që inkuadrohen në «botën e paangazhuar» ose në «botën e tretë», nuk mund të flitet për liri e sovranitet të vërtetë kombëtar e aq më pak për sovranitet të popullit. Vetëm mbi bazën e një analize shkencore të mbështetur në teorinë marksiste-leniniste mund të përcaktohet drejt cili popull është me të vërtetë i lirë dhe cili i robëruar, cili shtet është i pavarur e sovran dhe cili është i varur dhe i shtypur. Teoria marksiste-leniniste shpjegon qartë se kush janë shtypësit dhe shfrytëzuesit e popujve dhe cila është rruga që popujt të bëhen të lirë, të pavarur e sovranë. Vetëm në këtë mënyrë, në dritën e marksizëm-leninizmit, i kuptojmë ne, komunistët shqiptarë, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e shteteve dhe të popujve.

### **Qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj kontradiktave është një qëndrim idealist, revizionist e kapitullant**

Zbatimi i një strategjie të drejtë revolucionare, të bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit, kërkon jo vetëm analizën dhe vlerësimin e gjithanshëm dialektik të forcave lëvizëse të rrymës revolucionare e çlirimtare botërore, vlerësimin e drejtë të forcave të armikut, me anët e forta dhe dobësitë e tyre, por edhe kuptimin e drejtë e shkencor të kontradiktave që karakterizojnë kohën tonë.

Në rast se kontradiktat do t'i interpretojmë sipas mësimëve të teorisë marksiste-leniniste, në lidhje me faktet konkrete dhe me zhvillimin e vërtetë të situatave, atëherë nuk do të gabojmë.

Udhëheqësit kinezë, lidhur me kontradiktat, «teorizojnë», «interpretojnë», «filozofojnë», parafrazojnë dhe ngatërrojnë shumë teza që i kanë thënë aq qartë klasikët e marksizëm-leninizmit. Duke i interpretuar kontradiktat ndryshe nga kuptimi i tyre i vërtetë, ata bien në marrëveshje dhe bëjnë kompromise, jo në favor të luftës çlirimtare, të popujve, të revolucionit, të ndërtimit të socializmit, por në favor të borgjezisë e të imperializmit. Këta, që e mbajnë veten si filozofë marksistë-leninistë, kanë dy maska: njërin për t'u paraqitur sikur janë në rregull me teorinë marksiste-leniniste dhe tjetrën për ta shtrembëruar atë në praktikë.

Qëndrimi i tyre, lidhur me kontradiktat, aleancat dhe kompromiset, rrjedh nga një analizë e shtrembër e pragmatiste që ata u bëjnë gjendjes ndërkombëtare, kontradiktave që ekzistojnë në botë, kontradiktave midis fuqive imperialiste, midis shteteve të ndryshme kapitaliste, midis proletariatit dhe borgjezisë etj. Ky qëndrim i ka rrënjët te botëkuptimi i tyre idealist e revizionist.

Por nxjerrja nga udhëheqësit kinezë në tryezë për diskutim pikërisht e problemit të kontradiktave, aleancave dhe të kompromiseve nuk është e rastit. Tani udhëheqja revizioniste kineze ka hequr maskat dhe ka dalë hapur kundër revolucionit, ajo është bërë flamurtare e oportunizmit të djathtë, e revizionizmit. Si të

gjithë revizionistët, edhe udhëheqësit e Partisë Komuniste të Kinës po bëjnë përpjekje që largimin nga teoria marksiste-leniniste, orientimin e tyre revizionist, «ta justifikojnë» duke përdorur citate të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Natyrisht, këto citate ata i cungojnë, i copëtojnë dhe i shkëputin nga konteksti dhe, ashtu të sakatuara, i përdorin për të shitur si marksiste-leniniste qëndrimet e tezat e tyre reaksionare. Por revizionistët kinezë nuk janë as të parët, as të fundit që i bëjnë këto shtrembërime, këto cungime dhe interpretime tendencioze të teorisë sonë të drejtë. Shumë kohë më parë se ata, veprime të kësaj natyre kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë krerët e socialdemokracisë, titistët, revizionistët sovjetikë, italianë, francezë e të tjerë.

**Në radhë të parë, duke xhongluar me kontradiktat, udhëheqësit kinezë mundohen të justifikojnë qëndrimin e tyre ndaj imperializmit amerikan, të sheshojnë rrugët e afrimit e të bashkëpunimit me të.**

Revizionistët kinezë pretendojnë se në botën e sotme ekzistoka vetëm një kontradiktë, që vë përballë «botën e tretë», «botën e dytë», dhe gjysmën e «botës së parë», me Bashkimin Sovjetik. Duke u nisur nga kjo tezë që bashkon popujt me një grup imperialistësh, ata predikojnë se duhen lënë mënjanë të gjitha kontradiktat klasore dhe duhet luftuar vetëm kundër socialimperializmit sovjetik.

Po le të analizojmë si qëndron çështja e kontradiktave midis popujve e superfuqive dhe e kontradiktave midis vetë superfuqive.

Në kushtet e sotme, në përcaktimin e një strategjie dhe taktike revolucionare konsekuente, rëndësi të dorës së parë merr qëndrimi parimor ndaj dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, të cilat përbëjnë forcën më të madhe të mbrojtjes së sistemit shtypës e shfrytëzues kapitalist, kështjellat kryesore të reaksionit botëror. Ato janë armiqtë e betuar e më të rrezikshëm të revolucionit, të socializmit e të popujve të mbarë botës, që kanë marrë përsipër rolin e urryer të xhandarit ndërkombëtar kundër çdo lëvizjeje revolucionare e çlirimtare dhe përfaqësojnë fuqitë më agresive e luftënxitëse, të cilat me veprimet e tyre e shtyjnë botën drejt një lufte shkatërruese.

Askush, dhe ca më pak Partia e Punës e Shqipërisë, nuk mund të mohojë ekzistencën e kontradiktave të thella midis dy fuqive më të mëdha imperialiste të kohës sonë — imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Ne kemi theksuar vazhdimisht se kontradiktat në mes dy superfuqive jo vetëm ekzistojnë, por edhe thellohen. Krahas kësaj, nga ana e superfuqive bëhen orvatje për të rënë në ujdi me njëra-tjetrën për disa çështje. Këtë fenomen Lenini e shpjegon me dy tendencat e kapitalit. Ai thoshte se

*«...ekzistojnë dy tendenca, njëra që e bën të pashmangshme aleancën e të gjithë imperialistëve, tjetra — që i vë disa imperialistë kundër të tjerëve...»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 27, f. 418.

Po përse ka kontradikta dhe antagonizma të papajtueshëm midis dy superfuqive? Për arsye se secila prej tyre, duke qenë fuqi e madhe imperialiste, lufton për hegjemoni botërore, për të krijuar sfera të reja influence, për skllavërimin e shfrytëzimin e popujve. Oreksi dhe lakmia që ka secila prej tyre i bën ato të ngacmohen, bile dhe të fërkohen rëndë. Ky fërkim mund të çojë në luftë midis tyre dhe në një luftë të përgjakshme botërore.

Ne, marksistë-leninistët, duhet t'i shfrytëzojmë në interes të revolucionit dhe të luftërave çlirimtare të popujve kontradiktat që ekzistojnë midis superfuqive.

Shfrytëzimi i kontradiktave në kampin armik është pjesë përbërëse e strategjisë dhe e taktikës revolucionare. Stalini shfrytëzimin e kontradiktave e të konflikteve në radhët e armiqve të klasës punëtore, brenda vendit apo midis shteteve imperialiste në arenën ndërkombëtare, e konsideronte si rezervë të tërthortë të revolucionit proletar. Janë fakte historike të njohura mbajtja parasysht dhe shfrytëzimi i kontradiktave ndërimperialiste nga shteti socialist sovjetik, nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit, në periudhën pas Revolucionit të Tetorit ose në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Por në çdo rast vlerësimi dhe shfrytëzimi i kontradiktave midis armiqve nga ana e forcave revolucionare dhe e vendeve socialiste janë rezultat i një analize konkrete marksiste-leniniste të këtyre kontradiktave e të shkallës së ashpërsimit të tyre, të raportit të forcave në një periudhë apo moment të dhënë, për të përcaktuar në ç'rrugë, në ç'formë e me çfarë mjetesh të shfrytëzohen këto kontradikta. Parimore është që

kurdoherë kontradiktat të shfrytëzohen në dobi të revolucionit, në dobi të popujve e të lirisë së tyre, në dobi të çështjes së socializmit. Shfrytëzimi i kontradiktave në radhët e armiqve duhet të çojë në rritjen dhe në fuqizimin e lëvizjes revolucionare e çlirimtare e jo në dobësimin e në zbehjen e saj, të çojë në një mobilizim gjithnjë më aktiv të forcave revolucionare në luftën kundër armiqve, e sidomos atyre më kryesorë, pa lejuar krijimin e kurrfarë iluzioneve ndaj tyre midis popujve.

Në pikën e parë të programit të tyre të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik revizionist, kanë shtypjen e revolucionit e të socializmit. Udhëheqësit kinezë jo vetëm nuk e theksojnë këtë fakt, që është shprehje e kontradiktës së papajtueshme midis socializmit e kapitalizmit, por praktikisht edhe e mohojnë atë. Marksistë-leninistëve, natyrisht, nuk u lejohet të harrojnë se, me gjithë luftën që bëjnë në mes tyre për hegjemoni, me gjithë kontradiktat që kanë, superfuqitë nuk e largojnë aspak vëmendjen nga qëllimi i përbashkët për shtypjen e popujve që kërkojnë liri, për sabotimin e revolucionit, gjë që çon përsëri në luftëra të përgjithshme ose lokale. Në këtë çështje revizionistët kinezë vazhdojnë të mbajnë pozicionet e tyre të njohura të luftës vetëm kundër socialimperializmit sovjetik, që, sipas tyre, është më i rrezikshmi, më agresivi dhe më luftëdashësi. Imperializmin amerikan ata e vënë në radhë të dytë dhe theksojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës «dëshirojnë statukuonë, se ato janë në rënie». Së këtejmi revizionistët kinezë arrijnë në konkluzionin se mund

të bëhet dhe duhet të bëhet aleancë me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik.

Imperializmi amerikan nuk është aspak i dobët e i zbutur, siç pretendojnë udhëheqësit kinezë, përkundrazi, ai është agresiv, i egër dhe i fuqishëm, sikurse edhe socialimperializmi sovjetik. Fakti që imperializmi amerikan nuk e ka më atë pozitë sunduese që ka pasur më parë, nuk ndryshon asgjë. Kjo është dialektika e zhvillimit të kapitalizmit dhe vërteton tezat e Leninit se imperializmi është kapitalizëm në rënie, në dekadencë. Por, duke u nisur që këtej, të arrihet sa të nënvleftësohet forca ekonomike, ushtarake dhe agresive aktuale e njërrës ose e tjetrës superfuqi, kjo është e palejueshme. Është gjithashtu e palejueshme që nga një dobësim dhe rënie faktike e fuqisë së imperialistëve të thuhet se njëri imperializëm është bërë më pak i rrezikshëm dhe tjetri është më i rrezikshëm. Të dyja superfuqitë imperialiste janë të rrezikshme, sepse që të dyja nuk e harrojnë luftën kundër atyre që kërkojnë t'u bëjnë varrin dhe ata që kërkojnë t'u bëjnë varrin superfuqive, janë popujt.

Të predikosh luftën vetëm kundër socialimperializmit sovjetik dhe të shuash, në fakt, luftën kundër imperializmit amerikan, siç bëjnë udhëheqësit kinezë, do të thotë të mos u përmbahesh tezave themelore të marksizëm-leninizmit. Që duhet luftuar deri në fund kundër socialimperializmit sovjetik, për këtë s'ka asnjë dyshim. Por të mos luftohet me të njëjtën forcë edhe kundër imperializmit amerikan, kjo është e papranueshme, kjo është një tradhti që i bëhet revolucionit. Në qoftë se ndiqet rruga kineze, atëherë nuk do të

jetë e qartë ç'është imperializmi amerikan dhe ç'është socialimperializmi sovjetik, përse këto dy superfuqi kanë kontradikta dhe ku konsistojnë këto kontradikta, ku qëndron lufta në mes tyre që në duhet ta thellojmë, ç'duhet të bëjmë që këto dy shtete imperialiste të mos shpërthejnë luftën botërore etj.

Në qoftë se i kuptojmë drejt teorikisht këto çështje dhe në qoftë se veprojmë drejt në bazë të teorisë marksiste-leniniste, atëherë del e qartë domosdoshmëria e përkrahjes dhe e mbështetjes së popujve që luftojnë kundër dy superfuqive dhe klikave borgjeze kapitaliste që sundojnë mbi ta. Bota kapitaliste po kalon sot nëpër një krizë të rëndë. Por kjo krizë duhet gjykuar në tërë madhësinë e saj dhe kontradiktat që ekzistojnë në botën kapitaliste gjithashtu duhen gjykuar në tërë thellësinë e tyre.

Logjika pragmatiste e antimarksiste i çon revizionistët kinezë ta paraqesin Bashkimin Sovjetik si një vend që zhvillohet pa kontradikta, si një imperializëm që sundon pa telashe mbi vendet e tjera revizioniste, si Polonia, Gjermania Lindore, Hungaria, Çekosllovakia, Rumania dhe Bullgaria. Ata bllokun sovjetik e paraqesin si një bllok në ngjitje, ndërsa Bashkimin Sovjetik si të vetmin imperializëm që ka mbetur në botë dhe kërkon të vendosë kudo hegjemoninë e tij.

Në qoftë se flasim për hegjemoninë e Bashkimit Sovjetik mbi vendet revizioniste të Evropës Lindore, ajo shprehet, në radhë të parë, në pushtimin ushtarak të këtyre vendeve nga ana e forcave të armatosura sovjetike, në grabitjen pa mëshirë dhe pa skrupull të pasurive të tyre nga ana e socialimperializmit sovjetik,



i cili përpiqet bile t'i integrojë plotësisht në sistemin e republikave sovjetike. Natyrisht, Bashkimi Sovjetik revizionist gjen kundërshtime në këto përpjekje. Këto kundërshtime dhe kontradikta, që në stanin revizionist ekzistojnë në mënyrë latente, do të vijë koha të acarohen më tej dhe të shpërthejnë.

Socialimperializmin sovjetik ne e kemi cilësuar agresiv, për arsye se ai sulmoi e pushtoi Çekoslllovakinë, sepse ka ndërhyrë në Afrikë e gjetkë dhe ka plane e përgatitet për agresione të tjera. Por mos vallë imperializmi amerikan ka bërë më pak agresione ose është më pak agresiv se socialimperializmi sovjetik?

Udhëheqja kineze e ka harruar agresionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Koresë, e ka harruar luftën e tyre të gjatë e barbare kundër Vietnamit, Kamboxhias e Laosit, e ka harruar luftën e tyre në Lindjen e Mesme, ndërhyrjen në republikat e Amerikës Qendrore etj. Të tëra këto ajo i ka fshirë nga defteri dhe na del me konkluzionin se imperializmi amerikan qenka zbutur! Ajo harron se imperializmi amerikan i ka hedhur kthetrat kudo, në të gjithë botën, ka krijuar kudo baza ushtarake, të cilat po i zhvillon e po i forcon. Këto i harruan Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, i harron udhëheqja revizioniste kineze, kur na thonë se imperializmi amerikan na qenka dobësuar e zbutur, prandaj mund të bëhet aleancë me të! Të veprosh kështu do të thotë të kërkosh të shuhet lufta kundër imperializmit në përgjithësi dhe kundër imperializmit amerikan në veçanti, bile edhe kundër socialimperializmit sovjetik, ndaj të cilit Kina reklamonte sikur lufton kaq shumë.

Është e vërtetë se socialimperializmi sovjetik ka një uri të madhe për ekspansion. Ndërhyrja e tij në Angola e në Etiopi, përpjekjet që po bën ai për të krijuar baza në detin Mesdhe e në disa vende arabe, për të zaptuar ngushticat e Detit të Kuq, ose për të krijuar baza ushtarake në Oqeanin Indian, të gjitha këto janë veprime të hapura imperialiste. Por këto pozita nuk janë të konsoliduara në atë masë, siç i ka konsoliduar imperializmi amerikan pozitën e tij ekonomike neokolonialiste, strategjiko-ushtarake në vendet e tjera. Pikërisht këtë situatë udhëheqja kineze, në dukje, e nënvleftëson, por në realitet ajo e njeh dhe e mbështet.

Në të njëjtën kohë revizionistët kinezë nuk mund të mos gjejnë se, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në mes shteteve kapitaliste të Evropës Perëndimore dhe imperializmit amerikan, këta janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, janë të lidhur me alcanca politike, ushtarake dhe ekonomike, siç janë NATO-ja, Tregu i Përbashkët etj. Nuk është e mundur të mos e dijë udhëheqja kineze se kapitali amerikan ka hyrë thellë në ekonominë e vendeve të Evropës Perëndimore dhe jo vetëm këtu, por edhe në Evropën Lindore e në Bashkimin Sovjetik. Udhëheqja kineze e di fare mirë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë investuar dhe vazhdojnë të investojnë në vende të ndryshme të botës me dhjetëra miliardë dollarë. Atëherë çfarë shpreson ajo? Mos shpreson ajo se vendet perëndimore kapitaliste, me gjithë kontradiktat që kanë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të shkëputen nga këto për të dobësuar kampin e vet, për të hequr dorë nga ajo fuqi e arma-

tosur, nga ato lidhje ekonomike, shoqërore e kulturore që kanë me to dhe, për hir të interesave të Kinës, të zhvishen përballë socialimperializmit sovjetik? Ky është një absurditet i politikës së jashtme kineze.

Siç e theksuam edhe më lart, nuk ka asnjë dyshim se kontradiktat që ekzistojnë midis dy superfuqive dhe vendeve të tjera imperialiste e kapitalisto-revizioniste duhen shfrytëzuar nga forcat revolucionare e çlirimtare. Rëndësi ka që kjo të kuptohet drejt dhe të shihet kurdoherë nën prizmin e interesave të revolucionit e në varësi prej tyre. Shfrytëzimi i kontradiktave midis fuqive e grupeve imperialiste, shteteve kapitalisto-revizioniste etj., nuk mund të jetë asnjëherë për klasën punëtore e revolucionarët marksistë-leninistë një qëllim më vete.

Të shfrytëzosh kontradiktat midis vendeve imperialiste dhe dy superfuqive do të thotë të thellosh të çarat midis tyre, të inkurajosh forcat revolucionare e patriotike të këtyre vendeve që të kundërshtojnë imperializmin amerikan e socialimperializmin sovjetik, të cilët duan t'i nënshtrojnë ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht, t'i shfrytëzojnë, t'u mohojnë personalitetin e tyre kombëtar etj.

Por si vepron Kina?

Politika kineze predikon «aleancën e shenjtë» të vendeve kapitaliste perëndimore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bile ajo shkon edhe më tej. Ajo predikon aleancën e proletariatit të vendeve të Evropës Perëndimore me borgjezinë reaksionare të këtyre vendeve. Ku është këtu vija marksiste-leniniste revo-

lucionare? Ku është këtu vija e shfrytëzimit të kontradiktave? Mos mendojnë udhëheqësit kinezë se me një politikë të tillë ata do ta forcojnë këtë bllok, sipas dëshirës së tyre, kundër sovjetikëve? Ata e ëndërrojnë këtë utopi, por kjo është një pikëpamje metafizike nga ana e tyre.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet kapitaliste perëndimore, e bashkë me to edhe Japonia e Kanadaja nuk janë aq të marra sa mendojnë udhëheqësit kinezë, nuk bëjnë një politikë aq naive, siç e bëjnë kinezët. Nga ana e tyre ato dinë shumë mirë t'i shfrytëzojnë kontradiktat që ekzistojnë në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Ato dinë dhe veprojnë që fuqinë e madhe agresive, Bashkimin Sovjetik, ta dobësojnë dhe kanë kohë që po luftojnë në këtë drejtim dhe nuk mund të themi se nuk kanë arritur rezultate. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjithë shtetet e tjera kapitaliste i nxitin kontradiktat në mes vendeve revizioniste të Lindjes dhe Kremlinit.

Tani ka filluar edhe Kina ta zbatojë këtë politikë të vjetër amerikane. Vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani e Jugosllavi ishte në këtë rrugë. Por hapja e Kinës në Evropë, nxitja nga ana e saj e kontradiktave dhe sidomos përpjekjet për krijimin e një fushe të favorshme për të në Ballkan, të gjitha këto nuk bëhen në interes të popujve e të revolucionit. Ato janë pjesë e politikës kineze të nxitjes së luftës, e cila synon që popujt e Evropës të vriten me njëri-tjetrin, të bëhen mish për top në luftën imperialiste.

«Pravda» ka kohë që ka hyrë në një polemikë, natyrisht pa efekt, me Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës, duke i akuzuar këto se zhvillojnë me shpejtësi e në sasi të mëdha armatimet. Preokupacioni i saj nuk është të kritikohet ky veprim i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse socialimperialistët sovjetikë bëjnë vetë të njëjtën gjë. Çështja qëndron në atë që shtimi i potencialit luftarak amerikan e dobëson relativisht fuqinë luftarake sovjetike dhe e detyron Bashkimin Sovjetik t'i ndjekë këmba-këmbës Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të ekuilibruar potencialin ushtarak dhe fuqinë agresive të tij. Ndërkaq ndjekja këmba-këmbës e imperializmit amerikan në garën e armatimeve e dobëson ekonominë e Bashkimit Sovjetik, pse bën që fonde të mëdha materiale, monetare dhe njerëzore të kalojnë nga ekonomia në ushtri. Është kjo që i shqetëson brezhnjevianët.

Por ajo që është e çuditshme është fakti që revizionistët kinezë, me anë të gazetës së tyre «Zhenminzhibao», marrin pa rezerva anën e amerikanëve, duke botuar artikuj pas artikujsh që t'i nxitin Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mos humbasin epërsinë në garën e armatimeve, por të rritin pa pushim potencialin e tyre ushtarak. Pra, sipas «Zhenminzhibaos», del se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk po armatosen, se është vetëm Bashkimi Sovjetik ai që armatohet. Një avokat i tillë i amerikanëve, siç po bëhet udhëheqja revizioniste kineze, nuk gjendet në asnjë vend. Borgjezia përpiqet të paktën të ruajë masën në kritikën dhe në interpretimin e realiteteve, të balancojë, natyrisht me tendencë, situatat që po zhvillohen. Por që të veprohet kështu, siç bëjnë udhëheqësit kinezë, kjo nuk është parë kurrë.

Në takimin me Ten Hsiao Pinin, sekretari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Vensi, i shpjegoi këtij se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë epërsi ushtarake ndaj Bashkimit Sovjetik». Por Ten Hsiao Pini i tha një grupi të madh gazetarësh amerikanë, që në atë kohë po vizitonin Kinën, se «Pekini nuk e beson» deklaratën e Vensit dhe se «Bashkimi Sovjetik është shumë më superior se Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Kësaj i thonë: «I zoti e shet, tellalli s'e jep».

Nuk mund të pranohet teza kineze, që paraqitet si një tezë gjoja marksiste, e cila vë në dyshim faktin se nuk është vetëm njëra, por janë të dyja superfuqitë imperialiste që kërkojnë të bëjnë rindarjen e botës, të krijojnë koloni të reja, të shtypin popujt, të zgjerojnë tregjet.

Vetë shtrimi i çështjes që njëri imperializëm është më i fortë dhe tjetri më pak i fortë, njëri agresiv dhe tjetri i zbutur, nuk është marksist-leninist. Shtruarja në këtë mënyrë e çështjes është refleks i një pikëpamjeje reaksionare që i çon revizionistët kinezë në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me NATO-n dhe Tregun e Përbashkët, me mbretin e Spanjës, me shahun e Iranit, me Pinoçetin e Kilit e me të gjithë diktatorët fashistë. Politika kineze, që nuk prek imperializmin amerikan, që nuk prek fuqinë e bankave e të kapitalit më të madh të kohës sonë, është një politikë krejt reformiste borgjeze, pacifiste e shumë e trashë.

Udhëheqësit kinezë nuk mund të mos shohin se si kapitali financiar, trustet, monopolet amerikane nuk

po i pakësojnë aspak investimet e tyre përjashta, se nuk po heqin dorë nga synimet e tyre shfrytëzuese dhe skllavëruese, se përkundrazi, po forcohen dhe po përpigën që t'i ndryshojnë raportet e forcave në botë në favorin e vet.

Këtë gjë po bëjnë edhe socialimperialistët sovjetikë. Edhe politika e tyre ekonomike, edhe trustet e mëdha që ekzistojnë në Bashkimin Sovjetik, me të gjitha mjetet synojnë t'u thithin gjakun satelitëve dhe vendeve të tjera. Ata janë veshur me një petk të ri dhe paraqiten me një emër tjetër, duke u përpjekur, gjithashtu, në fillim gjoja me marrëveshje, me bisedime, por, kur të vijë koha, edhe me forcë, domethënë me luftë, të ndryshojnë raportin e forcave në dobi të vet.

Me arsyetimet se Shtetet e Bashkuara të Amerikës «dëshirojnë statukuonë», se «ato janë në rënie», se socialimperializmi sovjetik është «më i rrezikshmi, më agresivi, më luftëdashësi» etj., revizionistët kinezë kërkojnë të provojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund dhe duhet të bëhen aleate të Kinës kundër Bashkimit Sovjetik. Marrëdhëniet e ndryshme që po i zgjerojnë, përkrahja e hapët që i bëjnë shtimit të buxheteve të luftës dhe të armatimit të mëtejshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e vërtetojnë këtë gjë.

Revizionistët kinezë predikojnë se situata e sotme është e tillë që marksistë-leninistët, revolucionarët dhe popujt mund të bëjnë kompromis dhe të mbështeten tek imperializmi amerikan. Partia jonë është kundër çdo kompromisi me imperializmin e egër amerikan, sepse një gjë e tillë nuk është në interes të revolucio-

nit dhe të çlirimit të popujve. Ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi në luftë me imperializmin amerikan deri në shkatërrimin e tij të plotë. Ne, gjithashtu, jemi e do të jemi në luftë deri në fund edhe me socialimperializmin sovjetik.

Mbështetja që Kina i bën imperializmit amerikan nuk është aspak në favor të revolucionit e të popujve, por të kundërrevolucionit. Me vijën e saj politike dhe ideologjike reaksionare udhëheqja kineze i lë popujt e botës në kthetrat e imperializmit amerikan. Kjo dëshiron që këta të rrinë urtë, të mos ngrenë krye, bile të bashkohen me imperializmin amerikan kundër superfuqisë tjetër, e cila kërkon t'u grabitë Shteteve të Bashkuara të Amerikës pasuritë që kanë krijuar me mundin dhe djersën e popujve. Udhëheqja e Kinës u rekomandon vendeve kapitaliste të Evropës, që janë grumbulluar në Tregun e Përbashkët Evropian, të bashkohen. Në bashkimin kapitalist të Evropës ajo radhit edhe popujt. Ky qëndrim do të thotë: rriini urtë, mos flisni më për revolucionin, mos flisni më për diktaturën e proletariatit, por futuni në shërbim të trusteve, të kapitalistëve dhe, bashkë me ta, krijoni një forcë ekonomike dhe ushtarake akoma më të madhe, për të përballuar socialimperializmin sovjetik.

Tregu i Përbashkët Evropian, të cilin e mbështet dhe e fuqizon ekonomikisht Kina, nuk është gjë tjetër veçse një mjet për ruajtjen e fitimeve maksimale të trusteve monopoliste të Evropës Perëndimore dhe për grupimin e shteteve industriale të zhvilluara, ku klasat e pasura, siç thotë Lenini, marrin një haraç kolosal nga Afrika, nga Azia etj. Udhëheqësit kinezë, duke



mbështetur këto shtete kapitaliste, në fakt, mbështetin parazitizmin e një grushti kapitalistësh në kurriz të popujve të vetë këtyre vendeve, si dhe të popujve ku ata kanë hëdhur kthetrat.

Teoria e «tri botëve» e revizionistëve kinezë, me anën e së cilës ata përpiqen të përlligjin qëndrimet e tyre kundërrevolucionare, nuk është tjetër veçse një variant i oportunitizmit në radhët e lëvizjes punëtore, që ndihmon imperializmin të krijojë tregje dhe fitime mbi kurrizin e popujve të tjerë, me qëllim që të marrë edhe ky një pjesë nga thërrimet e sofrës që do t'i lënë kapitalistët.

Është fakt i pamohueshëm se udhëheqja kineze mbron forcat dhe shtetet kapitaliste dhe jo forcat revolucionare e proletariatin evropian që të ngrenë krye dhe të shkatërrojnë planet e imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik, të «Evropës së Bashkuar», të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të KNER-it, me një fjalë të të gjitha shtyllave të sistemit imperialist që, si një kuçedër e madhe, thith gjakun e popujve.

Megjithëse shtetet e zhvilluara kapitaliste, si Gjermaninë Perëndimore, Anglinë, Japoninë, Francën, Italinë etj., i fut në «botën e dytë», udhëheqja revizioniste e Kinës këto shtete nuk i konsideron si armike të revolucionit, pavarësisht nga llafet që thuhet në planin teorik mbi karakterin e tyre «të dyfishtë». Përkundrazi, kinezët e kanë gjetur të rrugës që të mbyllin sytë e të bien në kompromis të hapët me to, për t'i shfrytëzuar gjoja kundër socialimperializmit sovjetik.

Udhëheqja kinze, së cilës i janë errur sytë për shkak të politikës së saj pragmatiste e antimarksiste, «harron» se shtete të tilla, si Gjermania, Anglia, Japonia, Franca, Italia dhe të tjera si këto, kanë qenë dhe janë imperialiste, se prirjet skllavëruese dhe kolonizatore, që kanë qenë karakteristikat e tyre tradicionale, nuk u janë zhdukur dhe nuk mund t'u zhduken. Është e vërtetë se pas Luftës së Dytë Botërore këto fuqi imperialiste janë dobësuar, bile shumë, dhe se pozitat e tyre të mëparshme kanë ndryshuar në dobi të imperializmit amerikan, por megjithëkëtë as Franca, as Anglia etj., nuk kanë hequr dorë nga lufta për të mbrojtur tregjet e tyre dhe për të fituar tregje të tjera në Afrikë, në Azi dhe në vendet e Amerikës Latine.

Në mes të të gjitha këtyre shteteve kapitaliste dhe imperialiste jo kaq të fuqishme sa imperializmi amerikan, ekzistojnë kontradikta, por në të njëjtën kohë ekziston edhe prirja për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin.

Pas Luftës së Dytë Botërore, imperializmi amerikan i mëkëmbi ish-aleatët e tij të vjetër në Evropë dhe monopolet amerikane me ato të këtyre ish-aleatëve u lidhën në një lëmsh interesash të përbashkët. Por ndërmjet tyre kanë ekzistuar dhe ekzistojnë kontradikta në përpjekjet për të pasur secili duar të lira në akaparimin e tregjeve, në importimin e lëndëve të para dhe në eksportimin e mallrave të tyre industriale. Realiteti ndërkombëtar ka vërtetuar e vërteton edhe në këtë rast drejtësinë e tezës së Leninit mbi dy tendencat objektive të kapitalit.

Është gjithashtu e vërtetë se këto shtete kapitaliste

kanë kontradikta jo vetëm me imperializmin amerikan, por edhe me socialimperializmin sovjetik. Çështja shtrohet: si duhet të shfrytëzohen këto kontradikta? Kontradiktat ndër imperialiste në asnjë mënyrë nuk mund të shfrytëzohen ashtu siç predikojnë revizionistët kinezë. Ne, marksistë-leninistët, nuk mund të mbrojmë reaksionarët e ndryshëm në Gjermani, krerët konservatorë ose laburistë anglezë, për arsye se këta janë në kontradikta me socialimperializmin sovjetik. Në qoftë se do ta bënim këtë gjë dhe do të mbështetnim predikimin e kinezëve që «shtetet kapitaliste të Evropës duhet të bashkohen në Tregun e Përbashkët», që «Evropa e Bashkuar» të forcohet për t'i bërë ballë socialimperializmit sovjetik, kjo do të thoshte që ne të pranojmë të sakrifikohen lufta dhe përpjekjet e proletariatit të këtyre vendeve për thyerjen e zinxhirëve të robërisë, të sabotohet e ardhmja e revolucionit në këto vende.

Revizionistët kinezë, duke bërë kompromise pa parim me imperializmin amerikan, kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe revolucionin. Marksistë-leninistët e interpretojnë tezën e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit mbi kontradiktat dhe mbi kompromiset në frymën e saj të vërtetë. Kinezët e interpretojnë këtë tezë në një mënyrë diametralisht të kundërt me të vërtetën.

Partia jonë, duke ndjekur rrugën leniniste, nuk është kundër çdo kompromisi, por ajo është kundër kompromiseve tradhtare. Kur kompromisi është i do-

mosdoshëm dhe u shërben interesave të klasës e të revolucionit, atëherë ai mund të bëhet, por kurdoherë duke mbajtur parasysh që të mos prekë strategjinë, besnikërinë ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit, të mos prekë interesat e klasës e të revolucionit.

Në lidhje me qëndrimet ndaj kompromiseve, Lenini ndër të tjera thotë:

*«A i lejohet partizanit të revolucionit proletar të përfundojë kompromise me kapitalistët ose me klasën e kapitalistëve?... në qoftë se kësaj pyetjeje të përgjithshme do t'i përgjigjeshim në mënyrë negative, do të ishte një absurditet i dukshëm. Sigurisht, partizani i revolucionit proletar mund të përfundojë kompromise ose marrëveshje me kapitalistët. Gjithçka varet se çfarë marrëveshje dhe në ç'rrethana përfundohet. Këtu dhe vetëm këtu mund dhe duhet të kërkohet ndryshimi midis marrëveshjes, që nga pikëpamja e revolucionit proletar është e ligjshme, dhe marrëveshjes tradhtare, të pabesë (po nga ajo pikëpamje)»<sup>1</sup>.*

Dhe më poshtë Lenini vazhdon:

*«Konkluzioni është i qartë: të mohosh kryekëput çfarëdo marrëveshje ose kompromis me kusarët është një gjë po aq absurde sa edhe të nxjerrësh një justifikim për pjesëmarrje në*

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 30, f. 562-563.

*banditizëm nga teza abstrakte se, duke folur në përgjithësi, disa herë marrëveshjet me kusarët lejohen dhe janë të domosdoshme»<sup>1</sup>.*

Gjithashtu Lenini ka thënë:

*«Detyra e një partie me të vërtetë revolucionare nuk është që të shpallë se është e pamundur të heqësh dorë nga çfarëdo kompromisi, por të dijë ta ruajë, pavarësisht nga këto kompromise, përderisa ato janë të pashmangshme, besnikërinë ndaj parimeve të veta, ndaj klasës së vet, ndaj detyrës së vet revolucionare, ndaj veprës së përgatitjes së revolucionit dhe të edukimit të masave të popullit për arritjen e fitores në revolucion»<sup>2</sup>.*

Vetëm duke u nisur nga këto mësimet të Leninit, mund të lejohen kompromiset. Por si mund të jetë në interesin e socializmit dhe të revolucionit botëror kompromisi me imperializmin amerikan ose me social-imperializmin sovjetik, kur dihet se këto dy superfuqi janë armiqtë më të egër të popujve e të revolucionit? Ky kompromis jo vetëm nuk është i domosdoshëm, por përkundrazi, është i rrezikshëm për interesat e revolucionit. Të bësh kompromis ose të shkelësh parimet për këto probleme kaq të rëndësishme, do të thotë të tradhtosh marksizëm-leninizmin.

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 30, f. 565.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 359-360.

Në goftë se Mao Ce Duni dhe udhëheqësit e tjerë kinezë kanë folur dhe flasin shumë «teorikisht» për kontradiktat, atëherë ata duhet të flasin jo vetëm për shfrytëzimin e kontradiktave ndër imperialiste e kompromiset me imperialistët, por të flasin në radhë të parë për kontradiktat që qëndrojnë në themel të epokës së sotme, për kontradiktat midis proletariatit dhe borgjezisë, për kontradiktat që kanë popujt dhe vendet e shtypura me të dyja superfuqitë e me gjithë imperializmin botëror, për kontradiktat midis socializmit e kapitalizmit. Për këto kontradikta, që ekzistojnë objektivisht dhe nuk mund të fshihen, udhëheqësit kinezë heshtin. Ata flasin vetëm për një kontradiktë, e cila, sipas tyre, është ajo midis gjithë botës dhe socialimperializmit sovjetik, duke u përpjekur të justifikojnë me këtë kompromiset e tyre pa parim me imperializmin amerikan dhe mbarë kapitalizmin botëror.

Analiza klasore marksiste-leniniste dhe faktet tregojnë se ekzistenca e kontradiktave dhe e të çarave midis fuqive e grupimeve imperialiste nuk mënjanon aspak dhe as nuk sponon në plan të dytë kontradiktat midis punës dhe kapitalit në vendet kapitaliste e imperialiste ose kontradiktat midis popujve të shtypur dhe shtypësve të tyre imperialistë. Pikërisht kontradiktat midis proletariatit e borgjezisë, midis popujve të shtypur e imperializmit, midis socializmit dhe kapitalizmit janë më të thellat, të përhershme, të papajtueshme. Për pasojë, shfrytëzimi i kontradiktave ndër imperialiste ose midis shteteve kapitaliste e revizioniste ka kuptim vetëm në rast se shërben për krijimin e kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e fuqishëm të

lëvizjes revolucionare e çlirimtare kundër borgjezisë, imperializmit e reaksionit. Prandaj shfrytëzimi i këtyre kontradiktave duhet bërë pa krijuar në proletaria-tin e në popujt iluzione për imperializmin e borgjezi-në. Është e domosdoshme të bëhen të qartë punonjë-sit e popujt për mësimet e Leninit, të bëhen ata të vetëdijshëm se vetëm qëndrimi mospajtues ndaj shtypësve e shfrytëzuesve, se vetëm lufta e vendosur kundër imperializmit e borgjezisë dhe revolucionit do t'u sigurojnë lirinë e vërtetë shoqërore e kombëtare.

Shfrytëzimi i kontradiktave midis armiqve nuk mund të përbëjë detyrën themelore të revolucionit dhe t'i kundërvihet luftës për përmbysjen e borgjezisë, të diktaturës reaksionare e fashiste, të shtypësve im-perialistë.

Qëndrimi i marksistë-leninistëve në këtë çështje është i qartë. Ata u drejtohen popujve, proletariatit, u bëjnë thirrje masave që të ngrihen në këmbë për të shkatërruar planet hegjemoniste, shtypëse, agresive e luftënxitëse të imperialistëve amerikanë e të social-imperialistëve sovjetikë, për të përmbysur borgjezinë reaksionare e diktaturën e saj, si në Perëndim ashtu edhe në Lindje.

Për sa i përket shtetit tonë socialist, ai i ka shfry-tëzuar e i shfrytëzon kontradiktat në kampin kundër-shtar. Në shfrytëzimin e tyre Partia jonë nisët nga vlerësimi i drejtë i karakterit të kontradiktave që ek-zistojnë midis vendit socialist dhe vendeve imperialiste e borgjezo-revizioniste, nga vlerësimi i drejtë i kon-tradiktave ndër imperialiste.

Marksizëm-leninizmi na mëson se kontradiktat

midis vendit socialist dhe vendeve kapitaliste e revizioniste, si shprehje e kontradiktave midis dy klasash me interesa diametralisht të kundërt, klasës punëtore e borgjezisë, janë të përhershme, rrënjësore, të papajtueshme. Ato përshkojnë si një fill i kuq tërë epokën historike të kalimit nga kapitalizmi në socializëm në shkallë botërore. Ndërkaq kontradiktat midis fuqive imperialiste janë shprehje e kontradiktave në gjirin e shfrytëzuesve, të klasave me interesa themelore të përbashkët. Prandaj, sado të ashpra të jenë kontradiktat e konfliktet midis fuqive imperialiste, mbetet i përhershëm e gjithmonë aktual rreziku real i veprimeve agresive të imperializmit botëror ose i reparteve të ndryshme të tij kundër vendit socialist. Përçarja midis imperialistëve, grindjet e konfliktet ndër imperialiste mundet, të shumtën, të dobësojnë e të shtyjnë përkohësisht rrezikun e veprimeve të imperializmit kundër vendit socialist, prandaj është në interesin e këtij që t'i shfrytëzojë këto kontradikta në radhët e armiqve, por ato nuk e zhdukin këtë rrezik. Këtë e ka theksuar me forcë Lenini, i cili thoshte se

*«... nuk mund të mendohet që Republika Sovjetike të ekzistojë për një kohë të gjatë përbri shteteve imperialiste. Në fund të fundit, ose njëra, ose tjetra palë do të fitojë. Dhe derisa të vijë ky fund, do të ketë patjetër një varg ndeshjesh nga më të tmerrshmet midis Republikës Sovjetike dhe shteteve borgjeze»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 29, f. 160.



Këto mësimë të Leninit e ruajnë plotësisht aktualitetin e tyre. Ato janë vërtetuar katërcipërisht nga një varg ngjarjesh historike, siç janë agresioni fashist kundër Bashkimit Sovjetik në vitet e Luftës së Dytë Botërore, agresioni i imperializmit amerikan në Kore e më pas në Vietnam, veprimtaria armiqësore e kompletet e ndryshme imperialiste e socialimperialiste kundër Shqipërisë etj. Prandaj Partia jonë ka theksuar e thekson se çdo nënvleftësim i kontradiktave të shtetit socialist me fuqitë imperialiste e vendet kapitalisto-revizioniste, çdo nënvleftësim i rrezikut të veprimeve agresive të këtyre të fundit kundër Shqipërisë socialiste, çdo ulje e vigjilencës, si rrjedhim i mendimit se kontradiktat midis vetë fuqive imperialiste janë shumë të ashpra dhe se, për këtë arsye, nuk mund të ndërmarrin veprime të tilla kundër atdheut tonë, do të ishin të mbarsura me pasoja tepër të rrezikshme.

Partia e Punës e Shqipërisë niset edhe nga fakti se aleate të vërteta e të sigurta të vendit tonë si vend socialist mund të jenë vetëm forcat revolucionare, çlirimtare, liridashëse e progresive. Vendi ynë mban marrëdhënie shtetërore me vende të ndryshme të botës borgjezo-revizioniste, shfrytëzon kontradiktat midis shteteve imperialiste, kapitaliste e revizioniste dhe, në të njëjtën kohë, përkrah fuqimisht luftën revolucionare e çlirimtare të klasës punëtore, të masave punonjëse e të popujve të çdo vendi ku zhvillohet një luftë e tillë, duke e parë këtë përkrahje si detyrën e vet të lartë internacionaliste. Kësaj pikëpamjeje i është përmbajtur e i përmbahet me konsekuencë Partia e Punës e Shqipërisë, e cila edhe në Kongresin e saj të 7-të ri-

theksoi se do të mbështetë proletariatin e popujt, partitë marksiste-leniniste, revolucionarët e njerëzit përparimtarë, që luftojnë kundër superfuqive, kundër borgjezisë kapitaliste e revizioniste dhe reaksionit botëror për çlirimin shoqëror e kombëtar.

Partia Komuniste e Kinës lidhur me kontradiktat dikur ka cituar edhe parime e teza të njohura marksiste-leniniste. Kështu, për shembull, kinezët, në artikullin e njohur me titull: «Propozim në lidhje me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare», botuar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës më 1963, kanë pasë shkruar: «Këto ose ato kompromise të domosdoshme midis vendeve socialiste dhe imperialiste nuk kërkojnë që popujt dhe kombet e shtypura të bëjnë edhe ata kompromise me imperializmin dhe me veglat e tij». Dhe shtonin: «Askush dhe asnjëherë nuk duhet që, nën pretekstin e bashkëzistencës paqësore, të kërkojë nga popujt dhe nga kombet e shtypura të heqin dorë nga lufta revolucionare». Udhëheqja kineze fliste kështu atëherë, se në atë kohë ishte udhëheqja hrushoviane që u kërkonte popujve dhe partive komuniste të pranonin se imperializmi amerikan e krerët e tij ishin bërë paqësorë dhe t'i nënshtroeshin politikës sovjetike të afrimit me imperializmin amerikan. Tani është udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, e cila u predikon popujve, revolucionarëve, partive marksiste-leniniste dhe gjithë proletariatit botëror që të bëjnë aleancë me vendet imperialiste ose kapitaliste, të bashkohen me borgjezinë dhe me të gjithë reaksionarët kundër socialimperializmit sovjetik. Dhe këto ide kinezët nuk i shprehin me fraza të mbu-

luara, por haptazi. Të tilla lëkundje e kthesa 180 gradëshe s'kanë të bëjnë me politikën parimore marksiste-leniniste, ato janë tipar i politikës pragmatiste që ndjekin të gjithë revizionistët, të cilët ua nënshtrojnë parimet interesave të tyre borgjezë e imperialistë.

Udhëheqësit kinezë dhe të gjithë partizanët e teorisë së «tri botëve», për të justifikuar kompromiset e tyre pa parim me imperializmin amerikan e borgjezinë ndërkombëtare, spekulojnë duke shtrembëruar të vërtetën historike, lidhur me paktin e mossulmimit sovjetogjerman të vitit 1939, si dhe me aleancën anglo-sovjetogjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Pakti sovjetogjerman i mossulmimit ishte një shfrytëzim i zhdërvjellët i kontradiktave ndër imperialiste nga ana e Stalinit. Në atë kohë agresioni hitlerian kundër Bashkimit Sovjetik ishte iminent. Ishte përhadha kur Gjermania naziste kishte pushtuar Austrinë e Çekoslovakinë, ndërsa Italia fashiste Shqipërinë, kur ishte bërë Munihu dhe makina luftarake gjermane ecte me shpejtësi drejt Lindjes. Bashkimi Sovjetik përfundoi jo aleancë, por një pakt mossulmimi me Gjermaninë, pasi fuqitë perëndimore refuzuan t'i përgjigjeshin thirrjes së Stalinit për veprime të përbashkëta me shtetin sovjetik me qëllim që të frenoheshin agresorët nazifashistë, kur u duk qartë se këto fuqi e shtynin Hitlerin kundër vendit të sovjetëve. Pakti sovjetogjerman ua prishi këto plane dhe i dha kohë Bashkimit Sovjetik të përgatitej më tej për të përballuar agresionin nazist.

Për sa i përket aleancës anglo-sovjetogjermane, dihet se kjo u realizua kur Gjermania hitleriane, pasi

kishte pushtuar Francën dhe ndodhej në luftë me Anglinë, ndërmori agresionin e saj të egër kundër Bashkimit Sovjetik, kur lufta kundër fuqive të Boshtit mori karakter të qartë e të theksuar antifashist e çlirimtar. Duhet theksuar se asnjëherë e në asnjë rast Stalini dhe Bashkimi Sovjetik në atë kohë nuk predikuan e nuk bënë thirrje që proletariati e partitë komuniste të hiqnin dorë nga revolucioni e të bashkoheshin me borgjezinë reaksionare. Bile kur Brauderi hoqi dorë nga lufta e klasave dhe predikonte pajtimin klasor, pse kështu gjoja e kërkonin interesat e aleancës anglo-sovje-to-amerikane, ai u stigmatizua si revizionist e renegat i revolucionit nga Stalini dhe nga lëvizja komuniste.

Siç shihet, asgjë nuk i justifikon kompromiset e aleancat e paprincipita kineze me imperializmin amerikan dhe me forcat e ndryshme reaksionare. Analogjia historike që përpiqen të bëjnë revizionistët kinezë nuk qëndron.

Në propagandën që bëjnë, udhëheqësit kinezë përpiqen të lënë përshtypjen gjoja sikur ne, shqiptarët, jemi kundër çdo kompromisi dhe nuk luftojmë për t'i shfrytëzuar si duhet kontradiktat. Natyrisht, ata e dinë se qëndrimi ynë për këto çështje është në pozitë e marksizëm-leninizmit, por e vazhdojnë propagandën në këtë vijë të shtrembër për të fshehur largimin e tyre nga teoria shkencore marksiste-leniniste dhe nga rruga e revolucionit. Ata veprojnë kështu që të denigrojnë politikën dhe qëndrimet e drejta të Partisë e të shtetit proletar. Akuzat e tyre nuk qëndrojnë. Le t'u referohemi fakteve.

Partia jonë, si kurdoherë, ka mbrojtur dhe do të

mbrojë deri në fund energjikisht kauzën e drejtë të popujve arabë, pa përjashtim. Ne mbrojmë luftën e popullit palestinez kundër Izraelit, që është bërë prej kohësh një vegël e verbër, një xhandar i imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme. Atij i është ngarkuar detyra të mbrojë pusët e pasura të naftës arabe në favorin e kompanive të mëdha monopoliste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të ruajë statukuonë, siç e quajnë revizionistët kinezë.

Pavarësisht se presidenti Sadat dhe qeveria e tij ishin më parë në aleancë me Bashkimin Sovjetik, ne e mbrojtëm luftën e popullit të Egjiptit për të rimarrë tokat e pushtuara nga Izraeli, por qëllimet e Bashkimit Sovjetik ndaj Egjiptit, dhe, në përgjithësi, lodrat e tij në Lindjen e Mesme, i demaskuam. Në asnjë moment ne nuk kemi heshtur kundër qëllimeve kolonizuese të Bashkimit Sovjetik ndaj Egjiptit. Të njëjtën gjë e kemi bërë duke mbrojtur po me aq konsekuencë popullin egjiptian në luftën e tij edhe kundër imperializmit amerikan dhe Izraelit.

Duke mbrojtur interesat e popullit egjiptian dhe të popujve arabë, Partia dhe populli ynë demaskojnë edhe manovrat që po ndjek aktualisht imperializmi amerikan bashkë me Izraelin. Ne s'mund të aprovojmë asnjë rrugë, asnjë vijë kompromisi me Izraelin agresor nën pretendimin se kjo bëhet gjoja në favor të popullit egjiptian.

Kurse udhëheqja kineze nuk e demaskon imperializmin amerikan, ajo duartroket marrëveshjet izraelo-egjiptiane dhe i shtyn popujt arabë të bien në ujd, të bëjnë kompromis me imperializmin amerikan dhe

me Izraelin, që janë armiq nga më kryesorët për ta. Një qëndrim i tillë nuk është marksist-leninist, një kompromis i tillë ala kinez nuk është në interes të popujve. Nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë absurditeti kinez që, duke u hedhur nga një imperializëm te një imperializëm tjetër, «veprohet në interes të lirisë së popujve». Këto manovra dhe intriga tipike borgjeze nuk mund të quhen veprime marksiste-leniniste që ndihmojnë për të thelluar kontradiktat në mes dy superfuqive imperialiste.

Partia dhe populli shqiptar janë kundër luftërave grabitqare imperialiste dhe qëndrojnë vendosmërisht përkrah luftërave të drejta nacionalçlirimtare, të cilat janë dhe duhet të jenë kurdoherë në dobinë e popujve, në favorin e revolucionit. Ata nuk janë kundër përkrahjes, qoftë edhe të një shteti borgjez, kur shohin se njerëzit që sundojnë në një shtet të tillë, janë përparimtarë dhe luftojnë për interesin e çlirimit të popullit të tyre nga hegjemonia imperialiste. Por vendi ynë nuk mund të bëjë kauzë të përbashkët ose kompromis, siç e quajnë revizionistët kinezë, me një shtet ku sundon një klikë reaksionare, e cila, për interesin e klasës së vet dhe në dëm të interesave të popullit, hyn në aleancë me njërën ose me tjetrën superfuqi.

Shqipëria socialiste, gjithashtu, nuk është kundër mbajtjes së marrëdhënieve normale diplomatike me shtetet e «botës së tretë», apo të «botës së dytë». Ajo është kundër marrëdhënieve të tilla vetëm me dy superfuqitë dhe me shtetet fashiste. Por edhe marrëdhëniet diplomatike, ashtu sikundër edhe marrëdhëniet tregtare, kulturore etj., ne i zhvillojmë brenda pari-

meve, duke shikuar, në radhë të parë, interesat e vendit tonë dhe ato të revolucionit, kundër të cilave nuk kemi ecur dhe nuk do të ecim kurrë.

Ne, marksistë-leninistët, që kemi ardhur në pushtet, duhet të vendosim marrëdhënie diplomatike shtetërore edhe me shtetet borgjezo-kapitaliste, sepse për këto edhe ne kemi interes, por kanë dhe ato. Këta interesa janë reciprokë.

Marksistë-leninistët kurdoherë duhet të mbajnë parasysh parimet. Ata nuk mund të shkelin mbi parimet për hir të koniunkturave që krijohen në një periudhë ose në një tjetër. Duhet të kemi parasysh se në vendet ku sundojnë shtresat e larta të borgjezisë, këto janë në luftë të përhershme me popullin, me proletariatin dhe me fshatarësinë e varfër, me borgjezinë e vogël të qyteteve. Prandaj, si në rastin kur vendi socialist mban marrëdhënie shtetërore me vendet borgjeze, ashtu edhe kur nuk mban, ai duhet t'u lërë popujve të kuptojnë se mbron luftën e tyre, se nuk aprovon aktet reaksionare dhe antipopullore të sundimtarëve të tyre.

Ne, marksistë-leninistët, duhet të njohim e të mbajmë parasysh jo vetëm kontradiktat që ekzistojnë në mes klasave të shtypura dhe shtypësve të tyre, por edhe kontradiktat që dalin në mes shteteve, domethënë midis qeverive të këtyre vendeve me imperializmin amerikan, me socialimperializmin sovjetik, me vendet e tjera kapitaliste etj. Ne duhet të bëjmë kurdoherë një politikë të tillë që të mos mbrojmë një qeveri reaksionare për shkak se kjo, për interesat e vet dhe të klasës në fuqi, prishet përkohësisht me imperializmin

amerikan për t'u hedhur në prehrin e një imperializmi tjetër, si, fjala vjen, të atij anglez, sovjetik etj. Kontradiktat që ekzistojnë ndërmjet tyre, duhet t'i shfrytëzojmë me pikësnyimin që qëndrimi ynë t'i shërbejë fuqizimit të luftës së proletariatit dhe të masave të shtypura të atij vendi kundër qeverisë së tij reaksionare. Në qoftë se midis qeverisë reaksionare e shtypëse kapitaliste të një vendi të «botës së dytë» apo të «botës së tretë» kanë lindur kontradikta me qeverinë e një vendi të «botës së parë», sipas ndarjes që bëjnë revizionistët kinezë, këto kontradikta nuk do të thotë se janë gjithnjë në favorin e çlirimit të popullit të këtij vendi nga zgjedha e kapitalit, nga zgjedha e borgjezisë reaksionare që sundon atje. Këtu kemi të bëjmë kryesisht me interesa klasash, me interesa qeverish borgjeze që përfaqësojnë klasat shfrytëzuese, me çështjen kush jep më shumë e kush jep më pak, kush e mbron më mirë qenien e tyre në fuqi dhe kush kërkon t'u ngrejë këmbët për të sjellë sikush njerëzit e vet.

Në trajtimin e luftës së proletariatit nuk duhet ngatërruar qëndrimi ndaj borgjezisë me marrëdhëniet diplomatike, tregtare, kulturore e shkencore midis vendeve socialist dhe shteteve me sistem tjetër shtetëror. Këto marrëdhënie ndërshtetërore duhet të ekzistojnë dhe të zhvillohen, por në lidhjen e tyre vendi socialist duhet të ketë synime të qarta. Jeta ideologjike, politike, morale, materiale e vendit socialist duhet të jetë një pasqyrë për popujt e atyre shteteve me të cilat ka marrëdhënie, në mënyrë që nëpërmjet zhvillimit të



këtyre marrëdhënieve, popujt e shteteve josocialiste të shohin të mirat dhe epërsitë e sistemit socialist. Ecja ose jo në rrugën socialiste, natyrisht, është punë e tyre, por është detyra e vendit socialist të japë shembullin e mirë.

Të gjitha këto probleme politike, teorike, organizative udhëheqësit kinezë jo vetëm nuk i kanë të qarta dhe nuk duan t'i sqarojnë, por me qëllim i bëjnë akoma më të turbullta, sepse duhet të turbullojmë për të sqaruar, thotë Mao Ce Duni. Kjo tezë nuk është e drejtë. Përkundrazi, ne duhet të sqarojmë e të bindim që të bëhet revolucioni, pse sa për turbullirë, kjo ekziston. Në qoftë se shtrohet çështja për të turbulluar, atëherë le të turbullohet akoma më shumë imperializmi që është duke dhënë shpirt, por jo të ndihmohet ai e t'i vihen paterica që t'i zgjaket jeta. T'ia shkurtojmë jetën kapitalizmit që të çlirohen popujt, proletariati, që të afrohet perspektiva e socializmit dhe e komunizmit. Kjo është rruga jonë revolucionare, rruga e marksizëm-leninizmit. Tjetër rrugë nuk ka.

Udhëheqësit kinezë përdornin dikur shprehjen «luftë dhëmb për dhëmb» me imperializmin amerikan, por nuk e kanë zbatuar atë e aq më tepër nuk e zbatojnë sot. Ata nuk bëjnë luftë dhëmb për dhëmb, sepse janë në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse afrohen me imperializmin amerikan.

Marrëdhëniet diplomatike, tregtare e kulturore të Kinës me shtetet imperialiste dhe shtetet e tjera të botës janë mbi baza kapitaliste. Këto lidhje kanë për qëllim që, nëpërmjet ndihmës që kërkon të marrë

Kina nga shtetet e fuqishme imperialiste, të forcojë pozitën e saj ekonomike dhe ushtarake për të konkurruar edhe ajo me dy superfuqitë e tjera. Propaganda që bën Kina me radio e me mjete të tjera synon të krijojë në botë përshtypjen se Kina jo vetëm është një shtet i madh, i fuqishëm e me një kulturë të lashtë, por se edhe politika aktuale kineze është progresive, bile marksiste-leniniste. Por kjo veprimtari e revizionistëve kinezë nuk shërben e s'mund të shërbejë aspak si një shembull që duhet ta ndjekin popujt e botës në luftën e tyre për shkatërrimin e pushtetit kapitalist dhe imperialist.

### **Pikëpamja kineze mbi unitetin e «botës së tretë» është reaksionare**

Udhëheqja kineze kërkon bashkimin e të gjitha vendeve të «botës së tretë», vende heterogjene nga çdo pikëpamje: nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, social e kulturor, e kohës që i është dashur dhe e rrugës nëpër të cilën ka kaluar secili për të fituar atë shkallë lirie dhe pavarësie që ka sot etj.

Po si e përfytyron këtë bashkim që ajo predikon? Këtë bashkim udhëheqja kineze nuk e kupton në rrugën marksiste-leniniste dhe në interes të revolucionit e të çlirimit të popujve. Ajo e kupton nga pikëpamja borgjeze, domethënë si një bashkim nëpërmjet traktatesh e marrëveshjesh që lidhin e zgjidhin sundimtarët e këtyre vendeve, të cilët janë të lidhur sot me njërën fuqi imperialiste, por që nesër marrëveshjet që kanë

përfunduar i zgjidhin për t'u lidhur me një tjetër.

Udhëheqja revizioniste kineze harron se uniteti i këtyre shteteve kombëtare mund të sigurohet vetëm nëpërmjet luftës së proletariatit e të masave punonjëse të çdo vendi të veçantë, në radhë të parë, kundër imperializmit të jashtëm që ka depërtuar në atë vend, por edhe kundër kapitalizmit e reaksionit të brendshëm. Vetëm mbi këtë bazë mund të bëhet bashkimi i këtyre vendeve, vetëm mbi këtë bazë mund të realizohet fronti unik kundër imperializmit të huaj, si dhe kundër mbretërve, borgjezisë reaksionare, feudalëve dhe diktatorëve vendas.

Në kapitalizëm bashkimi bëhet vetëm nga lart, në krye, për të ruajtur fitoret e borgjezisë dhe për t'u mbrojtur nga revolucioni. Kurse bashkimi i vërtetë, bashkimi popullor, mund të arrihet kryesisht nga poshtë, duke pasur në krye të këtij bashkimi proletariatin.

Natyrisht nuk mund të hidhet poshtë taktika që mund të përdorë proletariati i një vendi të së ashtuquajturës botë e tretë ose proletariati i të gjitha këtyre vendeve për t'u bashkuar me forca të tjera politike kundër imperializmit. Nuk mund të neglizhohet uniteti i forcave revolucionare edhe me udhëheqjen borgjeze të një vendi kur, në një moment të caktuar, krijohet një kontradiktë e thellë me një imperializëm të jashtëm ose me një udhëheqje reaksionare të njërit nga vendet e «botës së tretë».

Të gjitha këto raste dhe mundësi duhen vëzhguar dhe shfrytëzuar nga forcat revolucionare. Për këtë arsye Lenini thotë se ndihma e vendit socialist dhe e

proletariatit ndërkombëtar duhet të jetë e nuancuar dhe me kushte.

Por udhëheqësit kinezë predikojnë pikërisht një aleancë pa kushte në mes qeverive reaksionare, gjoja për t'i bërë ballë imperializmit. Dhe kur flasin kundër imperializmit, ata nuk kanë parasysh imperializmin në përgjithësi, po vetëm socialimperializmin sovjetik.

Dobësimi i imperializmit dhe i kapitalizmit është sot tendenca kryesore e historisë botërore. Përpyekjet e shteteve të ndryshme për t'u çliruar nga influenca e imperializmit përbëjnë edhe këto një tendencë tjetër që çon në dobësimin e imperializmit. Por kjo tendencë e dytë, siç e absolutizon pa asnjë kusht udhëheqja revizioniste kineze, pa bërë asnjë diferencim midis vendeve, pa studiuar situatat e përgjithshme e të veçanta, nuk të çon në rrugën e drejtë të bashkimit të popujve në luftë për t'u çliruar nga ndërhyrja e sundimi imperialist. Nuk mund të çojë në rrugë të drejtë gjithashtu pikëpamja e revizionistëve kinezë që e konsideron Evropën si një kontinent me vende të «botës së dytë», të cilat ajo i fut në aleancë me «botën e tretë». Ky grupim shtetesh kapitaliste nuk mund të jetë kurrë për dobësimin e përgjithshëm të kapitalizmit botëror. Të thuash se një gjë e tillë mund të realizohet me ndihmën e bashkëpunimin e borgjezisë aristokrate të Anglisë, të borgjezisë revanshiste të Gjermanisë Perëndimore, të borgjezisë dinake franceze dhe të grupeve të tjera të mëdha kapitaliste, kjo është një naivitet për të ardhur keq.

Përkrahësit e teorisë së «tri botëve» mund të pretendojnë se, duke predikuar bashkimin e këtyre ven-

deve kapitaliste, synojnë dobësimin e imperializmit. Po cilin imperializëm do të dobësojë ky bashkim? Atë imperializëm me të cilin teoria e «tri botëve» bën thirrje për të krijuar një front unik kundër socialimperializmit? Atë imperializëm me të cilin vendet kapitaliste të Evropës, megjithëse kanë edhe kontradikta me të, janë në aleancë? Duket qartë se predikimi për forcimin e këtij grupimi shtetesh është një predikim për forcimin e pozitave të imperializmit amerikan, për forcimin e pozitave të shteteve kapitaliste të Evropës Perëndimore.

Nga ana tjetër, kur udhëheqja kineze flet për krijimin e aleancës midis shteteve të «botës së dytë» me shtetet e të ashtuquajturës botë e tretë, nënkupton aleancën midis qarqeve sunduese të këtyre vendeve. Por të pretendosh se këto aleanca do të ndihmojnë për çlirimin e popujve është një pikëpamje idealiste, metafizike, antimarksiste. Prandaj, të gënjesh me teorira të tilla revizioniste masat e gjera të popujve që kërkojnë çlirimin, është një krim që u bëhet popujve dhe revolucionit.

Partia Komuniste e Kinës mendon se imperializmi nuk di, nuk sheh, nuk i kupton dhe nuk i shfrytëzon kontradiktat që ekzistojnë midis vendeve që sapo kanë hedhur poshtë zgjedhën e kolonializmit dhe janë futur nën zgjedhën e neokolonializmit. Faktet tregojnë se këto kontradikta imperializmi i shfrytëzon çdo ditë e vazhdimisht në favorin e vet. Ai i nxit dhe i shtyn këto vende dhe popujt e tyre të luftojnë njëri kundër tjetrit, të përçahen, të grinden dhe të mos arrijnë në unitet, qoftë edhe për disa probleme të veçanta.

Imperializmi lufton edhe ai për jetë a për vdekje, përpiqet të zgjatë jetën e tij dhe, kur sheh se nuk ka mundësi që ta arrijë këtë me mjetet e zakonshme, atëherë hidhet edhe në luftë e agresion të hapur për të fituar përsëri epërsinë dhe hegjemoninë.

Udhëheqësit kinezë dëshirojnë t'i bashkojnë vendet e «botës së tretë» jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër socialimperializmit sovjetik. Me fjalë të tjera, revizionistët kinezë u thonë haptazi popujve të «botës së tretë» se armiku i tyre kryesor është socialimperializmi sovjetik, prandaj aktualisht ata nuk duhet të ngrihen as kundër imperializmit amerikan dhe as kundër aleates së tij, borgjezisë reaksionare që sundon në vendet e tyre. Sipas «teorisë» kineze, shtetet e «botës së tretë» duhet të luftojnë jo për forcimin e lirisë, pavarësisë e sovranitetit, jo për revolucionin, që përmbys sundimin e borgjezisë, por për statukuonë. Është e kuptueshme se, duke predikuar marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. në kundërshtim me interesat e revolucionit dhe të çështjes së çlirimit kombëtar, revizionistët kinezë i shtyjnë këto shtete në një kompromis tradhtar.

Partitë e vërteta marksiste-leniniste kanë për detyrë internacionaliste të inkurajojnë e të frymëzojnë proletariatin dhe popujt e të gjitha këtyre vendeve që të bëjnë revolucion, të ngrihen kundër shtypjes e skllavërimit të jashtëm e të brendshëm në çdo formë që të paraqiten. Partia jonë mendon se vetëm kështu mund të krijohen kushtet që popujt të luftojnë edhe imperializmin, edhe socialimperializmin, me të cilët borgjezia

kapitaliste e shumicës së këtyre vendeve të «botës së tretë» është e lidhur në format më të ndryshme.

Po ç'bën Kina? Kina mbron Mobutun dhe klikën e tij në Zaire. Në propagandën që zhvillon ajo përpiqet të krijojë përshtypjen sikur gjoja po mbron popullin e këtij vendi prej invadimit të mercenarëve të kurdisur nga Bashkimi Sovjetik, por në realitet mbron regjimin reaksionar të Mobutus. Klika e Mobutus është një agjunkturë në shërbim të imperializmit amerikan. Me propagandën dhe me qëndrimin e saj «pro Zairesë», Kina mbron aleancën e Mobutus me imperializmin amerikan, me neokolonializmin dhe lufton që në atë vend të mos ndryshojë statukuoja e vendosur. Detyra e revolucionarëve të vërtetë nuk është që të mbrojnë sundimtarët reaksionarë, vegla të imperialistëve, por të punojnë për të frymëzuar popullin e Zairesë që të luftojë për lirinë dhe sovranitetin e tij kundër Mobutus, kapitalit vendas dhe imperializmit amerikan, francez, belg etj.

Po ashtu si kundër Mobutus në Zaire, ne jemi kundër Netos ose ndihmësve të tij në Angola, pse të njëjtën gjë që bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mobutuja në Zaire, bën edhe Bashkimi Sovjetik me Neton në Angola. Duke marrë në shqyrtim zhvillimin e gjendjes në këto dy shtete që përmendëm, duket qartë se si zhvillohet atje rivaliteti midis superfuqive për të ndarë kolonitë, për të ndarë tregjet. Ne nuk mbrojmë as Neton, as Bashkimin Sovjetik, por, duke luftuar kundër tyre, nuk mund të mbështetim imperializmin amerikan dhe mercenarët e tij, armiq të popullit anglez. Në çdo situatë, në çdo rrethanë dhe

në çdo kohë duhet të mbështetim popujt revolucionarë dhe, në rastin e Zairesë e të Angolës, duhet të mbështetim vetëm popujt e këtyre dy vendeve për të hedhur tej zgjedhën që po u vënë në zverk superfuqitë.

Çfarë duhet t'u rekomandohet revolucionarëve të Zairesë? Të bëjnë kompromis me Mobutun, që populli i këtij vendi të shtypet akoma më shumë nga imperia-lizmi, siç rekomandojnë revizionistët kinezë? Jo, marksistë-leninistët nuk mund t'ia rekomandojnë këtë lloj kompromisi popullit të Zairesë dhe asnjë populli tjetër.

Le të marrim si shembull politikën e Kinës në Pakistan. Pakistani i khanëve, ku kanë sunduar kurdoherë borgjezia e pasur dhe latifondistët e mëdhenj, ka qenë gjoja aleat i Kinës. Ndihma e Kinës për këtë vend nuk ka qenë një ndihmë me drejtim revolucionar. Ajo ka ndihmuar forcimin e borgjezisë reaksionare dhe latifondiste të Pakistanit, e cila shtyp egërsisht popullin e këtij vendi, ashtu siç shtyp popullin indian klika e Nehruit, e Gandit dhe e manjatëve të tjerë reaksionarë. E njëjtë ishte edhe qeveria e Zylfikar Ali Butos. Më parë ndodhi shkëputja e Pakistanit Lindor nga Pakistani Perëndimor. India diti t'i shfrytëzojë kontradiktat e mëdha që ekzistonin në mes popullit të Pakistanit Lindor me borgjezinë reaksionare që sundonte në Pakistanin Perëndimor. Ajo i nxiti këto kontradikta derisa e çoi popullin e Pakistanit Lindor në kryengritje kundër Pakistanit të Ali Butos. U krijua në atë kohë në Pakistanin Lindor, që mori emrin Bangladesh, qeveria e Muxhibur Rahmanit, që luftonte gjoja për demokraci dhe për interesat e po-



pullit. Po Muxhibur Rahmani një mëngjes u vra nga elementë të lidhur ngushtë me imperializmin amerikan. Tani edhe Ali Buto u përmbys. Kështu miku dhe aleati i Kinës, latifondisti dhe pasaniku më i madh i Pakistanit, u rrëzua nga reaksionarë të tjerë me një grusht shteti.

Po ç'është kjo opozitë që erdhi në fuqi dhe kush janë ata që bëjnë pjesë në të? Edhe kjo është një forcë reaksionare, në të bëjnë pjesë ushtarakë, kapitalistë e çifligarë të mëdhenj. Të shtyrë nga interesat e tyre të klasës dhe nga lidhjet që kanë edhe këta qoftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë me Bashkimin Sovjetik, qoftë me Kinën, kërkojnë të mbajnë fort në duart e tyre pushtetin reaksionar. Në këto kushte t'i flasësh popullit të Pakistanit për aleancë të ngushtë dhe për përkrahje në favor të njërës apo të tjetrës forcë politike borgjeze, që të zëvendësojë një klikë sunduesish me një tjetër, siç bëjnë udhëheqësit kinezë, atij nuk i tregohet rruga e drejtë e revolucionit. Rruga e drejtë është t'i kërkohet popullit që në mes të dy zjarreve, të Butos dhe kundërshtarëve të tij, të ndezë zjarrin e fuqishëm revokucionar që t'i shuajë dy të parët, t'i përmbysë të dyja klikat e një brumi që ekzistojnë në Pakistan. Në këtë luftë në të dy krahët vetë populli pakistanez duhet të dijë të përfitojë nga kontradiktat.

Kështu mund të flasim për shumë vende të së ashtuquajturës botë e tretë ose «botë e paangazhuar».

Pra, udhëheqja kineze, jo vetëm në aleancat dhe në miqësinë me marksistë-leninistët, por edhe në ale-

ancat me shtetet borgjezo-kapitaliste nuk ka fat. Po përse nuk ka fat? Nuk ka fat, sepse politika e saj nuk është marksiste-leniniste, sepse analizat që bën dhe deduksionet që nxjerr prej tyre janë të gabuara. Në këto kushte çfarë besimi mund të kenë popujt e «botës së tretë» ndaj Kinës, e cila ka për qëllim t'i futë këto vende nën shtetullën e vet?

Vetëm diktatura e proletariatit, vetëm ideologjia marksiste-leniniste, vetëm socializmi krijojnë dashurinë e sigurtë, miqësinë e ngushtë dhe unitetin e çeliktë në mes popujve, duke zhdukur çdo gjë që i ndan e i përçan ata. Për të krijuar unitetin dhe miqësinë e popujve, për t'i zgjidhur problemet në rrugën më të mirë e më të përshtatshme për interesat e tyre, në asnjë mënyrë nuk duhet të ndihmohen e t'u bëhen lëshime borgjezëve të tillë të degjeneruar si Mobutu, Buto, Gandi e të tjerë në emër të krijimit gjoja të ekuilibrit politik, që është një shprehje e teorisë antishkencore, antipopullore e oportuniste të «ekuilibrit», e cila shërben për ruajtjen e statukuosë e të skllavërimit.

Ne, marksistë-leninistët, luftojmë kundër neokolonializmit, kundër borgjezisë shtypëse kapitaliste të çdo vendi, pra kundër atyre që i shtypin popujt. Kjo luftë mund të bëhet në qoftë se partitë e vërteta komuniste frymëzojnë, organizojnë dhe udhëheqin proletariatin dhe masat punonjëse. Udhëhoqja e proletariatit dhe e masave nga partia arrihet me sukses kur ajo ka një frymëzim marksist-leninist revolucionar dhe jo një frymëzim ekuivok me njëqind kuptime, me njëqind flamurë. Partia marksiste-leniniste e vendit

të vërtetë socialist nuk vepron duke u nisur vetëm nga interesi i shtetit të vet, por mban gjithnjë parasysh edhe interesin e revolucionit botëror.

### **Teoria kineze mbi «botën e tretë» dhe teoria jugosllave mbi «botën e paangazhuar» sabotojnë luftën revolucionare të popujve**

Të gjithë renegatët e marksizëm-leninizmit, revizionistët modernë, sovjetikë, titistë, kinezë e të tjerë, bëjnë çmos që të luftojnë marksizëm-leninizmin, teorinë fitimtare të proletariatit. Demaskimi që Partia jonë i bëri teorisë së «tri botëve», i ka vënë në pozitë të vështirë revizionistët kinezë, pasi nuk janë në gjendje t'u përgjigjen teorikisht kundërshtimit dhe demaskimit tonë, jo pse tremben nga ne, por tremben nga mungesa e argumenteve.

Mao Ce Duni dhe Ten Hsiao Pini, që e kanë cnonuar ose që e kanë bërë të tyren nocionin e «botës së tretë», nuk kanë mundur dhe nuk kanë dashur, jo pa qëllim, ta argumentojnë teorikisht atë. Pse nuk e kanë bërë këtë gjë? Kjo «neglizhencë» e tyre është me hile dhe ka për qëllim t'i mashtrorë njerëzit, të bëjë që këta ta pranojnë pa diskutim një tërë absurde, vetëm sepse e ka nxjerrë Mao Ce Duni. Mao Ce Duni nuk ka mundur ta shpjegojë se ku qëndron baza teorike e këtij nocioni «filozofik» ose «politik», sepse nuk ka si e shpjegon. Ai dhe nxënësit e tij e propagandojnë konceptin e tyre të ndarjes së botës më trish vetëm duke

e shpallur, por pa e mbrojtur, sepse edhe vetë ata e dinë që kjo tezë është e pambrojtshme.

«Bota e tretë» kineze dhe «bota e paangazhuar» jugosllave janë gati e njëjta gjë. Që të dyja këto «botë» kanë për qëllim të justifikojnë teorikisht shuarjen e luftës klasore në mes proletariatit dhe borgjezisë dhe t'u shërbejnë fuqive të mëdha imperialiste e kapitaliste për të ruajtur e për të përjetësuar sistemin borgjez të shtypjes e të shfrytëzimit.

Teoria e «botës së tretë», si teori e rreme, anti-marksiste, pa asnjë bazë teorike, miti që kanë krijuar rreth saj revizionistët kinezë, nuk ka asnjë efekt jo vetëm në masat e gjera të proletariatit dhe të popujve që vuajnë në vendet e «botës së tretë», por as edhe në udhëheqësit e këtyre vendeve. Këta të fundit, që udhëheqja kineze kërkon t'i fusë nën çadrën e vet, kanë pikëpamjet e tyre të rrënjosura në kokë, kanë ideologjinë e tyre dhe orientime të përcaktuara, prandaj përrallat kineze nuk i hanë. Ten Hsiao Pinët me shokë mendojnë se Kina me madhësinë e territorit e të popullsisë së saj do t'u imponohet këtyre vendeve. Deri në njëfarë shkalle, derisa nuk i prish punë, imperializmit amerikan i leverdis teoria kineze e «tri botëve». Kjo teori ushqen krijimin e situatave konfuze në botë, nga të cilat përfitojnë si imperializmi amerikan, ashtu edhe socialimperializmi sovjetik për të shtrirë secili hegjemoninë e vet, për të ndërlikuar e për të thurur akoma më shumë e më fort aleanca dhe marrëveshje me krerët kapitalistë e çifligaro-borgjezë të vendeve të botës së ashtuquajtur të tretë. Kjo situatë u shërben edhe qëllimeve socialimperialiste të revizionistëve kinezë.

Për sa i përket teorisë së «botës së paangazhuar» revizionistët jugosllavë e ngrenë në një teori universale, që duhet të zëvendësojë teorinë marksiste-leniniste, e cila për ta «është vjetruar», nuk është më «aktuale», pse popujt dhe bota gjoja kanë ndryshuar. Marksizëm-leninizmin nuk e denoncojnë hapur si Krriljoja, por, me mbrojtjen e teorisë së tyre të «botës së paangazhuar», e luftojnë atë, ndërsa ata që e mbrojnë marksizëm-leninizmin, sipas revizionistëve jugosllavë, përsëritin gjithmonë të njëjtin «faj», nuk pranojnë që të korrigjohen parimet, normat e kësaj doktrine revolucionare, prandaj janë «recidivistë». Sipas tyre, Partia e Punës e Shqipërisë (këtu e kanë qëllimin e sulmit) është një parti «recidiviste», sepse kërkon të zbatohen parimet, metodat, doktrina shkencore e Marksit, Engelsit, Leninit dhe e Stalinit në «një botë krejt të ndryshme nga ajo e kohës së tyre».

Pikëpamjet titiste janë krejt antimarksiste. Nga këto pozita niset edhe analiza që i bëjnë ata procesit të zhvillimit të sotëm botëror. Revizionizmi modern, në përgjithësi, dhe revizionizmi jugosllav e ai kinez, në veçanti, janë kundër revolucionit. Revizionistët jugosllavë e kinezë e konsiderojnë imperializmin amerikan si një forcë të fuqishme që mund të hyjë në një rrugë më të logjikshme, «të ndihmojë» botën e sotme, e cila, sipas tyre, është në zhvillim dhe nuk dëshiron të jetë e angazhuar. Por vetë termit «të paangazhuar» teoria jugosllave nuk arrin dot t'i japë përkufizimin e duhur. Vendet që ajo i fut në këtë botë të saj, në ç'pikëpamje janë të paangazhuara, politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht apo ushtarakisht? Këtë

çështje teoria pseudomarksiste jugosllave nuk e prek, nuk e përmend, për arsye se të gjitha këto vende, që ajo kërkon t'i udhëheqë gjoja si një botë e re, nuk mund të shpëputen nga vartësia e shumëllojshme që kanë me imperializmin amerikan ose me socialimperializmin sovjetik.

«Teoria» jugosllave spekulon me faktin që aktualisht është zhdukur në përgjithësi kolonializmi i tipit të vjetër, por ajo nuk thotë se shumë popuj kanë rënë në kthetrat e kolonializmit të ri. Ne, marksistë-leninistët, nuk e mohojmë faktin që kolonializmi i formave të vjetra është zhdukur, por theksojmë se ai është zëvendësuar me neokolonializmin. Janë po ata kolonizatorë të djeshëm, që vazhdojnë të shtypin edhe tani popujt nëpërmjet fuqisë së tyre ekonomike e ushtarakë, që i çoroditin politikisht e ideologjikisht, duke futur edhe mënyrën e korruptuar të jetesës së tyre. Një situatë të tillë titistët e quajnë një transformim të madh të botës dhe shtojnë se këtë nuk e ka njohur as Marksi, as Lenini, pale Stalini, të cilin ata nuk e pranojnë fare. Sipas tyre, tani popujt janë të lirë, të pavarur, ata aspirojnë vetëm të bëhen të paangazhuar, kurse pasuritë e botës të gjejnë një ndarje më racionale, më të drejtë.

«Teoricienët» jugosllavë kërkojnë që, për realizimin e kësaj «aspirate», imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë, si dhe shtetet kapitaliste të zhvilluara të vënë dorën në zemër dhe në mënyrë dashamirëse, nëpërmjet konferencave ndërkombëtare, nëpërmjet debateve, lëshimeve e koncesioneve që do t'i bëjnë vendet njëri-tjetrit të kontribuojnë në ndryshi-

min e botës së sotme, e cila, siç thonë ata, «është e ndërgjegjshme për të shkuar në socializëm».

Këtë «socializëm» predikojnë revizionistët titistë, predikim që e nxitin për të larguar popujt sa më shumë nga realiteti. Duke mos qenë për revolucionin, ata janë për ruajtjen e paqes shoqërore, që borgjezia dhe proletariati të merren vesh për «përmirësimin e jetesës së klasave të ulëta». Domethënë ata kërkojnë me përlulësi nga klasat e larta që këto të bëhen «bujare» dhe të lëshojnë diçka nga fitimet e tyre, për «të mjeruarit e botës».

Teorinë mbi «botën e paangazhuar» Titoja kërkon ta kthejë e ta bëjë «një doktrinë universale», që gjoja i përshtatet, siç e përmendëm më lart «gjendjes aktuale botërore». Popujt e botës janë zgjuar dhe duan të rrojnë të lirë, por kjo «liri», sipas teorisë së Titos, aktualisht nuk është «e plotë», për arsye se ekzistojnë dy blloqe, blloku i NATO-s dhe ai i Varshavës.

Titoja hiqet si personaliteti dhe flamurtari i politikës kundër blloqeve. Vërtet vendi i tij nuk bën pjesë në NATO dhe në Traktatin e Varshavës, por ai është i lidhur me shumë fije me këto organizata ushtarake. Ekonomia dhe politika jugosllave nuk janë të pavarura, ato janë të kushtëzuara nga kreditë, nga ndihmat e borxhet e vendeve kapitaliste, e në radhë të parë të imperializmit amerikan, prandaj mbështetet më tepër te ky imperializëm. Por Titoja mbështetet, po ashtu, edhe tek imperializmi sovjetik dhe tek të gjitha fuqitë e tjera të mëdha kapitaliste. Kështu Jugosllavia, që hiqet si e paangazhuar, *de facto*, në mos

*de jure*, është e angazhuar në organizatat agresive të superfuqive.

Si Titoja ka në botë edhe mjaft udhëheqës në vende të ndryshme, të cilët ai kërkon t'i grumbullojë në të ashtuquajturën botë e paangazhuar. Këto personalitete, përgjithësisht, janë borgjezë, kapitalistë, jomarksistë, shumë nga ata luftojnë kundër revolucionit. Apelacionet socialist, demokrat, socialdemokrat, republikan, republikan independent e të tjera që i veshin vetes disa nga këto personalitete, në shumicën e rasteve shërbejnë për t'i gënjyer proletariatin dhe popullin e shtypur, për t'i mbajtur ata nën zgjedhë, për të luajtur në kurrizin e tyre.

Në shtetet «e paangazhuara» sundon ideologjia kapitaliste, antimarksiste. Shumë nga këto shtete janë në ato lidhje e ndërlikime që Jugosllavia titiste është me superfuqitë dhe me të gjitha vendet kapitaliste të zhvilluara të botës. Grupimi në «botën e paangazhuar» që Titoja predikon për të gjitha vendet e botës, nën drejtimin e tij, ka si bazë të vetme pikësynimin dhe veprimtarinë për të shuar revolucionin, për t'i penguar proletariatin dhe popujt që të ngrenë krye e të rrëzojnë shoqërinë e vjetër kapitaliste dhe të vendosin shoqërinë e re, socializmin.

Kjo është ideja dhe ky është parimi kryesor nga udhëhiqet Titoja për grumbullimin e këtyre vendeve. Ai hiqet sikur e ka arritur grumbullimin dhe drejtimin e tyre, por, në fakt, një gjë e tillë nuk ekziston, pse teorisë titiste mbi «botën e paangazhuar», ashtu si dhe asaj kineze mbi «tri botët», askush nuk i vë atë rëndësi që dëshirojnë e kërkojnë flamurtarët e ty-



re. Gjithkush ecën sipas mënyrës së vet në rrugën që i sjell përfitime më të mëdha e më imediate.

«Bota e paangazhuar» e Titos, sipas të gjitha she-njave, është më e preferuar për imperializmin amerikan dhe për kapitalizmin botëror sesa «bota e tretë» e kinezëve. Vendet e zhvilluara kapitaliste dhe imperializmi amerikan, sido që e mbështetin teorinë kineze të «tri botëve», prapëscrapë kanë njëfarë druajtjeje dhe njëfarë ngurrimi, pse forcimi i Kinës mund të sjellë situata të papëlqyeshme dhe të bëhet pastaj i rrezikshëm edhe për vetë amerikanët. Kurse «bota e paangazhuar» e Titos nuk u shkakton Shteteve të Bashkuara të Amerikës asnjë rrezik. Prandaj Karteri, gjatë vizitës së fundit të Titos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ngriti shumë lart rolin e këtij të fundit për krijimin e «botës së paangazhuar» dhe e cilësoi lëvizjen e «vendeve të paangazhuara» si «një faktor shumë të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve të mëdha të botës së sotme».

«Vendet e paangazhuara», që në shumicë janë vende kapitaliste, i kanë hedhur zaret e tyre. Ato dinë të manovrojnë politikisht dhe janë me ato fuqi imperialiste e kapitaliste që u japin më shumë ndihma. Të bësh politikë, sipas pikëpamjes borgjeze e kapitaliste, do të thotë të gënjesh, të dredhosh, t'ia hedhësh njërit e tjetrit sa më shumë e sa më shpejt. Kjo politikë është një politikë prostitucioni, që ka për qëllim, në momente të caktuara dhe sipas koniunkturave, të përfitojë të paktën një kësht nga një shtet më i fuqishëm për interesat e klasës së vet, për interesat e bosëve të kësaj klase.

Titizmi me teorinë e «botës së paangazhuar» predikon pikërisht këtë politikë. Por ajo nuk ka kudo një orientim të njëjtë, siç reklamon Titoja. Shtetet «e paangazhuara» nuk pyësin Titon se ç'duhet të bëjnë dhe si duhet të veprojnë. Me ndonjë përjashtim, sundimtarët e këtyre shteteve përpiqen të forcojnë pushtetin kapitalist, të shfrytëzojnë popullin, të kenë miqësi me një vend të madh imperialist, të mos lejojnë shpërthimin e të shuajnë çdo revoltë e kryengritje popullore, çdo revolucion. Kjo është gjithë politika e «botës së paangazhuar» titiste.

Për statukuonë është edhe teoria kineze e «botës së tretë». «Bota e paangazhuar» titiste ka për qëllim të lypë nga imperializmi amerikan dhe nga vendet e tjera kapitaliste kredl për të pasuruar e për të mbajtur në fuqi klasën borgjeze. Edhe Kina me «botën e tretë» kërkon të pasurohet vetë, të forcohet ekonomikisht e ushtarakisht për t'u bërë superfuqi që të dominojë botën. Qëllimet e të dyja këtyre «botëve» janë antimarksiste, janë pro kapitalit, pro imperializmit amerikan.

Revizionistët jugosllavë, siç e tregoi edhe vizita e Titos në Kinë dhe ajo e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi, po i bëjnë shumë elozhe dhe lajka dinake Kinës, që i përshtaten fare mirë karakterit të revizionistëve kinezë, për t'i ndjellë ata në pozitat e tyre, me qëllim që teoria e «vendeve të paangazhuara» të gjejë jo vetëm një mirëkuptim, por edhe një pranim të plotë nga ana e Pekinit. Udhëheqësit revizionistë kinezë me Hua Kuo Fenin e Ten Hsiao Pinin në krye, megjithëse nuk heqin dorë nga teoria e «botës së tretë» janë

shprehur hapur në përkrahje të teorisë titiste të «botës së paangazhuar». Ata treguan se dëshirojnë të punojnë ngushtësisht në një vijë me revizionistët jugosllavë, në dy binarë paralelë, me një qëllim të përbashkët antimarksist për të gënjyer popujt e «botës së tretë». Udhëheqësit jugosllavë po i zhvillojnë tash këto pikëpamje në mbrojtje të Kinës. Duke e mbrojtur këtë, ata kanë ngritur bile edhe disa «argumente», të cilat janë ofenduese për Kinën, si një shtet megaloman që është. Titistët i dalin përkrah Kinës dhe e mbrojnë atë nga demaskimi që i bën Partia jonë udhëheqëse kineze, duke thënë se politika aktuale e Kinës qenka realiste.

Kina, thonë jugosllavët, është një vend i madh, i cili, për natyrën e tij, duhet të zhvillohet, pse është akoma i prapambetur, është një vend në zhvillim. Është gabim, pretendojnë titistët, që Kina për aspiratat e saj të drejta të zhvillimit dhe të mosangazhimit, të ndihmës që ajo u jep luftërave nacionalçlirimtare etj., etj., të atakohet nga partitë marksiste-leniniste, si Partia e Punës e Shqipërisë. Jugosllavia ka pretendimin që Kina të vijë rrotull si një satelit i saj. Për revizionistët jugosllavë rëndësi ka që Kina të adoptojë pa asnjë hezitim pikëpamjet e tyre antimarksiste.

Me teorinë e «botës së paangazhuar», Jugosllavia me Titon në krye i ka shërbyer gjithnjë me besnikëri imperializmit amerikan. Këtë lloj shërbimi Titoja dhe grupi i tij po e kryejnë edhe tash, duke u përpjekur që Kinën ta shtyjnë drejt afrimit dhe aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky ishte qëllimi kryesor i vajtjes së Titos në Pekin dhe i bisedimeve të tij, të

cilat rezultuan në lidhjen e një miqësie të ngushtë dhe që me vizitën e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi mori formën e një bashkëpunimi të gjerë jo vetëm shtetëror, por edhe në rrugë partic. Udhëheqësit kinezë, gjatë vizitës së Titos në Pekin, përgjysmë e pohuan se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë është një parti marksiste-leniniste dhe se në Jugosllavi ndërtohet socializmi i vërtetë. Kur Hua Kuo Feni erdhi në Beograd, këtë e pohuan plotësisht e zyrtarisht.

Me fjalë të tjera maoistët bënë atë punë që bënë në kohën e tyre Mikoiani dhe Hrushovi, që njohën me plot gojën se Titoja është «marksist», se «në Jugosllavi ndërtohet socializmi», se «Partia Komuniste e Jugosllavisë është një parti marksiste-leniniste».

Shtetet e Bashkuara të Amerikës luajnë sipas dëshirave të tyre si me fijen Tito, ashtu edhe me fijen Hua Kuo Fen dhe Ten Hsiao Pin. Këta të dy të fundit janë marioneta që nuk dalin hapur në skenat e teatrove për kalamanët, por janë nga ata që maskohen dhe, kur atakohen në teoritë e tyre, kur nuk gjejnë fakte për të polemizuar, shpallin se «nuk bëjmë polemikë»! Pse nuk bëjnë polemikë me Shqipërinë socialiste, kur ajo dhe Partia e Punës marksiste-leniniste i demaskojnë keqas në opinionin botëror? Çfarë presin ata? Ata nuk bëjnë polemikë për arsye se kanë frikë se demaskohet loja e tyre tradhtare ndaj marksizëm-leninizmit dhe ndaj revolucionit. Këtu qëndron qëllimi dhe fshehja e së vërtetës, kur udhëheqësit kinezë, nëpërmjet jugosllavëve e të tjerëve, thonë se Kina nuk do t'i përgjigjet polemikës shqiptare.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi So-

vjetik si edhe vende të tjera kapitaliste vazhdimisht bëjnë mbledhje të ndryshme dypalëshe, shumëpalëshe, mbajnë konferenca të çdollojta, mbajnë kongrese, adoptojnë rezoluta, mbajnë fjalime e konferenca shtypsi, thonë plot gënjeshtra e japin shpresa, bëjnë kërcënime e shantazhe. Të gjitha këto bëhen për të kaluar krizën që u ka zënë këmbët, për të shuar ndjenjën e hakmarrjes së popujve të shtypur që vuajnë, për të gënjyer masat e gjera punonjëse dhe proletariatin, për të gënjyer demokratët përparimtarë. Në gjithë këtë lojë, në këtë labirint të ndytë, luajnë kartën e tyre edhe revizionistët jugosllavë e ata kinezë.

Edhe teoria e «botës në zhvillim» është një kartë e kësaj loje, që ka të njëjtin qëllim antimarksist, të ngatërrojë mendjet e njerëzve. Kjo teori nuk zë në gojë çështjet politike, pse është e kotë që t'i zërrë. Për të ekziston vetëm «çështja ekonomike» dhe «çështja e zhvillimit» në përgjithësi. Se çfarë zhvillimi kërkon teoria e «botës në zhvillim», këtë nuk e përcakton kurrkush. Natyrisht, vendet e ndryshme të botës dëshirojnë të zhvillohen në të gjitha fushat e jetës, ekonomike, politike, kulturore etj. Popujt e botës, me proletariatin në krye, duan ta rrëzojnë botën e vjetër e të kalbur borgjeze kapitaliste dhe në vend të saj të ndërtojnë botën e re, socializmin. Por për këtë botë nuk flitet në teorinë e «botës së paangazhuar» e të «botës në zhvillim».

Kur ne, marksistë-leninistët, flasim për vendet e ndryshme, japim edhe konsideratat tona për to, bëjmë edhe vlerësimet për shkallën e zhvillimit të një vendi

ose të një tjetri, për mundësitë e çdo shteti në këtë drejtim. Ne themi se populli i çdo vendi duhet të bëjë revolucionin e të ndërtojë shoqërinë e re me forcat e veta. Ne themi se çdo shtet i lirë, i pavarur e sovran duhet të ndërtojë një shoqëri të re, të luftojë e të përmbysë shtypësit e tij, të luftojë çfarëdo imperializmi që e skllavëron, të fitojë e të mbrojë të drejtat politike, ekonomike, kulturore, të ndërtojë një atdhe plotësisht të lirë, plotësisht të pavarur, ku të sundojë klasa punëtore në aleancë me të gjitha masat punonjëse. Këtë themi në dhe jemi mbrojtës të vendosur të tezës leniniste mbi dy botët. Ne jemi pjesëtarë të botës së re socialiste dhe luftojmë për vdekje botën e vjetër kapitaliste.

Të gjitha «teoritë» e tjera mbi ndarjen e botës, në «botë të parë», «botë të dytë», «botë të tretë», «botë të paangazhuar», «botë në zhvillim» ose ndonjë «botë» tjetër që mund të shpiket nesër, i shërbejnë kapitalizmit, i shërbejnë hegjemonisë së fuqive të mëdha, u shërbejnë qëllimeve të tyre për të mbajtur në skllavëri popujt. Kjo është arsyeja që ne i luftojmë këto teori reaksionare e antimarksiste me të gjitha forcat.

Kjo luftë e Partisë sonë ndiqet me simpati në të gjithë botën, sidomos në vendet e të ashtuquajturave botë e tretë, botë e paangazhuar ose botë në zhvillim. Popujt e këtyre vendeve që teorinë revizioniste kineze, titiste, sovjetike e teorinë e imperializmit amerikan etj., kërkojnë t'i gënjejnë, shohin në pikëpamjet tona marksiste-leniniste, në qëndrimin ideologjiko-politik të Partisë sonë një qëndrim korrekt që i përgjigjet

rrugës së drejtë të çlirimit të tyre përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi.

Pikërisht për këtë armlqhtë e marksizëm-leninizmit e të Partisë sonë përpiqen të na akuzojnë se jemi sektarë, se jemi ultramajtistë, jemi blankistë, se nuk i bëjmë një analizë të drejtë gjendjes ndërkombëtare, por qëndrojmë në disa skema të vjetra etj. Kuptohet se ata e kanë fjalën për doktrinën tonë revolucionare, të cilën e quajnë «skematizëm marksist-leninist», «skematizëm stalinian» etj.

Ata na akuzojnë se gjoja u bëjmë thirrje vendeve, që kanë shpëtuar nga forma e shfrytëzimit të kolonializmit të vjetër dhe që kanë hyrë në formën e shfrytëzimit të kolonializmit të ri, për të kaluar përnjëherë në socializëm, për të bërë përnjëherë një revolucion proletar. Me këtë ata mendojnë se na godasin, duke na paraqitur si aventurierë. Por Partia jonë i qëndron besnike teorisë marksiste-leniniste, asaj teorie që e ka përcaktuar drejt rrugën e revolucionit, etapat nëpër të cilat duhet të kalojë ky revolucion dhe kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që revolucioni, qoftë ai nacional-demokratik e antiimperialist, qoftë revolucioni socialist, të realizohet me sukses. Kësaj teorie ne i kemi qëndruar besnikë në Luftën tonë Antifashiste Nacionalçlirimtare, i qëndrojmë aktualisht besnikë në ndërtimin e socializmit, i qëndrojmë besnikë në luftën tonë ideologjike dhe në politikën tonë të jashtme. Analiza jonë është e drejtë, prandaj atë nuk mund ta lëkundë asnjë shpifje.

## II

### PLANI I KINËS PËR T'U BËRË SUPERFUQI

Në fillim, duke analizuar strategjinë globale të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik për sundimin e botës, duke analizuar lindjen dhe zhvillimin e varianteve të ndryshme të revizionizmit modern, si dhe luftën që bëjnë të gjithë këta armiq kundër marksizëm-leninizmit e revolucionit, folëm edhe për vendin dhe strategjinë e revizionizmit kinez.

Vijën politike që ndjek, Kina e vetëquan marksiste-leniniste, por realiteti tregon të kundërtën. Përkërisht këtë realitet ne, marksistë-leninistët, duhet ta demaskojmë. Ne nuk duhet të lejojmë që teoritë revizioniste kineze të kalojnë për teori marksiste, nuk duhet të lejojmë që Kina, në rrugën ku është futur, të hiqet sikur po lufton për revolucionin, kurse në realitet ajo është kundër tij.

Me politikën që ndjek Kina, po duket edhe më qartë se ajo kërkon të forcojë pozitën e kapitalizmit në vend dhe të vendosë hegjemoninë e saj në botë, të bëhet një fuqi e madhe imperialiste, për të zënë, si i thonë, edhe ajo «vendin që meriton».



Historia tregon se çdo vend i madh kapitalist synon të bëhet një fuqi e madhe botërore, të arrijë e t'u dalë përpara fuqive të tjera të mëdha, të konkurrojë me to për sundimin botëror. Rrugët e shteteve të mëdha borgjeze për t'u shndërruar në fuqi imperialiste kanë qenë të ndryshme, ato janë kushtëzuar nga rrethana të caktuara historike e gjeografike, nga zhvillimi i forcave prodhuese etj. E ndryshme është rruga e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga ajo e fuqive të vjetra evropiane, si Anglia, Franca e Gjermania. Këto të fundit u formuan si të tilla mbi bazën e pushtimeve koloniale.

Pas Luftës së Dytë Botërore Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetën fuqia më e madhe kapitaliste. Ato mbi bazën e potencialit të madh ekonomik e ushtarak që dispononin dhe me zhvillimin e neokolonializmit, u shndërruan në një superfuqi imperialiste. Por s'kaioi shumë kohë dhe kësaj superfuqie iu shtua edhe një tjetër, Bashkimi Sovjetik, i cili, pas vdekjes së Stalinit dhe pasi udhëheqja hrushoviane tradhtoi marksizëm-leninizmin, u shndërrua në një superfuqi imperialiste. Ai shfrytëzoi për këtë qëllim potencialin e madh ekonomik, teknik dhe ushtarak të ngritur nga socializmi.

Tani ndodhemi përpara përpjekjeve të një tjetër shteti të madh për t'u bërë superfuqi, të Kinës së sotme, pasi edhe kjo po ecën me shpejtësi në rrugën e kapitalizmit. Por Kinës i mungojnë kolonitë, i mungon një industri e madhe e zhvilluar, i mungon një ekonomi e fortë në përgjithësi, një potencial i madh termobërthamor i asaj shkalle që kanë të dy superfuqitë e tjera imperialiste.

Për t'u bërë superfuqi nevojitet medoemos një ekonomi e zhvilluar, një ushtri e armatosur me bomba atomike, nevojitet sigurimi i tregjeve dhe i zonave të influencës, investimi i kapitaleve në vendet e huaja etj. Këto kushte Kina kërkon t'i sigurojë sa më shpejt. Kjo është shprehur në fjalimin që mbajti Çu En Lai në Asamblenë Popullore në vitin 1975 dhe u përsërit në Kongresin e 11-të të Partisë Komuniste të Kinës, ku u shpall se, përpara fundit të këtij shekulli, Kina do të bëhet një vend i fuqishëm e modern, me synimin që të arrijë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik. Tani i tërë ky plan është zgjeruar e precizuar në atë që quhet politika e «katër modernizimeve».

Por ç'rrugë ka zgjedhur Kina për t'u bërë edhe kjo një superfuqi? Aktualisht kolonitë dhe tregjet në botë janë të zëna nga të tjerët. Krijimi me forcat e veta, brenda 20 vjetëve, siç pretendojnë udhëheqësit kinezë, i potencialit ekonomik dhe ushtarak, i barabartë me atë që kanë amerikanët dhe sovjetikët, është i pamundur.

Në këto kushte, për t'u bërë superfuqi, Kinës do t'i duhet të kalojë nëpër dy faza kryesore: E para, të kërkojë kredi dhe investime nga imperializmi amerikan dhe nga vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, të blejë teknologji të re për të shfrytëzuar pasuritë e vendit të vet, një pjesë e madhe e të cilave do të kalojë si dividende për huadhënësit. E dyta, mbivlerat e fituara në kurriz të popullit kinez ajo do t'i investojë në shtete të kontinenteve të ndryshme, ashtu siç po

bëjnë aktualisht imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë.

Përpjekjet e Kinës për t'u bërë superfuqi, në rradhë të parë, qëndrojnë në zgjedhjen e aleatëve dhe në krijimin e aleancave. Sot në botë ekzistojnë dy superfuqi, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. Udhëheqësit kinezë kanë menduar se duhet të mbështeten tek imperializmi amerikan, nga i cili kanë shpresa të mëdha të ndihmohen në fushën e ekonomisë, të financës, të teknologjisë, të organizimit, por edhe nga ana ushtarake. Potenciali ekonomiko-ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të vërtetë është më i madh se ai i socialimperializmit sovjetik. Këtë revizionistët kinezë e dinë mirë, pavarësisht se thonë që Amerika është në rënie. Në rrugën ku po ecin, ata nuk mund të mbështeten në një partner të dobët, nga i cili s'mund të përfitojnë shumë. Pikërisht sepse janë të fuqishme, ata kanë zgjedhur për aleat Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ujdia e politikës kineze me politikën e imperializmit amerikan ka edhe qëllime të tjera. Ajo përmban në vetvete edhe kërcënimin kundër socialimperializmit sovjetik, gjë që vihet re nga propaganda shurdhuese dhe veprimtaria e ethshme që zhvillojnë udhëheqësit kinezë kundër Bashkimit Sovjetik. Me këtë politikë që ndjek, Kina i jep të kuptojë Bashkimit Sovjetik revizionist se lidhjet e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmbajnë një forcë kolosale kundër tij në rastin e shpërthimit të një lufte imperialiste.

Politika aktuale kineze synon, gjithashtu, të lidhë miqësi dhe aleanca me të gjitha vendet e tjera të zhvilluara kapitaliste, nga të cilat kërkon të përfitojë politikisht dhe ekonomikisht. Kina dëshiron dhe përpiqet ta forcojë aleancën amerikane me këto vende të «botës së dytë», siç i quan ajo. Ajo nxit unitetin ose më mirë të themi nënshtrimin e tyre ndaj imperializmit amerikan, të cilin e konsideron si partnerin e saj më të madh.

Kështu shpjegohen të gjitha ato lidhje të ngushta që qeveria kineze kërkon të vendosë me të tëra shtetet kapitaliste të pasura, me Japoninë, Gjermaninë Perëndimore, Anglinë, Francën etj., kështu shpjegohen vizitat e shumta të delegacioneve qeveritare ekonomike, kulturore e shkencore, që dërgohen në Kinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga të gjitha vendet e tjera të zhvilluara kapitaliste, qofshin këto republika ose mbretëri, ashtu si dhe vizitat e delegacioneve kineze në ato vende. Kështu shpjegohet që Kina vepron me sistem për të manifestuar në çdo rast qëndrimin e vet në favor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të shteteve të tjera kapitaliste të industrializuara, duke u përpjekur të vërë në dukje çdo shkrim, çdo thënie e çdo veprim të këtyre shteteve kundër socialimperializmit sovjetik.

Kjo politikë e udhëheqësve kinezë nuk mund të mos bjerë në sy dhe të mos gjejë përkrahjen e duhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dihet se në kohën e Luftës së Dytë Botërore në Departamentin Amerikan të Shtetit ekzistonin dy lobi lidhur me çështjen kineze: njëra pro Çan Kai Shisë dhe tjetra

pro Mao Ce Dunit. Natyrisht, në ato kohë në Departamentin e Shtetit dhe në Senatin Amerikan fitoi lobi i Çan Kai Shisë, kurse në terren, në kontinent, në Kinë fitoi lobi i Mao Ce Dunit. Nga frymëzuesit e këtij lobi ishin Marshalli e Vandemejeri, Edgar Snou dhe të tjerë, të cilët u bënë miq e këshilltarë të kinezëve, nxitës e frymëzues të lloj-lloj organizimeve në Kinën e re. Këto fije lidhjesh të vjetra aktualisht po ringjallen, po forcohen, po trashen e po bëhen më konkrete. Tani kushdo e sheh se Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po afrohen gjithnjë e më shumë. Para pak kohësh një nga gazetatat më të informuara amerikane, «Uashington post», shkruante: «Ka tani një konsensus amerikan, i cili përkrahet, bile edhe nga e djathta, edhe nga ata që kanë pak simpati për Pekinin. Sipas këtij konsensusi çfarëdo të ketë ndodhur në të kaluarën, nuk ka më arsye që Kina të konsiderohet një kërcënim për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç Tajvanit, ka pak gjëra për të cilat të dy qeveritë nuk bien dakord. Të dyja palët kanë pranuar, në fakt, për ta shtyrë çështjen e Tajvanit, me qëllim që të përfitojnë në fusha të tjera».

Çështja e Tajvanit, që ngrihet në marrëdhëniet midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka mbetur diçka formale. Tash Kina nuk insiston për këtë çështje. Ajo as çan kokën fare për Hong-Kongun dhe nuk bëhet fare merak që Makaoja gjendet akoma nën sundimin e portugezëve. Qeveria kineze nuk e pranon ofertën e qeverisë së re portugeze për t'ia kthyer Kinës këtë koloni, duke thënë se «dhurata nuk kthehet». Ekzistenca e këtyre kolonive është diçka.

anakronike, por politikës pragmatiste të udhëheqësve kinezë kjo nuk i prish punë. Sa kohë që qëndrojnë si koloni Hong-Kongu dhe Makaoja, pse të mos jetë i tillë edhe Tajvani? Siç duket, Kinës i intereson shumë që edhe në të ardhmen Tajvani të qëndrojë siç është. Asaj i intereson që, përveç marrëdhënieve të hapëta, marrëdhënie që i zhvillon në dritën e diellit, përmes këtyre tri portave të zhvillojë edhe trafikun e maskuar me imperialistët amerikanë, me imperialistët anglezë, japonezë etj. Prandaj, profkat që kërkojnë të shesin Ten Hsiao Pini e Li Hsien Nieni, se gjoja marrëdhëniet kino-amerikane varen nga qëndrimi amerikan ndaj Tajvanit, nuk janë veçse mjegull për të fshehur rrugën e afrimit që ka marrë Kina drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'u bërë superfuqi.

Karteri ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të lidhin marrëdhënie diplomatike me Kinën. Për sa i përket Tajvanit do të adoptojnë qëndrimin e Japonisë, domethënë formalisht do t'i presin marrëdhëniet diplomatike me ishullin, pa prerë marrëdhëniet ekonomike e kulturore dhe, nën to, edhe ato ushtarake. Në fakt marrëdhëniet ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Tajvanin i interesojnë Kinës. Kjo dëshiron që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbajnë forca në Tajvan, në Japoni, në Korenë e Jugut dhe në Oqeanin Indian, mbasi kështu mendon se është më mirë për të, sepse krijohet një kundërpeshë ndaj Bashkimit Sovjetik.

Të gjitha këto qëndrime kanë lidhje me rrugën që ka zgjedhur udhëheqja kineze, që Kina të bëhet superfuqi, duke u përpjekur të zhvillojë ekonominë

dhe të rritë potencialin ushtarak nëpërmjet kredive dhe investimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të vendeve të tjera të mëdha kapitaliste. Ajo e përlligj këtë rrugë duke pretenduar se zbaton gjoja një politikë të drejtë, vijën «marksiste» të Mao Ce Dunit, sipas të cilit «Kina duhet të përfitojë nga sukseset e mëdha të botës, nga patentat, nga teknologjitë e reja, duke e vënë të huajën në shërbim të zhvillimit të brendshëm» etj. Artikujt e «Zhenminzhibaos» dhe fjalimet e udhëheqësve kinezë janë mbushur plot me parulla të tilla. Sipas konceptit kinez, të përfitosh nga shpikjet e arritjet industriale të shteteve të tjera do të thotë të marrësh kredi e të pranosh investime nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Gjermania Perëndimore, Franca, Anglia dhe nga të gjitha vendet e tjera kapitaliste, që i lajnë e i lyejnë.

Udhëheqësit kinezë i kanë bërë të tyret teoritë revizioniste, sipas të cilave vendet e mëdha, siç është edhe Kina, që kanë pasuri të shumta, mund të marrin kredi nga imperializmi amerikan ose nga çdo shtet, trust e bankë e fuqishme kapitaliste, mbasi ato gjoja kanë mundësi t'i shlyejnë kreditë. Në mbrojtje të kësaj pikëpamjeje kanë dalë revizionistët jugosllavë, të cilët, duke reklamuar përvojën e tyre të «ndërtimit të socializmit specifik» me ndihmat e oligarkisë financiare botërore dhe posaçërisht të kapitalit amerikan, i japin shembull dhe e inkurajojnë Kinën të ecë pa ngurrim në këtë rrugë.

Kreditë që marrin, vendet e mëdha mund t'i shlyejnë, por investimet imperialiste që bëhen në këto

shtete të mëdha, si në Bashkimin revizionist Sovjetik ose në Kinë e kudo, nuk mund të mbeten pa konsekuenca të rënda neokolonialiste. Pasuritë dhe djersa e popujve shfrytëzohen edhe në interes të koncerneve e të monopoleve të huaja kapitaliste. Imperialistët amerikanë, si dhe shtetet e zhvilluara kapitaliste të Evropës Perëndimore ose Japonia, që bëjnë investime në Kinë dhe në vendet revizioniste, kanë për qëllim të ngulen aty, synojnë që koncertet e vendeve të tyre të pleksen në një bashkëpunim të ngushtë me trustet e degët e industrive kryesore në këto vende.

Investimi i kapitaleve të shteteve imperialiste në Kinë nuk është një problem aq i thjeshtë, siç përpiqen ta paraqesin revizionistët, që e quajnë të parrezikshëm këtë depërtim të kapitalit në vendet e tyre, pasi ky nuk hyka nëpërmjet marrëdhënieve ndërshtetërore (megjithëse tani së fundi udhëheqës të lartë kinezë kanë deklaruar se do të pranojnë kredi qeveritare nga jashtë), por nëpërmjet bankash e shoqëriish private pa komplikime dhe interesa politikë. Kredhja në borxhe e çdo vendi të vogël ose të madh, te njëri imperializëm ose te një tjetër, paraqet gjithnjë rreziqe të pashmangshme për lirinë, pavarësinë e sovranitetin e vendit që futet në këtë rrugë, aq më tepër për vende të varfra ekonomikisht, siç është Kina. Një vend i vërtetë socialist nuk ka nevojë për të tilla borxhe. Burimet e zhvillimit të tij ekonomik, ai i gjen në vendin e vet, në pasuritë e veta, në akumulimin e tij të brendshëm dhe në forcën krijuese të popullit. Se ç'mjete, ç'burime dhe ç'aftësi të pashtershme ka një vend socialist për t'u zhvilluar, flet shumë qartë shembulli i Shqì-



përisë, i një vendi të vogël. Shumë më të mëdha janë njetet e burimet për një vend të madh, në qoftë se ai ecën me konsekuencë në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Hapja e tregut kinez për imperializmin amerikan dhe për shoqëritë e mëdha amerikane e përcënimore është pritur me gëzim të papërmbajtur nga imperialistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga e gjithë borgjezia ndërkombëtare. Shoqëritë shumëkombëshe, industrialistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i njohin mirë ekonominë e Kinës e pasuritë e saj të mëdha, prandaj bëjnë çmos që atje të ndërtojnë rrjetin e tyre ekonomik, të krijojnë shoqëri të përbashkëta dhe të nxjerrin fitime të mëdha. Kështu po veprojnë në Kinë jo vetëm shoqëritë e mëdha amerikane, por edhe shoqëritë japoneze, gjermane dhe të vendeve të tjera të zhvilluara kapitaliste.

Kina që tani ka përfunduar një kontratë me Japoninë, për t'i livruar asaj deri në 10 milionë tonë naftë në vit. Përfaqësues të ENI-t italian, shkuan me një ekip të madh për të ofruar edhe ata licenca për kërkim të naftës në Kinë, por gjetën atje grupe të mëdha të kompanive të vajgurit amerikan, të cilat kanë hyrë që më parë në ujdin me Kinën për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e përbashkët të naftës. Kështu po bën Kina edhe në sektorët e tjerë të minierave, të hekurit e të mineraleve të ndryshme që mund të gjenden dhe që atje gjenden me shumicë të madhe. Manjatët gjermanë të qymyrit tanimë ndodhen në Kinë, ku përfunduan një kontratë prej disa dhjetëra miliardë markash. Ministrat kinezë po i bien kryq e tërthor Ja-

ponisë, Amerikës e Evropës për të marrë kredi, për të kontraktuar pajisje të reja teknologjike, për të blerë armë moderne, për të lidhur marrëveshje tekniko-shkencore etj. Të gjitha dyert e institucioneve dhe të ndërmarrjeve kineze janë hapur për biznesmenët e Tokios, të Uoll Stritit e të Tregut të Përbashkët Evropian që nxitojnë të shkojnë sikush më parë në Pekin për të akaparuar projektet e mëdha të «modernizimit» që u ofron qeveria kineze. Në këtë mënyrë edhe Kina po hyn në xhironin e madh të gëlltitjes imperialiste, të urisë së madhe imperialiste për të shtënë në dorë pasuritë e nëntokës e lëndët e para, për të shfrytëzuar krahun e punës në vendin e saj.

Dihet se kapitalisti kurrkujt nuk i jep ndihma pa shikuar, në radhë të parë, interesin e tij ekonomik, politik dhe ideologjik. Nuk është çështja vetëm te përqindja që ai merr si fitim. Vendi kapitalist që jep kredinë, bashkë me këtë, fut në vendin që merr «ndihmën» edhe mënyrën e vet të jetesës, mënyrën e mendimit të tij kapitalist, krijon baza dhe përhapet pa u kuptuar si vaji në lakra, zgjeron rrjetën e merimangës dhe kjo merimangë qëndron kurdoherë në mes dhe u thith gjakun të gjitha mizave që bien në rrjetën e saj, siç ka ndodhur në Jugosllavi, siç po ndodh sot në Bashkimin Sovjetik. Po kështu do të ndodhë edhe në Kinë.

Si rrjedhim, Kina do të lëshojë, siç po lëshon, edhe në çështjet politike dhe ideologjike, kurse tregu kinez do të bëhet një *débouché* me rëndësi të madhe për imperializmin amerikan dhe për fuqitë e tjera kapitaliste të industrializuara.

Kreditë dhe investimet amerikane, gjermanopë-rëndimore, japoneze etj. në Kinë s'ka se si të mos prekin, në njërin ose në tjetrën shkallë, pavarësinë dhe sovranitetin e saj. Të tilla kredi e bëjnë të varur çdo shtet që i merr, pse huadhënësi imponon politikën e vet. Prandaj, qoftë i madh, qoftë i vogël, cilido shtet që futet në ingranazhet e imperializmit i cungon ose i humbet lirinë politike, pavarësinë dhe sovranitetin. Në këtë gjendje cungimi të sovranitetit ka rënë edhe Bashkimi Sovjetik, i cili, kur hyri në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit, ishte shumë më i fuqishëm ekonomikisht e ushtarakisht nga sa është Kina sot, që po futet në të njëjtën rrugë.

Natyrisht, vendet e vogla, kur futen në ingranazhet e imperializmit, lirinë dhe pavarësinë i humbasin më shpejt se vendet e mëdha, siç janë Kina dhe Bashkimi Sovjetik, që mund t'i humbasin me një gradacion më të ngadalshëm, për shkak se kanë jo vetëm një potencial më të madh ekonomik dhe ushtarak, por edhe sepse, duke u mbështetur në këtë potencial, luftojnë që të ruajnë tregjet dhe të zënë të reja, të krijojnë dhe të zgjerojnë zona influence për t'i bërë presion njëri-tjetrit, për t'u futur edhe në luftë, kur të mos gjejnë tjetër rrugëdalje. Por kjo, prapëseprapë, nuk i shpëton dot ato nga zhinxhirët e kredive dhe të investimeve që u lidhin këmbët. Kreditë dhe kamatat duhen shlyer. Mirëpo, duke mos qenë në gjendje t'i shlyesh, do të hysh në borxhe të reja. Borxhi zë borxhin dhe kapitalisti kërkon rentat dhe, kur s'ke t'ia paguash, ai t'i vë të dy këmbët në një këpucë. Shoqëritë monopoliste amerikane, për shembull, që i impo-

nojnë politikën qeverisë së vet, e detyrojnë atë t'i mbrojnë me çdo mënyrë kapitalet, të deklarojnë, po qe nevoja, edhe luftë për mbrojtjen e tyre.

Duke gjukuar nga zelli që tregojnë udhëheqësit kinezë për t'u mbështetur tek imperializmi amerikan, te kapitalistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për zhvillimin e ekonomisë së vendit të tyre, bie poshtë edhe tërë ajo zhurmë shurdhuese që bëjnë ata rreth dobësimit të këtij imperializmi. Deklaratat e tyre, sikur gjoja imperializmi amerikan është dobësuar, janë vetëm një bluf, ashtu siç është bluf edhe deklarata mbi mbështetjen në forcat e veta. Revizionistët kinezë mendojnë të kundërtën e asaj që thonë, këtë kushdo e sheh në praktikën e tyre.

Gazetat zyrtare kineze shprehin shpesh shqetësim për kreditë që merr Bashkimi Sovjetik socialimperialist nga bankat amerikane, gjermanoperëndimore, japoneze etj. Ato i paralajmërojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara që të kenë mendjen, se ndihmat teknologjike dhe kreditë që i japin Bashkimit Sovjetik, ky i përdor për zhvillimin dhe për forcimin e potencialit të tij ekonomik e ushtarak, se këto ndihma dhe kredi e rritin rrezikun që u kanoset nga socialimperializmi, i cili, siç thonë udhëheqësit kinezë, ka zënë sot vendin e Rajhut të Tretë. Prandaj u bëjnë thirrje t'i presin këto kredi sa më parë.

Nuk është vështirë të nxjerrësh kuptimin e vërtetë të «shqetësimeve» që tregojnë udhëheqësit kinezë rreth kredive që merr Bashkimi Sovjetik. Natyrisht, ata nuk merakosen për natyrën kapitaliste të këtyre

kredive, as për rrezikun që paraqesin ato për sovranitetin e shtetit sovjetik. Por ata duan t'u thonë manjatëve të kapitalit amerikan dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapitalistëve dhe qeverive të vendeve të tjera imperialiste, se ato kredi dhe ato ndihma duhet t'ia japin jo Bashkimit Sovjetik, por Kinës, nga e cila s'kanë asnjë rrezik, përveç fitimeve.

Kjo është njëra anë e planit kinez për t'u bërë superfuqi. Ana tjetër janë përpjekjet për të dominuar vendet më pak të zhvilluara të botës, për t'u bërë lider i asaj që Kina e quan «botë e tretë».

Grupi që sundon sot në Kinë e vë shumë theksin mbi «botën e tretë», duke futur jo rastësisht dhe jo pa qëllim edhe veten në këtë botë. «Bota e tretë», e revizionistëve kinezë ka një qëllim politik mjaft të përcaktuar. Ajo është pjesë e strategjisë që synon ta shndërrojë sa më parë e sa më shpejt Kinën në një superfuqi. Kina kërkon të mbledhë rreth vetes të gjitha vendet e «botës së tretë» ose të «vendeve të paangazhuara», ose të «vendeve në zhvillim» për të krijuar një forcë të madhe, e cila jo vetëm do të rritë potencialin e përgjithshëm kinez, por edhe do ta ndihmojë Kinën t'u kundërvihet dy superfuqive të tjera, Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik, të ketë një peshë më të madhe në pazarllëqet për ndarjen e tregjeve e të zonave të influencës, të fitojë statusin e vërtetë të superfuqisë imperialiste. Kina mundohet ta realizojë qëllimin e saj për të grumbulluar sa më shumë shtete të botës rreth vetes nën parullën se ajo është gjoja për çlirimin e popujve

nga neokolonializmi dhe për kalimin e tyre në socializëm nëpërmjet luftës kundër imperializmit. Ky imperializëm është disi abstrakt, por ajo thekson se imperializmi më i rrezikshëm është ai sovjetik.

Kina ka hedhur një parullë të tillë demagogjike e pa përmbajtje teorike me shpresë që ta përdorë si mjet për qëllimet e saj hegjemoniste. Në fillim ajo synon vendosjen e dominimit kinez në të ashtuquajturën botë e tretë dhe pastaj manovrimin e kësaj «bote» për interesat e saj imperialistë. Këtë gjë Kina tash për tash përpigjet ta fshehtë me namini që ka marrë se është një vend socialist. Ajo spekulon me atë që një vend socialist nuk mund të ketë pikëpamje skllavëruese, pikëpamje për t'i hequr të tjerët nga hunda, për t'u bërë shantazhe, për t'i luftuar, për t'i shtypur dhe për t'i shfrytëzuar. Ajo e përdor dhe e mbështet këtë parullë të namini se Partia Komuniste e Kinës, e krijuar nga Mao Ce Duni «i madh», është gjoja një parti marksiste-leniniste, që ndjek me besnikëri teorinë e Marksit e të Leninit, teori që është kundër të gjitha të këqijave të sistemit kapitalist, shfrytëzimit kolonial etj.

E maskuar nën këtë genie të paqenë, e fshehur pas një fraze «botë e tretë» dhe duke e futur veten pa asnjë kriter dhe pa asnjë përcaktim klasor në këtë «botë», Kina mendon se mund t'ia arrijë më lehtë qëllimit të saj strategjik për të vendosur mbi të hegjemoninë e vet. Të njëjtin mashtrim ka përdorur edhe Bashkimi Sovjetik ndaj vendeve të tjera. Të tërë revizionistët hrushovianë ditë e natë predikojnë se «janë socialistë» dhe se partitë e tyre janë «parti marksiste-

-leniniste të vërteta». Gjithashtu nën këtë maskë përpiqen edhe revizionistët sovjetikë të vendosin hegjemoninë e tyre në botë. Si rrjedhim, mund të themi se nuk ekziston ndonjë ndryshim thelbësor në mes veprimeve kineze dhe atyre të socialimperializmit sovjetik.

I gjithë ky zhvillim i politikës dhe i veprimeve kineze vërteton plotësisht karakteristikat që i ka bërë marksizëm-leninizmi imperializmit, si sundim i oligarkisë financiare që kërkon tregje, që kërkon pushtimin e botës dhe vendosjen kudo të hegjemonisë së vet. Në këtë rrugë Kina përpiqet të depërtojë dhe të zërë edhe ajo një copë «tokë» në vendet e «botës së tretë». Por kjo «tokë» duhet të fitohet me sakrifica të mëdha.

Për t'u futur në «botën e tretë», për të zënë tregjet, duhen kapitale. Klasat sunduese, që janë në fuqi në vendet e «botës së tretë», kërkojnë investime, kërkojnë kredi dhe «ndihma». Mirëpo Kina nuk është në gjendje t'u japë atyre «ndihma» në përmasa të mëdha, pse nuk e ka potencialin ekonomik që kërkohet. Përkundrazi këtë potencial ajo po përpiqet ta krijojë tani me ndihmën e imperializmit amerikan. Në këto kushte borgjezia që sundon në vendet e «botës së tretë», e ka të qartë se hëpërhë nuk mund të përfitojë shumë nga Kina as nga ana ekonomike e teknologjike, as nga ana ushtarake. Ajo mund të përfitojë më shumë nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik, që kanë potencial të madh ekonomik, teknik dhe ushtarak.

Megjithatë, Kina, si çdo vend që ka synime imperialiste, lufton dhe do të luftojë edhe më shumë për tregje në botë, përpiqet dhe do të përpiqet edhe më

tepër për të përhapur influencën dhe dominimin e saj. Këto plane duken qysh tani. Ajo po krijon bankat e veta jo vetëm në Hong-Kong, ku i ka prej kohësh, por edhe në Evropë e gjetkë. Ajo do të luftojë veçanërisht të krijojë banka dhe të eksportojë kapitale në vendet e «botës së tretë». Sot për sot në këtë fushë ajo bën shumë pak. «Ndihma» e Kinës konsiston në ndërtimin e ndonjë fabrike çimentoje, të ndonjë hekurudhe ose të ndonjë spitali, sepse aq i ka mundësitë. Vetëm kur investimet amerikane, japoneze etj. në Kinë do të fillojnë të japin frytet e dëshiruara prej saj, domethënë kur të zhvillohen ekonomia, tregtia dhe teknika ushtarake, Kina do të jetë e aftë të ndërmarrë një ekspansion të vërtetë ekonomik dhe ushtarak në shkallë të gjerë. Por, për t'ia arritur kësaj, duhet kohë.

Deri atëherë ajo do të manovrojë, siç ka filluar të manovrojë, me politikën e «ndihmave» dhe të kredive pa kamatë ose me kamatë fare të vogël, në një kohë kur sovjetikët edhe amerikanët kërkojnë shumë më tepër. Sa kohë që kapitalet kineze nuk do të jenë në gjendje të vërshojnë jashtë vendit të tyre, udhëheqja revizioniste e Kinës do ta përqendrojë vëmendjen në anën propagandistike të «ndihmave» dhe të kredive të pakta që ajo u jep vendeve në zhvillim, duke predikuar «karakterin internacionalist», «qëllimet pa interes», duke e shoqëruar këtë me moton e «mbështetjes në forcat e veta», për çlirimin dhe ndërtimin e vendit.

Sa më tepër të zhvillohet Kina ekonomikisht dhe ushtarakisht, aq më tepër ajo do të kërkojë të futet



dhe të dominojë në vendet e vogla e më pak të zhvilluara me anë të eksportit të kapitaleve të saj dhe atëherë s'do të kërkojë më 1-2 për qind kamatë për kreditë e saj, por do të veprojë si gjithë të tjerët.

Por të gjitha këto plane e përpjekje nuk mund të realizohen lehtë. Vendet imperialiste dhe kapitaliste të zhvilluara, të cilat kanë influencë në vendet e të ashtuquajturës botë e tretë, nuk e lejojnë Kinën të pushtojë kollaj tregjet që ato i kanë fituar me kohë me luftëra grabitqare. Ato jo vetëm i ruajnë fort pozitat e vjetra, por përpiqen me të gjitha mënyrat të zënë edhe pozita të reja dhe nuk i lejojnë Kinës ta shtrijë dorën në këto vende.

Imperializmi është i pamëshirshëm ndaj çdo partneri të vet, kur gjendet në vështirësi ose në lulëzim. Ai, nganjëherë, nga zori dhe për të arritur përfitime më të mëdha, mund të bëjë ndonjë lëshim, por më shumë përpiqet t'i forcojë zinxhirët, jo vetëm kundër vendeve të dobëta, por edhe kundër atyre të zhvilluara, siç janë shtetet kapitaliste të industrializuara. Këtë politikë kanë ndjekur, për shembull, kurdoherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me aleatët e tyre kapitalistë, kur këta janë gjendur në momente të vështira në luftërat imperialiste që kanë shpërthyer në mes tyre. Por, edhe pas këtyre luftërave, kur ata kanë bërë përpjekje për t'u mëkëmbur, imperializmi amerikan ka vënë të gjitha forcat që t'i pengojë të futen në vendet e tjera të botës, ku ai kishte vendosur sundimin e tij. Në këtë mënyrë, pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, «duke ndihmuar» Anglinë dhe Francën, që dolën të dobësua-

ra nga kjo luftë, hynë thellë në tregun e sterlinës, në atë të frangut etj. Monopolet dhe kartelet amerikane të metalurgjisë, të kimisë, të hekurudhave e të shumë degëve të tjera jetike për zhvillimin e kapitalizmit depërtuan në një masë dërrmuese në monolet dhe në kartelet e Anglisë, të Francës etj., duke i vënë këto vende në varësi të imperializmit amerikan. Ky imperializëm i egër e i pangopur, si dhe çdo imperializëm tjetër, nuk mund të veprojë ndryshe edhe me Kinën.

Duke pasur parasysh vështirësitë që has për të depërtuar ekonomikisht dhe ushtarakisht në vendet e «botës së tretë», Kina mendon se hegjemonia e saj në to mund të sigurohet nëpërmjet vendosjes së influencës së saj politike dhe ideologjike. Ajo mendon se kjo do të arrihet duke iu përmbajtur tri drejtimeve: të mos luftojë imperializmin amerikan dhe klikat sunduese në vendet kapitaliste, përkundrazi, të hyjë në aleancë me këtë imperializëm dhe me këto klika; të luftojë socialimperializmin sovjetik, të cilin e ka në kufi, për t'ia dobësuar dhe për t'ia shkatërruar atij bazat në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine; të mashtrojë proletarin dhe popujt e shumëvujtur të këtyre kontinenteve me anë të demagogjisë dhe të manovrave pseudorevolucionare dhe pseudosocialiste, duke minuar çdo lëvizje çlirimtare revolucionare.

Këto qëllime të Kinës imperializmi amerikan dhe fuqitë e tjera imperialiste, bashkë me socialimperializmin, i kuptojnë fare mirë. Këto i kuptojnë gjithashtu edhe vendet e «botës së tretë», prandaj dyshojnë dhe e shohin se Kina po bën një bluf me to, se ajo

ka për qëllim jo t'i mbështetë e t'i ndihmojë, por të bëhet vetë një superfuqi. Shumica e udhëheqjeve që sundojnë në vendet e të ashtuquajturës botë e tretë, janë të lidhura ngushtë prej kohësh me imperializmin amerikan ose me fuqitë kapitaliste të zhvilluara, si Anglia, Franca, Gjermania, Belgjika, Japonia etj. Prandaj shteteve imperialiste e kapitaliste të zhvilluara nuk u shkakton ndonjë kokëçarje flirli i Kinës me «botën e tretë».

Përpyekjet e Kinës për të hyrë në «botën e tretë» me anë të politikës dhe të ideologjisë së saj të ashtuquajtur maocedunide, nuk mund të kenë sukses edhe për arsye se ideologjia dhe vija politike e saj janë një kaos. Vija politike e Kinës është e çoroditur, është një vijë pragmatiste që lëkundet e ndryshon sipas koniunkturave dhe interesave të çastit. Klasat sunduese në shtetet e «botës së tretë» nuk kanë frikë nga kjo ideologji, pse e kuptojnë që ajo nuk është për revolucionin dhe për çlirimin e vërtetë kombëtar të popujve. Borgjezia në këto vende, për të ushtruar më lehtë shtypjen dhe shfrytëzimin mbi popullin, ka krijuar partitë e veta me gjithfarë etiketash. Këto parti, që janë lidhur ngushtë me kapitalet e huaja të investuara në shtetet e të ashtuquajturës botë e tretë, nuk e kanë të vështirë të luftojnë dhe të demaskojnë vijën kineze. Prandaj udhëheqësit revizionistë kinezë kanë zgjedhur rrugën e buzëqeshjes ndaj partive të këtyre vendeve dhe përpiqen me çdo mënyrë e në çdo rast të jenë «të ëmbël si sheqeri» me to.

Kina, duke pasur në plan të sundojë mbi «botën e tretë», përpiqet t'i kanalizojë sa të jetë e mundur

në interesin e vet lëvizjet e masave punonjëse në këtë «botë». Por aktualisht popujt e shtypur, me proletariatin në krye, nuk ndodhen më në atë gjendje që ishin nga fundi i shekullit të 19-të ose në fillim të shekullit të 20-të. Ata kundërshtojnë çdo politikë hegjemoniste e nënshtrimi nga fuqitë e mëdha imperialiste, qofshin këta imperialistë të vjetër ose të rinj, amerikanë, sovjetikë ose kinezë. Sot masat e gjera të popujve të botës, në përgjithësi, janë zgjuar dhe, nëpërmjet luftërave të tyre, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë arritur të fitojnë njëfarë ndërgjegjeje për të mbrojtur të drejtat e tyre ekonomike dhe politike. Popujt e të ashtuquajturës botë e tretë nuk mund të mos e shohin se Kina punon jo për të çuar në vendet e tyre idetë e revolucionit e të çlirimit kombëtar, por për të shuar revolucionin, i cili pengon depërtimin e influencës kineze. Kursi kinez i aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera neokolonialiste, gjithashtu, e demaskon socialimperializmin kinez në sytë e popujve.

Kina nuk mund të bëjë një propagandë pozitive e revolucionare në vendet e «botës së tretë» edhe për arsye se do të binte në kundërshtim me atë superfuqi, nga e cila kërkon të përfitojë nga kapitalet që kjo mund të investojë në Kinë dhe nga teknologjia e përparuar e saj. Gjithashtu Kina nuk mund ta bëjë këtë propagandë edhe për arsye se revolucioni do të përmbyste pikërisht ato klika reaksionare që sundojnë në disa vende të së ashtuquajturës botë e tretë, të cilat Kina i përkrah dhe i ndihmon që të qëndrojnë në fuqi.

Etja e madhe e udhëheqësve kinezë për ta shndërruar sa më shpejt vendin e tyre në një superfuqi dhe për të vendosur kudo hegjemoninë e saj, e sidomos në të ashtuquajturën botë e tretë, i ka shtyrë ata që në bazë të strategjisë e të politikës së tyre të jashtme të vënë nxitjen e luftës ndër imperialiste. Ata dëshirojnë shumë një ndeshje frontale midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik në Evropë, ku Kina të ngrohte nga larg duart në zjarrin atomik që do të shkatërronte dy rivalet e saj kryesore dhe që do ta linte atë të vetmen sunduese të plotfuqishme në botë.

Derisa ta ndiejë veten plotësisht të fuqishme për të konkurruar superfuqitë e tjera, derisa të fitojë «vandin e merituar» si superfuqi, Kina do të kërkojë paqe për vete e luftë për të tjerët. Me nevojën që kanë aktualisht për paqe, kanë lidhje manovrat diplomatike të pamaskuara të revizionistëve kinezë për të nxitur luftën midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik, në mënyrë që vetë të rrinë mënjane e të merren me «modernizimet». Nuk është e rastit deklarata që ka bërë Ten Hsiao Pini se nuk do të ketë luftë për 20 vjet. Me këtë ai do t'u thotë superfuqive dhe vendeve të tjera imperialiste që të mos kenë frikë nga Kina gjatë këtyre 20 vjetëve. Në të njëjtën kohë, udhëheqësit kinezë nxitin një luftë midis superfuqive në Evropë, larg Kinës dhe larg rrezikut të implikimit të saj. Sa do të jetë kjo e mundshme, është tjetër gjë, por udhëheqësit kinezë punojnë në këtë drejtim, pasi e ndiejnë të domosdoshme nevojën e qetësisë për një periudhë që ata mendojnë

se u duhet për të realizuar qëllimet e tyre të shndërrimit të Kinës në superfuqi.

Kina predikon me të madhe forcimin e «unitetit evropian», të «unitetit të vendeve të zhvilluara kapitaliste të Evropës». Ajo në të gjitha çështjet e mbështet këtë unitet, duke u shitur mendje ujqve dhe dhelprave të vjetra, «duke i mësuar», ata si të forcojnë unitetin e tyre ushtarak dhe ekonomik, unitetin organizativ shtetëror etj., përballë rrezikut të madh të socialimperializmit sovjetik. Por këta nuk kanë nevojë për mësimet e Kinës, sepse janë në gjendje dhe e dinë shumë mirë se nga u vjen rreziku.

Vendet e zhvilluara të Perëndimit nuk janë aq naive që t'i zbatojnë *à la lettre*, këshillat e dëshirat kineze. Ato forcohen për të përballuar një rrezik eventual nga Bashkimi Sovjetik, por njëkohësisht bëjnë edhe përpjekje të shumta, të mos acarohen me të, të mos shkojnë shumë larg e të zemërojnë «ariun rus». Kjo, natyrisht, bie në kundërshtim me dëshirën e Kinës.

Shteteve kapitaliste të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u pëlqen nxitja që Kina i bën kontradiktës së tyre me sovjetikët, për arsye se tërthorazi u thonë këtyre që «armiku juaj kryesor është Kina, ndërsa ne, së bashku me ju, kërkojmë të krijojmë një detantë, një bashkëzistencë paqësore, pavarësisht se ç'thotë ajo». Nga ana tjetër, këto shtete, ndërsa hiqen sikur duan paqe, armatosen për të forcuar hegjemoninë dhe unitetin e tyre ushtarak kundër revolucionit, armikut kryesor të tyre. Këtu e kanë qëllimin të gjitha mbledhjet, si ajo e Helsinkit dhe e

Beogradit, që zgjaten e zgjaten e bëhen tërkuzë dhe i përngjajnë Kongresit të Vjenës pas thyerjes së Napoleonit, që njihet si kongresi i valleve dhe i suareve.

Udhëheqësit kinezë, siç e deklaroi zyrtarisht Ten Hsiao Pini në intervistën e dhënë drejtorit të AFP-së, bëjnë thirrje për krijimin e «një fronti të gjerë që do të përfshijë botën e tretë, botën e dytë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës» për të luftuar kundër social-imperializmit sovjetik.

Strategjia e udhëheqjes revizioniste të Kinës për nxitjen e imperializmit amerikan, të Evropës Perëndimore etj. për luftë kundër socialimperializmit sovjetik, rrezikon më shumë një luftë në mes saj dhe Bashkimit Sovjetik, sesa një luftë midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e aleatëve të tyre në NATO.

Atë që bën Kina duke nxitur të tjerët për luftë, e bëjnë edhe imperializmi amerikan, vendet kapitaliste të zhvilluara dhe të gjitha vendet ku në fuqi janë klika borgjeze kapitaliste, të cilat nxitin si Kinën, ashtu edhe Bashkimin Sovjetik, kundër njëri-tjetrit. Prandaj ka më shumë të ngjarë që politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vetë strategjia e gabuar e Kinës ta shtyjnë Bashkimin Sovjetik që të forcohet akoma më shumë ushtarakisht dhe, si fuqi imperialiste që është, të godasë më parë Kinën.

Kina, nga ana e saj, ka prirje të theksuara të godasë Bashkimin Sovjetik kur ta ndiejë veten të fuqishme, sepse ka ambicie të mëdha territoriale për Siberinë dhe për territore të tjera të Lindjes së Largme. Këto rivendikime ajo i ka ngritur me kohë, por ca më shumë

do të pretendojë kur të jetë e përgatitur, kur të ketë ngritur më këmbë një ushtri të armatosur me të gjitha llojet e armëve. Këtë kuptim ka deklarata që i bëri Hua Kuo Feni ish-kryeministrit konservator anglez, Hith, kur tha: «Ne shpresojmë se do të shohim një Evropë të bashkuar e të fuqishme, ne besojmë se Evropa nga ana e saj shpreson gjithashtu të shikojë një Kinë të fuqishme». Me një fjalë Hua Kuo Feni i thotë borgjezisë së madhe evropiane: «Ju forcohuni e sulmoni nga Perëndimi, kurse ne, kinezët, do të forcohemi dhe do të sulmojmë Bashkimin Sovjetik nga Lindja».

Politika kineze u hapi rrugë të gjerë e shumë të frytshme Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rrugë që e çelën në fillim Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe Niksoni. U hodhën shumë ura në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës, ura të maskuara, ura me efekte dhe me rezultate. Niksoni predikoi se «duhet të ndërtojmë një urë aq të madhe, sa të lidhë San-Franciskon me Pekinin». Ftesa që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai i bënë Niksonit, pas skandalit të Uotergejtit, dhe pritja e tij nga Maoja nuk ishin pa arsye dhe nuk bëheshin pa qëllim. Kjo donte të thoshte se miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo vetëm nuk është një miqësi koniunkturale në mes personash, por është një miqësi në mes vendesh, në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pavarësisht se presidenti që e hapi këtë rrugë u rrëzua nga posti i tij për batakçillëget që kishte bërë.

Tani që ka ardhur Karteri në fuqi, marrëdhëniet e miqësisë në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës po trashen. Shteteve të Bashkuara të



Amerikës u intereson shumë qëndrimi aktual i Kinës dhe strategjinë e saj Karteri e përkëdhel në shumë mënyra.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të interesuara t'i japin Kinës ndihmë të gjithanshme politike, ushtarake dhe ekonomike, për ta nxitur atë kundër Bashkimit Sovjetik. Ato i kanë dhënë Kinës sekrete atomike. Tashmë kjo është e qartë. Ato i kanë dhënë gjithashtu ordinatorë nga më modernët që shërbejnë për luftën bërthamore. Kina ka marrë të dhëna të plota që të ndërtojë vetë nëndetëse atomike. Tani në Uashington po flitet hapur e zyrtarisht për ta furnizuar Kinën me armë moderne. Të gjitha këto «të mira» që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ofrojnë Kinës, natyrisht, nuk i jepen me qëllim që kjo të bëhet një fuqi e atillë e madhe tokësore dhe detare sa të rrezikojë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç bëri Japonia në Luftën e Dytë Botërore. Jo, imperializmi amerikan i mat mirë të ashtuquajturat ndihma që i jep gjithë botës, dhe veçanërisht Kinës.

Në këtë mënyrë synimi dhe përpjekjet e ethshme të Kinës për t'u bërë superfuqi, që të kundërbalancojë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Bashkimin Sovjetik, nuk mund të mos çojnë në fërkime të reja, në konflagracione, në luftëra, të cilat mund të kenë edhe karakter lokal, por edhe karakterin e një lufte të përgjithshme.

E tërë teoria e «tri botëve», e tërë strategjia e saj, aleancat e «frontet» që ajo predikon, objektivat që kërkon të arrijë nxitin luftën imperialiste botërore.

Nikita Hrushovi dhe revizionistët modernë zhvilluan teorinë famëkeqe të «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane, që predikonte «paqen shoqërore», «garën paqësore», «rrugën paqësore» të revolucionit, «botën pa armë dhe pa luftë». Ajo synonte të dobësonte luftën e klasave, duke mbuluar e duke sheshuar kontradiktat themelore të epokës sonë. Veçanërisht Hrushovi predikonte shuarjen e kontradiktave midis Bashkimit Sovjetik dhe imperializmit amerikan, përgjithësisht kontradiktat midis sistemit socialist e atij kapitalist. Ai ushqente pikëpamjen se aktualisht, mbas ndryshimeve që kanë ndodhur në botë, kontradikta historike midis socializmit e kapitalizmit do të zgjidhet duke hyrë në garë paqësore me njëri-tjetrin, në një garë ekonomike, politiko-ideologjike, kulturore etj.

«T'ia lëmë kohës ta vërtetojë dhe të shihet se kush ka të drejtë», thoshte Hrushovi, dhe në këtë garë popujt të zgjedhin lirisht «në paqe të shenjtë» regjimin më të përshtatshëm. Nikita Hrushovi u predikonte popujve të shitnin pasuritë e tyre te superfuqitë dhe të pritnin që, si rezultat i kësaj gare të famshme «paqësore», t'u sigurohej liria, pavarësia, mirëqenia. Natyrisht, kjo politikë antimarksiste u demaskua dhe ishte Partia jonë e para që qëlloi kundër saj.

Një politikë si ajo e Hrushovit ka ndjekur Partia Komuniste e Kinës që kur ishte gjallë Mao Ce Duni. Edhe kjo u bën thirrje të dyja palëve, si proletariati ashtu edhe borgjezisë, si popujve ashtu edhe sunduesve të tyre, që të pushojnë luftën klasore, të bashkohen vetëm kundër socialimperializmit sovjetik dhe të harrojnë imperializmin amerikan.

Teoria e «tri botëve» është një teori reaksionare, ashtu siç ishte edhe teoria e Hrushovit e «bashkekzistencës paqësore». Por ndërsa Hrushovi dhe pasuesit e tij, zëdhënësit e revizionizmit modern, në dukje paraqiteshin si pacifistë, Mao Ce Duni, Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni etj., paraqiten haptazi si luftënxitës. Këta kërkojnë t'i japin koalicionit imperialisto-kapitalist, në të cilin fut edhe veten Kina, ngjyrën e një lufte revolucionare, kuptimin e një lufte për fitoren e proletariatit dhe të çlirimit të popujve. Por në realitet «teoria» e Mao Ce Dunit dhe e Partisë Komuniste të Kinës mbi «tri botët» bën thirrje jo për revolucion, po për luftë imperialiste.

Acarimi i kontradiktave e i rivalitetit midis fuqive e grupimeve imperialiste është i mbarsur me rrezikun e shpërthimit të konflikteve të armatosura, të luftërave grabitqare e skllavëruese. Kjo është një tezë e njohur e marksizëm-leninizmit, e vërtetuar në mënyrë të patundur nga historia. Drejtësinë e saj e tregojnë qartë edhe zhvillimet ndërkombëtare të ditëve tona.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka ngritur shumë herë zërin për demaskimin e propagandës shurdhuese pacifiste që përhapin superfuqitë për të vënë në gjumë vigjilencën e popujve e të vendeve paqedashëse, për t'i trullësuar ata me iluzione e për t'i zënë në befasi. Më se një herë ajo ka tërhequr vëmendjen se Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi rus po e çojnë botën drejt një lufte të re botërore dhe se shpërthimi i një lufte të tillë është një rrezik real e joimagjinar. Ky rrezik nuk mund të mos preokupojë vazhdimisht popujt, masat e gjera punonjëse, forcat e vendet pa-

qedashëse, marksistë-leninistët dhe njerëzit përparimtarë kudo në botë, të cilët përballë këtij rreziku nuk mund të qëndrojnë pasivë e duarlidhur. Po ç'duhet bërë për t'ua ndalur dorën luftënxitësve imperialistë?

Kjo nuk mund të jetë rruga e kapitullimit dhe e nënshtrimit ndaj luftënxitësve imperialistë dhe as ajo e zbutjes së luftës kundër tyre. Faktet provuan se kompromiset e lëshimet e paprincipita të revizionistëve hrushovianë nuk e bënë imperializmin amerikan më të butë, më të sjellshëm e më paqësor, përkundrazi, e bënë atë më arrogant e ia shtuan oreksin. Por marksistë-leninistët nuk janë as për të nxitur njërin shtet ose grupim imperialist kundër tjetrit, nuk bëjnë thirrje për luftëra imperialiste, sepse ata që vuajnë prej tyre janë popujt. Lenini i madh theksonte se politika jonë nuk synon të nxitë luftën, por të mos lejojë që imperialistët të bashkohen kundër vendit socialist.

*«... në qoftë se ne me të vërtetë do të nxitim në luftë punëtorët dhe fshatarët — thoshte ai — ky do të ishte një krim. Por gjithë politika dhe propaganda jonë nuk ka aspak për qëllim t'i futë popujt në luftë, por t'i japë fund luftës. Dhe eksperiencia ka treguar mjaft qartë se vetëm revolucioni socialist është rruga e daljes nga luftërat shekullore»<sup>1</sup>.*

Pra, ngritja e klasës punëtore, e shtresave të gjera punonjëse dhe e popujve në veprime revolucionare,

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 540.

për t'ua ndalur dorën luftënxitësve imperialistë në vendet e tyre, është e vetmja rrugë e drejtë. Marksistë-leninistët kurdoherë kanë qenë e janë kundërshtarët më të vendosur të luftërave të padrejta.

Lenini i ka mësuar revolucionarët komunistë se detyra e tyre është të shkatërrojnë planet luftënxitëse të imperializmit dhe të mos lejojnë shpërthimin e luftës. Në qoftë se kësaj nuk ia arrijnë, atëherë të mobilizojnë klasën punëtore, masat e popullit dhe ta shndërronjë luftën imperialiste në luftë revolucionare e çlirimtare.

Imperialistët dhe socialimperialistët e kanë në gjak luftën agresive. Synimet e tyre për skllavërimin e botës i çojnë ata në luftë. Por megjithëse luftën imperialiste botërore e shpërthejnë imperialistët, harxhet e saj i paguajnë me gjak proletariati, popujt, revolucionarët dhe gjithë njerëzit përparimtarë. Kjo është arsyeja që marksistë-leninistët, proletariati dhe popujt e botës janë kundër luftës imperialiste botërore dhe luftojnë pareshtur që t'ua prishin planet imperialistëve, që këta të mos e çojnë botën në një kasaphanë të re.

Këtëj del se nuk duhet predikuar lufta imperialiste, siç bëjnë revizionistët kinezë, por duhet luftuar kundër saj. Detyra e marksistë-leninistëve është të ngrenë proletariatin dhe popujt e botës në luftë kundër shtypësve për t'ua rrëmbyer atyre fuqinë, privilegjet dhe për të vendosur diktaturën e proletariatit. Këtë gjë s'e bën Kina, për këtë nuk punon Partia Komuniste e Kinës. Kjo parti, me teorinë e saj revizioniste, e dobëson dhe e largon revolucionin, i përçan forcat e pa-

rarojës së proletariatit, partitë marksiste-leniniste, të cilat do të organizojnë dhe do të udhëheqin këtë revolucion.

Rruga që predikon udhëheqja kineze është një mashtrim, është një rrugë që nuk i përgjigjet doktrinës sonë, marksizëm-leninizmit. Përkundrazi, vija revizioniste kineze i dobëson, i dërrmon proletariatin dhe popujt, i rrezikon ata që të mbajnë mbi supet e veta një luftë të përgjakshme, luftën imperialiste, luftën kriminale, aq të urryer nga proletariati dhe popujt.

Edhe për këtë arsye teoria e Mao Ce Dunit mbi «tri botët» e veprimtaria politike e Partisë Komuniste të Kinës dhe e shtetit kinez nuk mund të quhen në asnjë mënyrë marksiste-leniniste dhe revolucionare.

Udhëheqësit kinezë, kur Hrushovi predikonte garën ekonomike, ideologjike dhe politike midis socializmit e imperializmit, ishin gjoja kundër kësaj teze dhe thoshin se, që të realizohej bashkekzistenca e vërtetë paqësore, duhej të luftohej imperializmi, pasi «bashkekzistenca» nuk mund ta shkatërrojë imperializmin, nuk mund të çojë në fitoren e revolucionit e të çlirimit të popujve.

Por këto deklarata qëndruan në kartë. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, në realitet, ka qenë dhe është po ashtu për bashkekzistencën paqësore të llojit hrushovian. Në artikullin që përmendëm, «Propozim në lidhje me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare», është shkruar: «Politika parimore është e vetmja politikë e drejtë... Ç'do të thotë politikë parimore? Kjo do të thotë se, duke shtruar e duke përpunuar çfarëdo politike, ne duhet

të qëndrojmë në pozitat proletare, të nisemi nga interesat rrënjësorë të proletariatit dhe të udhëhiqemi nga teoria dhe nga tezat themelore të marksizëm-leninizmit». Kështu ka deklaruar Partia Komuniste e Kinës, por çfarë ka bërë dhe po bën ajo tani? Ajo ka bërë dhe po bën krejt të kundërtën.

Në artikullin e sipërm dhe në raste të tjera Partia Komuniste e Kinës ka deklaruar se «duhet të demaskohet imperializmi amerikan si armiku më i madh i revolucionit, i socializmit dhe i popujve të mbarë botës». Ndër të tjera ajo ka shtuar se «nuk duhet mbështetur as tek imperializmi amerikan, as te ndonjë imperializëm tjetër, nuk duhet mbështetur te reaksionarët». Por Partia Komuniste e Kinës nuk i ka zbatuar këto teza. Partia e Punës e Shqipërisë, që bazohet fuqimisht në parimet themelore të marksizëm-leninizmit, i përmbahet me vendosmëri luftës kundër imperializmit dhe socialimperializmit. Pikërisht për këtë çështje Shqipëria socialiste është në kundërshtim me Kinën dhe Partia e Punës e Shqipërisë është në kundërshtim me Partinë Komuniste të Kinës. Udhëheqësit kinezë na akuzojnë ne, shqiptarët, se gjoja nuk bëjmë «një analizë marksiste-leniniste të gjendjes ndërkombëtare e të kontradiktave» dhe, për pasojë, nuk ndjekim rrugën e kinezëve, që t'i bëjmë thirrje «Evropës së Bashkuar», Tregut të Përbashkët Evropian dhe proletarëve të botës të bashkohen me amerikanët kundër sovjetikëve. Konkluzioni i tyre është që, meqenëse ne nuk përkrahim imperializmin amerikan e «Evropën e Bashkuar» etj., favorizojmë gjoja socialimperializmin sovjetik.

Ky qëndrim i tyre jo vetëm është revizionist, i mbuluar me petkun e «antirevizionizmit», por është edhe armiqësor e shpifës ndaj Shqipërisë socialiste. Imperializmi amerikan është agresor, luftëdashës dhe luftënxitës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk duan vetëm statukuonë, siç pretendojnë kinezët, por duan edhe ekspansion, ndryshe nuk ka përse të kenë kontradikta me Bashkimin Sovjetik. Citati i Maos që përmendin ata se «Amerika është bërë si një mi, që gjithë bota thërret në rrugë: vriteni, vriteni!», kërkon të vërtetojë se vetëm Bashkimi Sovjetik dashka luftë, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo. Kjo butësi ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës nxit që të mos goditet ky shtet që «është katandisur si një mi», por që duhet të bëhet aleat i Kinës. Kjo është strategjia antimarksiste e Mao «marksistit»!

«Strategjia» kineze, në bazë të analizës që mbështetet në teorinë e «tri botëve», ka përcaktuar «definitivisht» se «rivaliteti mes dy superfuqive qëndron në Evropë». Çudi! Por pse nuk qëndron në një pikë tjetër të botës, ku Bashkimi Sovjetik kërkon ekspansion, si në Azi, në Afrikë, në Australi ose në Amerikën Latine, po pikërisht në Evropë?

«Teoricienët» kinezë këtë nuk e shpjegojnë. «Argumentimi» i tyre është ky: rivali kryesor i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është Bashkimi Sovjetik. Këto dy superfuqi, nga të cilat njëra do statukuonë dhe tjetra ekspansionin, do të shpërthejnë luftën, siç ndodhi në kohën e Hitlerit në Evropë. Edhe ky donte ekspansion, sundimin e botës, por, që ta arrinte këtë, më parë duhej të mposhte Francën, Anglinë dhe Bash-



kimin Sovjetik. Për këto arsye Hitleri luftën e filloi në Evropë dhe jo gjetkë. Dhe më tej revizionistët kinezë arsyetojnë se Stalini u mbështet tek Anglia dhe te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atëherë, konkludojnë kinezët, pse të mos mbështetemi edhe ne te Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Por ata, siç e shpjeguan edhe më parë, harrojnë se Bashkimi Sovjetik u lidh me Anglinë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbasi Gjermania sulmoi Bashkimin Sovjetik e jo më përpara.

Kur Gjermania e Vilhelmit të 2-të sulmoi Francën dhe Anglinë, krerët e Internacionales së Dytë predikuan «mbrojtjen e atdheut borgjez». Në këto pozita ranë si socialistët gjermanë, ashtu edhe ata francezë. Kjo dihet si u dënua nga Lenini dhe çfarë tha ai kundër luftërave imperialiste. Tani edhe revizionistët kinezë, kur predikojnë bashkimin e popujve evropianë me imperializmin në emër të mbrojtjes së pavarësisë kombëtare, veprojnë njësoj si partizanët e Internacionales së Dytë. Në kundërshtim me tezat e Leninit, ata nxitin luftën e ardhshme bërthamore që kërkojnë të shpërthejnë dy superfuqitë dhe u bëjnë thirrje «patriotike» popujve të Evropës Perëndimore dhe proletariatit të saj që të lënë mënjanë gjërat «e vogla» me borgjezinë (shtypjen, urinë, vrasjet, papunësinë), të mos ia cenojnë asaj pushtetin dhe të bashkohen me NATO-n, me «Evropën e Bashkuar», me Tregun e Përbashkët të borgjezisë së madhe e të koncerneve evropiane dhe të luftojnë vetëm kundër Bashkimit Sovjetik, të bëhen ushtarë të disiplinuar për borgjezinë. Një gjë të tillë nuk mund ta bënte më mirë as Internacionalja e Dytë.

Po popujve të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera revizioniste të Traktatit të Varshavës, të KNER-it, ç'u këshillon udhëheqja kineze të bëjnë? Asgjë! Më tepër hesht dhe nuk i peshon fare këta popuj. Herë pas here i nxit klikat revizioniste që sundojnë në këto vende të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik e të bashkohen me Amerikën. Në fakt këtyre popujve u thotë: heshtni, nënshtrohuni dhe bëhuni mish për top për klikën gjakatare të Kremlinit! Kjo vijë e udhëheqjes revizioniste të Kinës është antiproletare, luftënxitëse.

Të gjitha këto tregojnë se udhëheqësit kinezë i ngatërrojnë me qëllim situatat ndërkombëtare. Këto situata ata i shohin sipas interesave të vet për ta bërë Kinën superfuqi dhe jo në interes të revolucionit, i shohin në interesin e shtetit të tyre imperialist dhe jo në interesin e çlirimit të popujve, i shohin në prizmin e shuarjes së revolucionit në vendin e vet dhe të revolucioneve në vendet e tjera dhe jo në prizmin e organizimit dhe të intensifikimit të luftës së proletariautit e të popujve kundër të dyja superfuqive, si dhe kundër shtypësve borgjezë kapitalistë të vendeve të tjera, i shohin në prizmin e nxitjes së luftës imperialiste botërore dhe jo të kundërshtimit të saj.

Rruga e Kinës për t'u bërë superfuqi do të ketë pasoja të rënda, në radhë të parë, për vetë Kinën dhe për popullin kinez.

Analiza marksiste-leniniste e politikës kineze të çon në konkluzionin se udhëheqja kineze po e shpie Kinën në një rrugë pa kryc. Duke u shërbyer imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, ajo mendon

të nxjerrë për vete të saj disa fitime, por këto fitime janë të dyshimta dhe do t'i kushtojnë shtrenjtë Kinës. Ato do t'i sjellin katastrofën vendit e do të kenë, natyrisht, reperkusione të ndjeshme edhe në vende të tjera.

**Politika e Kinës për t'u bërë superfuqi, e frymëzuar nga një ideologji antimarksiste, po demaskohet dhe do të demaskohet akoma më shumë në sytë e të gjithë popujve, por sidomos të popujve të së ashtuquajturës botë e tretë. Popujt e botës i kuptojnë qëllimet e politikës së çdo shteti, cilido qoftë ky, socialist, revizionist, kapitalist ose imperialist. Ata e shohin dhe e kuptojnë se Kina, megjithëse hiqet si pjesëtare e «botës së tretë», nuk ka po ato aspirata dhe po ato qëllime të këtyre popujve. Ata e shohin se ajo ndjek një politikë socialimperialiste. Prandaj është e kuptueshme se një politikë e tillë jopopullore, që ndihmon shtypjen shoqërore e kombëtare, është e paprarrueshme për popujt. Ajo është një politikë që u intereson vetëm klikave reaksionare, vetëm atyre që sundojnë e shtypin popujt.**

Kina mbështet dhe i jep armë Somalisë, e cila, e shtyrë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, lufton kundër Etiopisë. Ndërkaq, Etiopia ndihmohet nga Bashkimi Sovjetik për të gëlltitur Somalinë. Kështu ndodh edhe me Eritrenë. Pra, Kina mban njërën anë, Bashkimi Sovjetik mban anën tjetër. Në qoftë se Kina shihet me sy të mirë në Somali, shihet nga ata që janë në fuqi, por jo nga populli i këtij vendi që po vritet. Ajo nuk shihet me sy të mirë as nga udhëheqja e Etiopisë, që mbështetet nga sovjetikët, por as nga populli

etiopian, i cili është i fryrë kundër somalezëve, që gjoja kërkojnë të pushtojnë Etiopinë. Në këtë mënyrë Kina nuk ka asnjë influencë as në Etiopi e as në Somali.

Por ajo nuk shihet me sy të mirë edhe në Algjeri. Kjo e fundit mbështet frontin «Polisario», kurse Kina mban anën e Mauritanisë e të Marokut, domethënë anën e imperializmit amerikan.

Me politikën e saj të jashtme Kina ndjek një kurs gjoja pro popujve arabë. Por kjo politikë konsiston vetëm në çështjen që popujt arabë të bashkohen kundër socialimperializmit sovjetik. Vetëkuptohet, pra, që Kina ndihmon çdo afrim të arabëve, në radhë të parë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për sa i përket Izraelit, udhëheqja kineze flet shumë kundër tij. Por në fakt, me strategjinë e saj, ajo është pro Izraelit. Këtë e kanë vënë dhe e vënë re popujt arabë e sidomos ai palestinez.

Në vendet e Azisë mund të themi se Kina nuk ka ndonjë influencë të dukshme dhe të qëndrueshme.

Kina nuk është në miqësi të sigurtë e të ngushtë me vendet e saj fqinje, pa lëre pastaj të mendohet për vendet e tjera që janë më larg. Politika e Kinës nuk është dhe nuk mund të jetë e drejtë, derisa nuk është marksiste-leniniste. Mbi bazën e një politike të tillë ajo nuk mund të jetë në miqësi të sigurtë me Vietnamin, me Korenë, me Kamboxhian, me Laosin, me Tailandën etj. Kina hiqet sikur do miqësi me këto vende, por, në fakt, midis saj dhe këtyre ekzistojnë kundërshtime për çështje politike, territoriale dhe ekonomike.

Me politikën që po ndjek, Kina tashmë ka rënë në konflikt të hapët me Vietnamin. Në mes këtyre dy vendeve po ndodhin incidente të rënda në kufi. Socialimperialistët kinezë kanë ndërhyrë rëndë në punët e brendshme të Vietnamit, ata, për qëllimet e tyre ekspansioniste, i fryjnë konfliktit midis Kamboxhias e Vietnamit etj. Kur udhëheqja kineze sillet në këtë mënyrë me Vietnamin, me një vend që deri dje e konsideronte si vend vëlla e mik të afërt, ç'mund të mendojnë vendet e Azisë për politikën kineze? A mund t'i zënë besë asaj?

Po të flasim për influencën e Kinës në vendet e Amerikës Latine, do të humbasim kohë. Ajo nuk ka këtu asnjë influencë, as politike, as ideologjike, as ekonomike. E gjithë influenca e Kinës qëndron në miqësinë me njëfarë Pinoçeti, që është një fashist e gjakatar i tërbuar. Ky qëndrim i Kinës ka zemëruar jo vetëm popujt e Amerikës Latine, por edhe opinionin botëror. Këta shohin se udhëheqja kineze është pro qeveritarëve shtypës, pro diktatorëve dhe gjeneralëve që sundojnë mbi popujt, është pro imperializmit amerikan që u ka hedhur kthetrat në grykë popujve të këtij kontinenti. Pra, influenca e Kinës në vendet e Amerikës Latine mund të themi se është e parëndësishme, pa forcë, pa brendi.

Politika e udhëheqësve kinezë jo vetëm që nuk gëzon simpatinë dhe mbështetjen e popujve, por ajo do të bëjë që Kina të izolohet gjithnjë e më shumë nga shtetet përparimtare, nga proletariati botëror. Nuk mund të ketë popull, nuk mund të gjenden proletariati e revolucionarë që të mbështetin politikën e Kinës,

kur shohin se në tribunën e Tien An Menit, siç ndodhi në ditën e festës kombëtare, më 1 Tetor 1977, krahas udhëheqësve kinezë të qëndrojnë ish-gjeneralët nazistë gjermanë, ish-gjeneralët e admiralët militaristë japonezë, gjeneralët fashistë portugezë etj., etj.

Në rrugën e transformimit të saj në një superfuqi Kina nuk mund të ecë dot përpara pa intensifikuar shfrytëzimin e masave të gjera punonjëse të vendit të vet. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera kapitaliste do të kërkojnë të sigurojnë superfitime nga kapitalet që do të investojnë atje, do të bëjnë edhe presione për ndryshime të shpejta e rrënjësore të bazës dhe të superstrukturës së shoqërisë kineze në drejtimin kapitalist. Intensifikimi i shfrytëzimit të masave shumëmilionëshe për të mbajtur borgjezinë kineze dhe aparatit e saj gjigant burokratik e për të përballuar shlyerjen e kredive dhe të kamatave të kapitalistëve të huaj, do të çojë patjetër në lindjen e kontradiktave të thella midis proletariatit dhe fshatarësisë kineze, nga njëra anë, dhe sundesve borgjezo-revizionistë, nga ana tjetër. Kjo do t'i vërë këta përballë masave punonjëse të vendit të vet, gjë që nuk mund të mos çojë në konflikte të mprehta e shpërthime revolucionare në Kinë.

### III

## MAO CEDUNIDEJA — TEORI ANTIMARKSISTE

Gjendja e sotme në Partinë Komuniste të Kinës, zigzagjet e shumta dhe qëndrimet e lëkundshme, oportuniste të saj, ndryshimet e shpeshta në strategji, politika që ka ndjekur e ndjek udhëheqja kineze për ta bërë Kinën superfuqi, shtrojnë në mënyrë krejt të natyrshme problemin e vendit dhe të rolit të Mao Ce Dunit dhe të ideve të tij, të ashtuquajturës maocedunide në revolucionin kinez.

Maocedunideja është një «teori» e zhveshur nga tiparet e marksizëm-leninizmit. Me maocedunidenë kanë spekuluar e spekulojnë në format e organizimit e në mënyrat e veprimit, në qëllimet strategjike e taktike të gjithë udhëheqësit kinezë, si ata që kanë qenë në fuqi më parë, ashtu edhe ata që kanë marrë aktualisht pushtetin, për t'i vënë në jetë planet e tyre kundërrevolucionare.

Mendimet dhe bindjen tonë mbi rrezikshmërinë që paraqet maocedunideja ne, komunistët shqiptarë, i kemi formuar gradualisht, duke parë veprimtarinë e dyshimtë, qëndrimet e lëkundura e kontradiktore, mungesën e parimeve dhe pragmatizmin e politikës së

brendshme e të jashtme kineze, shmangien nga marksizëm-leninizmi dhe maskimin me fraza të majta. Kur u krijua Partia jonë, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe pas Çlirimit, njohuritë e njerëzve tanë për Kinën ishin shumë të pakta. Por, si të gjithë revolucionarët në botë, edhe ne kishim krijuar një opinion progresist rreth saj: «Kina është një kontinent i madh, Kina lufton, në Kinë zien revolucioni kundër imperia- lizmit të huaj, kundër koncesioneve» etj., etj. Në përgjithësi ne njihnim diçka mbi veprimtarinë e Sun Jat Senit, për lidhjet dhe miqësinë e tij me Bashkimin Sovjetik dhe me Leninin; dinim diçka më në fund për Guomindanin, njihnim luftën e popullit kinez kundër japonezëve dhe ekzistencën e Partisë Komuniste të Kinës, që konsiderohej si një parti e madhe, me një marksist-leninist në krye, Mao Ce Dunin. Dhe kaq.

Kontaktet më të ngushta me kinezët Partia jonë i pati vetëm pas vitit 1956. Këto kontakte erdhën duke u shtuar për arsyet e luftës që Partia jonë zhvilloi kundër revizionizmit modern hrushovian. Atëherë me Partinë Komuniste të Kinës, ose më saktë, me kuadrot drejtues të saj kontaktet tona u bënë më të shpeshta e më të afërta, sidomos kur Partia Komuniste e Kinës hyri vetë në konflikt të hapët me revizionistët hrushovianë. Por duhet të pohojmë se, në takimet që kemi pasur me udhëheqësit kinezë, sido që kanë qenë të mira dhe shoqërore, Kina, Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës, në njëfarë mase, mbeteshin për ne një enigmë e madhe.

Po pse Kina, Partia e saj Komuniste dhe Mao Ce Duni ishin enigmë? Ishin enigmë, sepse shumë qëndri-



me, qofshin këto të përgjithshme, po edhe personale të udhëheqësve kinezë, për një sërë problemesh të mëdha politike, ideologjike, ushtarake dhe organizative ishin të lëkundura herë nga e djathta, herë nga e majta. Ata herë tregoheshin të vendosur, herë të pavendosur, nga njëherë mbanin edhe qëndrime të drejta, por më shumë binin në sy qëndrimet e tyre oportuniste. Politika kineze, në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës që jetoi Maoja, ka qenë e lëkundshme, ajo ishte një politikë e koniunkturave, nuk kishte palcë kurrizore marksiste-leninistë. Ndryshe flitej sot për një problem të rëndësishëm politik, ndryshe nesër. Në politikën kineze nuk mund të gjeje një fill të kuq të qëndrueshëm dhe konsekuent.

Natyrisht, të gjitha këto qëndrime tërhiqnin vëmendjen tonë dhe nuk i aprovonim, por megjithëkëtë, për aq sa e njihnim veprimtarinë e Mao Ce Dunit, shkonim nga mendimi i përgjithshëm se ai ishte një marksist-leninist. Për mjaft teza të Mao Ce Dunit, si ajo e trajtimit të kontradiktave midis proletariatit dhe borgjezisë, si kontradikta joantagoniste, teza për ekzistencën e klasave antagonistë gjatë gjithë periudhës së socializmit, teza «fshati të rrethojë qytetin», që absolutizon rolin e fshatarësisë në revolucion etj., kishim rezervat e pikëpamjet tona marksiste-leniniste, të cilat, sipas rastit, ua kemi thënë udhëheqësve kinezë. Ndërsa disa pikëpamje të tjera e qëndrime politike të Mao Ce Dunit e të Partisë Komuniste të Kinës që nuk pajtoheshin me pikëpamjet dhe qëndrimet marksiste-leniniste të Partisë sonë, i konsideronim si taktika të përkohshme të një shteti të madh të diktuar.

nga situata të caktuara. Por me kalimin e kohës bëhej gjithnjë më e qartë se qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës nuk ishin vetëm taktikë.

Partia jonë, duke i analizuar faktet, arriti në disa konkluzione të përgjithshme dhe të veçanta, që e bënë të ishte vigjilente, por ajo i shmangej polemikës me Partinë Komuniste të Kinës dhe me udhëheqësit kinezë, jo se kishte frikë të polemizonte me ta, por sepse të dhënat që kishte për rrugën e gabuar antimarksiste të kësaj partie dhe të vetë Mao Ce Dunit, nuk ishin të plota, ato nuk lejonin akoma të konkludohej plotësisht. Nga ana tjetër, për një kohë Partia Komuniste e Kinës kundërshtonte imperializmin amerikan dhe reaksionin. Ajo, gjithashtu, mbajti qëndrim kundër revizionizmit hrushovian sovjetik, pavarësisht se tashmë është e qartë se lufta e saj kundër revizionizmit sovjetik nuk diktohej nga pozita të drejta parimore marksiste-leniniste.

Përveç kësaj, ne nuk kemi pasur dijeni të plota mbi jetën e brendshme politike, ekonomike, kulturore, shoqërore etj. në Kinë. Organizimi i partisë dhe i shtetit kinez ka mbetur gjithnjë i mbyllur për ne. Nga ana e Partisë Komuniste të Kinës nuk na është dhënë asnjë mundësi që t'i studionim format e organizimit të partisë e të shtetit kinez. Ne, komunistët shqiptarë, kishim dijeni vetëm për njëfarë organizimi të përgjithshëm shtetëror të Kinës dhe asgjë më shumë, mbasi nuk na krijoheshin mundësitë që të njiheshim me eksperiencën e partisë në Kinë, të shihnim si vepronte ajo, si ishte e organizuar, çfarë drejtimesh

kishte marrë zhvillimi i punëve në sektorë të ndryshëm dhe cilat ishin konkretisht këto drejtime.

Udhëheqësit kinezë kanë vepruar me dinakëri. Ata nuk kanë bërë publike shumë dokumente të nevojshme për njohjen e veprimtarisë së partisë e të shtetit. Ata i ruheshin dhe i ruhen shumë botimit të dokumenteve të tyre. Edhe ato dokumente të pakta të botuara që disponohen, janë fragmentare. Ndërsa katër vëllimet me veprat e Maos, që mund të quhen zyrtare, jo vetëm përmbajnë materiale të shkruara deri në vitin 1949, por ato janë të ujditura me kujdes, në mënyrë të tillë që të mos i paraqesin ekzaktësisht situatat reale që janë zhvilluar në Kinë.

Paraqitja politike dhe teorike e problemeve në shtypin kinez, për të mos folur për literaturën, që ishte krejt e çoroditur, kishte vetëm karakter propagandistik. Artikujt ishin të mbushur plot me formula shabllone tipike kineze të shprehura me numra aritmetikë, si «tri të mirat dhe pesë të këqijat», «katër të vjetrat edhe katër të rejat», «dy kujtimet dhe pesë kontrollet e vetes», «tri të vërtetat dhe shtatë të rremet» etj., etj. Shtjellimi nga ana «teorike» i këtyre shifrave aritmetike ishte i zorshëm për ne që jemi mësuar të mendojmë, të veprojmë dhe të shkruajmë sipas teorisë dhe kulturës tradicionale marksiste-leniniste.

Udhëheqësit kinezë nuk ftuan për vizitë ndonjë delegacion të Partisë sonë për të studiuar eksperiencën e tyre. Edhe kur ka shkuar atje ndonjë delegacion, me kërkesën e Partisë sonë, më shumë i kanë bërë propagandë dhe e kanë çuar andej-këtej për vizita në-

për komuna e fabrika, sesa i kanë dhënë ndonjë shpjegim ose eksperiencë për punën e partisë. Dhe me kë e mbanin këtë qëndrim të çuditshëm? Me ne shqiptarët, miqtë e tyre, që i kemi mbrojtur në situatat më të vështira. Të gjitha këto veprime ishin për ne të pakuptueshme, por edhe një sinjal që tregonte se Partia Komuniste e Kinës nuk donte të na jepte një pasqyrë të qartë të gjendjes së saj.

Por akoma më shumë tërhoqi vëmendjen e Partisë sonë Revolucioni Kulturor, për të cilin na dolën disa pikëpyetje të mëdha. Gjatë Revolucionit Kulturor, që shpërtheu Mao Ce Duni, në veprimtarinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të shtetit kinez u vunë re ide dhe veprime politike, ideologjike dhe organizative të çuditshme, të cilat nuk bazoheshin në mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Duke gjykuar veprimet e dyshimta të mëparshme, si dhe ato që u konstatuan gjatë Revolucionit Kulturor, por sidomos ngjarjet pas këtij revolucioni e deri tash, ngritjet e uljet e njërit ose të tjetrit grup në udhëheqje, sot të grupit të Lin Biaos, nesër të atij të Ten Hsiao Pinit, të një Hua Kuo Feni e të tjerë, që secili kishte platformën e vet të kundërt me të tjetrit, të gjitha këto e nxitën Partinë tonë të thellohej më tepër në pikëpamjet dhe veprimet e Mao Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës, në njohjen më të plotë të maocedunidesë. Neve nuk na dukej qëndrim revolucionar kur shikonim që ky Revolucion Kulturor nuk udhëhiqej nga partia, por ishte një shpërthim kaotik pas një thirrjeje që bëri Mao Ce Duni. Autoriteti i Maos në Kinë bëri që të ngriheshin në këmbë miliona të

rinj të paorganizuar, studentë dhe nxënës shkollash, që marshonin drejt Pekinit, drejt komiteteve të partisë dhe të pushtetit, të cilat i shpërndanë. Këta të rinj thuhej se përfaqësonin atëherë në Kinë «ideologjinë proletare» dhe do t'u mësonin partisë dhe proletarëve rrugën «e vërtetë»!

Një revolucion i tillë, që kishte karakter të theksuar politik, u quajt kulturor. Për Partinë tonë ky emërtim ishte jo i saktë, pse në të vërtetë në Kinë kishte shpërthyer një lëvizje politike dhe jo kulturore. Por kryesorja ishte fakti që ky «revolucion i madh proletar» nuk udhëhiqej as nga partia, as nga proletariati. Kjo situatë e rëndë e kishte burimin në konceptet e vjetra antimarksiste të Mao Ce Dunit mbi nënvleftësimin e rolit udhëheqës të proletariatit dhe mbivlerësimin e rinisë në revolucion. Maoja ka pasë shkruar: «Ç'rol filloi të luajë rinia kineze që nga koha e «lëvizjes së 4 majit»? Ajo filloi të luajë në njëfarë kuptimi rolin e pararojës. Këtë e pranojnë të gjithë në vendin tonë, me përjashtim të njerëzve ultrareaksionarë. Ç'do të thotë të luash rolin e pararojës? Kjo do të thotë të luash rolin e udhëheqësit...»<sup>1</sup>.

Kështu klasa punëtore u la mënjanë dhe kishte raste të shumta që ajo ishte kundër gardistëve të kuq, bile edhe përleshej me ta. Shokët tanë, që ishin atëherë në Kinë, kanë parë me sytë e tyre punëtorët e fabrikave që luftonin kundër të rinjve. Partia u shpërnda. Ajo u likuidua dhe komunistët e proletaria-ti as përfilleshin. Kjo gjendje ishte shumë e rëndë.

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, f. 19.

Partia jonë e mbështeti Revolucionin Kulturor, sepse fitoret e revolucionit në Kinë ishin në rrezik. Vetë Mao Ce Duni na tha se partia dhe shteti atje ishin uzurpuar nga grupi renegat i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit dhe fitoret e revolucionit kinez ishin në rrezik. Në këto kushte, pavarësisht se kush ishte përgjegjës që punët kishin shkuar kaq larg, Partia jonë përkrahu Revolucionin Kulturor. Partia jonë mbrojti popullin vëlla kinez, çështjen e revolucionit dhe të socializmit në Kinë dhe jo luftën fraksioniste të grupeve antimarksiste që përplaseshin e përlesheshin deri dhe me armë në mes tyre për të marrë fuqinë.

Rrjedha e ngjarjeve tregoi se Revolucioni i madh Kulturor Proletar nuk ishte as revolucion, as i madh, as kulturor dhe sidomos aspak proletar. Ky ishte një puç pallati në shkallë pankineze për të likuiduar një grusht reaksionarësh që kishin marrë pushtetin.

Natyrisht ky Revolucioni Kulturor ishte një mistifikim, ai likuidoi edhe Partinë Komuniste të Kinës, edhe organizatat e masave dhe e futi Kinën në një kaos të ri. Ky revolucion u udhëhoq nga elementë jomarksistë, të cilët u likuiduan me puç ushtarak nga elementë të tjerë antimarksistë e fashistë.

Në shtypin tonë Mao Ce Duni është cilësuar si marksist-leninist i madh, por ne asnjëherë nuk përdorëm dhe nuk aprovuam përcaktimet e propagandës kineze që e quante Maon klasik të marksizëm-leninizmit dhe maocedunidenë si etapë të tretë e më të lartë të tij. Partia jonë e ka konsideruar si të papaj-

tueshëm me marksizëm-leninizmin fryrjen e kultit të Mao Ce Dunit në Kinë.

Zhvillimi kaotik i Revolucionit Kulturor dhe rezultatet e tij e forcuan edhe më shumë mendimin, të pakristalizuar mirë, se marksizëm-leninizmi në Kinë nuk njihej dhe nuk zbatohej, se në thelb Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni nuk kishin pikëpamje marksiste-leniniste, pavarësisht nga fasada dhe nga parullat që përdornin «për proletariatin, për diktaturën e tij dhe për aleancën me fshatarësinë e varfër» e të tjera e të tjera formula të tilla.

Në dritën e këtyre ngjarjeve Partia jonë filloi t'i shohë më thellë shkaqet e lëkundjeve që ishin vënë re në qëndrimin e udhëheqjes kineze ndaj revizionizmit hrushovian, siç ishte rasti më 1962, kur ajo kërkonte pajtimin e bashkimin me revizionistët sovjetikë në emër gjoja të një fronti të përbashkët kundër imperializmit amerikan, ose më 1964 kur Çu En Lai, në vazhdim të përpjekjeve për t'u pajtuar me sovjetikët, shkoi në Moskë për të përshëndetur ardhjen e grupit të Brezhnjevut në fuqi. Këto lëkundje nuk ishin të rastit, ato pasqyronin mungesën e parimeve dhe të konsekuencës revolucionare.

Kur Niksoni u ftua në Kinë dhe udhëheqja kineze, me Mao Ce Dunit në krye, shpalli politikën e afimit e të bashkimit me imperializmin amerikan u duk qartë se vija dhe politika kineze binin në kundërshtim të plotë me marksizëm-leninizmin e internacionalizmin proletar. Mbas kësaj filluan të bëheshin më të qarta synimet shoviniste dhe hegjemoniste të Kinës. Udhëheqja kineze filloi t'u kundërvihej më hapur luftërave

revolucionare e çlirimtare të popujve, proletariatit botëror dhe lëvizjes së vërtetë marksiste-leniniste. Ajo shpalosi të ashtuquajturën teori të tri botëve, të cilën po përpiquej t'ia impononte gjithë lëvizjes marksiste-leniniste si vijë të përgjithshme të saj.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u nisur nga interesat e revolucionit e të socializmit dhe duke menduar se gabimet që konstatoheshin në vijën e Partisë Komuniste të Kinës vinin nga vlerësime jo të drejta të situatave dhe nga vështirësi të ndryshme, është përpjekur ta ndihmojë më se një herë udhëheqjen kineze për t'i ndrequr e për t'i kapërcyer ato. Në mënyrë të sinqertë e shoqërore Partia jonë ua ka shfaqur hapur pikëpamjet e veta Mao Ce Dunit dhe udhëheqësve të tjerë kinezë dhe për mjaft veprime të Kinës, që preknin drejtpërdrejt vijën e përgjithshme të lëvizjes marksiste-leniniste, interesat e popujve e të revolucionit, vërejtjet e mospajtimin e saj ia ka bërë të njohura zyrtarisht dhe me shkrim Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës.

Por vërejtjet e drejta e parimore të Partisë sonë udhëheqja kineze asnjëherë nuk i ka mirëpritur. Ajo nuk na është përgjigjur kurrë dhe nuk ka pranuar as të diskutohet për to.

Ndërkohë veprimet antimarksiste të udhëheqjes kineze, si brenda dhe jashtë, u bënë më të hapëta e më të dukshme. Të gjitha këto e detyruan Partinë tonë, si të gjithë marksistë-leninistët e tjerë, që të rivlerësonte vijën e Partisë Komuniste të Kinës, konceptet politike dhe ideologjike nga të cilat është udhëhequr ajo, veprimtarinë konkrete dhe pasojat e saj. Si rrje-



dhim, ne pamë se maocedunideja, nga e cila është udhëhequr dhe udhëhiqet Partia Komuniste e Kinës, përfaqëson një variant të rrezikshëm të revizionizmit modern, kundër të cilit duhet zhvilluar një luftë e gjithanshme në planin teorik dhe politik.

Maocedunideja është një variant i revizionizmit, që ka filluar të marrë formë që para Luftës së Dytë Botërore, në mënyrë të veçantë pas vitit 1935 kur erdhi në fuqi Mao Ce Duni. Në këtë periudhë Mao Ce Duni me përkrahësit e tij shpërtheu një fushatë «teorike» nën parullën e luftës kundër «dogmatizmit», «skemave të gatshme», «shabloneve të huaja» etj. dhe shtroi problemin e përpunimit të marksizmit kombëtar, duke mohuar karakterin universal të marksizëm-leninizmit. Në vend të marksizëm-leninizmit ai predikonte «mënyrën kineze» të trajtimit të problemeve dhe stilin kinez «...të gjallë dhe plot freski, të këndshëm për veshët dhe për sytë e popullit kinez»<sup>1</sup>, duke propaganduar kështu tezën revizioniste, sipas së cilës në çdo vend marksizmi duhet të ketë përmbajtje të veçantë, specifike.

Maocedunideja u shpall shkalla më e lartë e marksizëm-leninizmit në epokën e sotme. Udhëheqësit kinezë kanë deklaruar se «Mao Ce Duni ka rregulluar më shumë punë se Marksi, Engelsi e Lenini...». Në Statutin e Partisë Komuniste të Kinës, të aprovuar në Kongresin e 9-të të saj, që zhvilloi punimet nën drejtimin e Mao Ce Dunit, thuhet se «Maocedunideja është marksizëm-leninizmi i epokës...», se Mao Ce

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 4, bot. shqip, f. 81.

Duni «...ka trashëguar, mbrojtur e zhvilluar marksizëm-leninizmin dhe ka bërë që ai të hyjë në një etapë të re edhe më të lartë»<sup>1</sup>.

Vënia në themel të veprimtarisë së Partisë jo e parimeve dhe e normave të marksizëm-leninizmit, por e maocedunidesë, i hapi edhe më shumë dyert oportunitizmit dhe luftës fraksioniste brenda radhëve të Partisë Komuniste të Kinës.

Maocedunideja është një amalgamë pikëpamjesh, ku janë përzier ide e teza të huajtura nga marksizmi me parime të tjera filozofike, idealiste, pragmatiste e revizioniste. Ajo i ka rrënjët në filozofinë e lash-të kineze dhe në të kaluarën politike, ideologjike të Kinës, në praktikën shtetërore dhe militariste të saj.

Të gjithë udhëheqësit kinezë, si ata që kanë marrë aktualisht pushtetin, ashtu edhe ata që kanë qenë e kanë rënë nga pushteti, por që kanë manovruar për të vënë në jetë planet e tyre kundërrevolucionare, si bazë ideologjike kanë pasur dhe kanë maocedunidenë. Vetë Mao Ce Duni ka pranuar se mendimet e tij mund të shfrytëzohen nga të gjithë, edhe nga të majtët edhe nga të djathtët, si i quan ai grupet e ndryshme që përbëjnë udhëheqjen kineze. Në letrën drejtuar Çian Çinit më 8 korrik 1966, Mao Ce Duni pohon se «e djathta në pushtet mund t'i përdorë fjalët e mia për t'u bërë e fuqishme për njëfarë kohe, por e majta mund të përdorë fjalë të tjera nga të miat dhe të orga-

---

1. Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës. Dokumente, Tiranë, 1969, f. 79-80.

nizohet për të përmbysur të djathtët»<sup>1</sup>. Kjo dëshmon se Mao Ce Duni nuk ka qenë një marksist-leninist, se pikëpamjet e tij janë eklektike. Kjo duket në tërë «veprat teorike» të Maos, që, megjithëse të kamufluara me frazeologji e slogane «revolucionare», nuk mund ta fshehin faktin se maocedunideja s'ka asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin.

Një vështrim kritik, qoftë edhe i pjesshëm i shkrimeve të Maos, i mënyrës së trajtimit të problemeve themelore që kanë të bëjnë me rolin e partisë komuniste, me çështjet e revolucionit, të ndërtimit të socializmit etj. e bën plotësisht të qartë ndryshimin rrënjësor të maocedunidesë nga marksizëm-leninizmi.

Le të marrim në fillim çështjet e organizimit të Partisë dhe të rolit udhëheqës të saj. Maoja hiqej sikur ishte për zbatimin e parimeve leniniste mbi partinë, por, po t'i analizosh konkretisht idetë e tij mbi partinë, dhe sidomos praktikën e jetës së partisë, del sheshit se ai i ka zëvendësuar parimet dhe normat leniniste me teza revizioniste.

Mao Ce Duni nuk e ka organizuar Partinë Komuniste të Kinës në bazë të parimeve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ai nuk ka punuar për ta bërë atë një parti të tipit leninist, një parti bolshevike. Mao Ce Duni nuk ishte për një parti klasore proletare, por për një parti pa kufij klasorë. Parullën e masivizimit të partisë ai e ka përdorur për të fshirë kufirin midis partisë dhe klasës. Si pasojë në këtë

1. «Lë Mond», 2 dhjetor 1972.

parti mund të hynte e të dilte kush të donte dhe kur të donte. Në këtë çështje pikëpamjet e maocedunidesë janë të njëjta me ato të revizionistëve jugosllavë dhe të eurokomunistëve.

Krahas kësaj Mao Ce Duni ndërtimin e partisë, parimet dhe normat e saj i ka vënë gjithnjë në vartësi të qëndrimeve dhe të interesave të tij politikë, në vartësi të politikës oportuniste, herë të djathtë e herë të majtë, aventuriste, të luftës midis fraksioneve etj.

Në Partinë Komuniste të Kinës nuk ka pasur dhe nuk ka unitet të vërtetë marksist-leninist mendimi e veprimi. Lufta midis fraksioneve, e cila ka ekzistuar që me themelimin e Partisë Komuniste të Kinës, ka bërë që në këtë parti të mos vendosej një vijë e drejtë marksiste-leniniste, të mos udhëhiqte mendimi marksist-leninist. Tendencat e ndryshme që shfaqeshin në udhëheqësit kryesorë të partisë, herë ishin të majta, herë oportuniste të djathta, disa herë centriste dhe shkonin deri në pikëpamje të hapëta anarkiste, shoviniste dhe raciste. Sa kohë ishte në krye të partisë Mao Ce Duni me grupin e tij, këto tendenca ishin një nga karakteristikat dalluese të Partisë Komuniste të Kinës. Vetë Mao Ce Duni ka predikuar nevojën e ekzistencës së «dy vijave» në parti. Sipas tij, ekzistenca dhe lufta midis dy vijave është diçka e natyrshe, është shfaqje e unitetit të kundërtave, është politikë elastike që bashkon në vetvete principialitetin me kompromisin. «Kështu, shkruan ai, mund të përdoren të dyja duart ndaj një shoku që ka gabuar: me njërin do të luftohet kundër tij, me tjetrën do të bëhet bashkimi me të. Qëllimi i kësaj lufte është të

ruhen parimet e marksizmit që do të thotë vendosmëri ndaj parimeve; ky është një aspekt i problemit. Aspekti tjetër është të bashkohemi me të. Bashkimi ka për qëllim t'i ofrojë atij një rrugëdalje, të realizojë një kompromis me të»<sup>1</sup>.

Këto pikëpamje janë diametralisht të kundërta me mësimet leniniste mbi partinë komuniste si një repart i organizuar dhe pararojë, që duhet të ketë një vijë të vetme dhe një unitet të çeliktë mendimi e veprimi.

Lufta klasore në gjirin e partisë, si pasqyrim i luftës së klasave që zhvillohet jashtë partisë, nuk ka asgjë të përbashkët me konceptet e Mao Ce Dunit mbi «dy vijat në parti». Partia nuk është arenë e klasave dhe e luftës së klasave antagonistë, ajo nuk është një grumbullim njerëzish me qëllime të kundërta. Partia e vërtetë marksiste-leniniste është vetëm parti e klasës punëtore dhe ka në themel interesat e saj. Ky është faktori vendimtar për fitoren e revolucionit dhe ndërtimin e socializmit. J. V. Stalini, duke mbrojtur parimet leniniste mbi partinë, që nuk lejojnë ekzistencën e shumë vijave, e rrymave opozitare në partinë komuniste, theksonte se

*«...partia komuniste është partia monolite e proletariatit dhe jo parti e një blloku elementësh të klasave të ndryshme»<sup>2</sup>.*

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 560.

2. J. V. Stalini; Veprat, vëll. 11, f. 280.

Kurse Mao Ce Duni e koncepton partinë si një bashkim klasash me interesa të kundërt, si një organizim në të cilin qëndrojnë përballë njëra-tjetrës dhe luftojnë dy forca, proletariati dhe borgjezia, «shtabi proletar» dhe «shtabi borgjez», të cilët duhet të kenë përfaqësuesit e tyre që nga poshtë deri në organet më të larta udhëheqëse të partisë. Kështu, në vitin 1956 ai kërkonte të zgjidheshin në Komitetin Qendror udhëheqësit e fraksioneve të djathta e të majta, duke paraqitur për këtë argumente sa naive, aq edhe qesharake. «Gjithë vendi, thotë ai, bile mbarë bota e di mirë se ata kanë bërë gabime vije, dhe është pikërisht fama e tyre arsyeja e zgjedhjes së tyre. Ç'të bësh? Ata janë njerëz të njohur, ndërsa ju që nuk keni bërë gabime ose që keni bërë vetëm gabime të vogla nuk jeni aq të famshëm sa ata. Në vendin tonë ku borgjezia e vogël është kaq e shumtë ata janë dy flamuj»<sup>1</sup>. Duke hequr dorë nga lufta parimore në radhët e partisë, Mao Ce Duni bënte lojën e fraksioneve, kërkonte kompromise me disa prej tyre për të kundërshtuar disa të tjera dhe për të forcuar kështu pozitat e veta.

Me një platformë të tillë organizative, Partia Komuniste e Kinës asnjëherë nuk ka qenë e nuk mund të ishte një parti marksiste-leniniste. Në të nuk respektoheshin parimet e normat leniniste. Kongresi i partisë, si organ kolegjal dhe më i lartë i saj, nuk është thirrur rregullisht. Kështu, për shembull, nga Kongresi i 7-të e deri tek i 8-ti kaluan 11 vjet, ndërsa nga

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 348.

i 8-ti tek i 9-ti pas lufte — 13 vjet. Veç kësaj, edhe ato kongrese, që janë zhvilluar, kanë qenë formale, më tepër mbledhje parade sesa pune. Delegatët e kongreseve nuk zgjidheshin në përputhje me parimet e normat marksiste-leniniste të jetës së partisë, por caktoheshin nga organet drejtuese dhe vepronin simbas sistemit të përfaqësisë së përhershme.

Kohët e fundit në gazetën «Zhenminzhibao» u botua një artikull, i shkruar nga një i ashtuquajtur grup teorik i «Zyrës së Përgjithshme» të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës<sup>1</sup>. Artikulli pohon se Maoja, nën emrin e «Zyrës së Përgjithshme», kishte krijuar rreth vetes një aparat të posaçëm që survejonte dhe mbante nën kontroll Byronë Politike, Komitetin Qendror të Partisë, kuadrot e shtetit, të ushtrisë, të sigurimit etj. Në këtë zyrë u ishte ndaluar hyrja dhe njohja me punën e saj të gjithëve, duke përfshirë Komitetin Qendror dhe Byronë Politike. Këtu hartoheshin projektet për rrëzimin ose për ngritjen e këtij apo të atij grupi fraksionist. Njerëzit e kësaj zyre ndodheshin kudo, përgjonin, vëzhgonin e raportonin në mënyrë të pavarur dhe jashtë kontrollit të partisë. Përveç këtyre, kjo zyrë kishte në dispozicion të saj edhe reparte të tëra të armatosura, që fshiheshin pas emrit të «gardës së kryetarit Mao». Kjo gardë pretoriane prej më se 50 000 vetash hynte në veprim kur kryetari vendoste «të vepronte me një të goditur», siç ka ndodhur shpesh në historinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe

---

1. «Të kemi gjithnjë në mendje mësimet e kryetarit Mao», «Zhenminzhibao», 8 shtator 1977.

siç ndodhi tani së fundi me arrestimin e «katërshes» e të përkrahësve të saj nga Hua Kuo Feni.

Nën pretekstin e mbajtjes së kontakteve me masat. Mao Ce Duni kishte krijuar, gjithashtu, një rrjet të posaçëm informatorësh për terrenin, të cilëve u qe ngarkuar detyra të hetonin e tëurvejonin pa dijeninë e kurrkujt kuadrot e bazës, gjendjen dhe psikologjinë e masave. Këta i raportonin drejtpërdrejt vetëm Mao Ce Dunit, i cili i kishte prerë të gjitha mjetet e komunikimit me masat dhe e shihte botën nëpërmjet të dhënave të agjentëve të «Zyrës së Përgjithshme». Maoja ka thënë: «Për veten time, unë jam një njeri që nuk i dëgjoj radiot, as ato të huajat dhe as atë të Kinës, po vetëm transmetoj». Ai ka pohuar gjithashtu: «Kam deklaruar hapur se nuk do ta lexoj më gazetën «Zhenminzhibao». Këto ia thashë edhe kryeredaktorit të saj: Unë nuk e lexoj gazetën tënde»<sup>1</sup>.

Artikulli i «Zhenminzhibaos» jep të dhëna të reja për të kuptuar edhe më mirë drejtimin antimarksist dhe pushtetin personal të Mao Ce Dunit në partinë dhe në shtetin kinez. Mao Ce Duni nuk ka pasur konsideratën më të vogël as për Komitetin Qendror, as për kongresin e partisë, pa lëre më për partinë në tërësi dhe për komitetet e saj në bazë. Komitetet e partisë, kuadrot udhëheqës dhe deri vetë Komiteti Qendror merrnin urdhra nga «Zyra e Përgjithshme», nga ky «shtab i veçantë», i cili pyeste vetëm Mao Ce Dunit.

---

1. Nga biseda e Mao Ce Dunit me shokë të Partisë sonë, 3 shkurt 1967. Arkivi Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë. (AQP).



Forumet e partisë, organet e zgjedhura të saj nuk kishin asnjë kompetencë. Në artikullin e «Zhenmin-zhibaos» thuhet se «asnjë telegram, asnjë letër, asnjë shkresë, asnjë urdhër, nuk mund të jepej nga kurrkush pa kaluar më parë nga Mao Ce Duni dhe pa u aprovuar më parë prej tij». Rezulton se qysh në vitin 1953 Mao Ce Duni kishte lëshuar një urdhër të prerë: «Që sot e tutje të gjitha dokumentet dhe telegramet që dalin në emrin e Komitetit Qendror, duhet t'i nënshtrohen kontrollit tim përpara se të dërgohen në destinacion, në rast të kundërt ato janë të pavlefshme e të paqena»<sup>1</sup>. Në këto kushte as që mund të bëhet fjalë për kolegjalitet, për demokraci të brendshme në parti, për norma leniniste.

Pushteti i pakufizuar i Mao Ce Dunit shkonte deri atje sa ai caktonte edhe trashëgimtarët e tij. Dikur ai ka pasë caktuar Liu Shao Çinë si zëvendësin e tij. Më vonë ai shpalli se trashëgimtari i pushtetit dhe i partisë, pas vdekjes së tij, do të ishte Lin Biaoja. Kjo gjë, që nuk është parë ndonjëherë në praktikën e partive marksiste-leniniste, u sanksionua deri në statutin e partisë. Ishte përsëri Mao Ce Duni ai që caktoi Hua Kuo Fenin kryetar të partisë, pasi të vdiste. Vetë Maoja, duke pasur fuqinë në dorë, kritikonte, gjykonte, ndëshkonte dhe pastaj rehabilitonte udhëheqës të lartë të partisë dhe të shtetit. Kështu ndodhi edhe me Ten Hsiao Pinin, i cili në të ashtuquajturën autokritikë të tij, më 23 tetor 1966, ka pohuar: «Unë dhe Liu Shao

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 96.

Çi jemi monarkistë të vërtetë. Thelbi i gabimeve të mia qëndron në faktin se unë nuk kam besim te masat, nuk i përkrah masat revolucionare, por qëndroj kundër tyre, kam ndjekur një vijë reaksionare për të shtypur revolucionin, në luftën klasore nuk kam qëndruar në anën e proletariatit, por të borgjezisë. . . Të gjitha këto tregojnë se. . . nuk jam i përshtatshëm të mbaj poste me përgjegjësi»<sup>1</sup>. Dhe me gjithë këto krime që ka bërë ky revizionist me damkë, u rikthye në kolltukun që kishte.

Thelbi antimarksist i maocedunidesë mbi partinë dhe rolin e saj duket gjithashtu edhe në mënyrën se si konceptoheshin teorikisht dhe zbatoheshin në praktikë marrëdhëniet midis partisë dhe ushtrisë. Pavarësisht nga formulat që përdorte Mao Ce Duni duke thënë «partia mbi ushtrinë», «politika mbi pushkën» etj., etj., ai në praktikë rolin kryesor politik në jetën e vendit ia linte ushtrisë. Qysh në kohën e luftës ai thoshte: «Të gjithë kuadrot e ushtrisë duhet të jenë të aftë të udhëheqin punëtorët dhe të organizojnë sindikata, të mobilizojnë dhe të organizojnë rininë, të bashkohen me kuadrot e krahinave të reja të çliruara dhe t'i mësojnë ata, të administrojnë industrinë dhe tregtinë, të drejtojnë shkolla, gazeta, agjenci lajmesh dhe stacione të radiopërhapjes, të merren me çështje të punëve të jashtme, të rregullojnë problemet lidhur me partitë demokratike dhe organizatat popullore, të koordinojnë marrëdhëniet midis qytetit dhe fshatit, të

1. Nga autokritika e Ten Hsiao Pinit. AQP.

zgjidhin problemet e ushqimit dhe të furnizimit me qymyr dhe artikuj e prodhime të tjera të nevojës së parë, si dhe të rregullojnë çështjet monetare e financiare»<sup>1</sup>.

Pra, ushtria qëndronte mbi partinë, mbi organet shtetërore, mbi gjithçka. Këtë del se fjalët e Mao Ce Dunit për sa i përket rolit të partisë, si faktori vendimtar për udhëheqjen e revolucionit dhe të ndërtimit socialist, kanë qenë vetëm slogane. Si në kohën e luftës çlirimtare, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, në të gjitha luftërat e vazhdueshme që janë bërë atje për marrjen e pushtetit nga ana e njërit ose e tjetrit fraksion, ushtria ka luajtur rolin vendimtar. Edhe gjatë Revolucionit Kulturor ushtria luajti rolin kryesor; ajo ishte rezerva e fundit e Maos. «Ne, ka thënë Mao Ce Duni në vitin 1967, mbështetemi në forcën e ushtrisë... Në Pekin kemi pasur vetëm dy divizione, por në maj sollëm dhe dy të tjera për të larë hesapet me ish-komitetin e partisë të Pekinit»<sup>2</sup>.

Mao Ce Duni, për të likuiduar kundërshtarët e vet ideologjikë, ka vënë kurdoherë në lëvizje ushtrinë. Ai ngriti ushtrinë me në krye Lin Biaon për të vepruar kundër grupit të Liu Shao Çisë dhe Ten Hsiao Pinit. Më vonë me Çu En Lain ai organizoi dhe e hodhi ushtrinë kundër Lin Biaos. E frymëzuar nga maocedunideja ushtria ka luajtur një rol të tillë edhe

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura. vëll. 4, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 355.

2. Nga bliseda e Mao Ce Dunit me delegacionin e Miqësisë të RPSH, 18 dhjetor 1967. AQP.

pas vdekjes së Maos. Si të gjithë ata që kanë ardhur në fuqi në Kinë, edhe Hua Kuo Feni u mbështet dhe veproi me ushtrinë. Ky, sa vdiq Maoja, ngriti përnjëherë ushtrinë, organizoi, bashkë me ushtarakët Jeh Çien Jin, Van Tun Hsin e të tjerë, puçin, arrestoi kundërshtarët e tij.

Në Kinë pushteti vazhdon të jetë në duart e ushtrisë, kurse partia qëndron në bisht. Kjo është karakteristikë e përgjithshme e vendeve ku sundon revizionizmi. Vendet e vërteta socialiste e forcojnë ushtrinë, si armë të fuqishme të diktaturës së proletariatit, për të shtypur armiqtë e socializmit, në rast se ngrenë krye, si dhe për të mbrojtur vendin nga një sulm i mundshëm nga ana e imperialistëve dhe e reaksionit të jashtëm. Por që ushtria ta luajë gjithnjë këtë rol, ajo, siç na mëson marksizëm-leninizmi, duhet të jetë kurdoherë nën drejtimin e partisë dhe jo të jetë partia nën drejtimin e ushtrisë.

Aktualisht në Kinë ligjin e bëjnë fraksionet më të forta të ushtrisë dhe që janë ato më reaksionaret, që synojnë ta shndërrojnë Kinën në një vend socialimperialist.

Në të ardhmen, krahas shndërrimit të Kinës në një superfuqi imperialiste, do të rriten gjithnjë e më shumë edhe roli e forca e ushtrisë në jetën e vendit. Ajo do të forcohet si një gardë pretoriane e armatosur deri në dhëmbë për mbrojtjen e një regjimi dhe të një ekonomie kapitaliste. Ajo do të jetë vegla e një diktature borgjeze kapitaliste, e një diktature që, në rast se rezistenca popullore do të jetë e fortë, mund të marrë edhe forma të hapëta fashiste.

Mao cedunideja, duke predikuar nevojën e ekzistencës në udhëheqje të vendit të shumë partive, të ashtuquajturin pluralizëm politik, bie në kundërshtim të plotë me doktrinën marksiste-leniniste mbi rolin e pandarë të partisë komuniste në revolucion dhe në ndërtimin socialist. Udhëheqjen e një vendi nga disa parti politike, sipas modelit amerikan, Mao Ce Duni, siç i ka deklaruar E. Snout, e quante formën më demokratike të qeverisjes. «Çfarë është më mirë, në fund të fundit, pyeste Mao Ce Duni, të kesh një apo shumë parti?» Dhe përgjigjej: «Siç e shikojmë ne tani, është e preferueshme të kemi shumë parti. Kështu ka qenë për të kaluarën dhe kështu mund të jetë edhe për të ardhmen. Kjo është bashkekzistenca për një kohë të gjatë dhe kontrolli reciprok»<sup>1</sup>. Maoja e ka quajtur të domosdoshme pjesëmarrjen e partive borgjeze në pushtet dhe në qeverisjen e vendit me po ato të drejta dhe me po ato prerogativa si dhe Partia Komuniste e Kinës. Dhe jo vetëm kaq, por këto parti të borgjezisë që, sipas tij, «ishin historike», nuk mund të shuhen veçse kur të vijë koha të shuhet edhe Partia Komuniste e Kinës, domethënë do të bashkekzistojnë deri në komunizëm.

Sipas maocedunidesë vetëm mbi bazën e bashkëpunimit të të gjitha klasave dhe të të gjitha partive mund të ekzistojë një regjim i ri demokratik dhe mund të ndërtohet socializmi. Një konceptim i tillë i demokracisë socialiste, i sistemit politik socialist, që mbësh-

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 319.

tetet në «bashkekzistencën e gjatë dhe kontrollin reciprok» të të gjitha partive dhe që është shumë i ngjashëm me predikimet aktuale të revizionistëve italianë, francezë, spanjollë e të tjerë, është një mohim i hapur i rolit udhëheqës e të pandarë të partisë marksiste-leniniste në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit. Përvoja historike ka vërtetuar tashmë se pa rolin udhëheqës e të pandarë të partisë marksiste-leniniste nuk mund të ekzistojë diktatura e proletariatit, të ndërtohet dhe të mbrohet socializmi.

*«...diktatura e proletariatit — thoshte Stalini — mund të jetë e plotë vetëm në rast se atë e udhëheq një parti, partia e komunistëve, e cila nuk e ndan dhe nuk duhet ta ndajë udhëheqjen me parti të tjera»<sup>1</sup>.*

Konceptet revizioniste të Mao Ce Dunit e kanë bazën e vet në politikën e bashkëpunimit dhe të aleancës me borgjezinë, që ka zbatuar vazhdimisht Partia Komuniste e Kinës. Këtu e ka burimin edhe kursi antimarksist e antileninist i «lulëzimit të 100 luleve dhe i konkurrimit të 100 shkollave», që është shprehje e drejtpërdrejtë e bashkekzistencës së ideologjive të kundërta.

Sipas Mao Ce Dunit, në shoqërinë socialiste, krahas ideologjisë proletare, materializmit dhe ateizmit, duhet të lejohen edhe ekzistenca e ideologjisë borgjeze, e idealizmit dhe e fesë, rritja e «barërave helmuese»

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 10, f. 97.

krahas «luleve me erë» etj. Një kurs i tillë, gjoja qenka i domosdoshëm për zhvillimin e marksizmit, për t'u hapur rrugën debateve, lirisë së mendimit, ndërsa në realitet, me këtë kurs ai përpiqet t'i vërë bazën teorike politikës së bashkëpunimit me borgjezinë dhe bashkëjetesës me ideologjinë e saj. Mao Ce Duni thotë se «...t'u ndalosh njerëzve të hyjnë në kontakt me atë që është e gabuar, me të shëmtuarën ose me atë që është armiqësore ndaj nesh, me idealizmin dhe metafizikën, të njihen me mendimet e Konfucit, Lao Cesë dhe të Çan Kai Shisë, do të ishte një politikë e rrezikshme. Ajo do të çonte në regresin e mendimit, në njëanshmëri dhe do ta bënte njeriun të paaftë për t'u qëndruar provave të jetës...»<sup>1</sup>. Prej kësaj Mao Ce Duni nxjerr konkluzionin se idealizmi, metafizika dhe ideologjia borgjeze do të ekzistojnë përjetë, prandaj ato jo vetëm që nuk duhet të ndalohen, por edhe t'u jepet mundësia të shpërthejnë, të dalin në sipërfaqe dhe të konkurrojnë. Ky qëndrim pajtues ndaj çdo gjëje reaksionare shkon aq thellë, saqë trazirat në shoqërinë socialiste i quan të pashmangshme dhe ndalimin e veprimtarisë së armiqve të gabuar. «Për mendimin tim, thotë ai, cilido që ka dëshirë të provokojë trazira, mund t'i bëjë dhe për aq kohë sa ai do: në qoftë se nuk i mjafton një muaj, ne t'i japim dy, me një fjalë ne nuk do ta deklarojmë qështjen të mbyllur veçse kur ai të jetë ngopur nga trazirat. Në qoftë

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura; vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 397.

se ju do të nguteni t'u jepni fund trazirave, ato shpejt ose vonë do të rifillojnë përsëri»<sup>1</sup>.

Të gjitha këto nuk kanë qenë diskutime akademike, «shkencore», por një vijë politike oportuniste kundërrivolucionare që i është kundërvënë marksizëm-leninizmit, që e ka çoroditur Partinë Komuniste të Kinës, në gjirin e së cilës kanë qarkulluar njëqind e një pikëpamje dhe mendime dhe sot ka me të vërtetë 100 shkolla që konkurrojnë. Kjo ka bërë që grerëzat borjeze të qarkullojnë lirisht në kopshtin e 100 luleve dhe të lëshojnë helmin e tyre.

Një qëndrim i tillë oportunist në çështjet ideologjike i ka rrënjët, përveç të tjerave, edhe në atë që Partia Komuniste e Kinës, gjatë gjithë periudhës që nga koha e themelimit të saj dhe derisa arriti në çlirimin e vendit dhe më vonë, nuk është përpjekur të konsolidojë ideologjikisht, nuk ka punuar për të futur në mendjet dhe në zemrat e anëtarëve të saj teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, nuk ka luftuar për të përvetësuar çështjet themelore të ideologjisë marksiste-leniniste dhe t'i zbatonte ato me konsekuencë dhe hap pas hapi, në kushtet konkrete të Kinës.

Maocedunideja është në kundërshtim me teorinë marksiste-leniniste të revolucionit.

Në shkrimet e Mao Ce Dunit flitet shpesh për rolin e revolucioneve në procesin e zhvillimit të shoqërisë, por në thelb ai i përmbahet një koncepti metafizik,

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 405-406.



evolucionist. Në kundërshtim me dialektikën materialiste, që argumenton zhvillimin progresiv në formë spiraleje, Mao Ce Duni predikon zhvillimin në formë ciklike, si rrethqarkullim, si një proces valë-valë që kalon nga ekuilibri në çekuilibër dhe përsëri në ekuilibër, nga lëvizja në jo lëvizje dhe përsëri në lëvizje, nga ngritja në ulje dhe nga ulja në ngritje, nga ecja përpara në kthim prapa, dhe përsëri ecje përpara etj. Kështu, duke iu përmbajtur konceptit të filozofisë së lashtë mbi rolin pastrues të zjarrit, Mao Ce Duni shkruan: «Duhet periodikisht «të ndizet zjarri». Por nga t'ia fillojmë në të ardhmen? Ta ndezësh atë, sipas jush, një herë në vit apo një çdo tre vjet? Për mendimin tim kjo duhet bërë të paktën dy herë në çdo pesë vjet, tamam ashtu si muaji i trembëdhjetë i kalendarit hënor-diellor, që vjen në çdo tre vjet ose dy herë në pesë vjet»<sup>1</sup>. Pra, ashtu si astrologët e dikurshëm, nga kalendari hënor ai nxjerr ligjin mbi ndezjen periodikisht të zjarrit, mbi zhvillimin që shkon nga «harmonia e madhe» në «çrregullimin e madh» dhe përsëri në «harmoninë e madhe» e kështu ciklet përsëriten periodikisht. Në këtë mënyrë konceptit materialist dialektik mbi zhvillimin, i cili, siç thotë Lenini,

*«...na jep çelësin për të kuptuar «vetëlëvizjen» e çdo gjëje ekzistuese; . . . na jep çelësin për të kuptuar «hopet», «ndërprerjen e gradualitetit»,*

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 499.

*«shndërrimin në të kundërtën», zhdukjen e së  
vjetrës dhe lindjen e së resë»<sup>1</sup>,*

maocedunideja i kundërvë konceptin metafizik që «është i vdekur, i zbectë, i thatë».

Kjo duket edhe më qartë në trajtimin që i bën Mao Ce Duni problemit të kontradiktave, për të cilin, sipas propagandës kineze, Maoja paska dhënë «kontribut të veçantë» dhe paska zhvilluar më tej dialektikën materialiste në këtë fushë. Është e vërtetë që Mao Ce Duni në shumë nga shkrimet e tij flet shpesh për të kundërtat, për kontradiktat, për unitetin e të kundërtave, përdor edhe citate e fraza marksiste, por megjithatë është larg kuptimit materialist dialektik të këtyre çështjeve. Në trajtimin e kontradiktave ai nuk niset nga tezat marksiste, por nga ato të filozofëve të lashtë kinezë, i shikon të kundërtat në mënyrë mekanike si fenomene të jashtme dhe shndërrimin e të kundërtave e përfytyron si ndërrim të thjeshtë të vendeve midis tyre. Duke operuar me disa të kundërta të tilla të përjetshme të marra nga filozofia e lashtë, si lart-poshtë, prapa-përpara, e djathtë-e majtë, e lehtë-e rëndë etj., etj., Mao Ce Duni, në thelb, mohon kontradiktat e brendshme në vetë sendet dhe fenomenet dhe zhvillimin e trajton si një përsëritje të thjeshtë, si një varg gjendjesh të pandryshueshme ku vërehen po ato të kundërta dhe po ai raport midis tyre. Shndërrimi i të kundërtave në njëra-tjetrën, i kuptuar si ndryshim i thjeshtë vendesh dhe jo si zgji-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 393.

dhje e kontradiktës e si një ndryshim cilësor i vetë fenomenit që i përmban këto të kundërta, përdoret nga Mao Ce Duni si një skemë formale së cilës i nënshtrohet gjithçka. Duke u nisur nga kjo skemë, Maoja arrin të deklarojë se «Kur dogmatizmi shndërrohet në të kundërtën e vet, ai bëhet ose marksizëm, ose revizionizëm»<sup>1</sup>, «metafizika shndërrohet në dialektikë dhe dialektika në metafizikë» etj. Prapa pohimeve të tilla absurde dhe prapa lojës sofistike me të kundërtat, fshihen konceptet oportuniste dhe antirevolucionare të Mao Ce Dunit. Kështu revolucionin socialist ai nuk e sheh si një ndryshim cilësor të shoqërisë, ku zhduken klasat antagoniste dhe shtypja e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, por e përfytyron si një ndërrim të thjeshtë të vendeve midis borgjezisë dhe proletariatit. Për të vërtetuar këtë «zbulim» Maoja shkruan: «Në qoftë se borgjezia dhe proletariati nuk mund të shndërrohen në njëri-tjetrin, atëherë si shpjegohet që nëpërmjet revolucionit proletariati bëhet klasë sunduese dhe borgjezia një klasë e sunduar?... Në dhe Guomindani çankaishist në themel jemi të kundërt me njëri-tjetrin. Si rrjedhim i luftës dhe i përjashtimit reciprok të të dy aspekteve kontradiktore ne me Guomindanin ndërruam vendet...»<sup>2</sup>. Po kjo logjikë e ka çuar Mao Ce Dunit edhe në revizionimin e teorisë marksiste-leniniste mbi dy fazat e shoqërisë komuniste. «Dialektika na mëson se regjimi socialist, si fenomen

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 479.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 399-400.

historik, do të zhduket një ditë, ashtu siç vdes njeriu, dhe se regjimi komunist do të jetë mohim i regjimit socialist. Si mund të konsiderohet si marksiste teza sipas së cilës regjimi socialist si dhe marrëdhëniet në prodhim dhe superstruktura e socializmit nuk do të zhduken? A nuk do të ishte kjo një dogmë fetare, teologji që predikon përjetshmërinë e zotit?»<sup>1</sup>.

Në këtë mënyrë Mao Ce Duni, duke revizionuar hapur kuptimin marksist-leninist mbi socializmin e komunizmin, që në thelb janë dy faza të një tipi, të një rendi ekonomiko-shoqëror dhe që dallohen vetëm nga shkalla e zhvillimit dhe e pjekurisë së tyre, e paraqit socializmin si diçka diametralisht të kundërt me komunizmin.

Nga koncepte të tilla metafizike e antimarksiste Mao Ce Duni trajton në përgjithësi çështjen e revolucionit, të cilin e shikon si një proces të pafund që përsëritet periodikisht gjatë gjithë kohës që do të ekzistojë njerëzimi mbi tokë, si një proces që kalon nga disfata në fitore, nga fitorja në disfatë e kështu me radhë. Konceptet antimarksiste, herë evolucioniste dhe herë anarkiste të Mao Ce Dunit mbi revolucionin, duken edhe më qartë kur ai trajton problemet e revolucionit në Kinë.

Siç del nga shkrimet e tij, Mao Ce Duni nuk është mbështetur në teorinë marksiste-leniniste për të analizuar problemet dhe për të përcaktuar detyrat e revolucionit kinez. Ai vetë pohon në fjalën e mbajtur në

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 409.

konferencën e zgjeruar të punës të thirrur nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës në janar 1962, se «puna jonë shumëvjeçare revolucionare kryhej qorrazi, pa ditur si duhet kryer revolucionit, kundër kujt duhet drejtuar tehu i revolucionit, pa i përfytyruar etapat e tij, se kë duhet të rrëzojë në fillim e kë më vonë etj.». Kjo ka bërë që Partia Komuniste e Kinës të mos ishte e aftë që të siguronte udhëheqjen e proletariatit në revolucionin demokratik dhe shndërrimin e tij në revolucion socialist. Gjithë zhvillimi i revolucionit kinez dëshmon për rrugën kaotike të Partisë Komuniste të Kinës, e cila nuk udhëhiqej nga marksizëm-leninizmi, por nga konceptet antimarksiste të maocedunidesë mbi karakterin e revolucionit, mbi etapat e tij, mbi forcat lëvizëse etj.

Mao Ce Duni nuk mundi të kuptojë asnjëherë e të shpjegojë drejt lidhjet e ngushta midis revolucionit demokratiko-borgjez dhe revolucionit proletar. Në kundërshtim me teorinë marksiste-leniniste, që ka argumentuar shkencërisht se midis revolucionit demokratiko-borgjez dhe revolucionit socialist nuk ngrihet një mur kinez, se këto dy revolucione nuk duhet të ndahen njëri nga tjetri me periudha të gjata kohe, Mao Ce Duni pohonte se «shndërrimi i revolucionit tonë në revolucion socialist është një çështje e së ardhmes... Se kur do të bëhet ky kalim... për këtë mund të duhet një periudhë mjaft e gjatë. Derisa për një kalim të tillë nuk janë të gjitha kushtet politike dhe ekonomike të nevojshme, derisa ky kalim nuk mund t'i sjellë dobi, por dëm shumicës dërrmuese të

popullit tonë, nuk duhet bërë fjalë për këtë kalim»<sup>1</sup>.

Këtij koncepti antimarksist, që nuk është për shndërrimin e revolucionit demokratiko-borgjez në revolucion socialist, Mao Ce Duni i është përmbajtur gjatë gjithë kohës së revolucionit, bile edhe pas çlirimit. Kështu, më 1940 Mao Ce Duni thotë se «Revolucioni kinez duhet të kalojë medoemos... fazën e demokracisë së re dhe vetëm pastaj — fazën e socializmit. Nga këto faza e parë do të jetë relativisht e gjatë...»<sup>2</sup>. Në mars të vitit 1949, në plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, në të cilin Mao Ce Duni paraqiti programin për zhvillimin e Kinës së pasçlirimit, thotë: «Gjatë kësaj periudhe do të duhet të lejohen të gjithë elementët e kapitalizmit, të qytetit dhe të fshatit». Këto pikëpamje dhe «teori» kanë bërë që Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni të mos luftojnë për rritjen e revolucionit në Kinë në revolucion socialist, t'u lënë fushë të lirë zhvillimit të borgjezisë dhe raporteve shoqërore kapitaliste.

Në çështjen e raportit midis revolucionit demokratik dhe atij socialist Mao Ce Duni qëndron në pozitë të krerëve të Internacionales të Dytë, të cilët ishin të parët që atakuan dhe shtrembëruan teorinë marksist-leniniste mbi rritjen e revolucionit dhe dolën me tezën se midis revolucionit demokratiko-borgjez dhe revolucionit socialist ekziston një periudhë e gjatë kohe,

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 1, bot. shqip, f. 210.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, f. 169.

gjatë së cilës borgjezia zhvillon kapitalizmin dhe krijon kushte për të kaluar në revolucionin proletar. Shndërrimin e revolucionit demokratiko-borgjez në revolucion socialist, pa i dhënë mundësi kapitalizmit të zhvillohet më tej, ata e shikonin si të pamundshëm, si një djegiec etapash. Këtij koncepti i përmbahet plotësisht edhe Mao Ce Duni, kur thotë: «Të përpiqesh ta ndërtosh socializmin mbi gërmadhat e rendit kolonial, gjysmëkolonial dhe gjysmëfeudal, pa një shtet të bashkuar të demokracisë së re... pa zhvilluar ekonominë kapitaliste private... do të ishte një utopi fund e krye»<sup>1</sup>.

Konceptet antimarksiste të maocedunidesë mbi revolucionin duken edhe më qartë në trajtimin që Maoja u ka bërë forcave lëvizëse të revolucionit. Mao Ce Duni nuk njihte rolin hegjemon të proletariatit. Lenini ka thënë se në periudhën e imperializmit, në çdo revolucion, pra edhe në revolucionin demokratik, në revolucionin antiimperialist nacionalçlirimtar dhe në revolucionin socialist, udhëheqja duhet t'i takojë proletariatit. Ndërsa Mao Ce Duni, megjithëse fliste për rolin e proletariatit, në praktikë nënvleftësonte hegjemoninë e tij në revolucion dhe ka ngritur lart rolin e fshatarësisë. Mao Ce Duni ka thënë se «...lufta e sotme kundër pushtuesve japonezë është, në thelb, luftë fshatare. Rendi politik i demokracisë së re, në thelb, do të thotë t'i japësh fshatarësisë pushtetin»<sup>2</sup>.

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 4, bot. shqip, f. 366.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, f. 177-178.

Këtë teori mikroborgjeze Mao Ce Duni e shprehte në tezën globale «fshati të rrethojë qytetin», «...fshati revolucionar, shkruante ai, mund të rrethojë qytetet... puna në fshat duhet të luajë rolin kryesor në lëvizjen revolucionare kineze, kurse puna në qytet — një rol të dorës së dytë»<sup>1</sup>. Këtë ide Maoja e ka pasqyruar edhe kur ka shkruar për rolin e fshatarësisë në pushtet. Ai ka thënë se të gjitha partitë dhe forcat e tjera politike duhet t'u nënshtrohen fshatarësisë dhe pikëpamjeve të saj. «...do të ngrihen më këmbë miliona fshatarë; ata do të jenë të rrëmbyer e të pamposhtur, si një uragan i vërtetë, shkruan ai, dhe s'do të ketë forcë që t'i ndalë... Ata do t'i vënë në provë të gjitha partitë dhe grupet revolucionare, të gjithë revolucionarët, me qëllim që ose t'i pranojnë pikëpamjet e tyre, ose t'i hedhin poshtë»<sup>2</sup>. Sipas Maos del se fshatarësia dhe jo klasa punëtore duhet të jetë hegjemone në revolucion.

Teza mbi rolin hegjemon të fshatarësisë në revolucion u predikua nga Mao Ce Duni edhe si rrugë e revolucionit botëror. Këtu e ka burimin koncepti anti-marksist që e konsideron të ashtuquajturën botë të tretë, që në letërsinë politike kineze quhet edhe «fshati botëror», si «forcën kryesore lëvizëse për transformimin e shoqërisë së sotme». Sipas pikëpamjeve kineze, proletariati është një forcë shoqërore e dorës së dytë, që nuk mund ta luajë atë rol që parashikojnë Marksi dhe Lenini në luftën kundër kapitalizmit dhe në fito-

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 4, bot. shqip, f. 257, 259.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 1, bot. shqip, f. 27-28.



ren e revolucionit, në aleancë me të gjitha forcat e shtypura nga kapitali.

Në revolucionin kinez ka dominuar borgjezia e vogël dhe e mesme. Është kjo shtresë e gjerë e mikroborgjezisë që ka influencuar në gjithë zhvillimin e Kinës.

Mao Ce Duni nuk bazohej në teorinë marksiste-leniniste që na mëson se fshatarësia, përgjithësisht borgjezia e vogël, është e lëkundshme. Natyrisht, fshatarësia e varfër dhe e mesme luan një rol të rëndësishëm në revolucion dhe ajo duhet të bëhet aleate e ngushtë e proletariatit. Por klasa fshatare, borgjezia e vogël, nuk mund ta udhëheqë proletariatin në revolucion. Të mendosh dhe të predikosh të kundërtën do të thotë të jesh kundër marksizëm-leninizmit. Këtu qëndron edhe një nga burimet kryesore të pikëpamjeve antimarksiste të Mao Ce Dunit, që kanë influencuar negativisht në tërë revolucionin kinez.

Parimi bazë revolucionar e udhërrëfyes mbi hegjemoninë e proletariatit në revolucion për Partinë Komuniste të Kinës nuk ka qenë i qartë as në teori dhe rrjedhimisht nuk zbatohet si duhet e me konsekuencë as në praktikë. Përvoja tregon se fshatarësia mund ta luajë rolin e saj revolucionar vetëm në qoftë se ajo vepron në aleancë me proletariatin dhe nën udhëheqjen e tij. Një gjë e tillë u provua edhe në vendin tonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Fshatarësia shqiptare ishte forca kryesore në revolucionin tonë, megjithëkëtë klasa jonë punëtore, sido që ishte shumë e vogël në numër, e udhëhoqi fshatarësinë, sepse ideologjia marksiste-leniniste, ideologjia e proletariatit. e

mishëruar në Partinë Komuniste, sot Partia e Punës, pararoja e klasës punëtore, ishte udhëheqësja e revolucionit. Prandaj ne fituam jo vetëm në Luftën Nacionalçlirimtare, por edhe në ndërtimin e socializmit.

Ne patëm suksese të njëpasnjëshme, me gjithë vështirësitë e panumërta që hasëm në rrugë. Këto suksese, në radhë të parë, i arritëm sepse Partia përvetësoi mirë thelbin e teorisë së Marksit e të Leninit, kuptoi ç'ishte revolucionin, kush e bënte dhe kush duhej ta udhëhiqte atë, kuptoi se në krye të klasës punëtore, në aleancë me fshatarësinë, duhej të ishte një parti e tipit leninist. Komunistët kuptuan se kjo parti nuk duhej të kishte vetëm emrin komuniste, por të ishte edhe një parti që të zbatonte në kushtet e vendit tonë teorinë marksiste-leniniste të revolucionit e të ndërtimit të Partisë, t'i hynte punës për krijimin e shoqërisë së re socialiste në shembullin e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit. Ky qëndrim i dha Partisë sonë fitoren, i dha vendit forcën e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake që ka sot. Po të ishte vepruar ndryshe, po të mos zbatoheshin me konsekuencë këto parime të teorisë sonë të madhe, në një vend të vogël si yni, të rrethuar me armiq, nuk mund të ndërtohej socializmi. Edhe në qoftë se për një moment do të merrej pushteti, atë do ta rrëmbente përsëri borgjezia, sikundër ndodhi në Greqi, ku, akoma pa u fituar lufta, Partia Komuniste Greke ua dorëzoi armët borgjezisë reaksionare të vendit dhe imperializmit anglez.

Prandaj çështja e hegjemonisë në revolucion ka

rëndësi të madhe parimore, sepse nga fakti se kush e udhëheq atë varet drejtimi dhe zhvillimi i tij.

*«Heqja dorë nga ideja e hegjemonisë — theksonte Lenini — është trajta më trashanike e reformizmit»<sup>1</sup>.*

Pikërisht mohimi nga maocedunideja i rolit hegjemon të proletariatit ishte një nga shkaqet që revolucionin kinez mbeti një revolucion demokratiko-borgjez dhe nuk u rrit në revolucion socialist. Mao Ce Duni në shkrimin «Demokracia e re» predikonte që, pas fitores së revolucionit në Kinë, të vendosej një regjim, i cili të mbështetej në aleancën e «klasave demokratike», ku ai përfshinte përveç fshatarësisë e proletariatit edhe borgjezinë e vogël të qytetit dhe borgjezinë kombëtare. «Në qoftë se është e drejtë, shkruan ai, që «duhet të hanë të gjithë», atëherë edhe pushteti nuk duhet të përvetësohet vetëm nga një parti, një grup, një klasë»<sup>2</sup>. Kjo gjë është reflektuar edhe në flamurin shtetëror të Republikës Popullore të Kinës me katër yje, që përfaqësojnë katër klasa: klasën punëtore, fshatarësinë, borgjezinë e vogël të qytetit dhe borgjezinë kombëtare.

Revolucioni në Kinë, që solli çlirimin e vendit, krijimin e shtetit të pavarur kinez, ishte një fitore e madhe për popullin kinez. për forcat antiimperialiste e demokratike botërore. Pas çlirimit në Kinë u bënë

1. V. I. Lenini, Veprat, vëll. 17, f. 252.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, f. 235.

mjaft ndryshime pozitive: u likuidua sundimi i imperializmit të huaj dhe i çifligarëve të mëdhenj, u luftuan varfëria dhe papunësia, u bënë një varg reformash ekonomike shoqërore në favor të masave punonjëse, u luftuan prapambetja arsimore e kulturore, u morën një varg masash për të rindërtuar vendin e shkatërruar nga lufta, u bënë edhe disa transformime me karakter socialist. Në Kinë, ku më parë vdisnin miliona, nuk kishte më uri etj. Këto janë fakte të pamohueshme, janë fitore me rëndësi për popullin kinez.

Nga marrja e këtyre masave dhe nga fakti që në pushtet erdhi Partia Komuniste e Kinës, u duk sikur Kina po shkonte në socializëm. Por nuk ndodhi kështu. Partia Komuniste e Kinës, e cila pas fitores së revolucionit demokratiko-borgjez duhej të ecte me kujdes, të mos tregojë majtiste dhe të mos i digjte etapat, duke pasur në bazën e veprimtarisë së vet maocedunidenë, u tregua «demokratike», liberale, oportuniste dhe nuk e udhëhoqi vendin me konsekuencë në rrugën e drejtë të socializmit.

Pikëpamjet politike dhe ideologjike jomarksiste, eklektike, borgjeze të Mao Ce Dunit i dhanë Kinës së çliruar një superstrukturë të paqëndrueshme, një organizim shtetëror dhe ekonomik kaotik, që nuk u stabilizua asnjëherë. Kina ndodhej në një rrëmujë të vazhdueshme, bile anarkiste, rrëmujë që nxitej nga vetë Mao Ce Duni me parullën «duhet turbulluar për të sqaruar».

Në shtetin e ri kinez një rol të posaçëm ka luajtur Çu En Lai. Ky ishte një ekonomist dhe organizator i

zoti, por nuk ka qenë kurrë një politikan marksist-leninist. Ai, si pragmatist tipik, diti të zbatonte pikëpamjet e tij jomarksiste dhe t'i akordonte këto në mënyrë të përsosur me çdo grup që merrte fuqinë në Kinë. Ai ishte një *poussah* që qëndronte përherë në këmbë, megjithëse kurdoherë lëkundej nga qendra në të djathtë, por asnjëherë në të majtë.

Çu En Lai ishte mjeshtër i kompromiseve pa parim. Ai ka mbështetur dhe dënuar Çan Kai Shinë, Kao Ganin, Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin, Mao Ce Dunin, Lin Biaon, «katërshen», por kurrë s'ka mbështetur Leninin dhe Stalinin, marksizëm-leninizmin.

Pas çlirimit, si rrjedhim i pikëpamjeve dhe i qëndrimeve të Mao Ce Dunit, të Çu En Lait e të tjerëve, në vijën politike të partisë u vunë re lëkundje të shumta nga të tëra anët. Në Kinë u ruajt e gjallë tendenca e predikuar nga maocedunideja, sipas së cilës etapa e revolucionit demokratiko-borgjez duhet të vazhdonte gjatë. Mao Ce Duni insistonte se në këtë etapë, krahas zhvillimit të kapitalizmit, të cilit i jepte prioritet, do të krijoheshin edhe premiset e socializmit. Me këtë lidhet edhe teza e tij mbi bashkekzistencën e socializmit me borgjezinë për një kohë shumë të gjatë, duke e paraqitur këtë si diçka të leverdishme edhe për socializmin edhe për borgjezinë. Duke iu përgjigjur atyre që e kundërshtonin një politikë të tillë dhe që sillnin si argument përvojën e Revolucionit Socialist të Tetorit, Mao Ce Duni thotë: «Borgjezia ruse ishte një klasë kundërrevolucionare; në atë kohë ajo nuk ishte për kapitalizmin shtetëror, merrej me sabotime e me veprimtari subversive, bile përdorte dhe armët. Proletariatit

rus nuk i mbetej gjë tjetër veçse ta likuidonte atë, por kjo i tërboi borgjezët e vendeve të ndryshme dhe ata filluan ta shajnë. Në Kinë ne e trajtojmë borgjezinë kombëtare në një mënyrë relativisht të moderuar dhe kjo e ndien veten më të qetë dhe mendon se mund të gjejë, megjithatë edhe ndonjë avantazh»<sup>1</sup>. Një politikë e tillë, sipas Mao Ce Dunit, i paska sjellë Kinës një nam të mirë në sytë e borgjezisë ndërkombëtare, por në të vërtetë ajo i ka bërë një dëm të madh socializmit në Kinë.

Qëndrimin oportunist ndaj borgjezisë Mao Ce Duni e ka paraqitur si një zbatim krijues të mësimëve të Leninit mbi NEP-in. Por midis mësimëve të Leninit dhe konceptit të Mao Ce Dunit mbi lejimin e pakufizuar të prodhimit kapitalist dhe të ruajtjes së marrëdhënieve borgjeze në socializëm ka një ndryshim rrënjësor. Lenini e pranon se NEP-i ishte një tërheqje që lejonte për një kohë zhvillimin e elementëve të kapitalizmit, por, thekson ai,

*«... këtu s'ka asgjë të rrezikshme për pushtetin proletar derisa proletariati e mban mirë pushtetin në duart e tij, derisa ai mban fort në duart e tij transportin dhe industrinë e madhe»<sup>2</sup>.*

Në Kinë as më 1949 dhe as më 1956, kur Mao Ce Duni bënte këto predikime, proletariati në fakt nuk mban-

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 338.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 434.

te në duart e tij as pushtetin, as industrinë e madhe.

Për më tepër NEP-in Lenini e shikonte si një çështje të përkohshme që imponohej nga kushtet konkrete të Rusisë së atëhershme të shkatërruar nga lufta e gjatë civile, por jo si një ligjshmëri të përgjithshme të ndërtimit socialist. Dhe është fakt se një vit pas shpalljes së NEP-it Lenini theksonte se tërheqja kishte marrë fund dhe hodhi parullën për përgatitjen e ofensivës kundër kapitalit privat në ekonomi. Kurse në Kinë periudha e ruajtjes së prodhimit kapitalist para-shikohej të zgjatej gati tërë jetën. Sipas pikëpamjes së Mao Ce Dunit rendi i vendosur pas çlirimit në Kinë duhej të ishte një rend demokratiko-borgjez, kurse në aparençë të ishte në fuqi Partia Komuniste e Kinës. E tillë është maocedunideja.

Kalimi nga revolucioni demokratiko-borgjez në revolucionin socialist mund të realizohet vetëm atëherë kur proletariati e largon në mënyrë të vendosur borgjezinë nga pushteti dhe e shpronëson atë. Sa kohë që në Kinë klasa punëtore e ndau pushtetin me borgjezinë, sa kohë që borgjezia ruajti privilegjet e saj, pushteti që u vendos në Kinë, nuk mund të ishte pushtet i proletariatit, si pasojë edhe revolucioni kinez nuk mund të rritej në një revolucion socialist.

Partia Komuniste e Kinës ka mbajtur një qëndrim dashamirës, oportunist ndaj klasave shfrytëzuese dhe Mao Ce Duni ka propaganduar hapur integrimin paqësor të elementëve kapitalistë në socializëm. Mao Ce Duni thoshte: «Ndonëse të gjithë ultrareaksionarët e botës janë sot ultrareaksionarë, dhe të tillë do të mbe-

ten edhe nesër e pasnesër, ata nuk mund të mbeten të tillë përjetë; në fund të fundit ata do të ndryshojnë... Ultrareaksionarët, në thelb, janë njerëz kokëfortë, por jo të qëndrueshëm... Qëllon që ultrareaksionarët ndryshojnë edhe për së mbari... ata i pranojnë gabimet e tyre dhe vihen në rrugë të drejtë. Me një fjalë ultrareaksionarët ndryshojnë»<sup>1</sup>.

Duke dashur t'i vërë një bazë teorike këtij koncepti oportunist dhe duke luajtur me «shndërrimin e të kundërtave», Mao Ce Duni thoshte se nëpërmjet diskutimit, kritikës e transformimit kontradiktat antagonistë shndërrohen në kontradikta joantagoniste, klasat shfrytëzuese dhe inteligjencia borgjeze mund të kthehen në të kundërtën e tyre, domethënë bëhen revolucionare. «Por në kushtet e vendit tonë, shkruan Mao Ce Duni më 1956, shumica e kundërrevolucionarëve do të korrigjohen në shkallë të ndryshme. Duke qenë se ne kemi adoptuar një politikë të drejtë ndaj kundërrevolucionarëve, shumë prej tyre kanë ndryshuar dhe nuk e kundërshtojnë më revolucionin. Bile disa i kanë bërë edhe shërbime»<sup>2</sup>.

Duke u nisur nga koncepte të tilla antimarksiste, sipas të cilave armiqtë e klasës me kalimin e kohës ndreqen, ai ka predikuar pajtimin klasor me ta dhe ka lejuar që ata të vazhdojnë të pasurohen, të shfrytëzojnë, të shprehen e të veprojnë lirisht kundër revolucionit. Për ta justifikuar këtë qëndrim kapitullues

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, f. 239.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 321.



ndaj armikut të klasës Mao Ce Duni shkruante: «Tani ne jemi të mbytur me punë deri në fyt dhe thjesht nuk kemi mundësi t'i atakojmë ata çdo ditë, gjatë 50 vjetëve. Ai që nuk dëshiron të ndreqet le të mbetet i tillë deri në varr dhe pastaj të dalë përpara gjyqit të ferrit»<sup>1</sup>. Duke vepruar në praktikë sipas këtyre konsideratave pajtuese me armiqtë, administrata shtetërore në Kinë mbeti në duart e funksionarëve të vjetër. Gjeneralët e Çan Kai Shisë u bënë edhe ministra. Bile edhe perandorin Pu Ji të Mançukuosë, perandorin kukull të pushtesve japonezë, e ruajtën me shumë kujdes dhe e kthyen në një objekt muzeal, në mënyrë që delegacionet të vinin të takoheshin e të bisedonin me të dhe të shikonin se si ricdukohen njerëz të tillë në Kinën «socialiste». Reklama që i bëhej këtij ish-perandori kukull, përveç të tjerash, kishte për qëllim t'u hiqte frikën edhe mbretërve, krerëve e kukullave të reaksionit të vendeve të tjera që këta të mendonin se «socializmi» i Maos është i mirë dhe nuk ka pse të kenë frikë prej tij.

Qëndrime që nuk bien erë luftime klase janë mbajtur në Kinë edhe ndaj atyre feudalëve e kapitalistëve, që kanë bërë krime të panumërta kundër popullit kinez. Duke i ngritur qëndrime të tilla në teori dhe duke i marrë hapur në mbrojtje kundërrevolucionarët, Mao Ce Duni deklaronte: «...të mos vrasim asnjë e të arrestojmë shumë pak... Zyrat e sigurimit publik nuk duhet t'i arrestojnë ata, organet e prokurorisë nuk

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 512.

duhet t'i ndjekin e të nisin procese hetimore kundër tyre, ndërsa gjyqet nuk duhet të gjykojnë asnjë. Pikërisht kështu duhet vepruar me mbi 90 për qind të kundërrevolucionarëve»<sup>1</sup>. Mao Ce Duni duke arsyetuar si sofist, thotë se nga ekzekutimi i kundërrevolucionarëve nuk ka asnjë përfitim, se një veprim i tillë pengoka prodhimin, nivelin shkencor të vendit, do të hapë nam të keq në botë etj., se po të likuidohet një kundërrevolucionar «do të detyroheshim ta krahasonim rastin e tij me atë të një të dyti, të një të treti e kështu me radhë, atëherë, si rrjedhim, shumë kokë do të rrokulliseshin... po u pre një kokë nuk mund të vihet në vend, ajo nuk është një qepë që lëshon sa herë pritët»<sup>2</sup>.

Si rrjedhim i këtyre koncepteve antimarksiste mbi kontradiktat, mbi klasat dhe mbi rolin e tyre në revolucion, që predikon maocedunideja, Kina asnjëherë nuk eci në rrugën e drejtë të ndërtimit socialist. Në shoqërinë kineze kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë jo mbeturina ekonomike, politike, ideologjike e sociale të së kaluarës, por atje ekzistojnë edhe klasat shfrytëzuese si klasa, të cilat kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë në fuqi. Borgjezia jo vetëm vazhdon të ekzistojë, por edhe të përfitojë nga të ardhurat e pasurive që ka pasur. Ligjërisht në Kinë renta kapitaliste nuk është zhdukur, sepse udhëheqja kineze i është përmbajtur strategjisë së revolucionit demo-

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 323.

2. Po aty.

kratiko-borgjez të formuluar nga Mao Ce Duni në vitin 1935, i cili thoshte atëherë se «Ligjet e punës të republikës popullore... nuk drejtohen kundër pasurimit të borgjezisë kombëtare...»<sup>1</sup>. Kulakëria, në format që kanë ekzistuar në Kinë, ka ruajtur, në përputhje me «politikën e së drejtës së barabartë për tokë», avantazhe dhe përfitime të mëdha. Vetë Mao Ce Duni udhëzonte që kulakët të mos preken, sepse kjo mund të zemëronte borgjezinë kombëtare me të cilën Partia Komuniste e Kinës kishte formuar një front unik politik, ekonomik dhe organizativ të përbashkët<sup>2</sup>.

Të gjitha këto tregojnë se maocedunideja nuk e drejtoi dhe nuk mund ta drejtonte Kinën në rrugën e vërtetë të socializmit. Bile, siç ka deklaruar Çu En Lai në vitin 1949, duke iu drejtuar në mënyrë sekrete qeverisë amerikane për të ndihmuar Kinën, as Mao Ce Duni, as përkrahësit e tij kryesorë nuk kanë qenë për rrugën e socializmit. «Kina, shkruante Çu En Lai, nuk është akoma një vend komunist dhe në qoftë se politika e Mao Ce Dunit do të vihet në jetë në mënyrë të drejtë, ajo nuk do të bëhet një vend komunist për një kohë të gjatë»<sup>3</sup>.

Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës në mënyrë demagogjike të gjitha deklaratat për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste ia kanë nënshtruar politikës së tyre pragmatiste. Kështu në vitet

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 1, bot. shqip, f. 209.

2. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 22.

3. «International Herald Tribune» 14 gusht 1978.

e të ashtuquajturit hop të madh, me qëllim që t'u hidhnin hi syve masave, që, të dala nga revolucioni, aspironin për socializëm, deklararin se brenda 2-3 pesëvjeçarësh do të kalonin direkt në komunizëm. Ndërsa më vonë, për të mbuluar dështimet e tyre, filluan të teorizojnë se ndërtimi dhe fitorja e socializmit do të kërkojnë 10 mijë vjet.

Partia Komuniste e Kinës vërtet quhej komuniste, por ajo u zhvillua në një drejtim tjetër, në një rrugë liberale kaotike, në një rrugë oportuniste dhe nuk mund të ishte një forcë e aftë për të udhëhequr vendin drejt socializmit. Rruga që ndiqte ajo, dhe që u konkretizua edhe më qartë pas vdekjes së Maos, nuk ishte rruga e socializmit, por rruga e ndërtimit të një shteti të madh borgjez, socialimperialist.

**Maocedunideja, si një doktrinë antimarksiste, e ka zëvendësuar internacionalizmin proletar me shovinizmin e shtetit të madh.**

Partia Komuniste e Kinës, që në hapat e parë të veprimtarisë së saj, shfaqti tendenca të hapura nacionaliste e shoviniste, të cilat, siç tregojnë faktet, nuk mundën të çrrënjosen as në periudhat e mëvonshme. Li Da Çao, një nga themeluesit e Partisë Komuniste të Kinës, thoshte se «evropianët mendojnë që bota u përket ekskluzivisht të bardhëve dhe këta përbëjnë klasën superiore, ndërsa popujt me ngjyrë klasën inferiore. Populli kinez, vazhdon Li Da Çao, duhet të jetë i gatshëm të zhvillojë një luftë klasore kundër racave të tjera të botës, në të cilën ai do të tregojë edhe një

herë veçoritë e veta kombëtare». Me të tilla pikëpamje u mbryjt që në fillim Partia Komuniste e Kinës.

Të tilla pikëpamje raciste dhe nacionaliste nuk duhej të ishin zhdukur krejtësisht as nga mentaliteti i Mao Ce Dunit, pa le i Liut dhe i Tenit. Në raportin që mbajti në Komitetin Qendror të Partisë, më 1938, Mao Ce Duni thoshte: «Kina e sotme është produkt i gjithë zhvillimit të kaluar të Kinës. . . Ne duhet të bëjmë përgjithësimin e gjithë të kaluarës sonë — që nga Konfuci deri te Sun Jat Seni — . . . duhet të hyjmë në zotërim të këtyre vlerave. Kjo do të jetë një mbështetje e shëndoshë për udhëheqjen e lëvizjes së madhe të ditës së sotme»<sup>1</sup>.

Natyrisht, çdo parti marksiste-leniniste pohon se duhet të mbështetet në pasurinë e së kaluarës të popullit të vet, veçse mban parasysh se duhet të mbështetet jo në çdo pasuri të trashëguar, por vetëm në atë përparimtare. Trashëgiminë reaksionare në fushën e ideve, si edhe në çdo fushë tjetër, komunistët e hedhin poshtë. Kinezët kanë qenë shumë konservatorë për sa u përket formave, brendisë dhe ideve të tyre të vjetra, bile edhe ksenofobë. Të vjetrën ata e ruanin si një thesar me vlerë të madhe. Gjithë eksperiencia revolucionare botërore, siç del nga bisedat që kemi bërë me ta, për kinezët nuk kishte shumë vlerë. Për ata ishin me vlerë vetëm politika e tyre, lufta që kanë zhvilluar kundër Çan Kai Shisë, marshimi i madh, teoria e Mao Ce Dunit. Sa për vlerat përparimtare të popujve të tjerë

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 2, bot. shqip, f. 250-251.

kinezët nuk kishin konsideratë, ose kishin fare pak, bile nuk merrnin as mundimin t'i studionin. Mao Ce Duni ka deklaruar se «kinezët duhet t'i lënë mënjanë formulat e krijuara nga të huajt». Po cilat janë këto formula, ai nuk e përcakton. Ai ka dënuar «të gjitha klishetë dhe dogmat e huajtura nga vendet e tjera». Këtu lind pyetja: mos vallë në këto «dogma» dhe «klishetë» të huaja për Kinën përfshihet edhe teoria e socializmit shkencor që nuk është përpunuar prej kinezëve?

Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës e ka konsideruar marksizëm-leninizmin si monopolin e Bashkimit Sovjetik ndaj të cilit Mao Ce Duni dhe shokët e tij kanë ushqyer pikëpamje shoviniste, pikëpamje të shtetit të madh, kanë pasur, si të thuash, njëfarë xhelozie borgjeze. Ata nuk e kanë konsideruar Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe të Stalinit si atdheun e madh të proletariatit botëror, tek i cili duhej të mbështeteshin proletarët e të gjithë botës për arritjen e revolucionit e që duhej ta mbronin me të gjitha forcat e tyre nga sulmi i madh i borgjezisë e i imperializmit.

Dekada më parë, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, dy liderët kryesorë të Partisë Komuniste të Kinës, kanë folur dhe kanë vepruar kundër Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, ata kanë folur edhe kundër vetë Stalinit. Mao Ce Duni e akuzonte Stalinin për subjektivizëm, se «nuk shihte lidhjen midis luftës së të kundërtave dhe unitetit të tyre»<sup>1</sup>, se paska bërë «një

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 400.

sërë gabimesh në lidhje me Kinën, se aventurizmi «i majtë» i ndjekur nga Van Mini nga fundi i luftës së dytë civile revolucionare dhe oportunizmi i tij i djathtë në ditët e para të luftës së rezistencës kundër Japonisë, të dyja vijnë nga Stalini»<sup>1</sup>, se veprimet e Stalinit ndaj Jugosllavisë e Titos kanë qenë të gabuara etj.

Mao Ce Duni, megjithëse sa për sy e faqe fliste nganjëherë në mbrojtje të Stalinit, duke thënë se gabimet e tij përbëjnë vetëm 30 për qind, në fakt, fliste vetëm për gabime të Stalinit. Nuk është e rastit deklarata e Maos në Mbledhjen e Moskës të partive komuniste e punëtore në vitin 1957 kur tha: «kur erdha te Stalini, e ndieja veten si nxënësi përpara mësuesit, kurse tash që piqemi me Hrushovin, jemi si shokë, jemi të lirë». Me këtë ai publikisht përshëndeste dhe aprovonte shpifjet e Hrushovit ndaj Stalinit dhe mbronte vijën hrushoviane.

Kritikat ndaj Stalinit Mao Ce Duni, ashtu si edhe revizionistët e tjerë, i ka përdorur për të përligjur largimin nga parimet marksiste-leniniste, të cilat i ka mbrojtur me konsekuencë dhe i ka pasuruar më tej Stalini. Me sulmin kundër Stalinit revizionistët kinezë synonin të ulnin veprën dhe autoritetin e tij, për të ngritur autoritetin e Mao Ce Dunit në rangun e një udhëheqësi botëror, të një klasiku të marksizëm-leninizmit, që paska ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë dhe të pagabueshme! Gjithashtu, këto kritika, shprehnin pakënaqësitë e grumbulluara ndaj Stalinit për vë-

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 328.

rejtjet dhe kritikrat që ai dhe Kominterni u kishin bërë udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit, që nuk zbatonin me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit, lidhur me rolin udhëheqës të proletariatit në revolucion, me internacionalizmin proletar, me strategjinë dhe taktikën e luftës revolucionare etj. Mao Ce Duni këtë pakënaqësi e ka shprehur hapur duke thënë: «Stalini dyshoi se mos fitorja jonë ishte një fitore e tipit të Titos dhe më 1949 dhe 1950 ai ushtroi mbi ne një presion shumë të madh»<sup>1</sup>. Gjithashtu, në bisedat me ne, këtu në Tiranë, Çu En Lai na ka thënë: «Stalini dyshonte se mos ne ishim pro amerikaneve, ose mos ndiqnim rrugën jugosllave». Koha provoi që Stalini ka pasur plotësisht të drejtë. Parashikimet e tij për revolucionin kinez dhe për idetë që e udhëhiqnin atë dolën të sakta.

Kontradiktat midis Partisë Komuniste të Kinës, të udhëhequr nga Mao Ce Duni, dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, si dhe kontradiktat midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Kominternit kanë qenë parimore, për çështje themelore të strategjisë dhe të taktikës revolucionare marksiste-leniniste. Kështu, për shembull, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ka injoruar tezën e Kominternit mbi zhvillimin korrekt e konsekuent të revolucionit në Kinë, orientimin e tij për një veprim të përbashkët të klasës punëtore në qytet dhe të ushtrisë çlirimtare, tezat e Kominternit mbi karakterin dhe eta-

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 5, bot. frëngj., Pekin, 1977, f. 328.



pat e revolucionit kinez etj. Mao Ce Duni dhe udhëheqësit e tjerë të Partisë Komuniste të Kinës kanë folur vazhdimisht me përçmim për të deleguarit e Kominternit në Kinë, duke i quajtur ata «të trashë», «inJORantë», që «nuk njihnin realitetin kinez» etj. Mao Ce Duni, duke e parë çdo vend si një «realitet objektiv më vete», «të mbyllur për të tjerët», e quante thjesht të pamundur e të panevojshme ndihmën e të deleguarve të Kominternit. Në fjalën e mbajtur në Konferencën e zgjeruar të punës të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, në janar 1962, Mao Ce Duni ka thënë: «Kina si botë objektive u njoh nga kinezët dhe jo nga shokët e Kominternit, të cilët merreshin me çështjen kineze. Këta shokë të Kominternit nuk e njihnin ose e njihnin pak shoqërinë kineze, kombin kinez dhe revolucionin kinez. Kështu përse të bëhet fjalë këtu për këta shokë të huaj?».

Mao Ce Duni e përjashtoi Kominternin kur është fjala për sukseset. Ndërsa për disfatat dhe deviacionet e Partisë Komuniste të Kinës, për moskuptimin dhe mosnxjerrjen e deduksioneve të drejta nga situatat që janë zhvilluar në Kinë, ia hedh fajin Kominternit ose përfaqësuesve të tij në Kinë. Ai dhe udhëheqës të tjerë kinezë e akuzojnë Kominternin se i paskësh penguar dhe ngatërruar në zhvillimin e një lufte konsekuente për marrjen e pushtetit dhe për ndërtimin e socializmit në Kinë. Por faktet e së kaluarës dhe sidomos realiteti i sotëm kinez vërtetojnë se vendimet dhe direktivat e Kominternit për Kinën në përgjithësi kanë qenë të drejta dhe se Partia Komuniste e Kinës

nuk ka vepruar në bazë dhe në frymën e parimeve të marksizëm-leninizmit.

Pasojat e nacionalizmit të ngushtë dhe të shovinizmit të shtetit të madh, që karakterizojnë maocedunidenë dhe që kanë qenë e janë në bazën e veprimtarisë së Partisë Komuniste të Kinës, pasqyrohen edhe në qëndrimet e veprimtarinë e kësaj partie në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Kjo duket konkretisht edhe në qëndrimin e Partisë Komuniste të Kinës ndaj partive të reja marksiste-leniniste, që u krijuan mbas tradhtisë së hrushovianëve. Në fillim udhëheqja kineze nuk pati as më të voglin besim në to. Këtë pikëpamje e ka shprehur haptazi Gën Biao, personi që vendos në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për sa u përket marrëdhënieve të saj me lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai ka thënë se «Kina nuk e aprovon krijimin e partive marksiste-leniniste dhe nuk dëshiron që përfaqësuesit e këtyre partive të vijnë në Kinë. Ardhja e tyre na prish punë, ka nënvizuar ai, por nuk kemi ç't'u bëjmë, se nuk mund t'i dëbojmë. Ne i pranojmë ata ashtu sikurse pranojmë edhe përfaqësuesit e partive borgjeze»<sup>1</sup>. Një politikë e tillë, që nuk kishte asgjë të përbashkët me Internacionalizmin proletar, ndiqej që në kohën kur ishte gjallë Mao Ce Duni, kur ai ishte plotësisht në gjendje të mendonte e të drejtonte, pra kishte aprovimin e plotë të tij.

Pasi këto parti të reja marksiste-leniniste, në

---

1. Nga blseda e Gën Biaos me shokë të Partisë sonë në Pekin, më 16.4.1973. AQP.

kundërshtim me dëshirat e udhëheqësve kinezë, filluan të forcohen, atëherë ata ndoqën një taktikë tjetër, njohjen e të gjitha partive të reja dhe të çdo grupi pa përjashtim dhe pa asnjë dallim, mjaft që ta quanin veten «parti marksiste», «parti revolucionare», «gardë e kuqe» etj. Këtë qëndrim dhe taktikë që ka ndjekur Partia Komuniste e Kinës, Partia e Punës e Shqipërisë e ka kritikuar. Të njëjtën gjë kanë bërë edhe partitë e tjera marksiste-leniniste të vërteta. Megjithatë udhëheqja revizioniste kineze ka vazhduar në po atë rrugë.

Udhëheqësit kinezë, në përputhje me politikën e tyre pragmatiste ndaj partive dhe grupeve të reja që u krijuan, kanë mbajtur qëndrime të diferencuara. Partitë e vërteta marksiste-leniniste ata i quanin armike të tyre, ndërsa grupet dhe partitë, që u kundërviheshin këtyre partive, u bënë shumë të dashura për ta. Aktualisht me këto parti dhe grupe antimarksiste, që ngrenë në qiell maocedunidenë, revizionistët kinezë jo vetëm mbajnë lidhje, por edhe i thërresin përfaqësuesit e tyre një nga një në Pekin, ku i përgatitin, u japin ndihma financiare dhe udhëzime politike e ideologjike, i instruktojnë si të veprojnë kundër Partisë së Punës së Shqipërisë dhe kundër partive marksiste-leniniste të vërteta. Ata kërkojnë prej tyre që të propagandojnë maocedunidenë, teorinë e «tri botëve» dhe në përgjithësi politikën e jashtme të Kinës, të ngrenë kultin e Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit dhe të dënojnë «katërshen». Ajo parti që plotëson këto kërkesa, për revizionistët kinezë është «mark-

siste-leniniste», ndërsa ato parti që janë kundër tyre shpallen si antimarksiste, aventuriste etj.

Të gjitha këto tregojnë se udhëheqësit revizionistë kinezë në marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste nuk kanë zbatuar parimet dhe normat leniniste që rregullojnë marrëdhëniet midis partive të vërteta komuniste. Ata, ashtu si edhe revizionistët hrushovianë, kanë përdorur ndaj partive të tjera konceptin antimarksist të «partisë mëmë», diktatin, presionet, ndërhyrjet në punët e brendshme dhe s'kanë pranuar asnjëherë këshillat e sugjerimet shoqërore të partive motra. Ata kanë kundërshtuar takimet shumëpalëshe të partive marksiste-leniniste, mbledhjet për të diskutuar problemet e mëdha të përgatitjes dhe të fitores së revolucionit, të luftës kundër revizionizmit modern për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për të shkëmbyer eksperiencën dhe për të koordinuar veprimet etj. Arsyeja e një qëndrimi të tillë, përveç të tjerash, është se ata kanë pasur frikë të ballafaqohen në mbledhje shumëpalëshe me marksistë-leninistët e vërtetë, për arsye se do të zbuloheshin e do të demaskoheshin teoritë e tyre antimarksiste e revizioniste në shërbim të kapitalit botëror dhe të strategjisë për ta shndërruar Kinën në superfuqi.

Një tregues tjetër i thelbit antimarksist të maocedunidesë janë edhe lidhjet që ka mbajtur e mban Partia Komuniste e Kinës me shumë parti e grupe heterogjene fashiste, revizioniste etj. Aktualisht ajo përpiket të krijojë terrenin për të depërtuar ose për të krijuar lidhje edhe me partitë e vjetra revizioniste të vendeve të ndryshme, si për shembull, me atë të

Italisë, të Francës, të Spanjës dhe të vendeve të tjera të Evropës, të Amerikës Latine etj. Këtyre lidhjeve revizionistët kinezë po u japin një rëndësi gjithnjë e më të madhe për arsye se ideologjikisht të gjitha ato janë në një vijë me Partinë Komuniste të Kinës, pavarësisht nga diferencat që kanë në taktikat, të cilat varen nga natyra, nga forca dhe nga fuqia e kapitalizmit në çdo vend.

Lidhjet e Partisë Komuniste të Kinës me këto parti tradicionale revizioniste gradualisht do të zgjerohen, veprimet e tyre do të akordohen, kurse grupet e vogla të quajtura «marksiste-leniniste», që ndjekin vijën kineze, do të vazhdojnë të përdoren prej saj për të luftuar dhe për të përçarë partitë e vërteta marksiste-leniniste, që ekzistojnë dhe që qëndrojnë në pozita të patundshme, si dhe partitë e tjera që lindin e do të lindin. Me këto veprime revizionistët kinezë ndihmojnë hapur kapitalizmin, partitë socialdemokrate e revizioniste, sabotojnë shpërthimin e fitoren e revolucionit dhe në mënyrë të veçantë përgatitjen e faktorit subjektiv, forcimin e partive të vërteta marksiste-leniniste që do ta udhëheqin këtë revolucion.

Këtë taktikë Partia Komuniste e Kinës e zbatoi në marrëdhëniet me të ashtuquajturën Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë, e cila ka punuar me të gjitha forcat për përçarjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe ka luftuar pa pushim kundër socializmit dhe marksizëm-leninizmit. Udhëheqësit aktualë kinezë dëshirojnë të ecin së bashku me revizionistët jugosllavë dhe të koordinojnë veprimet në luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha partive marksiste-

-leniniste, kundër revolucionit, socializmit dhe komunizmit.

Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës kanë mbajtur një qëndrim pragmatist ndaj revizionizmit jugosllav dhe kanë bërë një evolucion të madh në pikëpamjet e tyre për Titon dhe titizmin. Në fillim Mao Ce Duni ka thënë se Titoja nuk ka gabuar, por ishte Stalini ai që kishte gabuar ndaj Titos. Më vonë po ai Mao Ce Duni e fut Titon në një radhë me Hitlerin dhe me Çan Kai Shinë dhe thotë se «njerëz të tillë... si Titoja, Hitleri, Çan Kai Shia dhe cari nuk mund të ndreqen, ata vriten». Mirëpo këtë qëndrim ai e ka ndryshuar përsëri dhe ka shprehur dëshirën e madhe për t'u takuar me presidentin Tito. Vetë Titoja deklaroi kohët e fundit se «Unë kam qenë ftuar në Kinë që kur ishte gjallë Mao Ce Duni. Gjatë vizitës së kryetarit të Veçes Ekzekutive Federative, Xhemal Bijediç, në atë kohë Mao Ce Duni i ka shprehur dëshirën që unë të vizitoja Kinën. Kryetari Hua Kuo Fen, gjithashtu, më tha se Mao Ce Duni që para pesë vjetësh ka thënë se duhej të më ftonte mua për vizitë, duke theksuar se Jugosllavia edhe në vitin 1948 ka pasur të drejtë, gjë që ai (Mao Ce Duni) edhe në atë kohë e ka deklaruar në një rreth të brendshëm. Por, duke marrë parasysh marrëdhëniet e asaj kohe midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, këtë nuk e thanë publikisht»<sup>1</sup>.

Këtë «testament» të Mao Ce Dunit udhëheqja revizioniste e Kinës po e vë në jetë me besnikëri. Hua

---

1. Nga fjala e Titos në aktivin e RS të Sllovenisë, 8 shtator 1978.

Kuo Feni shfrytëzoi vizitën e Titos në Kinë dhe veçanërisht vizitën e vet në Jugosllavi për t'i bërë elozhe Titos, për ta paraqitur si një «marksist-leninist të shquar», si një «udhëheqës të madh» jo vetëm të Jugosllavisë, por edhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në këtë mënyrë udhëheqja kineze aprovoi hapur edhe të gjitha sulmet e titistëve kundër Stalinit e Partisë Bolshevike, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare e marksizëm-leninizmit.

Marrëdhëniet e ngushta politike e ideologjike të revizionistëve kinezë me titizmin, me eurokomunistët si Karriljo e kompani, përkrahja që u japin partive e grupeve antimarksiste, trockiste, anarkiste e socialdemokrate, tregojnë se udhëheqësit kinezë, të frymëzuar e të udhëhequr nga maocedunideja, po krijojnë një front ideologjik të përbashkët me renegatët e marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit, kundër interesave të luftës çlirimtare të popujve. Prandaj gjithë armiqtë e komunizmit gëzohen nga «teoritë» kineze, sepse ata e shikojnë se maocedunideja, politika kineze, drejtohen kundër revolucionit dhe socializmit.

Këto çështje që analizuam nuk e ezaurojnë gjithë përmbajtjen antimarksiste e antileniniste të maocedunidesë. Megjithatë, ato janë të mjaftueshme për të konkluduar se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, por një revolucionar demokrat, përparimtar, që qëndroi për një kohë të gjatë në krye të Partisë Komuniste të Kinës dhe që luajti një rol të rëndësishëm në fitoren e revolucionit demokratik, antiimperialist kinez. Brenda në Kinë, në parti, në popull dhe jashtë

Kinës atij i doli emri si një marksist-leninist i madh dhe vetë ai hiqej si komunist, si një dialekticien marksist-leninist, por nuk ishte i tillë. Ai ishte një eklektik që bashkonte disa elemente të dialektikës marksiste me idealizmin, me filozofinë borgjeze e revizioniste, bile dhe me filozofinë e vjetër kineze. Prandaj pikëpamjet e Mao Ce Dunit nuk duhen studiuar vetëm nga frazat e rregulluara në disa nga veprat e tij të botuara, por duhen studiuar në tërësinë e tyre, në zbatimin e tyre në jetë, duke parë edhe pasojat që kanë sjellë ato në praktikë.

Në vlerësimin e maocedunidesë e rëndësishme është të mbahen parasysh edhe kushtet konkrete historike në të cilat u formua ajo. Mendimet e Mao Ce Dunit u zhvilluan në kohën e kalbëzimit të kapitalizmit, pra në kohën kur në rendin e ditës janë revolucionet proletare dhe kur shembulli i Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, mësimet e mëdha të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit janë bërë udhërrëfyese të pagabuara për proletariatin dhe popujt revolucionarë të botës. Teoria e Mao Ce Dunit, maocedunideja, që lindi në këto kushte të reja, do të mundahej të vishte dhe veshi petkun e teorisë më revolucionare e më shkencore të kohës, të marksizëm-leninizmit, por në thelb ajo mbeti një «teori» që bie në kundërshtim me çështjen e revolucionit proletar dhe i shkon në ndihmë imperializmit në krizë dhe në kalbëzim. Prandaj ne themi se Mao Ce Duni dhe maocedunideja janë anti-marksistë.

Kur flitet për maocedunidenë, është e vështirë të përcaktosh një vijë të vetme e të qartë të saj, pasi



ajo, siç thamë në fillim, është një amalgamë ideologjish, duke filluar që nga anarkizmi, trockizmi, revizionizmi modern ala titist, ala hrushovian, ala eurokomunist dhe deri te përdorimi i disa frazave marksiste. Në gjithë këtë amalgamë një vend të nderuar zënë edhe idetë e vjetra të Konfucit, të Mencit e të filozofëve të tjerë kinezë, të cilët kanë ndikuar drejtpërdrejt në formimin e ideve të Mao Ce Dunit, në zhvillimin e tij kulturor dhe teorik. Edhe ato anë të pikëpamjeve të Mao Ce Dunit që dalin në formën e një marksizëm-leninizmi të deformuar kanë vulën dhe specifikën e njëfarë «aziokomunizmi» me doza të theksuara nacionaliste, ksenofobe dhe bile fetare, budiste, që një ditë do të binin hapur në kundërshtim me marksizëm-leninizmin.

Grupi revizionist i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit që sundon sot në Kinë, në politikën e në veprimtarinë e tij reaksionare ka si bazë teorike e platformë ideologjike maocedunidenë.

Grupi i Hua Kuo Fenit dhe i Jeh Çien Jinit që erdhi në fuqi, për të forcuar pozitën e veta të lëkundshme, valëviti flamurin e Mao Ce Dunit. Nën këtë flamur ai dënoi demonstratën e Tien An Menit dhe likuidoi Ten Hsiao Pinin, të cilit i vuri etiketën e merituar të revizionistit. Nën këtë flamur ky grup mori pushtetin me puç dhe shpartalloi «katërshen». Por kaosi që ka karakterizuar gjithnjë Kinën vazhdoi edhe më i madh. Kjo situatë e turbullt nxori në skenë dhe imponoi ardhjen në fuqi të Ten Hsiao Pinit, i cili rifilloi të ecë në rrugën e tij të ekstremit të djathtë me metoda fashiste.

Objektivi i Tenit ishte të forconte pozitat e grupit të vet, të ndiqte pa dorashka kursin e aleancës me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare botërore. Ten Hsiao Pini nxori programin e «katër modernizimeve», i vuri pikën Revolucionit Kulturor, likuidoi gjithë atë masë kuadrosh të ngritur në pushtet, në parti dhe në ushtri nga ky revolucion dhe i zëvendësoi këta kuadro me njerëzit e reaksionit më të zi, të demaskuar dhe të dënuar më parë.

Tash po asistojmë në një periudhë që karakterizohet nga daci baot kundër Mao Ce Dunit, që vënë partizanët e Ten Hsiao Pinit, duke qëndisur me to muret e Pekinit. Është periudha e «revanshit» që ka dy synime: së pari, të likuidojë «prestigjin» e Maos dhe të qërojë pengesën Hua Kuo Fen dhe, së dyti, ta bëjë Ten Hsiao Pinin një diktator fashist të plotfuqishëm dhe të rehabilitojë Liu Shao Çinë.

Në këto manovrime reaksionare ka nga ata në Kinë, por edhe jashtë, që bëjnë krahasimin e luftës së Ten Hsiao Pinit kundër Maos, që nuk ka qenë kurrë marksist-leninist, me krimin e Hrushovit që i hodhi baltë Stalinit, i cili ishte dhe mbetet një marksist-leninist i madh. Asnjëri me sadopak mend në kokë nuk mund ta pranojë një analogji të tillë.

Krahasimi më i drejtë që mund të bëhet është ai që Brezhnjevi dhe grupi i tij revizionist rrëzoi Hrushovin dhe tash Brezhnjevi kinez, Ten Hsiao Pini, po rrëzon nga piedestali Hrushovin kinez, Mao Ce Dunin.

E tërë kjo është një lojë revizioniste, është një luftë për pushtet personal. Kështu ka qenë kurdoherë në Kinë. Asgjë marksiste s'ka në këtë mes. Këtë si-

tuatë do ta ndreqë vetëm klasa punëtore kineze dhe një parti e vërtetë marksiste-leniniste e spastruar nga maocedunideja, nga «tenhsiaopinideja» dhe nga idera të tjera të tilla antimarksiste, revizioniste, borgjeze. Janë idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit që mund ta shpëtojnë Kinën nga kjo gjendje nëpërmjet një revolucioni të vërtetë proletar.

Ne besojmë se marksizëm-leninizmi dhe revolucioni proletar në Kinë një ditë do të fitojnë dhe armiq të proletariatit e të popullit kinez do të humbasin. Natyrisht, një gjë e tillë nuk do të arrihet pa luftë e pa gjak, për arsye se në Kinë do të duhen shumë përpjekje për të krijuar partinë revolucionare marksiste-leniniste, udhëheqësen e domosdoshme për fitoren mbi tradhtarët, për fitoren e socializmit.

Ne kemi bindjen se populli vëlla kinez, revolucionarët e vërtetë kinezë do të çlirohen nga iluzionet dhe mitet. Ata do të kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht se në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës nuk ekzistojnë revolucionarë marksistë-leninistë, por njëri të borgjezisë, të kapitalizmit, të cilët ndjekin një rrugë që s'ka asnjë lidhje me socializmin dhe komunizmin. Por, që ta kuptojnë këtë masat dhe revolucionarët, është e nevojshme të realizojnë se maocedunideja nuk është marksizëm-leninizmi dhe se Mao Ce Duni nuk ka qenë një marksist-leninist. Kritika që i bëjmë ne, marksistë-leninistët, maocedunidesë nuk ka asgjë të përbashkët me sulmet që i drejtohen Mao Ce Dunit nga grupi i Ten Hsiao Pinit në luftën që ky zhvillon për pushtet.

Duke folur hapur e sinqerisht për këto çështje,

ne, komunistët shqiptarë, kryejmë detyrën tonë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit dhe, njëkohësisht, si internacionalistë ndihmojmë edhe popullin e revolucionarët kinezë, për të gjetur rrugën e drejtë në këto situata të vështira që po kalojnë.

## **MBROJTJA E MARKSIZËM-LENINIZMIT — DETYRË E MADHIE PËR TË GJITHË REVOLUCIONARËT E VËRTETË**

Situatat e sotme ndërkombëtare janë të turbullta, kriza në vendet kapitalisto-revizioniste acarohet, politika agresive e superfuqive krijon çdo ditë e më shumë rreziqe të reja e të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve dhe për paqen e përgjithshme. Teoritë borgjeze e revizioniste hrushoviane, titiste, eurokomuniste e së bashku me to edhe teoritë kineze janë pjesë përbërëse të planit të madh strategjik të imperializmit dhe të revizionizmit modern për të shkatërruar socializmin e për të mbytur revolucionin.

Në këto kushte mbrojtja e marksizëm-leninizmit, e parimeve të internacionalizmit proletar, qëndrimi konsekuent e revolucionar ndaj problemeve të mëdha botërore përbëjnë sot për Partinë tonë, ashtu si për të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë, një detyrë themelore. Lufta jonë e drejtë duhet të nxitë te popujt dhe te njerëzit përparimtarë besimin në fitoren e çështjes së revolucionit, të socializmit e të çlirimit të popujve. Partia jonë është në rrugë të drejtë dhe ajo do të fitojë, pse me të janë revolucionarët dhe popujt e botës, pse me të është e vërteta marksiste-leniniste.

Marksistë-leninistët dhe revolucionarët kudo në

botë e shohin se Partia e Punës e Shqipërisë mbron marksizëm-leninizmin, kur të tjerët e sulmojnë, se ajo mbron parimet e internacionalizmit proletar, kur revizionistët e ndryshëm këto parime i kanë flakur tej. Ata e shohin se në qëndrimet e saj ajo niset jo vetëm nga interesat e vendit të vet, por shpreh dhe përfaqëson interesa shumë të mëdhenj, të afërt e të shtrenjtë për mbarë proletariatin, interesat e socializmit të vërtetë, interesat e të gjithë atyre që bazohen dhe udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi për transformimin revolucionar të botës.

Në të njëjtën kohë ne vërejmë se politika që ndjek Kina në marrëdhëniet me imperializmin amerikan, si dhe me socialimperializmin sovjetik, mbjell dyshime, pakënaqësi, kritikë të vazhdueshme kudo, sidomos në vendet e të ashtuquajturës botë e tretë. Kjo është e natyrshme, sepse njerëzit e ndershëm në këto vende shohin që politika kineze nuk është e drejtë, se ajo është një politikë që përkrah një imperializëm, i cili i shtyp, se shumë nga predikimet e udhëheqësve kinezë nuk përputhen me veprat e tyre dhe me realitetin konkret. Popujt shohin se Kina bën një politikë socialimperialiste që kërcënon interesat e tyre.

Në këtë drejtim, në mënyrë modeste, edhe Partia jonë jep kontributin e saj. Popujt e besojnë atë, sepse flet të vërtetën dhe e vërteta e ka burimin në teorinë marksiste-leniniste, që është zbatuar konkretisht në Shqipëri. Zhvillimi i vendit tonë, luftërat e tij çlirimtare, gjendja shoqërore, ekonomike, politike e shpirtërore e tij në të kaluarën, ka ngjashmëri me shumë vende të botës që kanë vuajtur ose vuajnë nga shtyp-

ja e egër e sunduesve të brendshëm dhe e sunduesve të jashtëm imperialistë. Përvoja e grumbulluar nga Partia jonë në marrjen e pushtetit nga ana e popullit, në vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe në ndërtimin e socializmit është një shembull dhe një ndihmë konkrete për këta popuj. Fitoret dhe sukseset e arritura në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë e kanë bazën në teorinë marksiste-leniniste, nga e cila frymëzohet dhe të cilën e zbaton në praktikë Partia e Punës e Shqipërisë.

Përveç lakenjve dhe ultrareaksionarëve asnjë nuk e merr në mbrojtje të drejtpërdrejtë teorinë e falimentuar kineze të «tri botëve». Politika e afrimit të kinezëve me imperializmin amerikan ringjall fantazmat e luftërave imperialiste, të cilat asnjë nuk do t'i shikojë, ajo dendëson errësirën koloniale e neokoloniale që asnjë nuk e duron, ajo mbështet shfrytëzimin kapitalist, të cilin të gjithë duan ta heqin çafe.

Partia e Punës e Shqipërisë ka luftuar, lufton e do të luftojë kurdoherë me vendosmëri për mbrojtjen e pastërtisë së ideve marksiste-leniniste. Ajo është e do të jetë kurdoherë kundër të gjithë atyre që përpiqen t'i shtrembërojnë e t'i zëvendësojnë ato me ide borgjeze, revizioniste e kundërrevolucionare. Partia jonë është një parti proletare, një parti marksiste-leniniste, një pjesëtare aktive e revolucionit botëror, për të cilin, ashtu si deri më sot, ajo është e vendosur të marrë parasysh çdo sakrificë. Nga kjo rrugë e nderit, plotësisht internacionaliste dhe e lavdishme, Partinë tonë s'ka forcë që ta largojë, s'ka forcë që ta frikësojë e ta mposhtë. Partia jonë nuk mund të

pajtohet me asnjë lloj oportunizmi, me asnjë lloj devijimi nga marksizëm-leninizmi, me asnjë shtrembërim të tij. Ajo do të luftojë me vendosmëri edhe kundër revizionizmit kinez, si dhe kundër çdo lloji tjetër.

Partia jonë është një parti e vogël marksiste-leniniste, por pse jemi një parti e tillë, ne nuk duhet të druhemi dhe të mos e themi haptazi të vërtetën. Partia jonë është e vogël për sa i përket numrit të anëtarëve që militojnë në radhët e saj, por është një parti e kalitur në shumë luftëra. Ajo kurdoherë ka pasur guximin për t'i thënë hapur çështjet në mbrojtje të pastërtisë së marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të socializmit. Faktet tregojnë se lufta jonë kundër revizionizmit kinez është e drejtë, është e domosdoshme, prandaj aprovohet e mbështetet nga marksistë-leninistët e revolucionarët e vërtetë.

Një parti e vërtetë revolucionare, siç është Partia jonë, në asnjë rast nuk heq dorë nga qëndrimet parimore. Ne nuk mund të tërhiqemi pse të tjerët virytin e guximit të Partisë sonë mund ta quajnë mendjemadhësi. Partia nuk i ka mësuar anëtarët e saj të jenë mendjemëdhën, por i ka mësuar të jenë kurdoherë të vendosur e të drejtë, të ashpër kundër armikut të klasës. Në këto çështje nuk ka diskutime nëse partia është e madhe ose e vogël.

Komunistët, revolucionarët e vërtetë, marksistë-leninistët duhet ta kuptojnë mirë si po zhvillohen situatat sot në botë. Ato nuk zhvillohen në formën e një klisheje. Në rast se studiohen, kuptohen dhe asimilohen si duhet mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, eksperiencia e luftërave revolucionare të



proletariatit botëror, si dhe eksperiencia e çdo partie të vërtetë marksiste-leniniste, atëherë mund të kuptohen si duhet këto situata që po zhvillohen dhe të ndihmohet fuqimisht revolucioni.

Ne, komunistët shqiptarë, duhet të kuptojmë mirë se përvetësimi i marksizëm-leninizmit është absolutisht i domosdoshëm. Nuk duhet nënvleftësuar kurrë rrethimi kapitalisto-revizionist dhe presioni që na bën ai. Ne nuk duhet të jemi fodullë në kuptimin e këtyre çështjeve dhe në luftën e vërtetë që duhet t'u bëjmë armiqve që na rrethojnë.

Revolucioni ka gjetur dhe gjen përpara shkëmbinj, të cilëve duhet t'u vërë minat dhe t'i hedhë në erë. Disave duhet t'u vërë minat drejtpërdrejt, disa duhet t'i gërryejë, disa të tjerëve duhet t'u marrë krahët dhe pastaj t'u japë goditjen e fundit. Kësaj i thonë të kuptosh strategjinë dhe taktikën e revolucionit. Që të krijohet bindja në fitoren e tij, është e domosdoshme të organizosh masat e gjera të popullit, të bësh të ndër-gjegjshëm proletariatin për udhëheqjen e palëkundshme të partisë së tij të vërtetë marksiste-leniniste, se ndryshe mund të shkohet edhe në aventura, të komprometohet çështja e revolucionit. Komunistët dhe masat e shtypura të popullit duhet të dinë se imperializmi dhe kapitalizmi botëror kanë një eksperiencë të madhe në shtypjen e masave, në organizimin e kundër-revolucionit. Prandaj edhe taktikat e strategjia e armiqve duhet të kuptohen dhe të përballohen, sepse ideologjia jonë, politika jonë, strategjia dhe taktikat tona janë më të fuqishme se çdo armik, mbasi këto i shërbejnë një kauze të drejtë, kauzës së komunizmit.

Tani për Partinë tonë, si dhe për të gjitha partitë marksiste-leniniste në botë, lufta kundër revizionizmit kinez meriton një vëmendje kryesore. Kjo çështje është me rëndësi, por nuk do të thotë se, duke u marrë me të, na lejohet të harrojmë revizionizmin sovjetik, revizionizmin titist, apo eurokomunizmin, që janë variante shumë të rrezikshme të revizionizmit modern. Të tëra këto korrente antimarksiste, pa varësisht nga ndryshimet në format e luftës, për sa u përket taktikave dhe strategjisë së tyre, janë të një rrjedhe, kanë të njëjtin qëllim, bëjnë të njëjtën luftë.

Për të gjitha këto arsye ne nuk duhet ta largojmë kurrë vëmendjen jo vetëm nga lufta që duhet bërë kundër imperializmit amerikan dhe gjithë borgjezisë reaksionare kapitaliste botërore, por edhe kundër revizionizmit sovjetik, revizionizmit jugosllav, revizionizmit kinez etj. Të tërë këta armiq, me gjithë kontraktat që kanë ndërmjet tyre, i lidh një fill i vetëm, që është lufta kundër revolucionit, kundër partive marksiste-leniniste, kundër unitetit të tyre, kundër organizimit të përgjithshëm të proletariatit e të mbarë masave punonjëse për t'u hedhur në revolucion.

Lufta kundër revizionizmit modern, dhe në veçanti kundër revizionizmit sovjetik, revizionizmit titist dhe revizionizmit kinez, nuk është një çështje e lehtë. Përkundrazi, kjo luftë është dhe do të jetë e rreptë, e gjatë. Që kjo luftë të bëhet me sukses, që të arrihen fitore hap pas hapi, komunistët, kuadrot, inteligjencia dhe të gjitha masat punonjëse të vendit tonë duhet të brumosen me ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, duhet të studiojnë edhe eksperiencën e

pasur të Partisë sonë në luftën kundër revizionizmit modern. Vetëm kështu do të jemi në gjendje të kalojmë pengesat dhe të mos na çjerrin ferrat në gjithë këtë pyll të madh armiqësor.

Partia jonë e Punës duhet të mbajë si kurdoherë qëndrime të qarta, të vendosura, të guximshme në vijën e drejtë marksiste-leniniste. Kjo vijë e Partisë sonë, me synime të qarta e të caktuara, do të ndihmojë për t'i demaskuar dhe për të zhvilluar me sukses luftën e pamëshirshme kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, si dhe socialimperializmit kinez.

Detyra e Partisë sonë, si dhe e të gjithë komunistëve të vërtetë në botë, është të luftojnë me devocion për të mbrojtur dhe për të spastruar teorinë tonë marksiste-leniniste nga të gjitha deformimet që i bëjnë asaj borgjezia, revizionistët modernë dhe të gjithë oportunistët e tradhtarët.

Marksizëm-leninizmi është ideologjia fitimtare. Kush e përqafton, e mbron dhe e zhvillon atë, ai është pjesëtar i armatës së lavdishme të revolucionit, i asaj ushtrie të madhe e të pamposhtur të komunistëve të vërtetë, që udhëheqin proletariatin dhe gjithë të shtypurit për të transformuar botën, për të shkatërruar kapitalizmin dhe për të ndërtuar botën e re, botën socialiste.



**TREGUESIT**



## TREGUESI I LENDES

### A

*Afrika; lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionare të popujve të Afrikës* — 24, 36, 84, 147, 151-156, 163, 166, 172, 173, 186.

*Aleancat, kompromiset, kuptimi marksist-leninist i tyre* — 251-253, 259-260, 266-267.

*Amerika Latine; lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve të Amerikës Latine* — 24, 82, 147, 163-171, 172, 175, 176, 186.

*Aristokracia e klasës punëtore* — 102-103, 193, 266.

*Armatimi, demagogjia e superfuqive për çarmatimin* — 35, 101-102, 127-128, 245.

*Azla; lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionare të popujve të Azisë* — 24, 84, 147, 156-163, 166, 172, 186, 324.

### B

*Bashkekzistenca paqësore — parim i politikës së jashtme*

*të shtetit socialist* — 77, 263-265.

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953)* — 4, 7, 237, 259, 362, 366-367.

*Bashkimi Sovjetik; socialimperializmi sovjetik*

— degjenerimi kapitalist i BS dhe veprimi i ligjeve të tij; degjenerimi i partisë dhe likuidimi i diktaturës së proletariatit — 13, 21-22, 59, 60, 69, 86-87, 101, 129, 299-300;

— tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit; demagogjia për zbatimin e marksizëm-leninizmit dhe për ndërtimin e socializmit — 8-10, 21-23, 25-26, 314;

— strategjia dhe taktikat; politika e jashtme hegjemoniste dhe ekspansioniste, lidhjet dhe kontradiktat me shtetet kapitaliste — 21-22, 23-24, 25-26, 72, 80, 86, 87-88, 138-140, 160, 172-174, 240-241, 245, 247, 261, 276, 289, 302-303, 320;

— politika hegjemoniste ndaj partive dhe vendeve revizioniste — 24-25, 87-88, 240-242, 247;

— roli i tij sabotues në lëvizjen komuniste ndërkombe tëare dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 22-23, 25-26, 161-162, 172-174.

*Shih edhe: Superfuqitë...*

*Baza dhe superstruktura kapitaliste* — 60-61, 64, 86-87, 96.

*Borgjezia. Borgjezia e re në vendet revizioniste* — 41, 43-44, 47, 68, 86-87, 103-104, 126-127, 129, 130, 137, 149-150, 152, 166, 181-182, 186-187, 188-189, 199, 221-222, 223, 230, 231, 245, 303.

## D

*Dialektika materialiste marksiste-leniniste, zhvillimi dialektik* — 105, 214-215, 218-219, 239, 353-356.

*Diktatura e proletariatit, sistemi politik i diktaturës së proletariatit dhe roli udhëheqës i Partisë në të* — 53, 348, 349-350.

## E

*Engels, Fridrih* — 2, 50, 106, 120, 177, 192, 197, 201, 213,

215, 217, 229, 235, 251, 277, 332, 339, 352, 384, 387, 392, 394.

*Epoka jonë — përcaktimi leninist i epokës; karakteri dhe forcat kryesore lëvizëse të saj* — 55, 116, 117-118, 144, 214-215, 217-224, 230-231, 285-286, 384.

## F

*Fashizmi, rreziku i fashizmit; lufta kundër tij* — 48, 202.

*Feja në vendet borgjeze* — 154, 162.

## GJ

*Gjermania, imperializmi gjerman — pushtimet ushtarake në Luftën e Dytë Botërore* — 19, 259-260, 320-321.

## I

*Imperializmi — karakteristika, tiparet* — 54-55, 64, 101, 106-107, 303, 315-316, 317, 393;

— koncentrimi i prodhimit dhe i kapitaleve, monopol; shoqëritë shumëkombëshe; kapitalizmi monopolist shtetëror —



- 55-66, 68, 69, 70-71, 77-78, 79-80, 83, 88, 90-91, 99-102, 125, 168-169, 297, 299-300;
- bankat dhe roli i tyre; kapitali financiar dhe oligarkia financiare — 60, 66, 67, 68-69, 71, 77-78, 80-81, 96, 166, 230;
  - eksportimi i kapitalit — veçoritë e tij sot; ndihmat, kreditë dhe huatë shtetërore — 18, 44-45, 62-63, 69, 72-78, 78-89, 96-99, 152-153, 163-165, 247, 250, 294-296, 297-301, 303-306;
  - ndarja ekonomike e botës dhe përpjekjet e fuqive imperialiste për rindarjen territoriale të saj — 24-26, 30-34, 35-37, 78-79, 81-89, 90-91, 92-99, 295-296, 303-306;
  - imperializmi — faza më e lartë e kapitalizmit dhe prag i revolucionit, kapitalizëm parazitar dhe në kalbëzim; kriza, kontradiktat, pashmangësia e zhdukjes së tij — 10-11, 14-18, 54-55, 62-65, 66, 67-72, 93-95, 99-107, 114-115, 117-118, 215-220, 227-228, 230-232, 236-240, 242-243, 246-247, 250-251, 268, 285, 295-296, 297-300, 305-306, 384;
  - fitimi maksimal në imperializëm dhe burimet për sigurimin e tij — 62, 67-69, 74-75, 79-81, 88-89, 95-96, 99, 110, 164, 165, 248-249, 297-298;
  - strategjia dhe taktikat e imperializmit, politika e luftës dhe e agresionit, aleancat; përpjekjet për të shkatërruar marksizëm-leninizmin, socializmin, revolucionin dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 4, 6-10, 11-21, 35, 37-38, 40, 46, 49-53, 112-113, 143-144, 242-243, 269-270, 289-291, 295-296, 298-300, 389, 393, 394;
  - lufta e popujve kundër imperializmit — 3-4, 11, 307-308.
- Inteligjencia në vendet kapitaliste; vendi dhe roli i saj në shoqëri* — 87, 185-186.
- Internacionalizmi proletar; përpjekjet e revizionistëve modernë për të shtrembëruar parimin e internacionalizmit proletar* — 77, 119-120, 206-212, 226, 227, 228, 257, 270-271, 274, 389-390.
- Internacionalja e Dytë* — 51, 54-55, 64-65, 108, 110-111,

112, 113, 208, 321, 358.

*Internacionalja e Tretë Komuniste* — 141, 376-378.

*Italia; gjendja e brendshme, politika e jashtme* — 4, 101, 103-104, 124, 130-132, 133, 134.

## J

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë* — 38-39, 42-43;

— zhvillimi i kapitalizmit në Jugosllavi dhe veprimi i ligjeve të tij; depërtimi i kapitaleve të huaja. Vetadministrimi jugosllav — 13, 27, 39-40, 41-45, 46;

— tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit; demagogjia për ndërtimin e socializmit — 38-39, 41-45, 59, 85, 88-89, 129, 279-280, 295;

— revizionizmi jugosllav — agjenturë në lëvizjen komuniste punëtoare dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve; kontradiktat e tij me Bashkimin Sovjetik të kohës së Stalinit — 8, 38, 39-42, 45-46, 137-138, 277-284, 381;

— marrëdhëniet me Kinën,

lidhjet dhe bashkëpunimi me revizionizmin kinez — 33-34, 282-284, 382;

— qëndrimi armiqësor ndaj PPSH — 277, 284.

## K

### *Kapitalizmi*

— forcat prodhuese dhe marrëdhëniet në prodhim — 55-64, 100;

— ligje të zhvillimit të tij; kriza, papunësia, akumulimi kapitalist, mbivlera dhe polarizimi i shoqërisë — 2-3, 4-5, 10, 11, 73-75, 86, 87, 92, 102-104, 124-135, 143, 149-150, 153, 169, 171-172, 178, 216, 221-224, 232-233.

*Shih edhe: Imperializmi* — karakteristika, tiparet.

### *Kina, revizionizmi kinez, socialimperializmi kinez*

— Kina, Partia Komuniste e Kinës; kongreset e saj, vija oportuniste, politika e jashtme koniunkturale dhe pragmatiste — 23, 29-34, 76, 157, 218-219, 244-245, 258-259, 265-266, 273-274, 290, 307-308, 309-313, 318-319, 323-326, 327-337, 339-341, 342-346, 352, 357, 364, 372-383, 387;

- zhvillimi i kapitalizmit në Kinë dhe veprimi i ligjeve të tij. Depërtimi i kapitaleve të huaja — 18, 20, 26-27, 60-61, 88, 89, 140, 294-296, 297-301, 303-305, 326, 348, 365-371;
- gjendja e brendshme; lufta e grupeve për pushtet. Revolucioni Kulturor — 332-335, 369-370, 385-387;
- politika e luftës dhe e agresionit; strategjia e Kinës për t'u bërë superfuqi, rrugët dhe taktikat për t'ia arritur këtij qëllimi — 10, 11, 26-34, 35, 36-37, 140, 282, 288-313, 314, 315, 320-323, 326;
- lidhjet dhe bashkëpunimi me ShBA, me shtetet kapitaliste dhe me klikat reaksionare; kontradiktat me BS — 18-19, 20-21, 23, 27, 28-30, 31, 32, 34, 35, 140, 142-143, 160, 174-176, 181-182, 236, 238-243, 244-251, 265, 266-267, 268-270, 271-273, 291-301, 306-308, 309-313, 320-321, 323-326, 328-329, 335, 390;
- synimet e Kinës në Azinë Afrikë dhe në Amerikën Latine; marrëdhëniet e saj me vendet fqinje*

— 19, 31-32, 324-325;

- marrëdhëniet me Jugosllavinë, lidhjet e bashkëpunimi me revizionistët jugosllavë dhe me partitë revizioniste — 26-27, 33-34, 207, 282-283, 284, 380-383;
- qëndrimi armiqësor ndaj PPSH — 260, 284, 319, 328-329, 330-331, 336.  
*Shih edhe: Teoria e «tri botëve» dhe maoceduni-deja... Imperializmi...*

*Klasa punëtore (proletariati), pozita shoqërore dhe misioni historik i proletariatit — 50-51, 64, 74, 106, 118-120, 125-126, 152-153, 165, 178, 184, 189, 193-194, 196, 219, 220, 222, 223-224, 231, 267, 285, 307-308, 317, 333-334.*

*Shih edhe: Revolucioni...*

*Klasat dhe lufta e klasave*

- lufta e klasave — ligjobjektiv në shoqërinë e ndarë me klasa; e ardhmja e klasave. Klasat dhe lufta e klasave në socializëm — 215-218, 229, 232;
- klasat dhe lufta e klasave në kapitalizëm — 118-119, 126, 131-132, 135, 141, 196, 200-201, 215-217, 221-224, 225-226, 227;
- përpjekjet e borgjezisë

dhe të revizionistëve për të mohuar luftën e klasave — 228-229.

*Kolonializmi, neokolonializmi; thelbi i tij; luftërat e popujve kundër sistemit neokolonial*

— 5, 6, 24-26, 62-63, 73-75, 79-80, 96-97, 145, 147, 152-158, 163-167, 171-170, 231-232, 278.

*Komunizmi* — 14, 215, 356.

*Kontradiktat themelore të epokës*

— kontradikta ndërmjet punës dhe kapitalit — borgjezisë dhe proletariatit — 64, 71-72, 87, 102, 118-119, 188-189, 214-217, 221-224, 227, 254-255;

— kontradikta ndërmjet popujve dhe imperializmit (vendeve neokoloniale dhe metropoleve) — 71-72, 91-92, 94-95, 154-155, 188-189, 227, 254-255;

— kontradikta ndërmjet shteteve kapitaliste, kontradikta ndërimperialiste; kontradikta ndërmjet superfuqive si shprehje e kësaj kontradikte në kushtet e sotme — 10-11, 37, 71-72, 92, 97-98, 127, 160, 188, 235-237, 239-240, 244-251, 254-256, 263-264, 269;

— kontradikta ndërmjet so-

cializmit dhe kapitalizmit — 218-220, 238-239, 254-257, 314;

— qëndrimi i marksistë-leninistëve ndaj kontradiktave të epokës; shfrytëzimi i tyre në interes të revolucionit dhe të socializmit — 2, 92, 155, 234, 240, 243, 251, 255-257, 259-260, 263-264.

*Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve dhe kuptimi i tyre marksist-leninist* — 41, 77, 294-301.

*Kuba — politika hegjemoniste dhe ekspansioniste; vasale e socialimperializmit sovjetik* — 25, 165, 167, 172-174.

## L

*Lenin, Vladimir Il'ic* — 2, 15, 23, 41, 42, 51, 54, 55, 56, 61, 63, 64, 65, 66, 67, 70, 71, 72, 77-78, 79, 89, 90, 92-93, 95, 97, 99, 100, 102, 103, 105, 106, 107, 108-109, 110, 111, 112-113, 114, 117, 119, 120, 121-122, 123, 130, 133, 136, 141-142, 144, 177, 180, 183, 186, 189, 192, 197, 200, 208, 210, 213, 215, 217-218, 220, 227, 228, 229, 232, 235, 236, 237, 239, 248, 250, 251, 252-253, 255, 256-257, 267-263, 277,

278, 302, 316, 317, 321, 328, 332, 339, 352, 353-354, 360, 362, 363, 366, 367, 374, 384, 387, 392, 394.

*Lëvizja komuniste e marksiste-leniniste ndërkombëtare.*

— strategjia dhe taktikat. Qëndrimi i partisë marksiste-leniniste dhe i marksistë-leninistëve ndaj revolucionit — 224-228, 233, 235-236, 237-240, 243, 255-257, 259-260, 264-265, 270-271, 274-275, 321;

— diferencimi në lëvizjen komuniste, lindja e partive të reja marksiste-leniniste. Vija e tyre — 9, 51-53, 219, 341, 373; — lufta e saj kundër imperializmit, borgjezisë dhe revizionizmit — 8, 9, 10, 219-220, 225-228, 236-240, 243-251, 253, 255-257.

*Shih edhe:* Revolucion!

*Lindja e Mesme — ndërhyrja e superfuqive në këtë rajon* — 32, 36, 98, 241.

*Liria, pavarësia, sovraniteti kombëtar; kuptimi i tyre marksist-leninist* — 145, 148-149, 151-152, 167, 230-233, 296, 298-300.

*Lufta e Dytë Botërore (1939—1945)* — 4-5, 19, 93-94, 259-260, 305, 313, 320-321.

*Luftërat, shkaqet dhe shkak-*

*tarët e shpërthimit të luftërave. Luftërat e drejta dhe të padrejta* — 12-13, 35-37, 90, 127-128, 262, 309-313, 315, 317;

— qëndrimi i marksistë-leninistëve ndaj luftërave; kthimi i luftës imperialiste në revolucion — 37, 208, 315-317, 318;

— qëndrimi i oportunistëve dhe i revizionistëve ndaj luftës — 208, 209, 315, 317-318, 321.

## M

*Marksizëm-leninizmi — bu-sull dhe udhëheqje për vep- rim; karakteri krijues, vitaliteti i tij* — 2-4, 7, 51-53, 120, 179, 184, 205, 215, 219, 233, 387, 389, 394-395;

— përpjekjet e borgjezisë dhe të revizionizmit për të shtrembëruar dhe mohuar marksizëm-leninizmin — 1-3, 4, 49-50, 205-206, 213, 234-235, 275, 277.

*Marks, Karl* — 2-3, 50, 70, 102, 105, 106, 108, 113, 117, 120, 177, 197, 201, 213, 214-215, 217, 219, 220, 220, 235, 251, 277, 278, 302, 332, 339, 352, 360, 362, 384, 387, 392, 394.

*Mbështetja në forcat e veta* —  
76-77, 286.

## N

*NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)* —  
6, 13, 16, 17, 19, 20, 32, 35,  
127, 142, 182, 209, 242, 246,  
279, 311, 321.

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri*

- zhvillimi dhe konsolidimi i shoqërisë socialiste
- 296-297, 362, 390-391.

## O

*Oportunizmi, revizionizmi modern, partitë revizioniste; agjentura dhe shërbëtorë të imperializmit; strategjia e tyre* — 8, 9, 10, 11, 37-38, 39, 47-53, 54-55, 102-103, 107-114, 129-130, 132-144, 168, 181-182, 193-194, 205-211, 219, 228-229, 230, 235, 260, 275, 277, 358-359, 394-395.

*Organizatat e masave në kapitalizëm; sindikatat, tredunionet* — 48-49, 70, 137, 191-195.

## P

*Partia e Punës e Shqipërisë*  
— karakteristikat e Partisë,

besnikëria e saj ndaj marksizëm - leninizmit, mbrojtja dhe zbatimi krijues i tij — 1-2, 23, 228, 362-363, 389, 391-392, 395;

- trajtimi materialist dialektik i fenomeneve të shoqërisë, analiza marksiste-leniniste e situatës ndërkombëtare — 1-2, 123-124, 251-252, 255-257, 262-263, 392-395;
- politika internacionaliste, përkrahja për revolucionin dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 228, 231-232, 257-259, 260, 261, 262, 265, 270-272, 236-287;
- lufta e saj kundër imperializmit, revizionizmit, borgjezisë dhe reaksionit — 1-2, 236, 247-248, 261, 270-272, 286-287, 319, 394-395;
- demaskimi i revizionizmit jugosllav dhe sovjetik — 9-10, 23, 204, 314;
- qëndrimi ndaj Kinës dhe PK të Kinës, demaskimi i revizionizmit kinez — 275, 328-337, 379, 387-388, 390-391, 392;
- rritja e prestigjit të PPSH — 286-287, 389-390, 391, 392.

*Partia Komuniste e Indisë, e Indonezisë dhe e Greqisë* — 161, 362.

*Partia Komuniste (revizioniste) e Italisë, e Francës dhe e Spanjës* — 47, 132, 134, 135, 181.

*Politika e jashtme e RPSSH*

— parimet themelore të politikës së jashtme — 226-227, 255, 257-258, 285-286;

— përkrahja dhe qëndrimi parlamentar marksist-leninist ndaj lëvizjeve dhe luftërave nacionalçlirimtare të popujve — 148, 228, 231-232, 260-261.

*Propaganda dhe shtypi borçjezo-revizionist* — 6-8, 21, 41-42, 72, 76, 104, 126, 141, 199, 207-208, 244-245, 260, 266, 271, 291, 300, 303, 318-319, 331, 334-335, 337-338, 343-344, 345, 354, 369.

*Propaganda dhe shtypi marksist-leninist* — 198-200.

## R

*Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917)* — 3, 4, 137, 365, 384.

*Revolucioni popullor në Shqipëri* — 190, 361-362.

*Revolucioni proletar socialist*

*dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve*

— pashmangësia e revolucionit, karakteri, detyrat, strategjia dhe taktikat e tij — 11, 49, 50-53, 55, 104-105, 106, 107, 145-148, 176-177, 178-179, 182, 214-215, 218-220, 225-228, 231-233, 266-267, 355, 387, 393, 395;

— revolucioni dhe çlirimi i popujve — çështje e shtruar për zgjidhje — 114-120, 123-137, 146, 160-163, 167, 169-171, 188-189;

— faktori objektiv — situata revolucionare, faktori subjektiv; faktori i brendshëm dhe i jashtëm në revolucion. Trajtimi konkret historik — 119-120, 121-137, 143-144, 146-147, 148-151, 154, 155, 167-168, 169, 170, 176, 189, 198, 227;

— forcat lëvizëse dhe aleancat në revolucionin socialist dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 118-120, 177, 185-188, 189-190, 360-362;

— roli hegjemon i proletariatit në revolucionin socialist dhe në luftërat nacionalçlirimtare — 106,

- 107, 118-120, 170-171, 176-177, 183-188, 189, 220-224, 227-228, 267, 359, 361-363;
- roli udhëheqës i partisë marksiste-leniniste në revolucionin socialist, strategjia dhe taktikat e saj; puna me masat; puna legale dhe ilegale; aleancat — 106, 107, 118-120, 122-123, 171, 178-180, 182, 185-188, 189, 191-196, 199, 200-201, 202-203, 206, 211-212, 223, 274-275, 276, 349-350, 362-363;
  - roli i partisë marksiste-leniniste në luftërat nacionalçlirimtare dhe në revolucionet demokratike, aleancat e saj me partitë borgjeze dhe roli i saj në këto aleanca — 158, 162, 176-177, 179-180, 186-188, 204-205, 206, 270-271, 274-275;
  - revolucioni me dhunë si kusht për kalimin nga kapitalizmi në socializëm; kryengritja e armatosur — 196-198;
  - çështja e pushtetit — çështje themelore e çdo revolucioni; shkatërrimi i aparatit të vjetër shtetëror dhe vendosja e diktaturës së proletariatit — çështje themelore e revolucionit socialist — 180, 184-185, 219;
  - luftërat nacionalçlirimtare dhe çlirimi kombëtar i popujve — pjesë përbërëse e revolucionit proletar. Teoria leniniste për shndërrimin e revolucionit demokratik në revolucion socialist — 84, 95, 144-170, 180, 227, 231-233, 285-288, 287-288, 307-308, 357-359, 367;
  - ligjet e revolucionit; teoria dhe praktika leniniste e revolucionit proletar; propaganda dhe aksioni revolucionar — 3-4, 51-53, 117-118, 119-120, 121-123, 136-137, 141-142, 144-145, 196-197, 198-201, 202, 205, 206, 227;
  - përpjekjet e borgjezisë, të revizionizmit dhe të reaksionit për të penguar revolucionin — 47-53, 119, 120, 130-144, 169-170, 171-176, 213, 224-228, 232, 393.

## 8

*Socializmi, sistemi socialist; lufta e imperializmit, e bor-*



*gjezisë dhe e revizionizmit kundër tij* — 4, 7-10, 76-77, 104-105, 117-118, 119, 215-216, 217, 232-233, 255-257, 284-285, 296, 296-297, 356.

*Spanja; gjendja e brendshme* — 134-135.

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 2, 3, 7, 8, 15, 21, 35-36, 38-39, 41, 42, 106, 110, 120, 144, 145, 177, 182, 189, 190-191, 197, 213, 215, 217-218, 235, 237, 251, 259, 260, 277, 278, 321, 332, 339, 341, 350, 352, 362, 374, 375-376, 382, 384, 386, 387, 392, 394.

*Superfuqitë; politika hegjemoniste dhe ekspansioniste, aleancat dhe rivaliteti ndërmjet tyre. Përpfjekjet për zona influence* — 10-11, 17, 26, 29, 34-37, 78, 97-98, 111, 127-128, 238-237, 238-240, 243, 244-245, 246, 247, 271-272, 284-285, 289, 389.

## SH

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës; gjendja e brendshme* — 69-70, 223-224;

— *Imperializmi amerikan* — kreu i imperializmit botëror; strategjia globale e tij, politika e luftës, e agresionit dhe e sundimit

— 5-6, 7, 11-20, 23-21, 28-30, 34-37, 73-74, 81-86, 157-158, 160, 162, 163-164, 168, 169, 175, 239, 241, 242-243, 244, 246-247, 276, 284, 289, 305-306, 320;

— *lichjet, bashkëpunimi me revizionistët kinezë dhe jugosllavë* — 17-18, 29-31, 40, 138, 281, 292-301, 312-313;

— *lufta e tij kundër marksizëm-leninizmit, socializmit dhe luftërave nacionalçlirimtare; disfatat në Vietnam* — 6-8, 11-17, 158-159;

— *marrëdhëniet, blloqet dhe aleancat me shtetet e tjera kapitaliste* — 6-7, 13-14.

*Shteti borgjez* — 62, 71.

## T

*Teoria e «tri botëve» dhe maocedunideja* — *thelbi i tyre antimarksist* — 32-33, 81-92, 106-107, 116, 196, 213-214, 216-217, 249, 275-276, 282, 315, 318, 327-328, 336, 337-339, 383-385, 387;

— *koncepti «botë e parë», «botë e dytë», «botë e tretë»;* pikëpamja për aleancën e «botës së tre-

- të» me «botën e dytë» dhe me gjysmën e «botës së parë» kundër gjysmës tjetër — 216-217, 220-223, 224-227, 228-230, 235, 249-251, 264, 266, 268-269, 270, 292, 301-304, 306-308, 360;
- mohimi i kriterit klasor në ndarjen e shoqërisë, i klasave dhe i luftës së klasave; qëndrimi ndaj borgjezisë — 216-217, 221-227, 229-230, 329-330, 340-342, 363, 365-371;
  - mohimi i teorisë leniniste për karakterin e epokës sonë, i kontradiktave themelore të epokës dhe i forcës kryesore lëvizëse të saj. Koncepti për «botën e tretë» si forcë kryesore lëvizëse e epokës — 113-114, 216-224;
  - pikëpamja për forcat lëvizëse në revolucion; mohimi i rolit hegjemon të proletariatit, mbivlerësimi i rolit të fshatarësisë. Teoria «fshati të rrethojë qytetin», «fshati botëror të rrethojë qytetin botëror» — 184, 197, 220-224, 329-330, 332-333, 357, 359-360, 361;
  - mohimi i rolit të partisë proletare dhe i karakterit klasor të saj; pluralizmi politik dhe ideologjik — 332-333, 339-349, 350-352;
  - trajtimi idealist, metafizik, eklektik i kontradiktave, i aleancave, i kompromiseve, i zhvillimit dhe i revolucionit — 140-143, 147, 229-230, 234-235, 243-244, 254, 258-259, 260, 261-262, 264, 266-267, 268-270, 319-323, 329-330, 352-357, 367-370;
  - mohimi i kontradiktës ndërmjet socializmit dhe kapitalizmit, mohimi i socializmit dhe i sistemit socialist — 218-219, 225-226, 238;
  - mohimi i kontradiktave dhe i aleancave ndërimperialiste; teoria e tyre e mbështetjes në një imperializëm për të luftuar tjetrin — 17, 108-110, 111-112, 113-114, 216-217, 235-237, 238-251, 261-262, 330, 335-336;
  - pikëpamja për shndërrimin e revolucionit demokratik në revolucion socialist; revolucionin në Kinë, karakteri i tij — 356-360, 363-372;
  - mohimi i Internacionalizmit proletar; qëndri-

met shoviniste, ksenofobe dhe nihiliste — 372-380;

- qëndrimi ndaj marksizëm-leninizmit, roli sabotues në revolucion dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 10, 76, 140-143, 159-160, 161-162, 174-176, 181-182, 207-208, 210-211, 217, 218-219, 224-227, 229-230, 234-235, 248-249, 251, 260, 261-262, 265, 266-267, 268-270, 271-273, 288, 302, 306-308, 314, 315, 317-318, 322, 334-335, 337-338, 339, 352, 366-367, 374, 375-376, 377-380, 381-382, 383;

- teoria për luftën popullore — mohim i kryengritjes së armatosur; qëndrimi ndaj ushtrisë — 197-198, 346-348.

*Teoritë dhe pikëpamjet borjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre* — 128-129, 136, 162, 181, 230, 389;

- teoritë për ndryshimin e natyrës së imperializmit. Shtrembërimi i teorisë leniniste mbi imperializimin — 11-17, 54-55, 64-65, 70-71, 98-99, 105, 107-114, 115-116;

- teoritë e revizionistëve

sovjetikë për «bashkekzistencën paqësore», për «rrugën paqësore për në socializëm» dhe për «partinë e gjithë popullit» — 22-23, 24, 26, 138-140, 183-184, 314-315;

- teoria e revizionistëve jugosllavë e «vendeve të paangazhuara» dhe për rrugën paqësore për në socializëm — 33, 114, 116, 137-138, 276, 277-283;

- mohimi i proletariatit dhe i rolit të tij hegjemon — 183-184;

- teoritë e eurokomunistëve; teoria e «kompromisit historik», e rrugës parlamentare për në socializëm — 47, 132-134, 136;

- teoria e «vendeve në zhvillim» — 285.

*Traktati i Varshavës* — 21, 127, 279, 322.

*Tregu i Përbashkët Evropian* — 11, 20, 32, 61, 72, 91, 127, 131, 142, 182, 209, 242, 246, 248-249, 298, 319, 321.

## U

*Ushtria në vendet borjezo-revizioniste* — 103-104.

## V

*Vendet arabe; gjendja e bre-  
ndshme, lufta e tyre kundër  
Izraelit dhe superfuqive —  
148, 149-151.*

*Vendet kapitaliste — 5, 84,*

201-202, 221, 230, 244, 249-  
-251, 280-282, 307-308, 310-  
-311.

*Vendet revizioniste; zhvillimi  
kapitalist i tyre. Kontradiktat  
me BS — 63, 69, 76, 80, 87, 88,  
129, 188-189, 240-241.*

## TREGUESI I ENRAVE

### B

- Berlinguer, Enriko — 132, 133,  
134, 181.  
Bernshtajn, Eduard — 103.  
Bijediç, Xhemal — 382.  
Bonaparti, Napoleon — 311  
Brauder, Èri — 39, 260.  
Brezhnjev, Leonid — 46, 333,  
386.  
Buto, Zylfikar Ali — 272, 273,  
274.

### Ç

- Çan Kai Shi — 157, 292, 351,  
365, 369, 373, 382.  
Çërcill, Uinston — 40, 41.  
Çian Çin — 338.  
Çu En Lai — 33, 241, 290, 312,  
335, 347, 364-365, 371, 374,  
376.

### F

- Fanfani, Amintore — 133.

- Franko, Françisko — 15, 125,  
187.

### G

- Gandì, Indira — 272, 274.  
Gën Biao — 378.

### H

- Hasani H — 175.  
Hilferding, Rudolf — 103.  
Hirohito — 15.  
Hitler, Adolf — 15, 19, 157,  
259, 320-321, 392  
Hith, Eduard — 312.  
Hrushov, Nikita — 8, 21, 105,  
234, 314, 318, 375, 386.  
Hua Kuo Fen — 33, 34, 46, 207,  
244, 282-293, 284, 312, 315,  
332, 344, 345, 348, 379, 382-  
-383, 385, 389.  
Huan Hua — 174.

### I

- Ibarruri, Dolores — 135, 131.

**J**

Jeh Çien Jin — 348, 385.

**K**

Kao Gan — 365.

Karlos, Huan — 135, 181.

Karter, Xhimi — 13-16, 17,  
28-29, 30, 36, 46, 281, 294, 312.

Karriljo, Santiago — 125, 181,  
277, 383.

Kautski, Karl — 55, 108, 109,  
110, 112, 142.

Konfuci — 351, 385.

**L**

Lao Ce — 351.

Leone, Xhovani — 131.

Levinson, Karl — 63.

Li Da Çao — 372-373.

Li Hsien Nien — 294.

Lin Biao — 332, 345, 347, 365.

Liu Shao Çi — 334, 345, 347,  
365, 373, 386.

Lumumba, Patris — 174.

**M**

Mao Ce Dun — 33, 197, 193,  
313-214, 216, 222, 223, 211,  
254, 265, 275, 293, 295, 302,  
312, 314, 315, 318, 320, 327.

328-329, 330, 331, 333, 334,  
335, 336, 337-339, 340, 341,  
342, 343-348, 349, 250, 351,  
352, 353, 354-361, 364, 365-  
-370, 371, 372, 373, 374-375,  
376, 377, 378, 382, 383-384,  
385, 386, 387.

Marshall, Xhorxh — 293.

Marshe, Zhorz h — 210.

Menci — 385.

Mikojan, Anastas — 284.

Mobutu, Sese Seko — 174, 227,  
271, 274.

Moro, Aldo — 131.

Mosadek, Mohamed — 83.

Musolini, Benito — 15, 187.

**N**

Nehru, Xhavaharlal — 272.

Neto, Agostino — 173, 174, 271.

Nikson, Riçard — 312, 335.

**O**

Ouen, Xhofrej — 81, 82-83, 84,  
85.

**P**

Pinoçet, Augusto — 175, 227,  
246, 325.

Pu Ji — 369.

**R**

Rahman, Muxhibur — 272-273.  
 Rankoviç, Aleksandër — 43.

365, 373, 379, 385, 386, 387.  
 Tito, Josip Broz — 33, 34, 38,  
 39, 40-41, 42, 43, 279, 280,  
 281, 282, 283-284, 375, 332,  
 383.  
 Toliati, Palmiro — 134.

**S**

Sadat, Anvar el — 261.  
 Serrati, Xhaçinto Menoti —  
 141.  
 Snou. Edgar — 293, 349.  
 Sun Jat Sen — 328.

**T**

Ten Hsiao Pin — 207, 246, 275,  
 282-283, 284, 294, 309, 311,  
 315, 332, 334, 345-346, 347,

**V**

Vandemejer, Albert — 293.  
 Van Min — 375.  
 Van Tun Hsin — 318.  
 Vens, Sajrus — 246.  
 Vilhelmi II — 321.

**X**

Xoxe, Koçi — 43.





## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA

### A

- AFP (Agjencia Franceze e Shtypit) — 311.  
Afrika e Jugut — 155-156.  
Algjeri — 93, 95, 151, 324.  
Amerikë (kontinenti ~) — 298.  
Angolë — 25, 173-174, 242, 271, 272.  
Arabia Saudite — 32, 78-79, 151.  
Argjentinë — 165.  
ASEAN (Organizata e vendeve të Azisë Juglindore) — 18, 31.  
Australi — 18, 320.  
Austri — 259.  
Azia Juglindore — 18, 36, 157.

### B

- Balkan (zona ~) — 244.  
Bashkimi Jugafrikan — 102.  
Belgjikë — 62, 153, 156, 307.  
Beograd — 284.  
Birmanë — 159.  
Bolivi — 165, 169.

Brazil — 165, 169.

Briiri i Afrikës — 128.

Britania e Madhe — 4-5, 20-21, 40, 57, 58, 66, 70, 73, 78, 88, 90-91, 93, 101, 124, 136, 153, 156, 192, 216, 249, 250, 260, 289, 292, 295, 305-306, 307, 320.

Buligari — 240.

Burundi — 216.

### Ç

Çekosllovakia — 59, 88, 240, 241, 250.

### D

Deti i Kuq — 242.

«Dështimi i Internacionales së Dytë» (V. I. Lenin, artikulli ~) — 121.

Dominikë [Republika Dominikane] — 165.

### E

Egjypt — 151, 152, 261.

Ekuador — 165.

Emiratet e Bashkuara Arabe  
— 79.

ENI (Enti Kombëtar për Hidrokarburet) — 297.

Eritre — 323.

Etiopi — 25, 98, 242, 323, 324.

Evropë, Evropa Perëndimore,  
«Evropa e Bashkuar» — 17,

32, 35, 80, 82, 84, 183, 242,

244, 248, 250, 263, 269, 290,

298, 304, 309, 310, 311, 319,

320, 321.

## F

Filipine — 159, 218.

«Ford» (shoqëria shumëkombëshe ~) — 82, 85.

Francë — 5, 20-21, 58, 68, 71,  
73, 83, 90-91, 93, 95, 101, 124,

131, 135-136, 153, 156, 175,

193, 216, 249, 250, 260, 289,

295, 305-306, 307, 320, 381.

## G

Greqi — 7, 362.

Guomindan (Partia Nacionaliste, Kinë) — 328, 355.

## GJ

Gjermania Lindore (RD Gjermane) — 240.

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 4, 20-21, 23,

57, 58, 68, 70, 71, 73, 88, 93,

101, 124, 131, 216, 249, 250,

292, 295, 307.

Gjiri Persik — 151, 161.

## II

Haiti — 165.

Holandë — 62, 78.

Hong-Kong — 72, 293-294, 304.

Hungari — 240.

## I

«Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit» (V. I. Lenin, vepra ~) — 54, 55, 57, 117.

Indi — 31, 32, 60, 161, 216, 272.

Indokinë — 94, 128, 158.

Indonezi — 159.

«Intërnëshënjll Biznes Mëshin» (korporata ~) — 85.

Irak — 80, 151.

Iran — 32, 78.

Izrael — 13, 101, 261, 262, 324.

## J

Jance (lumi ~) 89.

Japoni — 4, 18, 19, 28, 31, 57,

58, 66, 73, 85, 93, 124, 136,  
160, 244, 249, 250, 292, 294,  
295, 296, 297-298, 307, 313.

«Junajtid Stejts Still Korpë-  
rejshën» (shoqëria ~) — 57.

## K

Kambohia — 98, 162, 241,  
324, 325.

Kanada — 82, 84, 244.

«Kapitali» (K. Marks, vep-  
ra ~) — 70.

Katanga (Zaire) — 174.

Kili — 101, 165, 169.

KNER (Këshilli i Ndhmës  
Ekonomike Reciproke) — 24,  
61, 72, 88, 91, 127, 249, 322.

Kolumbi — 165.

Komuna e Parisit (18 mars  
1871 — 28 maj 1871) — 219.

Kongresi i Vjenës (shtator  
1814 — qershor 1815) — 311.

Kore — 7, 158, 241, 257, 324.

Koreja e Jugut — 101, 294.

Kosta-Rikë — 62.

«Krajsler» (shoqëria ~) —  
85.

Kuvajt — 79.

## L

Laos — 162, 241, 324.

Libi — 151, 152.

Lindja e Largme — 18, 157,  
311.

Londër — 72.

## M

Makao — 72, 293-294.

Malajzi — 159.

«Manifesti i Partisë Komuni-  
ste» (K. Marks—F. Engels, ve-  
pra ~) — 113, 120.

Marok — 93, 151, 174, 324.

Mauritani — 151, 324.

Mbledhja e partive komuniste  
e punëtores në Moskë (1957)  
— 375.

Meksikë — 165, 169.

Mesdhe (deti ~) — 242.

Mongoli — 18.

«Monro» (doktrina ~) — 163-  
-164.

Moskë — 335.

## N

NEP (Politika e Re Ekonomi-  
ke) — 366, 367.

## O

OPEK (Organizata e Vendeve  
Eksportuese të Naftës) — 14,  
91.

Oqeani — 18, 31.

Oqeani Indian — 161, 242, 294.  
Organizata e Shteteve Ameri-  
kane — 168.

## P

Pakistan — 32, 216, 272, 273.  
Pakistan Lindor [Bangladesh]  
— 272-273.  
Paris — 72.  
Pekin — 233, 234, 293, 333, 379,  
386.  
«Plani Marshall» — 80.  
POLISARIO (fronti ~) —  
324.  
Poloni — 88, 240.  
Portugall — 136, 153.  
«Pravda» (gazeta ~) — 244-  
-245.

## R

Rodezi — 101-102.  
Rumani — 240, 244.  
Rusi — 122, 136.

## S

Saharaja Perëndimore — 128.  
SALT (Traktati për Kufizi-  
min e Armëve Strategjike) —  
17.  
SEATO (Organizata e Trakta-

tit për Azinë Juglindore) —  
6.

«Sëmundja foshnjore e «maj-  
tizmit» në komunizëm» (V. I.  
Lenin, vepra ~) — 121.  
Siberi (BS) — 18, 311.  
Singapor — 72.  
Siri — 151.  
Skandali «Lokhid» — 63.  
«Sokoni Mobil» (korporata ~)  
— 81.  
Somali — 93, 323, 324.  
«Stëndërd Oil ov Nju Xhërsi»  
(monopoli ~) — 57, 81.

## T

Tajlandë — 324.  
Tajvan — 293-294.  
Tibet (Kinë) — 32.  
Tiranë — 376.  
Tokio — 298.  
Traktati (marrëveshja) i My-  
nihut (shtator 1938) — 259.  
Traktati (pakti) i mossulimit  
sovjeto-gjerman (gusht 1939)  
— 259.  
Tunizi — 93, 151, 152.

## U

«Uashington post» (gazeta ~)  
— 293.  
UDB (Drejtoria e Sigurimit  
Shtetëror, Jugosllavi) — 43.  
Urugual — 165, 169.

**V**

shën\* (trusti ~) — 57, 62, 65.

Vatikan — 134.

Venezuelë — 165, 169.

Vietnam — 7, 95, 98, 158-159,  
162, 241, 257, 324, 325.

**XII**

\*Xhenërëll Illektrik\* (shoqë-  
ria ~) — 85.

\*Xhenërëll Motërs Korpërej-

**Z**

Zaire — 174, 216, 271, 272.

Zvicër — 62.

Zurih (Zvicër) — 72.

**ZII**

\*Zhenminzhibao\* (gazeta ~)  
— 245, 295, 343, 344, 345.



## LE N D A

	Faqe
PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 65-TË .....	V—VII
PARATHËNIE PËR BOTIMIN E PARË TË LIBRIT «IMPERIALIZMI DHE REVOLUCIONI» .....	IX—XII
SHËNIM PËR BOTIMIN E DYTË .....	XIII

## PJESA E PARË

### I

STRATEGJIA E IMPERIALIZMIT DHE E REVIZIO- NIZMIT MODERN .....	1—53
— STRATEGJIA E IMPERIALIZMIT BOTËROR	11
— STRATEGJIA E SOCIALIMPERIALIZMIT SOVJETIK .....	21
— STRATEGJIA E SOCIALIMPERIALIZMIT KINEZ .....	26
— ROLI I TITIZMIT DHE I RRYMAVE TË TJERA REVIZIONISTE NË STRATEGJINË GLOBALE TË IMPERIALIZMIT E TË SO- CIALIMPERIALIZMIT .....	37
— REVOLUCIONI — ARMA E VETME PËR TË SHKATËRRUAR STRATEGJINË E ARMIQ- VE TË PROLETARIATIT DHE TË POPUJVE	49

## II

TEORIA LENINISTE MBI IMPERIALIZMIN MBE- TET GJITHINJË AKTUALE .....	54—116
--	--------

## III

REVOLUCIONI DHE POPUJT .....	117—212
— TË MBROJMË E TË ZBATOJMË MËSIMET MARKSISTE-LENINISTE MBI REVOLUCIO- NIN .....	121
— LUFTA ÇLIRIMTARE E POPUJVE — PJESË PËRBËRËSE E REVOLUCIONIT BOTËROR .....	144
— REVOLUCIONARËT E VËRTETË U BËJNË THIRRJE PROLETARËVE E POPUJVE TË NGRIHEN PËR BOTËN E RE, PËR BOTËN SOCIALISTE .....	178

## PJESA E DYTË

## I

TEORIA E «TRI BOTËVE» — TEORI KUNDËRRE- VOLUCIONARE DHE SHOVINISTE .....	213—287
— KONCEPTI MBI «TRI BOTËT» — MOHIM I MARKSIZËM-LENINIZMIT .....	214
— QËNDRIMI I REVIZIONISTËVE KINEZË NDAJ KONTRADIKTAVE ËSHTË NJË QË- NDRIM IDEALIST, REVIZIONIST E KAPI- TULLANT .....	233
— PIKËPAMJA KINEZE MBI UNITETIN E «BOTËS SË TRËTË» ËSHTË REAKSIONARE .....	260



— TEORIA KINEZE MBI «BOTËN E TRETË» DHE TEORIA JUGOSLLAVE MBI «BOTËN E PAANGAZHUAR» SABOTOJNË LUFTËN REVOLUCIONARE TË POPUJVE .....	275
--	-----

## II

PLANI I KINËS PËR TË BËRË SUPERFUQI .....	288—326
---	---------

## III

MAOCDUNIDEJA — TEORI ANTIMARKSISTE .....	327—388
MBROJTJA E MARKSIZËM-LENINIZMIT — DE- TYRË E MADHE PËR TË GJITHË REVOLUCIONA- RËT E VËRTETË .....	389—395
Treguesi i lëndës .....	397
Treguesi i emrave .....	413
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	417